



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



RAPORT VJETOR

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit

1 Janar - 31 Dhjetor
Viti 2012

Tiranë, Shkurt 2013

**E nderuar Zj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar deputetë,**

Në mbështetje të nenit 63 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 të Ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”, kam nderin që, në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, t’ju paraqes raportin për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2012.

**Me respekt,
AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI**

PËRMBAJTJA

Prezantim i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2012	7
---	---

KREU I:

1. Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri	9
2. Përmbledhje e Raporteve të Veçanta drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.....	29
3. Kontributi i Avokatit të Popullit për procesin e Integritimit European	39
4. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit të pranuar nga institucionet e administratës publike	43

KREU II

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndarë sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore....	49
--	-----------

A. Barazia përpara ligjit dhe ndalimi i diskriminimit.....	49
B. E drejta për informim.....	54
C. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë.....	57
D. Kufizime të lirisë së personit	59
- Veprimtaria e Policisë së Shtetit.....	59
- Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura.....	87
E. Çështje të administrimit të drejtësisë	89
- E drejta për një proces të rregullt ligjor	89
- Intitucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor.....	89
- Veprimtaria e Prokurorisë	94
- Veprimtaria e Zyrave të Shërbimit Përmbartimor Shtetëror	102
- Ndihma ligjore falas	107
F. E drejta e Pronës	107
G. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës	120
H. E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore	129
I. E drejta për arsimim.....	133
J. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim	137
K. Ndihma ekonomike	146
L. Mbrojtja e konsumatorit	150
M. E drejta për kujdes shëndetësor	161
N. Synimi për një mjedis të shëndetshëm	167
O. Problematikat e pushtetit vendor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve të tij	169

P. Trajtimi i ankesave të të përndjekurve politikë	177
Q. Veprimtaria e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës	185

KREU III

Marrëdhëniet me publikun dhe bashkëpunimi	212
1. Pritja e qytetarëve.....	212
2. Veprimtaria e Zyrave Rajonale dhe “Ditët e Hapura”	214
3. Marrëdhëniet me median	221
4. Komunikimi nepërmjet faqes zyrtare të web-it dhe medias sociale	227
5. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse.....	231
6. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare	238

KREU IV

Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit	246
1. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit dhe reformimi i saj gjatë vitit 2012	246
2. Buxheti i Institucionit për vitin 2012	252
3. Statistika përmbledhëse e vitit 2012	252

Prezantim i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2012

Në hartimin e këtij Raporti Vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, jemi bazuar në punën tonë gjatë vitit 2012. Ajo është drejtuar nga vizioni për një shoqëri që udhëhiqet nga principet e të drejtave të njeriut, në të cilën institucionet shtetërore veprojnë në mënyrë transparente, të drejtë, të përgjegjshme dhe efektive.

Shpresojmë që ky Raport dhe informacioni i përfshirë në të, mbi situatën e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, të jetë i jetë i vlefshëm si për anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë dhe organet e administratës publike, ashtu dhe për organizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, institucione homologe në rajon e më gjerë, institucione arsimore, median dhe publikun.

Disa pjesë të raportit mund të kenë më shumë interes për ju se të tjerat, e prandaj sugjerojmë leximin e kësaj hyrjeje për t'ju ndihmuar të kuptoni në cilat pjesë ju do të gjeni saktësisht informacionin e kërkuar. Kështu, raporti është ndarë në katër krerë, si në vijim:

Në **Kreun e parë**, nëpërmjet opinioneve dhe rekomandimeve të paraqitura synojmë të reflektojmë mbi çështjet më të rëndësishme të prezantuara gjatë vitit 2012 në punën e institucionit nëpërmjet ankesave, takimeve me qytetarë, inspektimeve, etj., si dhe të prezantojmë rekomandimet tona për ndërhyrje dhe përmirësime në standardet e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Një prezantim përmbledhës i është bërë dhe shtatë raporteve të veçanta të përgatitura nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012, të cilat synojnë të sjellin në vëmendje të Kuvendit dhe Ekzekutivit probleme dhe tematika emergjente që janë gjykuar prej institucionit se kanë nevojë për t'u adresuar më mirë prej organeve shtetërore, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor ose përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Krahas mbrojtjes të së drejtave të qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të administratës publike dhe promovimit e përmirësimit të standardeve të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka një rol thelbësor në procesin e Integritimit European në vend. Në këtë këndvështrim, në vijim, është paraqitur një analizë e kontributi i Avokatit të Popullit për procesin e Integritimit European.

Një risi e këtij viti, e bazuar dhe në kërkesën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me Rezolutën "Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011", dt.14.06.2012, ka qenë zhvillimi i një studimi nga ekspertë të pavarur për monitorimin

e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të pranuar të Avokatit të Popullit nga institucionet e administratës publike.

Kreu i dytë është një prezantim më i detajuar i problematikave dhe i punës së institucionit të Avokatit të Popullit në trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave,- i ndarë sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore. Kjo pjesë e raportit ofron studime të rasteve konkrete, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së dhënë dhe gjithashtu prezanton punën e institucionit për venien në vend të një të drejte të shkelur, apo të mohuar nëpërmjet rekomandimeve konkrete drejtuar institucioneve shtetërore.

Dhënia e kontributit në krijimin e një kulture të të drejtave të njeriut në Shqipëri, kërkon pjesëmarrje aktive në zhvillimin e mëtejshëm të axhendës së të drejtave të njeriut, rritje të njohurive dhe vetëdijes së publikut rreth të drejtave të njeriut, dhe bashkëpunim të ngushtë me median, shoqërinë civile dhe institucionet ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit.

Bazuar në këtë bindje, **Kreu i tretë** paraqet një pasqyrë të përgjithshme të bashkëveprimit me publikun, si dhe bashkëpunimit të institucionit me partnerë të ndryshëm të shoqërisë civile, të medias dhe partnerë ndërkombëtarë, të dedikuar ndaj standardeve të të drejtave të njeriut.

Kreu i fundit përfshin një informacion me të dhëna statistikore si për veprimtarinë gjatë 2012, por gjithashtu dhe të dhëna mbi strukturën re të institucionit dhe shpenzimet financiare.

KREU I:

I. Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri

Avokatit i Popullit është i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ai është konceptuar si një institucion që vepron si mbrojtës i qytetarëve në marrëdhëniet e tyre me organet e administratës publike. Avokati i Popullit synon gjithashtu krijimin dhe zhvillimin e një kulture të qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike në raport me qytetarët shqiptarë, si dhe forcim të përgjithshëm të shtetit ligjor, elementë këto të domosdoshëm për funksionimin e demokracisë dhe integrimin në Bashkimin Europian.

Në punën tonë kemi konstatuar se krijimi i një kulture të të drejtave të njeriut në Shqipëri, kërkon pjesëmarrje aktive dhe bashkëpunim të ngushtë me organet e administratës publike, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, qarqet akademike e median, si dhe rritje të njohurive dhe vetëdijes së publikut rreth të drejtave të tyre. Ne, tashmë, bashkëpunojmë me partnerë të ndryshëm, qeverinë qendrore e vendore, shoqërinë civile, median dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët janë, si edhe ne, të përkushtuar për arritjen e standardeve të të drejtave të njeriut.

Duhet theksuar dhe përgëzuar roli thelbësor e i pazëvendësueshëm i shoqërisë civile në vend, veçanërisht në evidentimin e problemeve, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Ndërhyrja e këtyre aktorëve gjatë vitit 2012 ka qenë me rëndësi të veçantë në adresimin e një sërë çështjesh të lidhura me minoritetin rom, çështjet gjinore, fëmijët në nevojë, komunitetin LGBT, personat me nevoja të veçanta, personat dhe familjet e prekura nga fenomeni i gjakmarrjes, burgjet dhe policinë, etj. Për këtë arsye, ne e konsiderojmë thelbësor fuqizimin e bashkëpunimit me këta partnerë, si dhe krijimin e marrëdhënieve të reja me aktorë të tjerë. Vetëm duke punuar së bashku dhe duke qenë sa më gjithëpërfshirës ndaj grupeve të ndryshme të shoqërisë, zëri ynë dhe i qytetarëve të cilëve u shërbejmë do të bëhet më i besueshëm dhe i fuqishëm, dhe do të nxisë më tej zhvillimin e axhendës të së drejtave të njeriut në Shqipëri.

Në këtë kuadër, në këtë pjesë të raportit të paraqitur në vazhdim, synojmë të reflektojmë mbi çështjet më të rëndësishme të prezantuara gjatë vitit 2012 në punën e institucionit nëpërmjet ankesave, takimeve me qytetarë, inspektimeve, etj., si dhe të prezantojmë rekomandimet tona për ndërhyrje dhe përmirësime në standardet e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Besojmë që ky informacion mbi situatën e të drejtave të njeriut në vend të jetë i vlefshëm si për anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë dhe organet e administratës publike, ashtu dhe për organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, median dhe publikun. Avokati i Popullit është një institucion i pavarur e i paanshëm dhe detyra e tij është të japë një paraqitje

reale dhe transparente të konstatimeve dhe gjetjeve. Në anën tjetër, detyrë e tij është edhe dhënia e opinionëve dhe rekomandimeve të tij për përmirësimin e të drejtave të njeriut në vend.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor në fuqi, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Shpesh herë hartimi, miratimi dhe ekzistenca e ligjeve nuk është e mjaftueshme, pasi është zbatimi konkret i këtyre detyrimeve ligjore që garanton shtetin e së drejtës dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kështu, gjatë vitit 2012, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar raste të shkeljeve të së drejtës për barazi përpara ligjit dhe ndalimin e diskriminimit, shkelje të së drejtës për informim, shkelje të të drejtave të njeriut nga policia, mosrespektim të të drejtave të të burgosurve, zvarritje të procedurave gjyqësore e administrative, shkelje të së drejtës së pronës, të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, mosplotësim të nevojave të shtetasve për strehim, probleme me përfitimin nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe ndihmës ekonomike, probleme në ushtrimin e lirë dhe efektiv të së drejtës për arsimim dhe kujdes shëndetësor, etj.

Avokati i Popullit nuk e zgjidh vetë një situatë të krijuar nga shkelja e një të drejte të caktuar të një qytetari që ankohet, por ai bën rekomandime për vënien në vend të kësaj të drejte të shkelur tek organi i administratës publike që sipas tij ka shkaktuar shkeljen e saj. Për të gjitha rastet e trajtuara, kemi bërë ndërhyrjet e nevojshme nëpërmjet paraqitjes të rekomandimeve përkatëse. Bërja e rekomandimeve në rastet kur pas shqyrtimit dhe hetimit të ankesave të shtetasve, është konstatuar shkelja e të drejtave të tyre ligjore nga administrata publike, është njëra anë e “medaljes”. Ndërsa ana tjetër e kësaj “medaljeje” dhe më e rëndësishmja, ka të bëjë me zbatimin e këtyre rekomandimeve nga organet dhe institucionet e administratës publike. Bërja e rekomandimeve nuk është qëllim në vetvete. Zbatimi i tyre duhet vlerësuar sepse është në interes si të ankuesve, ashtu edhe të vetë administratës publike, e cila e ka detyrim ligjor që të zbatojë e respektojë të drejtat dhe liritë e shtetasve.

Kështu, vlen për t’u vlerësuar se gjatë vitit 2012 janë pranuar nga organet e administratës publike dhe i’u është dhënë zgjidhje në favor të qytetarit 1368 rasteve, që përbëjnë 76% të ankesave të trajtuara dhe që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencës. Ndërkohë, sipas studimit të pavarur për “Monitorimin e efektivitetit të punës së Avokatit të Popullit në vitin 2012” zbatueshmëria e plotë e ankesave të pranuar në favor të qytetarëve nga ana e administratës publike rezulton të jetë në nivelin 58%.

Por, nga praktika e deritanishme rezulton se ka edhe raste që rekomandimet nuk zbatohen, ose që përgjigjet e rekomandimeve nuk vijnë brenda afatit ligjor dhe për këtë detyrohemi që sipas rastiit të përsërisim rekomandimin, ose të kërkojmë kthimin e përgjigjeve. Ka edhe raste që rekomandimet e Avokatit të Popullit, ndonëse të mirë argumentuara, nuk pranohen për zbatim, sidomos në rastet e zbatimit të vendimeve gjyqësore, kthimeve në punë, fillimin e hetimeve për veprat penale etj. Ndodh, gjithashtu, që rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit mbeten pa përgjigje nga organet e administratës publike, edhe pse përbëjnë detyrim ligjor sipas nenit 22 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 8454, datë 4.2.1999, të ndryshuar. Kështu, deri më datë 11 janar 2013 në institucionin e Avokatit të Popullit kishte 55 rekomandime të mbetura pa përgjigje¹ nga organet e administratës publike, jashtë afateve të lejuara ligjërisht.

1 Numri total i rekomandimeve drejtuar organeve të administratës publike gjatë vitit 2012 ishte 402 rekomandime në total, prej të cilave 75 janë refuzuar, 238 rekomandime janë pranuar plotësisht, 34 rekomandime janë ende në proces zbatimi, ndërsa për 55 rekomandime nuk ka marrë përgjigje.

Ne jemi në shërbim të qytetarëve, të vendosur dhe të angazhuar plotësisht për të ndërmjetësuar e për t'i dhënë zgjidhje çdo ankese të tyre, rast pas rasti, pasi kështu vendosim në vend një të drejtë të mohuar, apo të shkelur. Në praktikën tonë, zgjidhja e një rasti individual, shpesh evidenton një problem në fushën e respektimit të drejtave të njeriut dhe, për rrjedhojë, synon krijimin e një praktike të re në punën e organeve të administratës publike. Në këtë këndvështrim, edhe në rastet kur organi përkatës nuk ka reaguar ndaj rekomandimeve tona, Avokati i Popullit i është drejtuar shkallë-shkallë organeve më të larta në hierarki, duke përfshirë këtu Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave.

Gjatë vitit të fundit, Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se një sërë praktikash, fenomenesh e situatash shqetësuese për shoqërinë shqiptare nuk kanë qenë në pajtim me standardet kombëtare a ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke ndikuar negativisht në gëzimin e plotë të të drejtave të qytetarëve. Me qëllim përmirësimin e gjendjes dhe harmonizimin e saj me standardet më të mira për të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit, në konsultim dhe me organet e administratës publike përkatëse, shoqërinë civile dhe faktorin ndërkombëtar, ka përgatitur 7 (shtatë) raporte të veçanta për një gamë shqetësimesh të mprehta e aktuale të shoqërisë. Këto raporte, që do të trajtohen më gjerësisht në seksionin pasardhës të raportit, përfshijnë një sërë rekomandimesh për ndryshime legjislative dhe masa konkrete të drejtuara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, apo institucioneve të administratës publike, për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Shprehim keqardhje që këto raporte, që prekin problematika të mprehta të shtresave në nevojë të shoqërisë sonë, deri më tani nuk janë shqyrtuar nga Kuvendi, gjë që e ka bërë të pamundur bërjen e tyre publike (sipas nenit 28, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 8454, datë 4.2.1999, të ndryshuar). Po kështu, në bazë të problematikave të evindetura nga rastet e trajtuara dhe analizave ligjore të zhvilluara nga institucioni, gjatë vitit 2012 janë përgatitur 17 rekomandime për nxjerrje, amendime, apo plotësime të ligjeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave apo Ministrive përkatëse, si dhe i jemi drejtuar Gjykatës Kushtetuese me qëllim shfuqizimin e akteve nënligjore, apo ndryshimeve ligjore, që në mendimin tonë, çenojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Për një listë të plotë të rekomandimeve për ndryshime ligjore dhe rasteve drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ju lutem shihni Shtojcën I në fund të raportit.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2012, ka shqyrtuar me vëmendje të veçantë ankesat e ardhura nga individë të komuniteteve vulnerabël, të cilët janë edhe më të rrezikuarit nga shfaqjet e fenomenit të diskriminimit. Ndonëse këta qytetarë ankohen për shkeljen e një të drejte të caktuar, në thelb rastet përkatëse mbartin elementë të **diskriminimit dhe shkeljes së barazisë**, të cilat kanë shërbyer si shkak në shkeljen e të drejtave të tjera.

Në këtë kuadër, vëmendje i është kushtuar respektimit të të drejtave të **minoritetit rom**, i cili jeton në kushte tejet të vështira ekonomike. Përmbushja e detyrimeve, që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, kërkon koordinim ndër-institucional. Duke vlerësuar problematikën ekzistuese të minoritetit rom, institucioni ynë ka përgatitur dhe dërguar një sërë rekomandimesh legjislative për minisritë përkatëse. Kështu, me synim integrimin social të këtij minoriteti, Avokati i Popullit i dërgoi një rekomandim Ministrisë së Brendshme për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual. Në këtë rekomandim kemi propozuar që në Ligjin Nr.10129 datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar, të parashikohen dispozita të veçanta të kufizuara në kohë për këtë minoritet, duke hequr parashikimet që kërkojnë pronësinë, ose marrjen me qera të një banese, si pjesë e kriterëve dhe procedurave të regjistrimit dhe transferimit të gjendjes civile.

Gjithashtu, një nga problematikat e prezantuara pranë Avokatit të Popullit, si nga pjesëtarë të minoritetit rom, ashtu edhe nga organizata jofitimprurëse të vetë këtij minoriteti, apo që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e tyre, lidhet me faktin se familjet rome, të cilat kanë pasur vendbanimin e tyre të mëparshëm në fshat dhe që janë regjistruar në qytet, apo kanë ndryshuar vendbanim nga një qytet në një tjetër, pas datës 1 gusht 1991, kanë pengesa në përfitimin e ndihmës ekonomike. Kështu, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ndërmarjen e nismës për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 787/2005, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike" i ndryshuar, duke propozuar ndryshime konkrete me qëllim që anëtarë të minoritetit rom të kenë mundësi të përfitojnë ndihmën ekonomike në rastet e nevojshme. Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në dt. 18.02.2013, na bën me dije se do të krijohet një grup i përbashkët pune për të identifikuar rrugët dhe instrumentat e duhur për të zbatuar Rekomandimin e Avokatit të Popullit.

Duke marrë parasysh gjendjen mjaft të rëndë të minoritetit rom, si dhe mos përfshirjen e tyre në skemën e ndarjes së banesave për të pastrehët e këtij minoriteti, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrin të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit fillimin e procedurave për ndryshimin e Ligjit nr. 9232/2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane", i ndryshuar, duke sugjeruar shtimin e përcaktimeve që do të rregullonin strehimin e qytetarëve romë. Më konkretisht, Avokati i Popullit sugjeroi përfshirjen e tyre si kategori prioritare brenda kushtit social për përfitimin e strehimit. Megjithëse në përgjigje të këtij Rekomandimi, ministria në fjalë na informon se me ndryshimet e fundit në Ligjin Nr. 9232, datë 13.05.2012, janë parashikuar kushtet e përfitimit nga programet sociale të strehimit, Avokati i Popullit konstaton se këto ndryshime dhe mostrajtimi si kategori prioritare në mënyrë të shprehur i minoritetit rom, nuk i vendos ata në pozita të favorshme.

Lidhur me ndryshimet legjislativë që Avokati i Popullit i ka propozuar ministrive përkatëse për komunitetin rom, i jemi drejtuar edhe Kryeministrit të vendit me një kërkesë për të dhënë mbështetjen e tij për këto rekomandime.

Gjithashtu, lidhur me minoritetin rom, një sërë rekomandimesh me masa konkrete të hartuara në konsultim me organizatat rome dhe organizata të tjera të të drejtave të njeriut janë dërguar nga institucioni i Avokatit të Popullit në drejtim të ministrive, mbi a) marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit rom në regjistrat e gjendjes civile dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të të dhënave të gjendjes civile në njësitë vendore, ku ata kanë vendbanimin e ri; b) marrjen e masave për ngritjen e klasave përgatitore për arsimin parashkollor, për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve romë në të gjitha nivelet e arsimit dhe bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të ndërgjegjësuar pjesëtarët e minoritetit rom për nevojën që kanë fëmijët e tyre të ndjekin shkollën; dhe c) marrjen e masave për përfshirjen në vazhdimësi, me prioritet, të pjesëtarëve të minoritetit rom në programet e formimit profesional dhe punësimin në vazhdimësi, me prioritet, të personave në moshë pune të minoritetit rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që ky minoritet të mos ndihet i diskriminuar.

Ndërkohë, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta zgjidhjen përfundimtare të çështjes së strehimit dhe plotësimit të kushteve të përshtatëshme për jetesë për disa familjeve rome në mjediset e Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat, Tiranë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 02.02.2012. Në vijim të këtij rekomandimi Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në datën 18.02.2013, na bën me dije se ka parashikuar fondin prej 8,000,000 lekë për ndërhyrje

fillestare, i cili do të pasohet nga një fond prej 22,000,000 lekësh të parashikuara në fushat e investimit për të kryer rikonstrukcionin e këtyre mjediseve në vazhdimësi.

Po kështu, në korrik 2012 institucioni i Avokatit të Popullit ka dërguar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë raportin e veçantë me objekt “Problematikat e komunitetit rom”, i cili vazhdon të jetë i pashqyrtuar.

Me vëmendje të veçantë është hetuar dhe monitoruar veprimtaria e Policisë Bashkiake në Tiranë, e cila për një periudhë të caktuar bllokoi aktivitetin e përditshëm, si dhe mjetet lëvizëse të disa anëtarëve të minoritetit rom. Institucioni i Avokatit të Popullit, pa paragjykuar qëllimin e ndërhyrjes dhe bazueshmërinë ligjore të këtyre veprimeve nga Bashkia e Tiranës, të cilat mund të ishin edhe në të mirë të interesit publik, ndërmori hapa ligjore për verifikimin e kësaj shtate, duke kërkuar shpjegime dhe vënien në dispozicion të aktit administrativ, i cili orientonte sekuestrimin e të vetmit mjet jetese të një numri të konsiderueshëm shtetasish të këtij komuniteti, si dhe dokumentacionin përkatës sipas të cilit legjitimohet bllokimi dhe mbajtja e mjeteve pranë ambienteve të Policisë Bashkiake Tiranë. Duke mos pasur një përgjigje zyrtare nga ana e strukturave të bashkisë dhe duke iu referuar ankesave të këtij komuniteti, Avokati i Popullit rekomandoi: -ndërprerjen e veprimeve arbitrare dhe denigruese ndaj antarëve të komunitetit rom, të cilët për të siguruar jetesën e tyre detyrohen të merren me grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme; -fillimin e konsultimeve të përbashkëta rreth impaktit social-ekonomik të këtij urdhëri, përfshirë parashikimin e masave tranzitore, apo sigurimin e alternativave të tjera për sigurimin e të ardhurave të domosdoshme dhe përmirësimin e situatës ekonomike të anëtarëve të minoritetit rom, të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme; -angazhimin e minoritetit rom jo vetëm si aktor, por edhe si pjesëmarrës aktiv në vendimmarrje; -pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe vetë pjesëtarëve të minoritetit rom, në hartimin e politikave vendore që Bashkia e Tiranës duhet të ndjekë për punësimin e tyre, të cilat duhet të jenë në përputhje me politikën dhe legjislacionin në fuqi.

Një ndër çështjet e filluara me inisiativë është rekomandimi për një ndryshim në Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, drejtuar Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në nenin 9, të Kodit të Punës (i ndryshuar) parashikohet se ndalohet çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit, ndër të cilat nuk përfshihet ndalimi i diskriminimit për shkak të orientimit seksual, apo identitetit gjinor. Një boshllëk i tillë në legjislacionin e punës, mund të përbëjë shkak për një trajtim jo të barabartë të **personave LGBT** në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe formim profesional. Për të venë në vend këtë të drejtë të personave LGBT, i është rekomanduar Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përfshirja në pikën 2, të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si shkaqe për diskriminim edhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”, si dhe përfshirja në fund të nenit 9, të një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka pasur diskriminim mbi personin. Paragrafi i formuluar duhet të jetë në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 10 të Direktivës 2000/78 EC, pra duke e vendosur barrën e provës mbi punëdhënësin. Ndërkohë, jemi informuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta se këto rekomandime janë përfshirë në projekt-ligjin për ndryshimin e Kodit të Punës.

Për këtë komunitet, Avokati i Popullit i është drejtuar edhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për përfshirjen në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të sigurt pa dhunë, përjashtime sociale apo trajtim çnjerëzor. Avokati i Popullit ka kërkuar trajnimin e stafit akademik për moslejimin e çdo forme diskriminimi duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore. Po kështu, në vijim të Rekomandimit 11 të Komisionit European, si dhe mbi bazën e propozimeve të

ardhura nga komuniteti LGBT, Avokati i Popullit ndërmori një studim krahasues të legjislacionit penal në lidhje me mbrojtjen që i garantohet anëtarëve të këtij komuniteti. Bazuar në këtë vlerësim, Avokati i Popullit, i ka dërguar rekomandim, Ministrin të Drejtësisë, ku ka propozuar që në nenin 50, germa “j”, të Kodit Penal, të shtohet si rrethanë rënduese kryerja e veprës penale shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me orientimin seksual. Ky rekomandim është marrë në konsideratë nga Ministria e Drejtësisë, dhe në rastin më të parë të ndërmarrjes së iniciativës për rishikimin e Kodit Penal, do të merret në analizë edhe rekomandimi i sipërpërmendur. Avokati i Popullit ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë, raportin e veçantë mbi problematikën e komunitetit LGBT, por edhe ky raport është ende i pashqyrtuar.

E drejta për informim, mbetet një nga të drejtat themelore, ushtrimi efektiv i së cilës, shërben si indikator i suksesit të një qeverisjeje të mirë. Çështjet e shqyrtuara gjatë vitit 2012 nga institucionit i Avokatit të Popullit në lidhje me këtë të drejtë, kanë nxjerrë në pah se legjislacioni mbi të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare nga administrata publike qëndrore dhe vendore nuk zbatohet, duke shmangur kështu përgjegjësinë e saj për dhënien e dokumentacionit të kërkuar. Për më tepër ky legjislacion nuk njihet në mënyrë të plotë nga kjo e fundit, gjë që sjell vështirësi dhe pengesa në funksionimin normal dhe transparent të administratës publike, si dhe në marrëdhëniet e kësaj të fundit me publikun. Shpesh herë arsyet e mos realizimit të së drejtës për informim kanë të bëjnë me mangësi në kapacitetet infrastrukturore të institucioneve, me dobësi të kapaciteteve administrative shfaqur sidomos në komuna të vendit, dhe me tendenca autokratike të funksionarëve të administratës. Në një sërë rastesh janë të kushtëzuara edhe nga mangësi të kuadrit ligjor të së drejtës së informimit, i cili ka mbetur i pandryshuar që prej vitit 1999. Në këtë kontekst, mbeten parësore ndryshimet dhe përmirësimet e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si një kërkesë e përshtatjes së legjislacionit të brendshëm me “acquis communautaire”. Institucioni i Avokatit të Popullit në pozicionin e kujdestarit të respektimit të së drejtës për informim, vë në dukje se rekomandimet e tij për ndryshime në bazën ligjore ekzistuese, për garantimin e së drejtës për informim, ende nuk janë marrë në konsideratë. Në vazhdojmë të theksojmë rëndësinë e realizimit të këtyre ndryshimeve, për të bërë të mundur ushtrimin sa më efikas të kësaj të drejte nga ana e individëve. Gjithashtu, theksojmë se praktika e mirë e krijuar në disa institucione të administratës publike të pushtetit qendror, apo qeverisjes vendore, në të cilat janë krijuar tashmë zyrat e informimit dhe të marrëdhënieve me publikun, duhet të shtrihet dhe të funksionojë në të gjitha organet e tjera të administratës publike, me qëllim që ligji të gjejë zbatim efektiv dhe qytetarët të gëzojnë realisht të drejtën për informim në rastet kur i drejtohen këtyre institucioneve publike.

Gjatë inspektimeve të bëra dhe ankesave të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit në vitin 2012, konstatohen një sërë problematikash dhe shkeljesh të të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve nga **IEVP-të, organet e Policisë së Shtetit dhe institucionet e shëndetit mendor**. Janë evidentuar raste kur cënohen të drejtat e personave që i u është privuar liria, duke i torturuar e keqtrajtuar fizikisht e psikologjikisht. Problematike mbetet infrastruktura e ambienteve të shoqërimit dhe sigurisë dhe burgjeve, që në një sërë rastesh janë jashtë standardeve ligjore dhe nuk ofrojnë kushtet minimale të qëndrimit dhe jetesës së personave që mbahen në to.

Trajtimi i ankesave ka vënë në pah faktin se policia e shtetit ka privuar lirinë personale të individit, duke bërë ndalim e shoqërim pa shkaqe ligjore, ose mosregjistrim të saktë të kohës së arrestimit, apo ndalimit të qytetarit. Po kështu, ka raste që nga punonjësit e policisë nuk merren, administrohen dhe ndiqen konform ligjit kallëzimet penale, ankesat apo kërkesat e bëra nga shtetasit. Gjithashtu, nuk ka përfunduar ende procesi i vënies në funksionim të librave për administrimin e ankesave të personave të shoqëruar, arrestuar ose ndaluar, procesi i monitorimit me kamera të këtyre ambienteve, si dhe nuk janë afishuar në të gjitha ambientet

postera me të drejtat e personave të ndaluar dhe të arrestuar.

Por, vlen për t'u theksuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka miratuar Programin e Punës në **përbushje të Rekomandimit 12 të KE, për zbatimin e Rekomandimeve të Avokatit të Popullit**, lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore dhe trajnimin e punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë. Gjithashtu, është konstatuar se gjatë vitit 2012 organet e Policisë së Shtetit kanë bashkëpunuar intensivisht dhe janë hapur me shoqërinë civile, me të cilën janë lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi për monitorimin e të drejtave të njeriut dhe trajnimin e punonjësve të policisë.

Ndërkohë, vlen për t'u përgëzuar pranimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë të Shëndetësisë për marrjen e masave të nevojshme për njohjen e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe personelit mjekësor me aktet ndërkombëtare e rajonale që trajtojnë dhe menaxhojnë grevën e urisë. Kështu, në fund të muajit shkurt 2013, do të mbahet një konferencë nga institucioni i Avokatit të Popullit me titull "Roli i personelit mjekësor, punonjësve të Policisë së Shtetit dhe I EVP-ve në monitorimin dhe menxhimin e grevave të urisë", me pjesëmarrjen e personelit mjekësor, punonjësve të Policisë së Shtetit dhe punonjësve të administratës të I EVP-ve. Në këtë konferencë do të jenë pjesëmarrës dhe ekspertë ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Për problematikat e konstatuara në I EVP-të, theksojmë se është bërë zbatueshmëria e disa prej pikave të rekomanduara, ku vlen për t'u përmendur ulja e mbipopullimit në këto institucione, ndërtimi i I EVP Elbasan, etj. Po kështu, vlerësojmë procesin e aplikimit dhe funksionimit të shërbimit të provës që është instensifikuar gjatë vitit 2012, çka i shërben jo vetëm personave që përfitojnë prej tij, por edhe uljes së nivelit të mbipopullimit në I EVP. Gjithashtu, vlen për t'u përmendur bashkëpunimi i institucionit tonë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku së bashku me OJQ të ndryshme gjatë 2012 janë realizuar një sërë inspektimesh të përbashkëta, si dhe aktivitete të tjera të përbashkëta si: ofrimi i shërbimeve psikologjike për personat e burgosur dhe trajnimeve për policinë e burgjeve. Ndërkohë, mbeten problematike çështjet si: trajtimi i problemeve shëndetësore dhe diagnostifikimi i tyre në kohë, shtimi në organikë i stafit psiko-social, psikiatrik, shtimi i infermierëve, si dhe shtimi i programeve rehabilituese dhe riaftësuese kryesisht në institucionet ku qëndrojnë të miturit.

Aktualisht, në qendrat spitalore psikiatrike konstatohet se ka probleme mbipopullimi (spitali i Vlorës dhe Elbasanit), si dhe ka vështirësi në realizimin e deinstitutionalizimit të pacientëve kronikë, pasi qendrat rehabilituese nuk ofrojnë kapacitetin dhe stafin përkatës në raport me numrin e pacientëve. Për pasojë një numër i konsiderueshëm i pacientëve janë të shtruar në spitale psikiatrike dhe qëndrimi i gjatë në këto institucione dëmton mundësinë për përmirësimin, apo rehabilitimin e tyre. Ndërkohë shërbimi shëndetësor në qendrat spitalore psikiatrike nuk është në nivelin e duhur, ka mungesë të personelit mjekësor (mjek të përgjithshëm, psikiatër, dentist), si dhe ka mungesë të pajisjeve dhe materialeve e medikamenteve mjekësore. Shërbimi psikosocial, sidomos për të miturit, ka mungesë të personelit dhe të programeve rehabilituese. Vijon të mbetet shqetësuese mosqetja e një zgjidhjeje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar. Por, me miratimin e Ligjit të ri nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", i cili është i standardeve bashkëkohore, dhe përgatitjen e nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatim të tij², besojmë se ky problem shqetësues disa vjeçar do të

2 Institucioni i Avokati të Popullit është përfshirë në grupin e punës për përgatitjen e akteve nënligjore të Ligjit të ri nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", të cilat do të bëjnë të mundur zbatimin konkret të këtij Ligji.

gjejë zgjidhje përfundimtare. Është për t'u vlerësuar fakti që në këtë ligj, parashikohet përfshirja e Avokatit të Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, dhe e OJQ-ve si monitorues të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor.

Pavarësisht rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit drejtura organeve përkatëse, problemetet e sipër përmendura, të cilat duhet të konsiderohen prioritete edhe për performancën e administratës tonë publike në kuadër të integritetit të vendit në BE, mbeten ende të pazgjidhura. Problematika e hasur ka nevojë të shqyrtohet edhe nga organet e larta shtetërore, pasi siç u vu në dukje dhe më sipër, problematika shpesh herë është e lidhur me mungesën e fondeve dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit. Gjithashtu, për disa çështje kërkohet trajnimi në vazhdimësi i punonjësve të administratës publike (të Policisë së Shtetit, të Policisë së Burgjeve dhe punonjësve të tjerë të IEVP-ve, e qendrave spitalore psikiatrike), për respektimit e të drejtave të shtetasve, pavarësisht pozitës juridike të tyre. Po kështu, zgjerimi i bashkëpunimit të strukturave të Policisë së Shtetit dhe IEVP-ve me shoqërinë civile me qëllim monitorimin dhe përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave të njeriut në këto organe, është thelbësore dhe duhet të vazhdojë më tej.

Duke vlerësuar të **drejtën e jetës** si të drejtën themelore dhe më të rëndësishme të njeriut të mbrojtur me ligj, si dhe duke njohur rrezikun që **fenomeni i gjakmarrjes** ka mbi gëzimin e kësaj të drejte (krime vrasjeje, ngujime, si dhe privim të të drejtave dhe lirive të tjera), Avokati i Popullit gjatë vitit 2012 ka marrë iniciativën për sensibilizimin e institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe individëve lidhur me këtë çështje sensitive. Sipas statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2012 kanë ndodhur 5 vrasje me motiv gjakmarrjen. Avokati i Popullit konstaton se gjatë vitit 2012 pati lëvizje pozitive nga organet e shtetit. Përveç faktit të pranimit publikisht të këtij fenomeni, organet shtetërore kanë filluar të marrin masa konkrete, të tilla si: ngritjen e grupit të punës ndërrikasterial për përgatitjen dhe miratimin nga Këshilli i Ministrave të tre akteve nënligjore në bazë dhe në zbatim të Ligjit 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes". Por përveç këtyre masave kërkohet zbatimi i menjëhershëm i ligjit përkatës, dhe një angazhim dhe bashkëpunim mes institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore për t'u përballur me këtë fenomen.

Një tjetër problematikë e paraqitur në institucion, me një numër jo të vogël ankesash, ka qenë e lidhur me rillogaritjen e gabuar të **pensioneve të ish-ushtarakëve**. Është fakt se me vendime gjyqësore të formës së prerë, disa ish-ushtarakë kanë fituar të drejtën për të marrë pensionin suplementar. Këta ushtarakë kanë depozituar ankesa në institucionin e Avokatit të Popullit duke pretenduar se nga ana e sigurimeve shoqërore po bëhet rillogaritja e pensionit, me efekte negative në kundërshtim me kërkesat e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë shkak Avokati i Popullit në Janar 2012 i rekomandoi Ministrin të Financave rregullimin ligjor me qëllim që neni 29, i ligjit të mësipërm të zbatohet sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Rekomandimi i Avokatit të Popullit ende nuk ka marrë një përgjigje, e për rrjedhojë problemi mbetet ende pa një zgjidhje ligjore përfundimtare.

Viti 2012 ka qenë më dinamik në kuadër të kërkesave që **ish të dënuarit politikë** kanë parashtruar për zgjidhje për realizimin e të drejtave të tyre. Problematikat e parashtruara në këto ankesa, apo kërkesa, kanë të bëjnë me pretendimet për: mospërfitimin në mënyrë të padrejtë të dëmshpërblimit në kushtet e cilësuar nga Ligji Nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar; mosgjetjen e eshtrave të të afërmeve, ish të dënuar politikë, të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; mospërfitimin e kësteve të dëmshpërblimit që përfitojnë si ish të dënuar politikë; caktimin jo korrekt të masës së dëmshpërblimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë; zvarritjen e procedurave për caktimin e

masës së dëmshpërblimit; mosgjetjen e mundësive reale të futjes në përdorim të letrave me vlerë, të përfituara si ish i dënuar politik; mundësimin e marrjes së shumës totale të dëmshpërblimit në mënyrë të menjëhershme dhe jo sipas radhës së kësteve të përcaktuara; zvarritjen e procesit të dëmshpërblimit për grupimin e të internuarve, sipas parashikimeve të ligjit; e trajtimin me ndihmë sociale nga shteti për këtë kategori.

Një ngjarje gjatë 2012, e njohur dhe nga opinioni publik, ka qënë greva e urisë së një grupi ish të dënuarish politikë, e cila u zhvillua në një ambient të hapur në Tiranë, gjatë kohështirjes së muajve shtator-tetor 2012. Një grup i këtyre grevistëve paraqiti një kërkesë për ndërhyrje në institucionin e Avokatit të Popullit, ku parashitroreshin këto problematika kryesore: -zhdëmtimi i plotë dhe i menjëhershëm i të burgosurve politikë në shumën e llogaritur paraprakisht, sipas ligjit; -përfitimi nga shërbimet sociale shtetërore të të gjithë të burgosurve politikë, aktualisht pa përkrahje dhe të vetmuar; -garantimi i përgjithshëm i shërbimit mjekësor falas për të gjithë të burgosurit politikë; -futja në përdorim e letrave me vlerë, në vlerën e tyre reale; -marrja e masave të shpejta për mundësimin e punësimit të ish të burgosurve politikë; -ndërhyrje për miratimin në Kuvend të projektligjit që mundëson trajtimin e dosjeve të vonuara të të burgosurve-dënuarve politikë, që nuk kanë mundur të përfitojnë dëmshpërblim deri tani dhe amendimin paraprak në këtë projektligj për disa përcaktime të bëra në të.

Grevistët kërkonin gjithashtu, ndërhyrje për ndryshim, apo propozim të nxjerrjes së legjislacionit të ri, për: a) shtimin në masën 30% të vlerës përkatëse nominale të llogaritur si dëmshpërblim për çdo ish të burgosur politik, si pasojë e inflacionit që ka ndodhur në vend për vitet 2007-2012; b) Lidhjen e një pensioni të posaçëm për të gjithë të burgosurit politikë, të cilët aktualisht janë gjallë, sikurse është parashikuar në ligjin nr.7703 datë 11.09.1993, në nenin 5/c, si dhe në VKM me nr.429 datë 12.09.2002; c) amendimin e legjislacionit në fuqi, pasi ka ish të burgosur politikë, që nuk kanë patur mundësi për arsye të ndryshme të përgatisin dokumentat për marrjen e dëmshpërblimit brenda afatit që përcaktonte ligji.

Avokati i Popullit mendon se mjeti i duhur për të trajtuar dhe zgjidhur probleme që shqetësojnë qytetarët, apo grupe të caktuara interesi, është dialogu social mes administratës publike dhe qytetarëve. Duhet vënë në dukje se atmosfera që shoqëroi grevën e urisë nuk ishte ajo e duhura për nxitjen e dialogut. Administrata publike nuk duhet për asnjë moment t'i shmanget këtij dialogu për çfarëdo lloj rrethane, apo arsye.

Bazuar në problematikat e lartë përmendura, të cilat paraqesnin një kompleksitet kërkesash dhe rrugë zgjidhjesh, dhe pas një analize të kujdesshme të legjislacionit në fuqi, i cili rregullon çështjet dhe marrëdhëniet juridike konkrete, të prekura në kërkesën e grevistëve të urisë, i jemi drejtuar me shkresë Ministrin të Drejtësisë, Ministrin të Financave, Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe Ministrin të Shëndetësisë.

Në këtë shkresë është bërë një përmbledhje e gjithë problematikës dhe rrugëve të mundshme ligjore të zgjidhjes së tyre, duke theksuar rëndësinë e gjetjes së një zgjidhje të pranuar nga të gjitha palët, nëpërmjet një procesi negociimi mes institucioneve respektive të administratës publike dhe grevistëve për kërkesat e parashtruara prej tyre, pavarësisht vështirësive dhe ndasive që ekzistonin mes palëve.

Duke e konsideruar problematikën e parashtruar nga grevistët e urisë si aktuale, shqyrtimi i saj është parë në një këndvështrim shumë më të gjerë se sa momenti i inicimit të grevës. Bazuar në shqyrtimin e çështjes për ecurinë e procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, në përputhje me parashikimet e bëra në Ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, kemi konstatuar

se përmbajtja e ligjit bazë, e ndryshimeve që ai ka pësuar, por edhe e akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre (kjo pjesë i referohet VKM nr.419 datë 14.04.2011), kanë krijuar konfuzion në ecurinë e procesit të dëmshpërblimit dhe kanë sjellë si pasojë zgjatjen kohore të procesit të dëmshpërblimit, pa një afat përfundimtar të përcaktuar qartë.

Ky moment çënon parimin e sigurisë juridike, si një komponent i rëndësishëm i shtetit të së drejtës, i cili në këtë rast ka të bëjë me trajtimin administrativ të çështjes brenda afateve të arsyeshme kohore, që plotësojnë pritshmërinë e palëve të interesuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Këto afate efektivisht janë ndryshuar, duke përkeqësuar periudhën kohore të trajtimit dhe realizimit të së drejtës individuale, ndërkohë që ato kanë qenë parashikuar me një akt tjetër normativ të mëparshëm, në mënyrë më favorizuese për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist. Për sa më sipër, i është rekomanduar Ministrit të Drejtësisë, që në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, realizimi i inisiativës legjislative, për një ndryshim në VKM nr.419, datë 14.04.2011 "Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist", me qëllim përcaktimin e një afati përfundimtar të arsyeshëm, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit, për ish të përndjekurit politikë të regjimit komunist.

Nga shqyrtimi i ankesave individuale që lidhen me këtë fushë, ka rezultuar gjithashtu se, ende nuk ka filluar trajtimi i kategorisë së **të internuarve** nga regjimi komunist me dëmshpërblimin përkatës, sipas kushteve të parashikuara në ligj. Sikurse evidentohet në këto ankesa, megjithëse individët e interesuar kanë kohë që kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë, ende nuk ka filluar trajtimi i tyre me dëmshpërblim. Ky fakt konfirmohet edhe në shkresën nr.2709/2 datë 8.01.2013 të Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën ndër të tjera thuhet se: "...në ligjin nr.9831 datë 12.11.2007, neni 6 i tij, përcakton si masë dëmshpërblimi për personat e internuar, ose të dëbuar një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende".

Pavarësisht kërkesave të hershme për dëmshpërblim, që janë paraqitur nga subjektet e interesuara, përfaqësues të kategorisë të së internuarve, ose të dëbuarve nga regjimi komunist, Këshillit i Ministrave ende nuk ka miratuar skemën e pensionit me anë të Vendimit përkatës, skemë nga e cila do të përfitojnë dëmshpërblimin kjo kategori ish të dënuarish politikë.

Sa më sipër i kemi rekomanduar Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta dhe Ministrit të Drejtësisë, paraqitjen në një kohë sa më të shpejtë të mundshme në Këshillin e Ministrave, të propozimeve për miratimin e skemës së pensionit për kategorinë e të internuarve, ose të dëbuarve nga regjimi komunist, me qëllim nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore, që do t'i mundësojnë marrjen e dëmshpërblimit këtyre kategorive.

Një numër i madh ankesash i janë drejtuar institucioni të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 në lidhje me pushtetin gjyqësorin, të cilat konsistojnë në shkelje të kryera nga **administrata gjyqësore** dhe kanë lidhje me zvarritjen e padrejtë të gjykimeve, si dhe me procedurat gjyqësore. Ankesat e ardhura sipas rastit janë hetuar dhe janë bërë ndërhyrjet e nevojshme, duke synuar në nxjerrjen e shkaqeve të këtyre shkeljeve dhe duke bërë edhe rekomandimet e duhura për ndreqjen, ose mos përsëritjen e këtyre shkeljeve në të ardhmen.

Po kështu, kanë vazhduar të vijnë ankesa ndaj **organit të prokurorisë** duke pretenduar shkelje procedurale gjatë hetimit paraprak dhe është kërkuar ndërhyrja e institucionit të Avokatit të Popullit për anulimin e tyre si veprime të pavlefshme. Ankesa kanë ardhur gjatë këtij viti në lidhje me shkeljet e kryera nga organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, duke pretenduar se personat që kanë mbaruar vuajtjen e dënimit dhe nga organet e prokurorisë, nuk

janë dërguar urdhrat e ekzekutimit, ku të përcaktohet afati përfundimtar i vuajtjes së dënimit. Një grup tjetër ankesash kanë pasur objekt pretendimet se gjyqtarë të veçantë janë përfshirë në veprime korruptive, apo kanë pasur njëanshmëri në gjykimet e çështjeve. Gjithashtu janë paraqitur ankesa ndaj noterëve dhe avoketërve privat duke pretenduar shkelje ligjore në veprimtarinë e tyre. Në të gjitha rastet ankesat i janë dërguar për kompetencë shqyrtimi, Ministrisë së Drejtësisë, ose KLD-së për verifikim dhe marrjen e masave disiplinore ndaj tyre, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, apo Dhomës Kombëtare të Noterëve sipas rastit.

Në këtë drejtim, një arritje e rëndësishme ishte nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit mes institucionit të Avokatit të Popullit, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë në fillim të vitit 2013, i bazuar dhe në kërkesën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011”, dt.14.06.2012. Nënshkrimi i këtij memorandum bashkëpunimi ndërinstytucional, pas një periudhe negocimi disa mujor në bashkëpunim dhe me Misionin EURALIUS të Bashkimit Europian, ka si qëllim referimin e rasteve të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit dhe marrjen e masave administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë, sipas kompetencës të secilës palë, kur konstatohen shkelje të ligjit. Një bashkëpunimi i tillë me këto institucione synon të vendosë një mekanizëm, ku qytetarët do të kenë mundësinë të jenë më të sigurt ndaj veprimeve arbitrare të sistemit të drejtësisë, për të garantuar të drejtën e tyre për akses në drejtësi, për të siguruar transparencën dhe ligjshmërinë e veprimtarisë të sistemit gjyqësor.

Marrëdhëniet me organin e Prokurorisë kanë qenë përgjithësisht korrekte, bashkëpunuese, për kompetencën dhe trajtimin profesional të kërkesave dërguar nga Avokati i Popullit në Drejtorinë e Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme. Megjithatë, ndërsa konstatohet mirëkuptim në kthimin e përgjigjeve të kërkesave të Avokatit të Popullit për shpjegime, apo informacione të rastit, nga ana e organit të Prokurorisë në rrethe, nuk kthehen përgjigje për disa nga Rekomandimet e paraqitura dhe veçanërisht për ato që lidhen me mënyrën e përfundimit të hetimit të procedimit penal, filluar mbi bazën e Rekomandimit të Avokatit të Popullit.

Edhe gjatë vitit 2012 ka pasur një numër të konsiderueshëm ankesash me objekt **mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave** nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror, ai Privat, si dhe subjektet e tjera të përfshira në ekzekutimin e këtyre titujve. Shqetësuese është kjo situatë veçanërisht kur organet më të larta të Administratës Publike pa asnjë shkak ligjor, refuzojnë përmbushjen e detyrimeve të vendosura me vendime gjyqësore të formës së prerë, të dhëna gjatë vitit 2012, por dhe në vitet e mëparshme.

Në këtë situatë është e nevojshme rritja e përgjegjshmërisë së administratës publike, lidhur me përmbushjen, ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe përmirësimi i marrëdhënieve konkrete të punës midis prokurorisë, policisë gjyqësore, gjykatave dhe institucioneve të tjera ligj-zbatuese, brenda një afati të arsyeshëm. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do t'i shërbejë rritjes së standardeve të lirive, të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve në Shqipëri, si dhe do të përmirësonte ndjeshëm perceptimin dhe vlerësimin që ekziston mbi gjykatat dhe administratën shtetërore. Lidhur me problematikën e lartpërmendur, Avokati i Popullit ka hartuar dhe i ka dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Raportin e Veçantë “Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë”, i cili ende nuk është shqyrtuar në Kuvend.

Procesi i njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe legjislacioni mbi të cilën mbështetet korrigjimi i një padrejtësie nëpërmjet rivendosjes të ligjshmërisë dhe drejtësisë, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Nga ankesat dhe

kontaktet direkte të stafit me individët ankues, konstatohet se në shumë raste nuk u hapen dyert e organeve të administratës publike qendrore, apo vendore për të dëgjuar kërkesat ose ankesat që kanë, si dhe për t'u siguruar informacionin dhe sqarimet e nevojshme.

Gjatë vitit 2012, individë dhe grupe individësh kanë adresuar ankesa dhe problematika të ndryshme, të cilat pavarësisht organit kundër të cilit drejtohen (AKKP-së, ZRPP-ve, Komunave dhe Bashkive, Komisioneve të Verifikimit të Ligjshmerisë së Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të çdo qarku apo gjykatave), kanë të përbashkët shqetësimin për mbrojtjen e pronës së paluajtshme dhe të luajtshme dhe të drejtave reale mbi to, përfitimin nga ndarja e tokës bujqësore dhe nga procesi i kthimit e kompensimit të pronave, të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara mbi trojet e tyre dhe dëmshpërblimin për shpronësimet për interesa publike.

Në krahasim me vitin e kaluar konstatojmë se, aktorë të tillë të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes dhe garantimit të pronës private, si Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave dhe Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kanë konsoliduar autoritetin e tyre ligjor në ushtrimin e funksioneve të tyre ligjore. Gjithashtu, ndikim dhe përmirësim në procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ka sjellë dhe Ligji nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i cili shfuqizoi Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, duke përmirësuar mënyrën e gëzimit të tagrave të pronësisë prej pronarëve legjitimë dhe duke zvogëluar mundësinë e cënimit të këtyre tagrave nga organet e administratës publike gjatë vendimmarrjes së tyre, qoftë normative apo individuale, vendimmarrje e cila prek dhe pengon subjektet në përdorimin lirisht të pronës.

Por ndërkohë, në ZRPP-të ka ende shumë për të berë lidhur me shpejtësinë e trajtimit të ankesave, me rritjen e nivelit të transparencës, në sqarimin e saktë të individëve për dokumentacionin dhe procedura që duhen ndjekur, veçanërisht për problematikat që kanë të bëjnë me mbivendosjen e pronave. Megjithatë duhet pranuar se nga shqyrtimi i ankesave të paraqitura gjatë këtij viti, nuk ka rezultuar që mbivendosja të ketë qenë produkt i veprimeve, apo mosveprimeve të paligjshme e të pandërgjegjshme të regjistruarve të zyrave vendore. Mbivendosjet e pronave janë rezultat i përplasjeve midis vendimeve gjyqësore, vendimeve të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe ish komisioneve të tokave bujqësore në Komuna dhe Bashki, që kanë kaluar në pronësi të familjeve bujqësore, trojet, apo tokat që ishin objekt i Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar. Këto pasoja janë rrjedhim i veprimeve të nxituara dhe shpesh herë jo profesionale të organeve të ngarkuara nga ligji për kalimin e pronësisë, të cilat pa bërë verifikimet e duhura njohin pronësinë mbi sipërfaqe toke, të cilat kanë qenë të regjistruara ndërkohë në emër të pronarëve të tjerë, duke krijuar kështu një konflikt të ri pronësie mbi sipërfaqen e tokës së disponuar me vendimmarrje.

Problematike mbetet kompensimi financiar i të shpronësuarve për pamjaftueshëri të burimeve monetare të destinuara për ta. Vazhdojnë të vijnë ankesa lidhur me cënime të të drejtës së pronës, nëpërmjet mosrespektimit të normave të Ligjit nr. 8651, dt. 22.12.2009 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik". Nga hetimi administrativ i këtij grupi ankesash ka rezultuar moskryerje me transparencë e procedurave të shpronësimit, mospërputhje mes shpronësimeve në terren me ato të deklaruara në aktin nënligjor, kundërshtime të çmimit të tokës të shpronësuar dhe vonesa në dhënien e dëmshpërblimit.

Problematike mbeten dhe ankesat e individeve lidhur me mospërfitimin e dëmshpërblimit për **shtëpitë e përmytura në qarkun e Shkodrës** në fund të vitit 2010. Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje situatën e krijuar pas përmytjeve në Qarkun e Shkodrës dhe ka rekomanduar

konkretisht alokimin e fondeve nga KESH në një Depozitë të veçantë të Qeverisë Shqiptare. Mungesa e fondeve nga KESH nuk mund të jetë arsye, apo shkak ligjor për zvarritjen e dhënies së dëmshpërblimit të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 842, datë 06.12.2011. Gjithashtu, duhen marrë në konsideratë pretendimet e subjekteve tregëtare, si dhe procedurat e vlerësimit të dëmeve dhe klasifikimit të tyre jashtë listës së përfituesve. Në këtë aspekt, shprehim rezervat tona për mungesën e bashkëpunimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, e cila për asnjë moment nuk vuri në dispozicion të institucionit të Avokatit të Popullit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në rrugë zyrtare. Po kështu, duhet miratuar një vendim i ri i Këshillit të Ministrave, ku të parashikohen ato subjekte të lëna në harresë gjatë procedurave të përpilimit të dokumentacionit me qëllim që të gjithë fermerët të përfitojnë dëmshpërblimin. Duhen realizuar investime konkrete, me qëllim që në të ardhmen të shmangen përmbytje të tjera në zonat e rrezikuara. Në lidhje me përmbytjen në Shkodër, Avokati i Popullit hartoi një Raport të Veçantë, me anë të të cilit ka njohur Kuvendin e Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave me situatën e krijuar dhe masat që duheshin marrë nga autoritetet shtetërore respektive, për të zbutur pasojat e përmbytjes dhe përmbushur detyrimet ligjore që burojnë nga Vendimi i Këshillit të Ministrave. Ky raport nuk është diskutuar ende në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk kemi patur asnjë reagim zyrtar nga institucionet, të cilave u jemi drejtuar.

Sipas Progres-Raportit për Shqipërinë për vitin 2012, reformimi i **Administratës Publike** për të garantuar meritokraci, eficensë dhe transparencë mbetet një nga 12 prioritetet kyçe të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Gjatë punës sonë kemi konstatuar se shumica e rasteve kanë të bëjnë me largime të pamotivuara nga puna, mosrespektim të afateve ligjore për këto largime nga punëdhënësi dhe mos arsyetim të vendimeve gjyqësore, ç'ka pengon punëmarrësit për garantimin dhe respektimin sa më të drejtë të marrëdhënieve të punës. Po kështu, në një pjesë të rasteve kemi evidentuar se vendet e punës ende nuk caktohen përmes një procesi përzgjedhje në bazë merite. Këto fenomene paraqesin pengesa serioze për zhvillimin profesional të administratës publike.

Pavarësisht, rekomandimeve të drejtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe detyrimeve ligjore që kanë organet e administratës shtetërore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, vazhdon të konstatohet papërgjegjshmëri dhe mungesë vullneti për ekzekutimin e tyre, e për rrjedhojë vendimet mbeten të paekzekutuara. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës në kundërshtim me ligjin, si dhe mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave, krijon pasoja financiare, të cilat arrijnë shuma të kondiserueshme. Përgjegjësia për vendimarrjen e jashtëligjshme dhe fatura financiare që rrjedh prej saj nuk duhet t'i faturohet organit të administratës, por duhet të jetë më së shumti përgjegjësi individuale e titullarit të organit, si personi që merr vendimin dhe që ka detyrimin ligjor për zbatimin e ligjit. Shumë prej problematikave të lartpërmendura e që kërkojnë zgjidhje, Avokati i Popullit i ka përfshirë në një dokument me propozime e rekomandime për draftligjin e ri "Për statusin e nëpunësit civil", që i është dërguar Departamentit të Administratës Publike dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2012, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar dhe konstatuar një sërë rastesh të shkeljes të së drejtave të qytetarëve, për përfitime të ndryshme nga **skema e sigurimeve shoqërore**. Një ndër problematikat e trajtuara nga institucioni ynë, ka qenë ajo e një numri ankesash të shtetasve, të cilëve u është ulur masa e pensioneve, apo të tjerëve që nuk e kanë përfituar atë. Kështu, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të

Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, sipas pikës 2 të nenit 29 të këtij ligji është bërë rillogaritja e masës së pensioneve për këto kategori qytetarësh dhe kjo masë jo vetëm është ulur në mënyrë drastike, por këta persona janë shpallur edhe debitorë ndaj Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Duke e konsideruar këtë ndryshim të masës së pensionit si cenim të drejtave të tyre të ligjshme të fituara, institucioni ynë, ju drejtua Ministrisë së Financave me rekomandimin për plotësimin e nenit 29 të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe monitorimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, vlerësojmë se për një përmirësim të metëjshëm të legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore, është e nevojshme: -rishikimi i masës së pensionit minimal në shkallë vendi, e cila është e pamjaftueshme për përballimin e një jetese normale; - rivënien në vend të së drejtës së shkelur të pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensioneve suplementare për një kategori të caktuar, si pasojë e rillogaritjes së këtyre pensioneve në bazë të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”; -rritje të kapaciteteve të punonjësve përgjegjës pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me qëllim shmangien e abuzimeve në llogaritjen e masave të pensionit të pleqërisë; dhe -përmirësim të nenit 62 të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me datën e lindjes të së drejtës për përfitim të pensionit të pleqërisë për ata shtetas që ndjekin rrugën gjyqësore. Sipas legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore, nëse kërkesa depozitohet brenda afatit 1 (një) vjeçar nga lindja e së drejtës për të përfituar pension pleqërie, shtetasi e përfiton pensionin që nga data e lindjes të së drejtës. Por në rast se ankuesi ndjek rrugën gjyqësore për parregullsi të dokumentacionit, atij i lind e drejta e përfitimit pas mbarimit të procesit gjyqësor, proces që minimumi zgjat 2 vjet.

Pavarësisht problematikave të përmendura më lart, duhet theksuar se bashkëpunimi ndërmjet Avokatit të Popullit me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe institucioneve në varësi të saj, ka qenë rezultativ dhe ndër të tjera ka konsistuar edhe në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ana jonë.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2012 janë depozituar e trajtuar një sërë ankesash, ku shtetas të ndryshëm kanë pretenduar mosdhënien e së drejtës për të përfituar **ndihmë ekonomike**, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, si dhe ankesa për mundësim të përfitimit të pagesës së ndihmës ekonomike për ata persona që nuk e përfitojnë atë, për arsye të ndryshimit të vendbanimit.

Një nga problemet që lidhet me ndihmën ekonomike është edhe mosdeklarimi i minimumit jetik në Shqipëri. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, sindikata, grupe interesi dhe organizma të tjera jo qeveritare kanë paraqitur në mënyrë të vazhdueshme ndër vite kërkesat e tyre për shpalljen zyrtarisht të minimumit jetik nga organet përkatëse, por ende kjo problematikë nuk ka gjetur zgjidhje. Kjo çështje kërkon zgjidhje, pasi minimumi jetik, nuk është vetëm një tregues që lidhet me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, por bazuar në të, përcaktohen edhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes shoqërore.

Konkretisht, në datën 25 Qershor 2012, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qeverisë, përfaqësues të

institucioneve ndërkombëtare, të trupës diplomatike të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe të një numri organizatash për të drejtat e njeriut, organizoi Konferencën Kombëtare “Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, pjesë integrale e të drejtave të njeriut”. Nga kjo konferencë dolën disa rekomandime për institucionet përkatëse shtetërore të kësaj fushe dhe për gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm të përfshirë në të. Në një nga rekomandimet, i kërkohet Qeverisë shqiptare përcaktimi i minimumit jetik në nivel kombëtar, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e statusit ekonomik të **Personave me Aftësi të Kufizuar**, si grupi social më i rrezikuar nga varfëria. Në kushtet e mospërmbyesjes së këtij detyrimi të rëndësishëm ligjor, i cili ka impakt të jashtëzakonshëm në jetën e shumë qytetarëve e famljeve që i përkasin shtresës më pak të mbrojtur e më në nevojë, më datë 06.12.2012 i jemi drejtuar përsëri Kryeministrit të Shqipërisë për të rimarrë në konsideratë rekomandimin e propozuar nga ana jonë, për ngritjen e një grupi pune, për studimin dhe përcaktimin e nivelit minimal të standardit të jetesës në Shqipëri. Jemi ende në pritje të qëndrimit ndaj këtij rekomandimi.

Me iniciativën e Avokatit të Popullit, në mbështetje të nenit 27 të Ligjit 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, është hartuar një Raport i Veçantë “Varfëria dhe kontributi i programit të Ndhmës Ekonomike në reduktimin e saj, si dhe veprimtaria e Avokatit të Popullit lidhur me të”, i cili është dërguar pranë Kuvendit të Shqipërisë në muajin Korrik 2012 dhe ende nuk është diskutuar në Kuvend.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga rasti i bërë publik në media, për vonesa në dhënien e pagesës së paaftësisë personave me aftësi të kufizuar, vendosi të hetojë me iniciativë këtë rast. Për këtë qëllim, përfaqësues të institucionit u dërguan në qytete të ndryshme për të zhvilluar takime me këtë kategori personash. Nga hetimi i ankesave të paraqitura rezultoi se personat me aftësi të kufizuar në disa bashki dhe komuna nuk kishin marrë pagesën e paaftësisë nga muaji shtator 2012. Në disa raste pagesa e paaftësisë nuk ishte dhënë nga muaji tetor 2012, e në disa raste të tjera kjo pagesë nuk ishte dhënë e plotë. Për këtë arsye u rekomandua lëvrimi sa më parë i fondeve për pagesën e vonuar të personave me aftësi të kufizuar, rekomandim i cili ju dërgua Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si edhe Ministrisë së Financave. Në përgjigjen e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta sqarohet se në muajin Janar 2013 është akorduar e gjithë vlera e pretenduar nga njësitë e pushtetit vendor për mangësitë e vitit 2012. Duke analizuar situatën e krijuar me vonesat në dhënien e pagës së paaftësisë personave me aftësi të kufizuar, Avokati i Popullit mendon se pavarësisht vështirësive financiare, apo mosrakordimit mes pushtetit qendror dhe vendor, institucionet shtetërore duhet të kenë kujdes të veçantë për mos përsëritjen e kësaj situate, që cënon rëndë të drejtat e një grupi vulnerabël. Gjithashtu, në çdo rrethanë nuk duhet neglizhuar transparenca ndaj opinionit publik dhe aktorëve të interesuar në trajtimin e kësaj situate, pavarësisht vështirësive që ajo mbart.

Në fillim të vitit 2012, i kemi dërguar Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë pranë Kuvendit të Shqipërisë mendimet tona lidhur me projektligjin “Për disa ndryshime në Ligjin nr.8098/1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar” si dhe të projektligjit “Për disa ndryshime në Ligjin nr.8626/2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar”. Nga shqyrtimi i projektligjeve, kemi konstatuar se nëpërmjet këtyre ndryshimeve, situata e përfitimeve për kategoritë e paraplegjikëve/tetraplegjikëve dhe të të verbërve, ndryshon jo në mënyrë të favorshme. Kemi vlerësuar qëllimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave të qarta për dhënien e përfitimeve dhe kryerjen e pagesave ndaj këtyre kategorive, por institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parimin e sigurisë juridike është i mendimit se ligji duhet të garantojë llojin dhe masën e përfitimit, ndërkohë që mekanizmat dhe procedurat e dhënies së këtyre përfitimeve dhe rimbursimeve që duhet t’u jepen operatorëve të shërbimeve,

mund të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Me miratimin e Ligjit 26/2012 datë 05.04.2012 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për statusin e të Verbërit” si dhe Ligjit Nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8626 datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, një sërë ankesash janë paraqitur pranë institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me problematikën që këto ndryshime ligjore kanë për personat e verbër dhe paraplegjikë e tetraplegjikë. Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve dhe Shoqatën Kombëtare të Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë, i ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese një kërkesë me objekt “Shfuqizimin si antikushtetues të Ligjit 26/2012 datë 05.04.2012 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për statusin e të Verbërit” si dhe të Ligjit Nr. 27/2012, datë 05.04.2012 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8626 datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, për të cilat është vendosur edhe kalimi i çështjeve për shqyrtim në seancë plenare.

Dhuna ndaj grave vazhdon të mbetet një fenomen mjaft i përhapur dhe problematik për shoqërinë tonë. Numri i grave viktime të dhunës në familje në 2012 është mjaft shqetësues. Ndërkohë, është rritur numri i individëve, kryesisht i grave, që i drejtohen gjykatës për arsye të dhunës në familje, si dhe numri i urdhër-mbrojtjeve të lëshuara prej tyre. Ka pasur një rritje të numrit të gjykatave që kanë lëshuar urdhra mbrojtjeje për viktimat e dhunës në familje, por shpejtësisë së gjykatës nuk i përgjigjen strukturat e përmbarimit, të cilat duket se e gjejnë zbatimin e vendimeve gjyqësore të vështirë në terren. Edhe pse, gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës seksuale, ato kanë dhe barrën e provës në rastin kur ky abuzim seksual ndodh. Dhuna përbën elementin kryesor të veprës penale dhe, kur viktime nuk mund të tregojë prova të shenjave të dhunës, krimi nuk mund të provohet. Po kështu, procesi i dëmshpërblimit të gruas që ka pësuar torturë, dhunë seksuale, ose forma të tjera të keqtrajtimit, në praktikë është i vakët. Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara gjatë vitit 2012 midis Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të grave, do të bëjnë të mundur ndërhyrjen konkrete dhe përcimin e mesazheve të rëndësishme ndaj institucioneve shtetërore lidhur me gjendjen e të drejtave të grave, ndaj të cilave duhet ndërhyrje ligjore, administrative, etj.

Në kuadrin e garantimit dhe monitorimit në vazhdimësi të respektimit të të drejtave dhe lirive të njerut në Shqipëri, institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer inspektime në **Qendrat Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror**: në Qendrën Ditore të Zhvillimit, Lezhë, në Qendrën e Zhvillimit, Durrës, në Shtëpinë e Foshnjës, Durrës, në Qendrën e Zhvillimit “Unë jam si ju”, Berat, si dhe në Qendrën e Zhvillimit “Lira”, Berat. Në përfundim të inspektimeve, u kemi dhënë rekomandime kryetarëve të Bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror për një zbatim sa më efektiv të shërbimeve sociale në Qendrat Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror. Kemi kryer inspektim dhe në Institutin e Nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, Tiranë, ku kemi rekomanduar përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të fëmijëve, që strehohen në këtë institucion.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme, të politikave të mbrojtjes sociale, por një numër i konsiderueshëm fëmijësh jetojnë ende në kushte të rënda dhe shpesh pa mbështetjen e prindërve të tyre. Këtu përfshihen fëmijët jetimë, fëmijët e rrugës, fëmijët e shpërngulur dhe ata refugjatë, fëmijët e trafikuar, fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht dhe seksualisht, dhe fëmijët që janë në burgje. Në këto kushte, është shumë e nevojshme të merren disa hapa konkretë për përmirësimin e sistemit të **përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë**. Institucioni i Avokati të Popullit ka sjellë në vëmendje dhe ka kërkuar ndaj organeve të administratës publike marrjen e një sërë masash, si: nxitjen e procesit të decentralizimit të shërbimeve dhe shpërndarjen e tyre në komunitet; forcimin e cilësisë dhe aksesit në shërbime të

tjera të institucioneve rezidenciale, (një element mjaft i rëndësishëm nëse mbajmë parasysh që ky grup fëmijësh ka nevoja të veçanta psikosociale); nxitjen e deinstitutionalizimit të fëmijëve në qendrat rezidenciale nëpërmjet transformimit të tyre në formën shtëpi – familje; promovimin e shërbimeve mbështetëse, të cilat zbusin institucionalizimin e fëmijëve, shërbimin e kujdestarisë në familje, birësim dhe rikthim në familjen biologjike; si dhe fuqizimin e kapaciteteve në nivel qendror dhe rajonal të strukturave që punojnë me fëmijët, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të stafeve të shërbimeve sociale, pasi njohuritë në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve në praktikën e përditshme, janë ende të kufizuara.

Avokati i Popullit, në vijim të përpjekjeve institucionale, ka ndërmarrë nisma për evidentimin dhe vënien në dukje të të metave që ofrojnë **shërbimet shëndetësore**, si kusht parësor për të mënjanuar dukuritë negative dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve që ofrohen në qendrat tona spitalore. Veprimtaria e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012, është fokusuar në inspektime në Qendrat Spitalore Rajonale në shumë rrethe të Shqipërisë si dhe në Qendrën Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Nga inspektimet e kryera si dhe nga rastet e trajtuara që lidhen me të drejtën për kujdesin shëndetësor, është arritur në konkluzionin se, në përgjithësi, shërbimet shëndetësore dhe sociale që u ofrohen individëve në këto qendra kanë nevojë për më shumë fonde investimi, plotësim organike, medikamente dhe materiale mjekësore, shpejtësi në realizimin e projekteve, përqëndrim dhe vëmendje më të madhe në trajtimin human të të sëmurëve. Inspektimet dhe vizitat e kryera në këto institucione, për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit ka paraqitur rast pas rasti rekomandimet përkatëse, kanë patur një rol të madh në evidentimin e problematikave që ekzistojnë në këto institucione, lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse.

Çështje të lidhura me të **drejtën e strehimit** vazhdojnë të mbeten ende një problem mjaft shqetësues i shoqërisë shqiptare. Numri i ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit nga familjet e pastreha, të cilat banojnë në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar, ka njohur një rritje progresive menjëherë mbas nxjerrjes së Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave me nr. 3, datë 1.08.2012, *“Për lirin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”* dhe veçanërisht pas miratimit nga Kuvendi të aktit normativ, për shkak të pasojave që ka sjellë zbatimi i tij. Avokati i Popullit çmon se akti normativ i nxjerrë nga Këshilli i Ministrave në vetvete dhe zbatimi i tij në veçanti, ka krijuar probleme serioze për palët e përfshira ndaj efekteve detyruese të tij, sidomos për qeramarrësit në banesat e ish-pronarëve, duke përbërë përveçse rrezik potencial të krijimit të konflikteve të reja sociale, dhe shtim të ndjeshëm të numrit të të pastrehëve në vend. Praktikisht, ankesat e paraqitura nga familjet qiramarrëse pas hyrjes në fuqi të aktit normativ, kanë nxjerrë në pah disa probleme konkrete: a) Një pjesë e mirë e këtyre familjeve qiramarrëse, ankohen se në gjendjen e tyre aktuale edhe pse kanë aplikuar pranë BKT-së për të marrë kredi me 0% interes, sikurse parashikon akti normativ, nuk kanë mundur t’a përfitojnë atë, pasi sipas bankës, nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e kësaj kredie; b) Këto familje ankohen se, megjithëse kanë aplikuar për trajtim me banesë sociale, jo vetëm nuk kanë përfituar një trajtim të tillë, por edhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga ana e bashkive respektive; dhe c) Bashki të caktuara (sikurse Bashkia Kuçovë), kanë kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit me kërkesa konkrete, për të mundësuar trajtimin me banesa, apo kredi të këtyre familjeve, pasi ato vetë nuk disponojnë mundësi financiare, apo banesa sociale, për t’i trajtuar familjet përkatëse qiramarrëse sipas parashikimeve të aktit normativ.

Evidentohet gjithashtu si e përealizueshme, mënyra e sistemimit të të moshuarve, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta, sipas shifrave që zyrtarisht jepen për këtë qëllim nga ministria e linjës.

Nisur nga një vlerësim objektiv i situatës faktike, Avokati i Popullit mendon se kthimi i pronës tek pronari i ligjshëm i saj dhe krijimi i të gjithë kushteve që ai të bëjë gëzimin e plotë të saj, ka qenë dhe mbetet një detyrim moral dhe ligjor i shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Zgjidhja e ndërmarrë do të duhej të ishte më e plotë, duke konsideruar krijimin e kushteve për respektimin dhe mbrojtjen edhe të të drejtave të qytetarëve të tjerë, siç është e drejta e strehimit. Vendimarrje të tilla të rëndësishme, siç ishte Akti Normativ i Këshillit të Ministrave me nr. 3, datë 1.08.2012, “Për lirim të banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”, duhet në çdo rast të paraprihen nga studime të thelluara dhe korrekte, që kanë në thelb të tyre shqetësimin e respektimit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve.

Është e kuptueshme se përmbajtja e dispozitave të Aktit Normativ nr.3 datë 1.08.2012, nuk është bazuar në një analizë të mirë të gjendjes së subjekteve që afektohen nga zbatimi i aktit, gjë që çon në konkluzionin se kjo përmbajtje krijon premisë për shkeljen e të drejtave të tyre. Për sa më sipër, Avokati i Popullit i ka rekomanduar me propozime konkrete Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Sali Berisha, realizimin e inisiativës legislative, për ndryshimin dhe përmirësimin e bazës ligjore, që do të mundësojë trajtimin me strehim në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, të individëve, apo familjeve qiramarrëse, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë punës së tij i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtës për **mbrojtjen e konsumatorit**, e drejtë e cila duke ju referuar numrit të ankesave për vitin 2012 rezulton të jetë çënuar në jo pak raste nga shërbimet e ofruara prej shoqërive “CEZ Shpërndarje sh.a.”, dhe Ujësjellës- Kanalizime sh.a. Ndër ankesat e paraqitura, problematike mbetet situata e mungesës së furnizimit me energji elektrike për disa zona të vendit, për shkak se nuk janë bërë projekte për investime, ose në rastet kur ekzistojnë projektet, nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së fondeve dhe vështirësive që është përballur këtë vit Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.” Krahas zonave që përballen me mungesën e furnizimit me energji elektrike, problematikë e cila është mbartur gjatë viteve është edhe keqfaturimi i energjisë elektrike, duke përfshirë mbifaturim dhe nënfaturim të sasisë së energjisë elektrike. Këtë vit, problematikë e madhe ka qenë edhe penalizmi i qytetarëve debitorë me ndërprerje të energjisë elektrike. Hetimi që kemi ndërmarrë ka qenë kryesisht në drejtim të atyre zonave, të cilat pretendonin se nuk rezultonin 100% debitorë dhe për të cilat pretendohet se bëhej dënim kolektiv për të gjithë banorët.

Në problematikat e evidentuara gjatë vitit 2012, kemi konstatuar gjithashtu fenomenin e keqfaturimit të ujit të pijshëm. Problematikë tjetër e hasur ka qenë situata për faturim të ujit në nivele të konsiderueshme edhe për persona që nuk banonin në apartamente. Krahas problematikave të përmendura më sipër, kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, edhe nëpërmjet rekomandimeve drejtuar E.Rr.U-së që të shqyrtohen, verifikohen dhe konstatohen rast pas rasti të gjitha ankesat e abonentëve dhe në rastet kur “UK sh.a.” nuk ka reaguar pozitivisht ndaj një pretendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj të abonentit, kemi insistuar dhe kemi kërkuar të ndërmerren masat e nevojshme ligjore kundrejt ndërmarrjes së “Ujësjellës-Kanalizime sh.a.”, duke vendosur edhe sanksione administrative ndaj personave përgjegjës që janë bërë pengesë në ushtrimin e detyrave funksionale dhe që kanë dëmtuar interesat e ligjshme të konsumatorit.

Krahas problematikave të mësipërme vlen të theksohet bashkëpunimi ndërinstitucional që ne kemi patur gjatë vitit 2012, si me Kompaninë “CEZ Shpërndarje sh.a., ashtu dhe me” “UKT sh.a.”, si dhe gadishmërinë e tyre për të verifikuar dhe zgjidhur brenda afateve ligjore ankesat

e konsumatorëve, të paraqitura pranë zyrave tona.

Në ankesat e trajtuara gjatë vitit 2012 në institucion, janë evidentuar një sërë problematikash të lidhura me **pushtetin vendor**. Në administratën e disa organeve të qeverisjes vendore ka probleme me formulimin e akteve administrative, mungesën e referencave ligjore, mënyrën e procedimit administrativ, mosrespektimin e afateve ligjore, shkeljen e parimeve të tilla si bashkëpunimi i administratës me personat private, përgjegjshmërinë e organeve dhe nëpunësve të tyre, përfundimin e procedimit me marrjen e një vendimi, të drejtën për të informuar individët, konflikt të interesave në vendimmarrje, lidhjet farefisnore mes pushtetarëve lokalë dhe banorëve, duke sjellë edhe subjektivizëm në vendimmarrje dhe në ekzekutimin e akteve administrative, apo planeve konkrete të njësisve të qeverisjes vendore. Të gjitha këto pasqyrohen në një nivel të ulët shërbimi të administratës ndaj qytetarit, zvarritje në zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë banorët e zonave nën juridiksionin e tyre, si dhe mohim të standardeve të njëjta administrate në shërbim të individit.

Po ashtu, mungesa e bashkëpunimit të shumë njësisve të qeverisjes vendore me komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë prefektëve të qarqeve, sipas ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" mbetet ende një nga shkaqet për zvarritje të procedimeve administrative dhe më pas gjyqësore, pra efektshmëri të ulët të Komisioneve, mandati i të cilëve, në bazë të ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, është shtyrë tashmë deri në 31 dhjetor 2013.

Nga ankesat që janë shqyrtuar, rezulton se nga ana e administratës vendore nuk respektohet dhe nuk zbatohet e drejta për informim gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ, ndaj atyre subjekteve të së drejtës administrative që kanë një interes të drejtëpërdrejtë, ose të ligjshëm në këtë procedim. Gjithashtu, mos respektimi i afateve ligjore, në trajtimin e ankesave, apo kërkesave të personave fizikë dhe juridikë privatë, nga organet e administratës vendore, veçanërisht nga I.N.U.V.-të në Bashki dhe Komuna, ka qenë dhe mbetet një problem mjaft i mprehtë. Mosveprimi i Inspektoriatit Ndërtimor, në rang komune, bashkie apo kombëtar, në shumë raste përbën shkak dhe burim për konflikte dhe mosmarrëveshje mes palëve si dhe zvarritje të mëtejshme të tyre në organet e prokurorisë, apo ato gjyqësore me qëllim që të vihet në vend e drejta e shkelur, apo të pushohet cënimi i pretenduar. Veprimi në kohë dhe zbatimi rigoriz i dispozitave ligjore do të shmangte burokracitë dhe do të sillte një pozitë juridike më të sigurtë për qytetarin dhe pronën e tij.

Synimi për **një mjedis të shëndetshëm** ka qenë një ndër çështjet e trajtuara gjatë punës së institucionit të Avokatit të Popullit në 2012. Problematikat e ankesave të shqyrtuara gjatë këtij viti kanë qenë kryesisht të fokusuar në shmangien e ndotjeve të ambientit nga agjentë të ndryshëm, apo aktivitete të paligjshme e të palicësuara, ndotjen e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, hedhjen e mbeturinave në vende publike, vibrimet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve. Avokati i Popullit konstaton se situata mjedisore dhe mbrojtja e ambientit në Shqipëri kërkon një vëmendje të veçantë dhe bashkëpunim mes qytetarëve dhe strukturave shtetërore. Ende konstatohen probleme me hedhjen e mbetjeve, trajtimin dhe përpunimin e tyre, apo edhe respektimin e normave të tjera mjedisore, të cilat në këndvështrimin e parë nuk lënë pasoja, por efektet e tyre janë afatgjata, të ngadalta dhe të padukshme, duke rrezikuar seriozisht shëndetin dhe jetën e individëve. Inspektoratet e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit në rang qarku duhet të evidentojnë detyrat dhe përgjegjësitë që u burojnë nga aktet ligjore dhe nëligjore, për të patur një kontroll sa më efikas

mbi territorin në të cilin ato ushtrojnë funksionet e tyre. Duhet evidentuar dhe ndëshkuar raset e hedhjes në vende të hapura dhe djegia e lirë e mbetjeve. Duhet marrë masa për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre, monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike, monitorimin dhe marrjen e masave për heqjen e mjeteve motorrike, të rimorkiove, si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare, si dhe detyra të tjera që burojnë nga larmia e akteve që rregullojnë çështjet mjedisore. Qytetarët duhet të perceptojnë si një të drejtë të tyre të jetuarit në një ambient të pastër, por njëkohësisht duhet që dhe ata vetë të kontribuojnë në arritjen e këtij qëllimi.

Avokati i Popullit me ftesë të shoqërisë civile ka ndjekur nga pranë shqyrtimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të kërkesës së një përfaqësie të shoqërisë civile për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të Ligjit nr. 10 463, datë 22. 09. 2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Çështja ndodhet tashmë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, e cila do të vlerësojë kushtetueshmërinë e kësaj kërkesë për referendum. Avokati i Popullit, si dhe shoqëria civile, janë në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

II. Përmbledhje e Raporteve të Veçanta drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Gjatë vitit 2012 institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur gjithësej 7 raporte të veçanta, të cilat janë dërguar në Kuvendin e Shqipërisë deri në datën 05.09.2012.

Përgatitja dhe paraqitja Kuvendit e Raporteve të veçanta bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 63, pika 2 ku parashikohet se: “Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”, si dhe në nenin 27 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku thuhet se: “Përveç raportimit vjetor, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetësh”.

Prej raporteve të veçanta të dërguara në Kuvend deri në dt. 18.02.2013, asnjëri prej tyre nuk është diskutuar e për rrjedhojë, referuar nenit 28 të ligjit 8454 dt. 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, asnjëri prej tyre nuk është bërë publik.

Raportet e veçanta të Avokatit të Popullit janë munduar të sjellin në vëmendje të Kuvendit dhe Ekzekutivit probleme dhe tematika emergjente, të cilat janë gjykuar prej tij se kanë nevojë për t’u adresuar më mirë prej organeve shtetërore, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, ose përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre. Në çdo rast problematika e ngritur nuk ka qenë rrjedhojë e një reagimi të momentit për një ngjarje të veçantë, por rezultat i një studimi disavjeçar, i cili është përpjekur të studiojë fenomenin, duke treguar arsyet e problematikave dhe duke rekomanduar rrugët që sipas mendimit të institucionit të Avokatit të Popullit do të çonin në përmirësimin dhe/ose zgjidhjen e problemit.

Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të problematikës dhe rekomandimeve të pasqyruara në secilin nga Raportet e Veçanta.

Raporti 1 “Për të drejtat e personave LGBT”

Depozituar në dt. 05.09.2012

Në Raport Progresin e BE për Shqipërinë për vitin 2011, është tërhequr vëmendja mbi një serë çështjesh dhe problematikash që ka shoqëria shqiptare në trajtimin e komunitetit LGBT. Në raport theksohet se “...janë raportuar disa raste dhune dhe keqtrajtimi që kanë vënë në shënjestër persona të komunitetit transeksual, si dhe homofobia vazhdon të jetë gjerësisht e përhapur, madje edhe në radhët e zyrtarëve të shërbimit publik.”

Shqipëria ka firmosur e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, të cilat në thelb kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, por edhe të drejtave të komunitetit LGBT në veçanti. Shqipëria ka hartuar edhe legjislacionin të saj në kombëtar në një linjë me këto Konventa, por realiteti tregon se Konventat Ndërkombëtare, apo Legjislacioni Kombëtar, jo gjithnjë zbatohen

Garantimi i zbatimit të të drejtave të këtij komuniteti në praktikë, është konsideruar tepër i rëndësishëm dhe për këtë arsye ato janë përfshirë brenda Rekomandimit 11 të BE për Shqipërinë

“Liritë dhe të drejtat e njeriut”, dhe konkretisht në pjesën e mosdiskriminimit ndaj grupeve të ndryshme shoqërore.

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, një ndër prioritetet e punës së tij, ka dhe respektimin e të drejtave të personave që i përkasin komunitetit LGBT. Nëpërmjet raportit është përpjekur të tregohen problematikat më shqetësuese të këtij komuniteti dhe hapat që duhen ndërmarrë me qëllim garantimin e të drejtave të njohura, duke bërë rekomandimet e mëposhtme:

1. Përfundimin e një Plani Kombëtar Veprimi për Masat për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT. Avokati i Popullit sugjeron që ky plan të jetë gjithpërfshirës në drejtim të institucioneve që do ta hartojnë, por edhe zbatojnë atë, si dhe të jetë sa më i plotë në drejtim të aktiviteteve, masave, treguesve, indikatorëve dhe buxheteve që do të programohen për realizimin e çdo mase.

2. Ndryshimin e Kodit të Punës së RSH:

a. Përfshirjen në pikën 2, të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si shkaqe për diskriminim edhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.

b. Përfshirja në fund të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin. Paragrafi i formuluar duhet të jetë në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 10 të Direktivës 2000/78 EC, pra duke e vendosur barrën e provës mbi punëdhënësin.

3. Në vijim të plotësimit të rekomandimit të sipërcituar, duhet që autoritetet shtetërore përgjegjëse, Inspektorati Shtetëror i Punës, të kontrollojë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave të ndryshuara, në mënyrë që të garantojë edhe zbatimin në praktikë të dispozitës, nga punëdhënësit publik, apo privatë.

4. Ndryshimin e Kodit Penal të RSH, plotësimin e tij në nenin 50, gërma “j”, duke parashikuar edhe orientimin seksual si motiv që përbën rrethanë rënduese. Pra, në gërmën “j” të nenit 50 të Ligjit nr.7895 datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pas fjalës “gjininë” të shtohet shprehja “orientimi seksual”.

5. Përfshirjen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të sigurt, pa dhunë, fyerje, përjashtim social, apo trajtim ç’njëzësor lidhur me orientimin seksual, ose me identitetin gjinor.

6. Trajnimin nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, i stafit akademik për moslejimin e çdo forme diskriminimi duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore për shkak të përkatësisë së tyre seksuale.

Raporti 2 “Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë”.

Depozituar në dt. 27.07.2012

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është pjesa më kryesore dhe më e rëndësishme e realizimit të së drejtës në një shtet ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të funksionijë, nëse vetë ndërtuesit e tij nuk realizojnë problemin më themelor, atë të përfitimit materialisht të kësaj të drejte dhe të garantimit jo vetëm ligjor, por edhe të mbrojtjes efektive të saj.

Informimi për gjendjen e krijuar ngas mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është pasqyruar në raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit ndër vite si dhe në informacione të veçanta drejtuar autoriteteve përgjegjëse. Megjithatë situata nuk rezulton të ketë ndryshuar. Numri i ankesave të qytetarëve drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit për të ndërhyrë pranë autoriteteve përgjegjëse, për të realizuar të drejtën e tyre të fituar gjyqësisht, vazhdon të rritet. Bashkë me numrin e ankesave për këtë objekt, rritet dhe fatura financiare e shtetit për detyrimet që ky i fundit (në rastet kur është debitor) i ka individëve gjyqfitues.

Nëpërmjet raportit Avokati i Popullit është përpjekur të tregojë problematikat më shqetësuese lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, veçanërisht ato në lidhje me kthimet në punë, ekzekutimin e detyrimeve në të holla nga organet e administratës shtetërore dhe pagimin e detyrimit ushqimor, duke bërë rekomandimet e mëposhtme:

- 1) Ndryshimin e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 02, datë 18.08.2011, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”
- 2) Zyrate Përmbartimit duhet në çdo rast të garantojnë ushtrimi e funksioneve të tyre, në zbatim të plotë të ligjit organik si dhe në aplikim të dispozitave të parashikuara në nenet 527, 581, 583, 589 dhe 606 të K.Pr.Civile

Raporti 3 “Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit”.

Depozituar në dt. 24.07.2012

Shqipëria ka nënshkruar pothuajse të gjitha konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me parandalimin dhe dënimin e dhunës ndaj grave si dhe ka përmirësuar legjislacionin e brendshëm të akteve ligjore e nënligjore që promovojnë barazinë ligjore dhe garantojnë mbrojtje për viktimat e trafikut/dhunës po formave të tjera të keqtrajtimit ndaj grave.

Pavarësisht këtyre arritjeve, dhuna ndaj grave vazhdon të jetë një fenomen i përhapur dhe pasojat që ajo sjell kanë nevojë për trajtim të vazhdueshëm dhe serioz prej të gjitha institucioneve të shtetit përfshirë edhe institucionin e Avokatit të Popullit. Nëpërmjet këtij raporti është bërë një analizë e fenomenit të dhunës në familje, të politikave, legjislacionit në fuqi, të mekanizmit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje si dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse, dhe përpjekjet e institucionit të Avokatit të Popullit për trajtimin e rasteve të hetuara administrativisht për mbrojtjen dhe respektimin e **të drejtave të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.**

Raporti evidenton problematikat vijuese:

- 1) Gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës seksuale dhe ato kanë barrën e provës në rastin kur abuzimi seksual ndodh. Gjithsesi, provat mblidhen përmes një raporti mjekësor dhe shpesh nuk bëhen hetime të menjëhershme tërësore. Për më tepër, dhuna psikologjike është tepër e vështirë të provohet dhe shpesh i lë autorët të pandëshkuar. Dhuna përbën elementin kryesor të veprës penale dhe, kur viktimja nuk mund të tregojë prova të shenjave të dhunës, krimi nuk mund të provohet.
- 2) Në praktikë hasen shpesh raste ku i kërkohet viktimës të tregojë nëse e ka provokuar, apo jo personin që ka kryer krimin/aktin e dhunës.
- 3) Abuzimet seksuale për shkak të shpërdorimit të varësisë, ose të detyrës mbeten shpesh të heshtura dhe të padenoncuar..
- 4) Çështja e dëmshpërblimit përmes padisë civile në procesin penal përgjithësisht vazhdon të mos ketë vëmendjen e duhur. Marrja e tij kërkon angazhim të madh, mjete financiare për të paguar një avokat, pasi edhe pse legjislacioni procedural e parashikon diçka të tillë, gjyqtarët, rrallë pranojnë shqyrtimin e padisë civile brenda procesit penal.
- 5) Në praktikë, nuk ndeshen raste të denoncimit të dhunës seksuale midis bashkëshortëve, ndërkohë që, jo rrallë ajo është bërë shkak për divorcet. Kodi Penal nuk parashikon dispozitë të veçantë për marrëdhëniet seksuale me dhunë mes bashkëshortëve, por, nëse bashkëshortja vendos të denoncojë dhunën seksuale të ushtruar nga bashkëshorti i saj, ajo mund t'i referohet për t'u mbrojtur nenit 102 të këtij Kodi.

Në përfundim raporti del me këto rekomandime:

- 1) Vazhdimin e punës për ndërgjegjësimin e komuniteti lidhur me të drejtat e grave nga të gjitha institucionet shtetërore. Me këtë synim, marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara gjatë vitit 2012 midis Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të grave, do të bëjnë të mundur që vetë shoqëria civile "ta përdorë efektivisht Avokatin e Popullit për të përçuar mesazhe të rëndësishme lidhur me gjendjen e të drejtave të grave, ndaj të cilave duhet ndërhyrje ligjore, administrative, etj".
- 2) Shtimi i numrit të vendimeve për urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga Gjykata tregon se është rritur ndërgjegjësimi, reagueshmëria dhe besimi i viktimave të dhunës në sistemin e mbrojtjes. Kësaj shpejtësie në reagim duhet ti përgjigjen edhe strukturat e përmbartimit, të cilat duket të përmirësojnë punën e tyre lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore.
- 3) Shtimin e iniciativave shtetërore kundër fenomenit të dhunës ndaj grave, duke konsoliduar dhe garantuar arritjet e deritanishme.
- 4) Vlerësimin e ndërhyrjeve, të cilat do të garantonin aplikim më të gjërë të padisë civile në procesin penal.

- 5) Rritjen e punës së organeve të policisë dhe drejtësisë, me qëllim identifikimin e autorëve të veprave penale të dhunës ndaj grave dhe dënimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër.
- 6) Aplikimin e politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ritrajnimi me synim përmirësimin e gjendjes ekonomike të grave.
- 7) Ngritjen në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore (qarqe dhe bashki) e mekanizmave të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare
- 8) Ngritjen dhe forcimin e mekanizmave për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht shpejtimin e procesit për emërimin e nëpunësve gjinorë në strukturat e ministrive dhe të nëpunësve vendorë për çështjet gjinore në bashkitë e vendit.

Raporti 4 *“Varfëria dhe kontributi i programit të Ndhmës Ekonomike në reduktimin e saj, si dhe veprimtaria e Avokatit të Popullit lidhur me te”*

Depozituar në dt. 24.07.2012

Nga ankesat e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit del qartë se një numër i konsiderueshëm i popullsisë jeton në kushte mjaft të vështira jetese.

Pavarësisht vlerësimit të saj, qoftë në nivelin sasior e cilësor, në aspektin ekonomik, apo si shqetësim social, ajo mbetet me peshë të dukshme për një numër jo të vogël të familjeve shqiptare. Varferia nuk identifikohet vetëm me të papunët, apo me familjet që jetojnë në varfëri ekonomike, por përfaqësohet gjithashtu me kategori të cilat janë të përjashtuara nga të drejta themelore si: për të patur një banesë, ushqim të mjaftueshëm, ngrohje dhe veshje në dimër, punë në përputhje me aftësitë fizike, nivelin arsimor dhe formimin profesional, shkollë afër shtëpisë dhe mundësi për ta ndjekur atë, akses në shërbim shëndetësor, mbrotje nga grabitja dhe dhuna, të drejtë dhe zë për të kërkuar të drejtat. Prandaj, duke qenë se varfëria është problem social shumë kompleks, me shumë shkaqe dhe e lidhur me mjaft faktorë, ajo duhet të vlerësohet më intensivisht dhe njëherësh me angazhim të fortë individual, shoqëror, komunitar dhe shtetëror.

Pasi ka identifikuar problematikat më të ndjeshme lidhur me varfërinë dhe kontributin që programi i ndihmës ekonomike ka dhënë për reduktimin e saj, Avokati i Popullit ka bërë rekomandimet e mëposhtme:

- 1) Shtrirja e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës, do të shndërrojë atë nga një skemë passive, në një skemë aktive të mbrojtjes sociale.
- 2) Nevojitet hartimi i politikave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore me njësitë e qeverisjes vendore, apo edhe sisteme monitorimi të përbashkëta, për të identifikuar familjet që realisht nuk kanë të ardhura nga “Puna e zezë”, me qëllim punësimin në përshtatje me formimin profesional të anëtarëve të familjes në moshë pune, si dhe integrimin e tyre në jetën ekonomike dhe sociale.

- 3) Rritja e punësimit dhe ulja e papunësisë, është rruga kryesore për rritjen e prodhimit dhe të të ardhurave, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e varfërisë.
- 4) Ndihma ekonomike ka një ndikim relativisht të ulët tek varferia, duke qenë se mbulimi që ajo siguron (masa e përfitimit) është e pamjaftueshme për përballimin e jetesës.
- 5) Moskoordinimi mes institucioneve vendore e qendrore, të cilat janë pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale, ka ngadalësuar hapat e integritit të jetimëve në vendin tonë. Problem që duhet përmiresuar është identifikimi i nevojave të fëmijëve jetime në nivel vendor. Përfitimet e tyre në bazë të statusit të jetimit aktualisht nuk mbulojnë nevojat jetike.
- 6) Shkaqet e punës së rëndë të fëmijëve duhen kërkuar tek perjashtimi social, mundësitë e pakta të familjeve për të siguruar të ardhura, si dhe varfëria. Megjithë fushatat e ndërgjegjësimit nga njësitë e qeverisjes vendore, shkollat, OJF-të, fenomeni i shfrytëzimit për punë nuk është parandaluar. Nevojitet një koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve lidhur me këtë problem, si dhe ofrim alternativash për formimin profesional të të rinjve në moshë pune.
- 7) Është e nevojshme të ndërgjegjësohen prindërit, apo të rriturit për shkollimin dhe formimin profesional në përgjithësi, në mënyrë që ata të vlerësojnë faktin që një fëmijë i arsimuar ka mundësi më të mira për punësim dhe të ardhura, sesa një fëmijë i paarsimuar, dhe se punësimi i bazuar në një arsimim cilësor mundëson përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së tyre.
- 8) Impenjimi dhe shkalla e përgjegjësisë e institucioneve shtetërore dhe e faktorëve të tjerë aktive të shoqërisë civile, informimi i drejtë i strukturave përgjegjëse dhe opinionit, do të rrisë interesin e të gjithë shoqërisë dhe ndikimin e tyre në mbrojtjen e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, sigurimin e një niveli ekonomik të nevojshëm për ta, për përmirësimin e kushteve të strehimit, të rritjes së mundësive për punësim, për ngritjen e nivelit të tyre kulturor, arsimor e profesional, me synim integrimin e tyre të metejshëm në shoqëri.
- 9) Megjithëse masa e Ndihmës Ekonomike tenton të plotësojë nivelin e varfërisë, prej 2 USD në ditë për person, mekanizmi aktual nuk e ofron plotësisht këtë mundësi sepse ekzistojnë kufizime të shumta ligjore që e frenojnë këtë proces. Kufizimet diskriminojnë familjet me shumë anëtarë, ku dominojnë fëmijët.
- 10) Sipas të dhënave të anketave të LSMS rezulton se të varferit në rreth 50% të tyre jetojnë në familje që kanë në përbërje 6 e më shumë anëtarë, ku reziku i varfërisë është prezent në familjet që kanë si kryefamiljar individ që janë pa arsim, ose me arsim 4 ose 8 vjeçar.
- 11) Për shkak të kufizimit (tavanit) prej 8000 lekë në muaj për familje, familjet me shumë anëtarë sipas mekanizmit të sotëm përfitojnë mesatarisht me pak lek për çdo person, se sa përfitojnë familjet e tjera të varfëra që kanë më pak persona në përbërje të tyre.

- 12) Për të vendosur drejtësi e barazi në përfitimin e masës së NE, pa ndryshuar mekanizmin ekzistues të përlllogaritjes sipas strukturës së familjes, për të gjithë kategoritë e personave kudo që ato janë në njësi të ndryshme vendore, duhet të rritet tavan i masës së NE për familje.
- 13) Në kushtet e plotësimit të objektivave të përfshirjen sociale dhe mos diskriminimin e grupeve vulnerabël dhe veçanërisht të pakicave (romët, egjyptianet), apo familjet me shumë fëmijë etj, mendojme që kufizimi (tavani) nga 8000 lekë në muaj për familje, të paktën tani për tani të rritet deri në 10.000 lekë në muaj, duke tentuar të afrohet sa të jetë e mundur më afër me nivelin e pensionit minimal në qytet.

Raporti 5 *“Problematikat e komunitetit rom gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2012, dhe trajtimi i tyre nga Avokati i Popullit”*

Depozituar në dt. 16.07.2012

Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”, duke sanksionuar kështu barazinë, pa asnjë lloj diskriminimi të të gjithë personave që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë: shqiptarë, pjesëtarë të pakicave kombëtare, të huaj, apo persona pa shtetësi.

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, një ndër prioritetet e punës së tij, ka dhe respektimin e të drejtave të komunitetit rom, si një komunitet, i cili jeton në kushte jetese tejet të vështira. Përmbushja e detyrimeve, që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, me qëllim që ky komunitet të jetojë me standartet e pjesës tjetër të popullësisë në vendin tonë, kërkon koordinim ndërinstytucional, me rëndësi thelbësore për mbrojtjen më efektive të të drejtave të komunitetit rom. Në këtë raport Avokati i Popullit thekson se ndonëse zgjidhjet e problemeve të këtij komuniteti nuk janë as të lehta, as të thjeshta dhe as të shpejta, por pjesë integrale, të lidhura pazgjidhshmërisht me zhvillimin tërësor të Shqipërisë, pra edhe me forcimin e vazhdueshëm të ekonomisë, duhen zbatuar strategji të qarta, të cilat do të garantojnë përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij komuniteti.

Pasi identifikon problematikat dhe analizon mënyrën e adresimit të tyre, raporti përmban rekomandimet e mëposhtme:

1. Ndryshimin e ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), për të dhënë rregullime më të qarta dhe të sakta, për familjet e komunitetit rom. Për më tepër sugjerojmë përfshirjen si kategori prioritare brenda kushit social për përfitimin e strehimit.
2. Ndryshimin e akteve nënligjore, të cilat parashikojnë kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe transferimit të gjendjes civile, duke hequr për familjet e komunitetit rom, parashikimet të cilat lidhen me pasjen në pronësi, ose me qira të një banese.
3. Vazhdimin e përpjekjeve për funksionimin e klasave përgatitore për arsimin parashkollor,

për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve romë në të gjitha nivelet e arsimit dhe bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të ndërgjegjësuar pjesëtarët e komunitetit rom, për moslargimin e fëmijëve të tyre nga ndjekja e shkollës.

4. Marrjen e masave për përfshirjen në vazhdimësi, me prioritet, të pjesëtarëve të minoritetit rom në programet e formimit profesional dhe punësimit në vazhdimësi, me prioritet, të personave në moshë pune të minoritetit rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që ky minoritet të mos ndihet i diskriminuar.

5. Marrjen e të gjitha masave të mundshme organizative për përgatitjen e vend-strehimeve apo vend-qendrimave provizore për grupe të tilla në nevojë emergjente, si pjestarë të komunitetit rom, personave endacakë, apo të pastrehë dhe këdo tjetër që kërkon ndihmë nga organet e pushtetit vendor, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën, apo shëndetin e tyre, veçanërisht të fëmijëve.

6. Të miratohet nga Këshilli i Ministrave një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të seminarit (të z. Pier Mirel) të dhjetorit 2011 "Për të drejtat e minoritetit rom", si dhe të ndërmerren në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit masa ligjore dhe zbatuese për zgjidhjen e problematikave, me të cilat ndeshen qytetarët romë, duke filluar nga regjistrimi, strehimi, punësimi, arsimimi, përfitimi i ndihmës ekonomike etj.

Raporti 6 "Për situatën e krijuar pas përmbytjeve në qarkun e Shkodrës"

Depozituar në dt. 06.07.2012

Gjatë muajit dhjetor 2010 qarku i Shkodrës u përball për herë të dytë me përmbytje të mëdha, të cilat arritën të preknin jo vetëm zonat e banuara të këtij qyteti, kryesisht lagjet që ishin afër me Liqenin e Shkodrës, por edhe komunat dhe fshatrat që shtriheshin përgjatë shtratit të Lumit Drin dhe Buna.

Gjendja e krijuar ishte alarmante për banorët e Shkodrës në përgjithësi, të cilët ishin të prekur direkt, apo indirekt nga përmbytja e krijuar, duke ngjallur pasiguri dhe shqetësim për jetën dhe shëndetin e banorëve. Raporti fokusohet në problematikën që kanë rezultuar nga hetimi i nisur nga institucioni i Avokatit të Popullit në zonat e përmbytura.

Pasi ka identifikuar problematikën dhe fushat e ndërhyrjes emergjente me qëllim zbutjen dhe eliminimin e pasojave të përmbytjes, raporti përmban rekomandimet e mëposhtme:

- 1) Alokimin e fondeve nga KESH në një Depozitë të veçantë të Qeverisë Shqiptare. Mungesa e fondeve nga KESH nuk mund dhe duhet të jetë arsye, apo shkak ligjor për zvarritjen e dhënies së dëmshpërblimit të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave.
- 2) Duhet marrë në konsideratë pretendimet e subjekteve tregtare si dhe procedurat e vlerësimit të dëmeve dhe klasifikimit të tyre jashtë listës së përfituesve. Në këtë aspekt, shprehim kritikën tona institucionale për mungesën e bashkëpunimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, e cila për asnjë moment nuk vuri në dispozicion të Avokatit të Popullit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në rrugë zyrtare.

- 3) Duhet miratuar një vendim i ri i Këshillit të Ministrave, ku të parashikohen ato subjekte të lëna në harresë gjatë procedurave të përpilimit të dokumentacionit nga ana e DRBUMK Shkodër, me qëllim që të gjithë fermerët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të përfitojnë dëmshpërblimin ashtu si dhe bashkëfshatarët e tyre.
- 4) Të miratohet vendimi i Këshillit të Ministrave për dëmshpërblimin e banorëve të qytetit të Shkodrës, të cilat kanë pësuar dëme serioze në banesat dhe orenditë e tyre shtëpiake.
- 5) Duhet miratuar një Udhëzim i përbashkët mes Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm, në zbatim të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 82 datë 06.12.2011, për kryerjen e pagesave për personat përfitues.
- 6) Duhet realizuar investime konkrete brenda një afati të shkurtër, duke shmangur periudhën e vjeshtës dhe shirave të mundshëm, me qëllim që të shmangen përmbytje të tjera të zonave të rrezikuara.

Raporti 7 *“Për veprimtaria e Avokatit të Popullit dhe niveli i zbatimit të Rekomandimit 12 të Opinionit të Komisionit Europian për Shqipërinë”*

Depozituar në dt. 23.04.2012

Përmbajtja e Rekomandimit 12 të opinionit të Komisionit Europian është njëra prej pikave mjaft të rëndësishme që përfshin në mënyrë aktive rolin e Avokatit të Popullit për të ndikuar në përmirësimin e trajtimit të individëve të privuar nga liria në burgje, paraburgime dhe polici, si dhe hetimin e rasteve të keqtrajttimeve. Gjithashtu, ky rekomandim nënkupton në mënyrë imperative nevojën për të monitoruar shëndetin mendor në këto ambiente si dhe në spitalet psikiatrike.

Hartimi i raportit të posaçëm ka për qëllim të evidentojë kontrollin e kryer në mënyrë të pavarur nga Institucioni i Avokatit të Popullit për të qartësuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të tij nga ana e administratës publike, nën fokusin e implemtimit të Rekomandimit 12 të Komisionit Europian.

Nga kontrolli i kryer në të gjitha vendet e privimit të lirisë dhe rekomandimeve të dala nga institucioni i Avokatit të Popullit, vërehen një sërë problematikash të cilat kanë nevojë të ngutshme të shyrtohen dhe përmirësohen. Më konkretisht në vijim po paraqesim disa nga problemet ende të pazgjidhura të cilat në terma praktike duhet të konsiderohen prioritet për performancën e administratës sonë publike në kuadër të integritetit të vendit në BE, dhe për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut:

- 1) Zgjidhja përfundimtare e sistemimit në një institucion të veçantë të të sëmurëve mendorë me shtrim të detyrues, jashtë mjediseve të burgjeve dhe paraburgimeve;
- 2) Miratimin e një akti nënligjor të veçantë, që përcakton modelin e ndërtimit të burgjeve dhe qendrave shëndetësore për të burgosurit dhe paraburgosurit;

- 3) Standartartizimin e mëtejshëm të mjediseve të shoqërimit dhe sigurisë në polici, duke i sjellë ato në përputhje me normat e parashikuara në legjislacionin në fuqi;
- 4) Përcaktimin e saktë të mjeteve dhe formave të shtrëngimit fizik të personave, si dhe bërjen publike të çdo manuali, apo praktike standarde që perdoret në këto raste;
- 5) Eliminimin e praktikave abuzive të provokimit të të dyshuarve për vepra penale; ushtrimin e kontrolleve sipas një manuali që respekton dinjitetin njerëzor dhe heqjen dorë nga mbështetja me dëshmi në grup të policisë, në rast denoncimi për dhunë nga pala e dëmtuar;
- 6) Përmirësimin e kushteve në disa prej mjediseve të spitaleve psikiatrike nëpërmjet orendive të reja, pajimeve personale, si dhe përmirësimit të ushqimit për të sëmurët;
- 7) Vijimin e dehospitalizimit të të sëmureve mendorë kronikë pranë qendrave komunitare dhe respektimin e procedurave të shtrimit të tyre të detyrueshëm.

III. Kontributi i Avokatit të Popullit për procesin e Integrimit Europian

Krahas mbrojtjes të së drejtave të qytetarëve nga veprimet, apo mosveprimet e paligjshme të administratës publike dhe promovimit e përmirësimit të standardeve të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka një rol thelbësor në procesin e integrimit europian. Në këtë aspekt, mandati i tij i gjerë përfshin fusha të tilla si: shteti ligjor, qeverisja e mirë, transparenca, antikorrupsioni, të drejtat e njeriut, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se reformat, që ndërmerren nga institucionet e shtetit shqiptar, duhet të jenë të përqasura me standardet më të mira ndërkombëtare, duke garantuar në këtë mënyrë zbatimin e parimeve demokratike të shtetit të së drejtës dhe të të drejtave të njeriut. Zbatimi i ligjit në mënyrë të barabartë **për të gjithë qytetarët** nga institucionet qendrore, organet e qeverisjes vendore, si dhe respektimi i parimeve themelore të një shteti demokratik, ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe **përmbushjen e interesave të tyre**. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se si garanci për këtë shërben qeverisja e mirë, e drejtë, asnjëanëse dhe e orientuar drejt filozofisë së zbatimit të ligjit për të mundësuar mirë funksionimin e shoqërisë dhe përparimin e saj në rrugën e zhvillimit.

Gjatë vitit 2012, institucioni i Avokatit të Popullit ka kontribuar në vazhdimësi, me nismat, analizat dhe rekomandimet e tij, edhe në drejtim të plotësimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për Zbatimin e 12 Rekomandimeve të Komisionit Europian për Shqipërinë, ndër të cilat mund të veçojmë tre kontribute kryesore:

1. Raporti për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012, dërguar Ministrisë së Integrimit.
2. Raporti i Veçantë për veprimtarinë e Avokatit të Popullit dhe nivelin e zbatimit të Rekomandimit 12 të Opinionit të Komisionit Europian për Shqipërinë, dërguar Kuvendit të Shqipërisë.
3. Disa mendime për projektligjin “Për nëpunësin civil”, dërguar strukturave të administratës publike dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në themel të këtyre raporteve, si edhe në çdo hap të Avokatit të Popullit, qëndron qasja konstruktive për të ndihmuar, brenda mandatit dhe mundësive të tij, në përmbushjen e aspiratës kombëtare për integrim në Bashkimin Europian dhe, më gjerë, në strukturat euro-atlantike.

I. ZBATIMI I MASAVE TË PARASHIKUARA NË REKOMANDIMET 6, 7, 10, 11 DHE 12 TË BE PËR SHQIPËRINË, TË CILAT KANË LIDHJE ME FUSHËN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT.

Në këtë raport, Avokati i Popullit analizon në mënyrë të hollësishme rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 dhe masat e parashikuara për zbatimin e tyre.

Lidhur me Rekomandimin 6, “Reforma në administratën publike” Avokati i Popullit, ndër të tjera, rekomandon: a) të zbatohen standardet e vendosura nga kuadri ligjor ekzistues që garanton marrëdhëniet e punës nga ana e administratës publike, qendrore dhe vendore; b) të nxirret përgjegjësia e drejtuesve të institucioneve (dëmi jashtëkontraktor) të cilët, me veprimet e tyre të parregullta dhe të pabazuara, rrisin faturën financiare të detyrimit të shtetit ndaj gjyqfituesve; c) të rriten kapacitetet e stafeve të administratës publike, që janë përgjegjëse për

ndjekjen e procedurës për largimin nga puna, me qëllim që të realizohet kuptimi dhe zbatimi i drejtë i procedurës së parashikuar në ligj dhe t'u garantohen punëmarrësve të drejtat e sanksionuara; etj.

Vlerësimi i institucionit të Avokatit të Popullit për Rekomandimin 7 "Reforma në Gjyqësor" është fokusuar në masat që garantojnë *aksesin në drejtësi* të grupeve vulnerabël, si dhe zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore. Ndër rekomandimet e bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit për ofrimin e ndihmës juridike, janë: I) trajtimi si raste me përparësi i grupeve vulnerabël, të tilla si, romët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë e dhunuara, personat përfitues të ndihmës ekonomike etj.; II) lehtësimi i procedurave dhe dokumentacionit që paraqitet për përfitimin e ndihmës juridike, duke shmangur shpenzimet e vetë individit; III) krijimi i mundësisë për lista të hapura të avokatëve, me qëllim zgjedhjen nga vetë individit të avokatit që do t'i ofrojë ndihmën juridike; IV) monitorimi nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar nga avokatët, apo organizatat jofitimprurëse, si një element shumë i rëndësishëm për garantimin dhe dhënien e drejtësisë ndaj cilitdo që pretendon se i është shkelur e drejta.

Lidhur me *ekzekutimin e vendimeve gjyqësore*, Avokati i Popullit ka përgatitur një raport të veçantë për zbatimin e vendimeve gjyqësore nga organet e administratës publike, si dhe për shkallën e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim të analizës, Avokati i Popullit ofron edhe disa rekomadime, ndër të cilat veçojmë:

- Rritjen e kapaciteteve profesionale dhe standardeve etike të stafit përmbarimor,
- Unifikimin e praktikave përmbarimore,
- Përmirësimin e infrastrukturës së Shërbimit Përmbarimor Shtetëror,
- Hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor për mënyrën dhe afatin maksimal të ekzekutimit të titujve ekzekutivë nga organet e shtetit lidhur me detyrimet monetare, apo kryerjen e një veprimi të caktuar (neni 605 i KPrC).
- Krijimin e një baze të dhënash për pasqyrimin e të gjitha praktikave përmbarimore, ku debitorë janë institucionet buxhetore.

Lidhur me *Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.2, datë 18.08.2012 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit"*, Avokati i Popullit konstaton se ka përcaktime, të cilat nuk vijnë në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Civile për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv. Ato krijojnë premisa për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm dhe tejkalojnë misionin për ekzekutim pranë personit të tretë apo palës debitore.

Në kuadrin e Rekomandimit 10 "Strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e pronës" institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar vazhdimisht pranë AKKP-së, përcaktimin përfundimtar të fondit të pasurive të paluajtshme për kompensim fizik të të shpronësuarve, veprim ky i cili nuk është realizuar dhe vështirë që të realizohet në të ardhmen e afërt, kur rreth 20% e trojeve nuk janë futur në sistem (nuk janë dixhitalizuar dhe regjistruar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme). Duke qenë se kompensimi financiar mbetet i vështirë për t'u realizuar, kompensimi fizik do të ishte zgjidhja më e mirë, si për qeverinë, ashtu dhe për ish-pronarët.

Përsa i takon Rekomandimit 11, “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut” në morinë e të drejtave të cënura, Avokati i Popullit ndalet në dukuri të tilla negative si: dhuna në familje; procesi i dëmshpërblimit të gruas që ka pësuar torturë, dhunë seksuale, ose forma të tjera të keqtrajtimit; të drejtat e komunitetit LGBT; të drejtat e fëmijëve; të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; të drejtat e komunitetit rom; etj. Si në ëdo rast tjetër, Avokati i Popullit ofron edhe rekomandimet e tij për përmirësimin e situatës së grupeve vulnerabël.

II RAPORTI I VECANTË PËR VEPRIMTARINË E AVOKATIT TË POPULLIT DHE NIVELIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMIT 12 TË OPINIONIT TË KOMISIONIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË.

Në këtë raport, duke analizuar masat që duhen marrë për përmirësimin e situatës në institucionet e burgjeve dhe paraburgimit, Avokati i Popullit vëren një sërë problematikash, të cilat kanë nevojë të ngutshme të shqyrtohen dhe përmirësohen. Më poshtë renditen disa prej tyre:

1. Zgjidhja përfundimtare e sistemimit në një institucion të veçantë të të sëmurëve mendorë me shtrim të detyruar, jashtë mjediseve të burgjeve dhe paraburgimeve;
2. Miratimin e një akti nënligjor të veçantë, që përcakton modelin e ndërtimit të burgjeve dhe qendrave shëndetësore për të burgosurit dhe paraburgosurit;
3. Standartartizimin e mëtejshëm të mjediseve të shoqërimit dhe sigurisë në polici, duke i sjellë ato në përputhje me normat e parashikuara në legjislacionin në fuqi;
4. Përcaktimin e saktë të mjeteve dhe formave të shtrëngimit fizik të personave, si dhe bërjen publike të çdo manuali, apo praktike standarde që perdoret në këto raste;
5. Eliminimin e praktikave abuzive të provokimit të të dyshuarve për vepra penale; ushtrimin e kontrolleve sipas një manuali që respekton dinjitetin njerëzor dhe heqjen dorë nga mbështetja me dëshmi në grup të policisë, në rast denoncimi për dhunë nga pala e dëmtuar;
6. Përmirësimin e kushteve në disa prej mjediseve të spitaleve psikiatrike nëpërmjet orendive të reja, pajimeve personale, si dhe përmirësimit të ushqimit për të sëmurët;
7. Vijimin e dehospitalizimit të të sëmureve mendorë kronikë pranë qendrave komunitare dhe respektimin e procedurave të shtrimit të tyre të detyrueshëm.

III. DISA MENDIME PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NËPUNËSIN CIVIL

Forcimi dhe thellimi i demokracisë në shoqërinë shqiptare, forcimi i demokracisë institucionale, rritja e nivelit të qeverisjes dhe garantimi i plotë e i gjithanshëm i lirive, të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve nxjerr si domosdoshmëri forcimin e shërbimit civil, mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, të pavarësisë, integritetit, të paanësisë politike, të transparencës dhe shërbimit cilësor ndaj publikut. Bazuar në këto parime, projektligji “Për nëpunësin civil”, duhet të garantojë zbatimin e parimeve kushtetuese, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në të, si dhe të standardeve të akteve ndërkombëtare në këtë fushë.

Pasi i bën një analizë të hollësishme përmbajtjes së këtij projektligji, Avokati i Popullit ka dhënë edhe rekomandime për mënyrën konkrete të përmirësimit të disa prej neneve më kryesore të këtij projektligji. Në tërësi, Avokati i Popullit sugjeron ripunimin e tij në bazë të

rregullave të teknikës legjislative, plotësimin e përkufizimeve dhe nocioneve që janë përdorur në përmbajtjen e tij, përdorimin e terminologjisë së duhur në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, kufizimin e përcaktimeve të përgjithshme dhe parashikimin sa më të plotë të çështjeve me rëndësi të veçantë në brendinë e tij, duke shmangur delegimin e rregullimit të tyre me akte nënligjore. Avokati i Popullit mendon se hartimi i këtij projektligji është një përpjekje për t'u dhënë zgjidhje shumë problemeve që kanë dalë gjatë zbatimit në praktikë të ligjit aktual në fuqi, si dhe rekomandimeve të Opinionit të Komisionit të BE për Shqipërinë në vitin 2010. Ai sugjeron që përmbajtja e projektligjit të konsultohet me institucionet, të cilat do të jenë pjesë e shërbimit civil sipas këtij ligji, me nëpunësit mbi të cilët do të shtrihen dispozitat e tij, si dhe me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, me synim zbatimin korrekt të tij në të ardhmen.

IV. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit të pranuar nga institucionet e administratës publike

Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit i ka themelet e tij në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në të cilën në nenet 60 deri në nenin 63 jepen nocionet e funksionimit të tij, kompetencat, parimet e veprimtarisë dhe statusi i tij.

Veprimtari e Avokatit të Popullit rregullohet në ligjin nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit " ndërsa në ushtrimin e aktivitetit të tij institucioni i Avokatit të Popullit bazohet vecanërisht në legjislacionin e mëposhtëm:

- ❖ Kodi i Procedurave Administrative,
- ❖ Ligji "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare",
- ❖ Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim"
- ❖ Ligji "Për mbrojtjen e Konsumatorit"
- ❖ Ligji " Kundër Diskriminimit"

Mbështetur në kuadrin ligjor të përmendur më sipër, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ose të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Juridiksioni i tij përfshin qeverinë, ministritë, institucione të tjera qendrore, siç janë shërbimet sekrete, Banka Kombëtare dhe bankat me pjesëmarrje kapitali shtetëror, entet publike, organet e pushtetit vendor, ku përfshihen prefekturat, qarqet, bashkitë, komunitat si dhe ato institucione apo autoritete publike që veprojnë për llogari të këtyre organeve të administratës publike dhe institucionet në varësi të tyre në qendër dhe rrethe.

Ky monitorim u bë nga Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, me seli në Tiranë, e cila është një organizatë jo qeveritare, jo fitimprurëse, e barazlartuar nga çdo ndikim politik. Ajo ushtron aktivitetin e saj në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në procesin e integritit që nga viti 2002.

Kjo qendër ka një CV të pasur në lidhje me kryerjen e monitorimeve në raport me zbatimin e ligjeve nga ana e institucioneve shtetërore në nivel kombëtar apo lokal dhe disponon burime njerëzore të kualifikuara në këtë lloj veprimtarie.

Ky monitorim u kërkua nga Institucioni i Avokatit të Popullit me qëllim verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të pranuar nga Administrata Shtetërore..

METODOLOGJIA

Monitorimi u realizua në një periudhë kohore 5 ditore, nga dita e hënë, datë 11 shkurt deri në ditën e premte, datë 15 Shkurt 2012. Kohëzgjatja ditore e punës së eksperteve ka qenë 8 orë në ditë.

Qëllimi i monitorimit ka qenë matja e nivelit të zbatueshmërisë së ankesave dhe rekomandimeve të pranuar nga organet e administratës publike në nivel qendror e lokal, që institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar gjatë vitit kalendarik 2012.

Gjatë vitit 2012, numri i ankesave të shqyrtuara nga stafi i Avokatit të Popullit ishin 3965 ankesa nga të cilat 1795 ishin brenda kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Prej tyre 1368 ankesa janë pranuar si të drejta nga organet e administratës publike dhe wshtw raportuar zbatimi i tyre, rregullimi i situatës dhe/ose ndalimi i shkeljes. Për të njohur dhe vlerësuar zbatueshmërinë e ankesave dhe rekomandimeve të pranuar . Për realizimin e këtij monitorimi, në mënyrë që qëllimi të arrihej me sukses, u përjashtuan nga mundësia për t'u monitoruar rastet si më poshtë:

1. Dosjet për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit kishte nisur investigimin me iniciativen e tij.
2. Dosjet të cilat nuk kishin një numër telefoni fiks apo celular për t'u kontaktuar. Kjo ndihmonte në kontaktimin 100% të qytetarëve ankues.

Përjashtimi i këtyre dosjeve do të ndihmonte në nxjerrjen e saktë të rezultatit të monitorimit dhe, nga ana tjetër, do të shmange cdo lloj ndikimi në të.

Kështu, me short nga lista e përgjithshme e ankesave të qytetarëve të pranuar nga organet e administratës publike, u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme 400 dosje të trajtuara nga stafi ndihmës dhe komisionerët e Avokatit të Popullit. Të gjitha dosjet përmbanin masat e sugjeruara nga stafi i Avokatit të Popullit dhe numërin e telefonit celular apo fiks.

Monitorimi u realizua në zyrat e institucionit të Avokatit të Popullit, ku na u vu në dispozicion 1 zyrë për të punuar si edhe 2 linja telefoni me numra të ndryshëm, të cilët do të ndihmonin për realizimin e monitorimit.

Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, kishte caktuar 2 ekspertë të saj, Z. Ilir Aliaj dhe Znj. Viola Plumbi, të dy me profesion jurist, të cilët u angazhuan me kohë të plotë për këtë monitorim.

Detyra e ekspertëve konsistonte në këto çështje:

- ❖ Të evidentonin nëse dosjet përmbanin masa të sugjerura për zgjidhje nga Avokati i Popullit
- ❖ Të evidentonin nëse dosjet kishin telefona kontakti (ceularë apo fiks)
- ❖ Të kontaktonin nëpërmjet telefonit me qytetarin për të pyetur nëse sugjerimet e Avokatit të Popullit ishin respektuar nga institucioni me të cilin qytetari kishte ndeshur vështirësi në krye të herës.
- ❖ Të hartonin raportin përfundimtar të monitorimit.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Nga shqyrtimi i 400 dosjeve të përzgjedhura për monitorim, problematikat për të cilat publiku ankohet ishin të shumta dhe konsistonin kryesisht në çështjet sociale, ekonomike, ligjore etj., për të cilat ata nuk kishin mundur të gjenin zgjidhje deri në momentin kur i ishin drejtuar Avokatit të Popullit.

Për të paraqitur sa më mirë larminë e ankesave të qytetarëve po i grupojmë ato në kategoritë e mëposhtme:

1. Ankesa për probleme që lidhen me pronësinë. Në këtë kategori përfshihen ankesat për probleme të mosregjistrimit të pronave në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive, probleme në vonesa të procesit të legalizimeve të banesave, probleme të vonesave në shqyrtimin e dosjeve të pronësisë nga Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, probleme me shpronësimet, probleme me vonesat në pagesën e shpronësimit.

Numri total i tyre është **59**.

2. Ankesa për probleme sociale. Në këtë kategori përfshihen ankesat që lidhen me problemet e pensioneve, me probleme të masës së përcaktimit të tij, me probleme të kategorizimit të pensioneve, me probleme për mospranimin në azilet e pleqve, probleme me spitalet, probleme me mospagimin e sigurimeve shoqërore, probleme me mosdhënien apo vonimin e ndihmës ekonomike, problemet e largimeve të padrejta nga puna, problemet me përfitimin e statusit të personit me aftësi të kufizuar dhe të masës së kompensimit nga ky status.

Numri total i tyre është **57**.

3. Probleme të sistemit gjyqësor. Në këtë kategori përfshihen ankesat për probemet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, problemet me zyrat e përmbarimit, problemet me gjykatat për zvarritje të proceseve gjyqësore apo mosvënien në dispozicion të vendimeve të gjykatës.

Numri total i tyre është **42**.

4. Probleme me Prokurorinë dhe Policinë e Shtetit. Në këtë kategori hyjnë ankesat që lidhen me problemet e Prokurorive për mosfillimin e procedimeve penale, problemet me policinë e kalimit të kufirit, problemet me sekuestrimin e automjeteve, etj.

Numri total i tyre është **42**.

5. Probleme me entet publike. Në këtë kategori përfshihen ankesat që lidhen me problemet e furnizimit me ujë të pijshëm, problemet e furnizimit me energji elektrike, me mbifaturimin e këtyre shërbimeve, me problemet e pagimit të taksës së televizionit publik, me gjelbërimin, me uljen e nivelit të zhurmës, me mirëmbajtjen e rrugëve.

Numri total i tyre është **103**.

6. Probleme me pushtetin vendor. Në këtë kategori përfshihen ankesat që lidhen me probleme të mosfunksionimit të këshillave bashkiake, probleme që lidhen me strehimin e qytetarëve, probleme të ndërtimeve pa leje, probleme të uzurpimit të pronës private.

Numri total i tyre është **67**.

7. Probleme me pushtetin qendror, Në këtë kategori përfshihen ankesat që lidhen kryesisht me respektimin e ligjit “ Për të drejtën e informimit të publikut mbi dokumentat zyrtare”, moskthim përgjigjeje për miratime aktesh ligjore dhe nënligjore.

Numri total i tyre është **30**.

Ankesat e depozituara në dosjet, në bazë të problematikës që trajtonin, kishin si objekt ankimit ndaj institucioneve të ndryshme publike, qendrore dhe lokale. Qytetari ankohej për mosrespektim të ligjit nga ana e këtyre institucioneve, për mosdhënie informacioni, për mosrespektim të vendimeve të gjykatës dhe për probleme të tjera që lidhen, në tërësi, me mosfunksionimin siç duhet të këtyre institucioneve.

Kështu, gjatë shqyrtimit të dosjeve u vu re se institucionet kundrejt të cilave bëheshin ankime nga qytetarët mund t'i klasifikojmë si më poshtë:

- Institucionet e qeverisjes qendrore, të tilla si institucioni i Presidencës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Integritit, Ministria e Punës dhe Cështjeve Sociale, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Shëndetësisë.
- Institucione të qeverisjes vendore, të tilla si bashkitë, komunat, dhe prefekturat.
- Institucionet e vartësisë, të tilla si: Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, drejtoritë arsimore, Inspektoriat i Ndërtimit, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive, Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyrat e gjendjes civile, zyrat e përmbarrimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, etj.
- Entet publike të tilla si: Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve, CEZ Shpërndarje, etj.
- Institucionet e sistemit të drejtësisë, të tilla si gjykatat, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, drejtoritë e burgjeve, prokuroritë.
- Institucionet e ruajtjes së rendit të tilla si: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, komisariatet e policisë.

Kontakti telefonik me qytetarët ankues pranë Avokatit të Popullit ishte shumë miqësor dhe frytdhënës në realizimin e këtij monitorimi. Gjatë telefonatave nuk patëm asnjë lloj refuzimi për të na kthyer përgjigje në lidhje me pyetjen që ne ju shtronim, pra nëse Avokati i Popullit kishte parashtruar zgjidhje për problemin e tyre.

Në të gjitha telefonatat, qytetarët shpreheshin me shumë respekt dhe mirënjohje për të gjithë stafin e Avokatit të Popullit, pavarësisht statusit në të cilin ishte zgjidhja e problemit të tyre. Madje, pati disa raste kur vetë qytetarët dëshironin të vinin në zyrën e Avokatit të Popullit për të treguar më hollësisht në lidhje me përpjekjet dhe ndihmën e madhe jo vetëm ligjore, por edhe morale, që stafi i Avokatit të Popullit kishte bërë për ta.

Ata vlerësuan shumë faktin që u rikontaktuan vullnetarisht nga Avokati i Popullit, për t'i pyetur nëse sugjerimi i dhënë prej institucionit të tij ishte zbatuar nga institucionet përkatëse apo nëse qytetari i kishte ndjekur udhëzimet e Avokatit të Popullit. Kjo për qytetarin ishte një risi, që një institucion shtetëror interesohej edhe mbas një periudhe kohe në lidhje me zgjidhjen e problemeve të tyre.

Nga monitorimi telefonik, secili qytetar u përgjigj në mënyrë të hapur në lidhje me zgjidhjen e problemit të tij. Ne po i klasifikojmë si më poshtë:

1. Ankesa dhe rekomandime të pranuar dhe të zbatuara. Në këtë kategori hyjnë ankesat dhe rekomandimet e pranuar nga institucionet e administratës publike, të cilat rezultojnë se janë zbatuar.

Numri i tyre është 232.

2. Ankesa dhe rekomandime të pranuar dhe të zbatuara pjesërisht. Në këtë kategori hyjnë ato ankesa dhe rekomandime të cilat kanë patur 2 çështje për të zgjidhur, si psh, rastet e largimit nga puna. Në këto raste është dhënë kompensimi material për dëmin që iu është shkaktuar, por qytetari nuk është rikthyer në punë.

Numri i tyre është 8.

3. Ankesa dhe rekomandime të pranuar dhe që janë në proces zbatimi. Në këtë kategori hyjnë rastet kur për zbatimin e rekomandimit pritet të dalin vendime të Këshillit të Ministrave, udhëzime të ndryshme, ndryshime ligjore, vendime të këshillave bashkiake, apo vendime gjyqësore.

Numri total i tyre është 50

4. Ankesa dhe rekomandime të pranuar por të pazbatuara nga institucionet. Në këtë kategori hyjnë të gjitha llojet e ankesave dhe rekomandimeve të lëshuara nga Avokati të cilat janë pranuar nga organet e administratës publike, por që nuk janë zbatuar to. Në këto raste qytetari nuk ka gjetur ende zgjidhje për problemin e tij.

Numri i tyre është 93.


5. Ankesa dhe rekomandime për të cilat u refuzua dhënia e informacionit. Numri i tyre është 17.

KONKLuzionet:

1. Avokati i Popullit, gëzon besimin e publikut si një institucion në përpjekje të vazhdueshme për të mbrojtur të drejtat e qytetarit.
2. Duhet të vazhdojë forcimi institucional i Avokatit të Popullit nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe fuqizimit financiar të tij.
3. Avokati i Popullit, është një institucion i cili gëzon respektin e institucioneve të tjera: lokale, qendrore, enteve publike, etj., të cilat kanë zbatuar rekomandimet e tij.
4. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të cilat janë pranuar nga institucionet e administratës publike, tregon se stafi i Avokatit të Popullit bën një punë profesionale, ligjore dhe të drejtë në shërbim të qytetarit, por nga ana tjetër kjo gjithashtu tregon se institucionet përmbushin detyrimin e tyre ligjor në mbështetje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.
5. Zbatueshmëria e Rekomandimeve të Avokatit të Popullit të pranuar nga institucionet e administratës publike është shumë pozitive. Po ta shprehim në përqindje, kjo situatë është si më poshtë:
 - Ankesa dhe rekomandime të pranuar dhe të zbatuara janë në masën 58%.
 - Ankesa dhe rekomandime të pranuar dhe të zbatuara pjesërisht janë në masën 2%.

- Ankesa dhe rekomandimet për të cilat qytetarët refuzuan të japin informacion janë në masën 4%.
- Ankesa dhe rekomandime të pranuar, por që janë në proces zbatimi, janë në masën 13%.
- Ankesa dhe rekomandime të pranuar por të pazbatuara nga institucionet janë në masën 23 %.

*Ankesa dhe rekomandime të zbatuara
(nga totali i ankesave dhe rekomandimeve të pranuar)*



KREU II

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndarë sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore

A. Barazia përpara ligjit dhe ndalimi i diskriminimit

Vështrim i përgjithshëm

Barazia para ligjit është sanksionuar në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. E njëjta dispozitë ndalon edhe diskriminimin e padrejtë për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, arsimit, gjendjes ekonomike a shoqërore ose përkatësisë prindërore. Koncepti i barazisë, lidhet organikisht me kuptimin e mosdiskriminimit. Megjithatë, efektivisht kjo dispozitë nuk ndalon diskriminimin pozitiv, duke lejuar kështu trajtimin, ose përkrahjen specifike për grupe të caktuara individësh. Jo vetëm kaq, por neni 20 i Kushtetutës parashikon edhe mbrojtje për pakicat, duke garantuar barazi të plotë para ligjit për minoritetet.

Si një nga aktet normative më të rëndësishme në kuadër të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, në nenin 14 të saj, sanksionon ndalimin ndaj diskriminimit.

Sot mund të flasim për një legjislacion të detajuar, i cili garanton dhe mbron të drejtën e barazisë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit dhe që në të njëjtën kohë, krijon mundësi dhe hapësira për ndërveprim mes shumë aktorëve në fushën e mbrojtjes të së drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2012, ka marrë në shqyrtim 11 ankesa të cilat, kanë pasur si objekt të tyre të drejtpërdrejtë, pretendimin për shkelje të barazisë apo diskriminim. Nga këto ankesa vetëm njëra është ende në shqyrtim, ndërsa janë përfunduar 10 të tjerat. Nga ankesat e përfunduara, 3 prej tyre janë jashtë juridiksionit, 1 jashtë kompetencës dhe 6 prej tyre kanë përfunduar të zgjidhura pozitivisht. Duhet theksuar fakti se pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar e trajtuar një numër i madh ankesash nga individë të komuniteteve vulnerable si: anëtarë të minoritetit rom (nga ky minoritet janë trajtuar në mënyrë individuale, apo në grup ankesa për 183 idividë) dhe persona nga aftësia e kufizuar (nga ky komunitet janë trajtuar në mënyrë individuale apo në grup ankesa për 163 individë, duke rezultuar ky grup, si grupi më i ekspozuar ndaj fenomenit të diskriminimit. Pavarësisht faktit që këta qytetarë pretendonin shkeljen e një të drejte të caktuar, rastet mbartin elementë të shkeljes së barazisë,

ose të diskriminimit negativ, të cilat kanë shërbyer si shkak në shkeljen e të drejtave të tjera të pretenduara nga ankuesit. Këto raste janë përfshirë dhe trajtuar në raport sipas të drejtave, të cilat ankuesit kanë pretenduar se i janë shkelur.

Analizë e rasteve konkrete

Ankesa me **Nr. Dok. 201200708**, lidhur me kërkesën e Shoqatës për Integrim të Pensionistëve të Shqipërisë, për miratimin e Statusit të Moshës së Tretë, dhe për pjesëmarrjen në komitetet ndërministrorë gjatë diskutimeve vendimmarrëse që lidhen me moshën e tretë. Kjo ndërhyrje është kërkuar pasi, duke e konsideruar veten të diskriminuar në krahasim me shtetasat e tjera të shoqërisë, miratimi i Statusit për moshën e tretë, do të përbënte hapin e duhur për rregullimin e gjendjes.

Pas ndërmarrjes së një procesi ndërmjetësimi me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për këtë qëllim jemi vënë në dijeni se prioritetet e politikave të shërbimeve sociale, bazohen në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, në Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale, pjesë e së cilës është edhe Dokumenti i Politikave Ndërsektoriale për Moshën e Tretë (DPNMT), së bashku me Planin e Veprimit. Një nga objektivat e Planit të Veprimit të Dokumentit të Politikave Ndërsektoriale për Moshën e Tretë, është hartimi i Statusit për të Moshuarit. Me urdhërin nr.820/15 datë 11.06.2010, është ngritur grupi i punës për hartimin e projekt-ligjit “Për Statusin e Moshës së Tretë”, me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financës, Ministria e Drejtësisë, ISKSH, ISSH, etj. Projekt-ligji për miratimin e statusit të sipërcituar, ishte parashikuar të shkonte për miratim në Këshillin e Ministrave në fund të vitit 2012. Duke e konsideruar si një zhvillim pozitiv punën e grupit përkatës, institucioni ynë do të vazhdojë verifikimin e përmbylljes së procesit të miratimit të këtij akti normativ.

Rekomandimi për një ndryshim në ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, drejtuar Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Kjo është një ndër çështjet e filluara me inisiativë, ku evidentohet roli aktiv i institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit, nga veprimet, apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike, apo personave të tretë të lidhur me të, por edhe për promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, pavarësisht nëse individi është pjesë e një grupimi shoqëror në minorancë, apo është pjesë e shumicës së shoqërisë.

Komuniteti i Lezbikëve, Gejve, Biseksualëve dhe Transgjinjorëve (LGBT) në Shqipëri, në bazë të legjislacionit në fuqi, duhet të gëzojë të drejta dhe liri të barabarta si të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, bazuar në parimin e barazisë të të gjithë shtetasve përpara ligjit (neni 18 i Kushtetutës), të lidhur ngushtë me parimin e mosdiskriminimit, pavarësisht përkatësisë së tyre gjinore, apo orientimit seksual.

Parashikimi në legjislacionin shqiptar i të drejtave dhe lirive themelore për komunitetin LGBT si dhe garantimi i zbatimit të tyre në praktikë, janë tepër të rëndësishme dhe për këtë arsye, ato janë përfshirë brenda Rekomandimit 11 të BE për Shqipërinë “Liritë dhe të drejtat e njeriut”, dhe konkretisht në pjesën e mosdiskriminimit ndaj grupeve të ndryshme shoqërore.

Orientimi seksual përshkruan një model/strukturë të qëndrueshme tërheqjeje emocionale, romantike dhe seksuale, ose kombinim të tyre, - drejt seksit të kundërt, seksit të njëjtë, të dyja sekseve, ose asnjërit prej sekseve dhe gjinive që i shoqërojnë ato. Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologjisë, orientimi seksual i referohet gjithashtu ndjenjës së "identitetit personal dhe shoqëror" të personit, pra në vetvete, një relacioni social të ndryshëm të këtyre individëve nga personat e tjerë.

Identiteti gjinor është mënyra se si një njeri vet-identifikohet me një kategori gjinore, si për shembull të jesh femër ose mashkull, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik. Lidhur me personat, të cilët kanë një identitet gjinor të kundërt nga ai i dy gjinive të njohura (femër ose mashkull), vlerësojmë se dispozita është gjithpërfshirëse, duke mos përcaktuar llojet e gjinive në mënyrë eksplicite.

Pra, mbështetur në përcaktimet e nenit 18 të Kushtetutës, orientimi seksual, apo entiteti gjinor i individëve, mund të përbëjë shkak për të diferencuar dhe trajtuar në mënyrë të pabarabartë komunitetin LGBT, i cili për shkaqe të ndryshme ka, apo mund të ketë një përbërje sociale të pavarur nga meritat e tyre, apo ka një identitet gjinor të ndryshëm nga ai i dy gjinive (femërore ose mashkullore).

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit "Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional". Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë, pavarësisht, përkatësisë gjinore, raciale, etnike, gjuhësore, bindjeve politike, fetare etj. E drejta për punë sipas këtij përcaktimi kushtetues përfshin: zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e formimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Parashikimi që bën neni 49 i Kushtetutës "...duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ai përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cënuar këtë të drejtë."

Në këtë kuptim, ekziston baza legjislative për referimin e çështjes si, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 15); konventat ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara nga vendi ynë, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, por edhe të drejtave të komunitetit LGBT në veçanti, si Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Deklarata e OKB mbi "Orientimin seksual dhe identitetin gjinor" nënshkruar nga vendi ynë më 18 dhjetor 2008, Protokollin nr. 12, i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut "Për një ndalim të Përgjithshëm të Diskriminimit", nënshkruar dhe ratifikuar në vitin 2010, Konventa nr.111 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit"; pika V e rekomandimit të Rezolutës së Këshillit të Ministrave, të KiE, CM/REC(2010)5, ku trajtohen çështjet mbi punësimin, dhe në të cilin përcaktohet se "Shtetet anëtare duhet të sigurojnë krijimin dhe zbatimin e masave të përshtatshme që ofrojnë mbrojtje efektive, kundër diskriminimit në sektorin publik apo privat, në bazë të orientimit seksual apo identitetit gjinor në punësim dhe profesion. Këto masa duhet të mbulojnë kushtet për qasje në punësim dhe zhvillim, largimet nga puna, pagesën dhe kushtet e tjera të punës, duke përfshirë parandalimin, luftën dhe dënimin e ngacmimeve dhe formave të tjera të viktimizimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet për të siguruar mbrojtje efektive të të drejtave për intimitetin e individëve transeksualë në kontekstin e punësimit, në aplikime të veçanta për punësim në lidhje me, për të shmangur çdo zbulimin e parëndësishme të historisë

së tyre gjinore ose emrin e ish-të punëdhënësit dhe të punësuarit tjerë”; Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, si një ligj kuadër që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, ku përcaktohen parimet, rregullat dhe masat e përgjithshme për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërkohë që aktet e tjera ligjore në fuqi, rregullojnë në mënyrë të posaçme mosdiskriminimin lidhur me të drejtën për punësim, të drejtën për arsimim, të drejtën për akses në të mirat dhe shërbimet, etj.

Rregullimi ligjor i posaçëm, të cilit i referohet kjo çështje për ndalimin e diskriminimit, lidhur me të drejtën për punësim është ligji 7961/1995 “Kodi i Punës i RSH” (i ndryshuar). Në nenin 9, të Kodit të Punës (i ndryshuar) parashikohet se ndalohet çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit. Në pikën 2, të nenit 9, të Kodit të Punës, përcaktohet përkufizimi i diskriminimit si dhe shkaqet në bazë të të cilave mund të ndodhë diskriminimi si: raca, ngjyra, seksi, mosha, feja, bindjet politike, origjina kombëtare, origjina shoqërore, lidhjet familjare, të metat fizike ose mendore.

Në shkaqet e sipërcituara nga neni 9 i Kodit të Punës nuk përfshihet ndalimi i diskriminimit për shkak të orientimit seksual, apo identitetit gjinor. Megjithëse nuk ka kufizime ligjore të shprehura në mënyrë eksplicite për të drejtën për punësim në Kodin e Punës, në brendinë e tij nuk ka dispozita specifike që ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në fushën e punësimit dhe formimit profesional. Një boshllëk i tillë në legjislacionin e punës, mund të përbëjë shkak për të cënuar garantimin e të drejtës për punë të komunitetit LGBT, në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë. Pra, në këtë rast, mangësia ligjore në legjislacionin e posaçëm mund të sjellë probleme të zbatimit në praktikë të parimit të barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit lidhur me ushtrimin e të drejtës së punës dhe për rrjedhojë, mospërmbyshjen e qëllimeve të ligjit kundër diskriminimit, mosndëshkim të sjelljes diskriminuese dhe vendosjen e ministrisë përgjegjëse për zbatimin e ligjit, në pamundësi për të arritur qëllimet dhe objektivat e ligjit.

Në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, neni 70, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëri-BE, ka përcaktuar detyrimin e përgjithshëm për përafrimin e legjislacionit shqiptar, me atë të Bashkimit Europian. Sipas këtij neni, palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit, zbatimin efektiv të tij. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të bëhen gradualisht në përputhje me *acquis* e Komunitetit, si dhe do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm do të zbatohet siç duhet. Në paragrafin 3 të këtij neni të marrëveshjes, përcaktohet se ky përafrim fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të shtrihet gradualisht në të gjitha elementet e *acquis* të Komunitetit. Gjatë fazës së parë, siç përcaktohet në nenin 6 të MSA, përafrimi do të përqëndrohet në elementët themelore të *acquis* tregut të brendshëm, si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si: konkurrenca, të drejtat intelektuale, industriale dhe tregtare të pronës, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, tokës dhe transportit detar – me theks të veçantë në sigurinë dhe standardet mjedisore si dhe aspektet sociale – ligji i shoqërive tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësitë e barabarta. Për më tepër, Komisioni Europian në Opinionin e vitit 2010 për Shqipërinë, ka theksuar se ka filluar procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të BE në fushën e legjislacionit të punës, trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe anti-diskriminimit, por janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme, për një përputhshmëri të plotë lidhur me këto çështje.

Mbi sa më sipër bazuar edhe në parashikimet e Direktivës 2000/78 EC “Për krijimin e një kornize të përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion”, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se në nenin 9, të Kodit të Punës duhet të shtohen në shkaqet për të cilat ndalohet diskriminimi edhe “orientimi seksual dhe identiteti gjinor”.

Në nenin 1, të Direktivës 2000/78 EC, parashikohet se, qëllimi i saj është për të përcaktuar një kuadër të përgjithshëm për luftën kundër diskriminimit në bazë, të fesë ose besimit, paaftësisë, moshës, ose orientimit seksual për sa i përket punësimit dhe profesionit, me synimin që në shtetet anëtare të zbatohet parimi i trajtimit të barabartë. Pra, Direktiva kuadër, ka parashikuar në shkaqet e diskriminimit edhe orientimin seksual. Për më tepër, me qëllim garantimin e zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, në nenin 10 të Direktivës parashikohet se “Shtetet Anëtare marrin masa të tilla që janë të nevojshme, në përputhje me sistemet e tyre kombëtare gjyqësore, për të siguruar që personat, të cilët e konsiderojnë veten të dëmtuar për shkak se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, të paraqesin para gjykatës, apo organit tjetër kompetent faktet nga të cilat mund të supozohet se personi ka qenë direkt, ose indirekt i diskriminuar, ndërkohë që i padituri (në këtë rast punëdhënësi) duhet të provojë se nuk ka kryer shkelje të parimit të trajtimit të barabartë”.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështje nga Avokati i Popullit u arrit në konkluzionin se, neni 9, i Kodit të Punës nuk garanton *trajtim të barabartë* të personave LGBT për ushtrimin e të drejtës për punësim dhe formim profesional. Ai nuk është në përputhje me parimin kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, në të cilin parashikohet se: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit*”, si dhe të një serë akte ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga shteti Shqiptar, të cituara më lart, përfshirë edhe nenin 1 të “Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 217 A, të 10 Dhjetorit 1948, në të cilën përcaktohet se: “*Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave*”.

Për të rivendosur në vend këtë të drejtë të personave LGBT, i është rekomanduar Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, konkretisht:

1. Përfshirja në pikën 2, të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si shkaqe për diskriminim edhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.
2. Përfshirja në fund të nenit 9, të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin. Paragrafi i formuluar duhet të jetë në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 10 të Direktivës 2000/78 EC, pra duke e vendosur barrën e provës mbi punëdhënësin.

Ndërkohë, jemi informuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (me shkresë datë 18.02.2012), se këto rekomandime janë përfshirë në projektligjin për ndryshimin e Kodit të Punës.

Konkluzione

Legjislacioni aktual në fuqi, në vendin tonë, prezanton një bazë të mirë ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Hierarkia e akteve normative që garantojnë barazinë para ligjit njohu një detajim adekuat me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10221 datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Ky ligj veç përcaktimeve të dhëna për kuptimin e barazisë dhe elementëve- mosrespektimi apo veçimi i qëllimshëm i të cilave, çon në diskriminim- ka shërbyer si bazë, për krijimin e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me kompetenca të gjera në këtë fushë, duke filluar nga ato rekomanduese dhe deri tek kompetencat vendimmarrëse dhe me një shtrirje juridiksionale në sektorin shtetëror dhe në atë privat.

Krijimin e këtij institucioni të ri kombëtar të mbrojtjes të së drejtave të njeriut, Avokati i Popullit e ka vlerësuar si një mundësi të mirë të koordinimit të punës për mbrojtjen nga diskriminimi në të gjithë spektrin kompleks të problematikave të hasura dhe si një vlerë, që nuk përjashton kontributet e veçanta të aktorëve të tjerë në këtë drejtim, por që i amplifikon dhe konkretizon përfundimisht me vendimmarrje ato.

Ky këndvështrim, bazohet në parimin kushtetues se mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, është jo vetëm një e drejtë e individit, por edhe detyrim parësor kushtëzues në veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore dhe të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë në vend, me kontribut të rëndësishëm në këtë fushë.

Avokati i Popullit, i ka kushtuar kujdes dhe ka kryer një analizë të vëmendshme të akteve ku pretendohet diskriminim, duke vlerësuar në një këndvështrim më të gjerë, shpesh, shkelja e të drejtave të caktuara, sidomos të atyre të drejtave që i përkasin anëtarëve të grupeve vulnerabel, fsheh në thelb diskriminimin negativ.

B. E drejta për informim

Vështrim i përgjithshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si akti me i lartë normativ në vend, në nenin 23 të saj garanton te drejtën për informim.

Janë të shumta aktet ndërkombetare, në të cilat afirmohet kjo e drejtë, duke u dhënë garancia e mbrojtjes dhe respektimit të saj. Ratifikimi i këtyre akteve nga ana e shtetit shqiptar, sjell detyrime që kanë të bëjnë me respektimin e përcaktimeve të dhëna në to, si dhe harmonizimin dhe përshtatjen e legjislacionit të brendshëm me parimet, mbi bazën e të cilave ngrihet regjimi juridik ndërkombëtar i së drejtës. Aktet ndërkombetare, më të rëndësishme në këtë fushë janë:

a) Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në 10 Dhjetor 1948, e cila në nenin 19 të saj, afirmon të drejtën për informim, si një nga të drejtat themelore të individit;

b) Konventa Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në paragrafin e parë të nenit 10 të saj, bëhet

një riformulim dhe theksim i përcaktimit të bërë në nenin 19, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut;

c) Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (Dhjetor 1966).

d) Deklarata e Këshillit të Europës, mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, e vitit 1982, e cila shpreh si një nga përparësitë në veprimtarinë e Këshillit të Europës, aksesin në informacion. Në këtë deklaratë jepen parimet kryesore në lidhje me të drejtën e informimit dhe rolin që luan kjo e drejtë në shoqëri “si një kusht i nevojshëm për zhvillimin e shoqërisë”.

e) Konventa e Aarhusit, “Mbi të drejtën e publikut për informim, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin”, një akt tjetër që elaboron këtë të drejtë, në një fushë të caktuar.

Dy ligjet më të rëndësishme që përcaktojnë regjimin juridik të kësaj të drejte, janë Ligji Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si dhe Kodi i Procedurave Administrative miratuar me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, i cili e parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2012, ka marrë në shqyrtim 38 ankesa që lidhen me të drejtën për informim. Nga ky numër ankesash 3 janë ende në shqyrtim, ndërsa për 35 të tjera ka përfunduar shqyrtimi. Nga ankesat e shqyrtuara rezultojnë 11 jashtë kompetencës, 18 ankesa të zgjidhura pozitivisht, 5 ankesa të pabazuara, ndërsa për 1 ankesë është hequr dorë nga ankuesi në fillim të procesit të shqyrtimit të ankesës. Ankesat kanë të bëjnë me mosrealizimin e të drejtës për informim në kuadër të veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror, njërive të pushtetit vendor, të veprimtarisë së enteve publike, si dhe të personave juridikë që ofrojnë shërbime publike.

Analizë e rasteve konkrete

Në ankesën me **nr. 201201877 Doc**, shtetasi H.B ka shprehur shqetësimin për zvarritje në dhënien e informacionit të kërkuar prej tij, me anë të disa kërkesave zyrtare, drejtuar Bashkisë Tiranë. Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështjeje nga institucioni ynë kemi kërkuar shpjegime nga ana e Bashkisë Tiranë, lidhur me bazueshmërinë e pretendimeve të ankuesit dhe trajtimin konkret të kësaj ankese. Në përgjigje të kërkesës tonë, ka patur një reagim pozitiv nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Tiranë, i cili na ka paraqitur një pasqyrim të detajuar të situatës ligjore dhe faktike, përsa i përkiste pretendimeve të ankuesit. Ndërkohë, nga ana e tij është sqaruar se pas kësaj ndërhyrjeje, ankuesit i është kthyer përgjigje zyrtare mbi kërkesat e paraqitura. Për këtë fakt na është vënë në dispozicion edhe një kopje të informacionit që i është dërguar ankuesit. Në përfundim, pasi kemi vënë në dijeni për këtë ndërhyrje ankuesin dhe nuk ka pasur më asnjë kundërshtim prej tij, kemi ndërprerë shqyrtimin e mëtejshëm duke e konsideruar ankesën si të zgjidhur pozitivisht.

Në ankesën me **nr. 201202397 Doc**, shtetasi A.K, ka shprehur shqetësimin për mosrealizimin e të drejtës së tij për informim, bazuar në disa kërkesa të drejtura për këtë qëllim, në Drejtorinë e Tatim Taksave, Tiranë. Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështjeje nga ana jonë, kemi kërkuar

shpjegime nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Tatim Taksave, Tiranë, lidhur me bazueshmërinë e pretendimeve të ankuesit dhe trajtimin konkret të kësaj ankese. Në përgjigje të shkresës tonë, ka patur një reagim pozitiv nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Tatim Taksave, Tiranë, e cila na ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga ankuesi, së bashku me ekstraktet e sistemit përkatës elektronik, në të cilat pasqyrohen edhe të dhënat konkrete të kërkuara nga ana e shtetasit A.K në këtë rast.

Në përfundim, pasi i kemi dërguar ankuesit një kopje të përgjigjes zyrtare të Drejtorit të Drejtorisë së Tatim Taksave Tiranë, së bashku me dokumentacionin zyrtar të kërkuar dhe nuk na janë paraqitur pretendime të tjera prej tij, kemi ndërprerë shqyrtimin e mëtejshëm, duke e konsideruar ankesën si të zgjidhur pozitivisht..

Konkluzione

Problematika e konstatuar në shqyrtimin e çështjeve nga ana e Avokatit të Popullit për këtë të drejtë, evidenton elementë që kanë të bëjnë me përmbajtjen e dispozitave të ligjit bazë që rregullon regjimin juridik të së drejtës për informim “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”, si dhe çështje që kanë të bëjnë me zbatimin konkret dhe njohjen e këtyre dispozitave. Edhe gjatë vitit 2012, konstatohet e njëjta problematikë e hasur në vitin 2011, lidhur me moszbatimin, ose zbatimin jo korrekt të dispozitave ligjore që njohin dhe garantojnë të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare nga Administrata Publike. Shkaqet e mosdhënies, ose vonesës në dhënien e informacionit për dokumente zyrtare lidhen me mosnjohjen, ose njohjen e përciptë të këtij ligji nga Administrata Publike, si dhe me mangësitë që hasen në vetë dispozitat e ligjit.

Mbetet kërkesë imediate, nevoja për përmirësime në Ligjin “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”. Pavarësisht kërkesave tona të vazhdueshme për mendimin e ligjit dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij, në kushtet e mosmarrjes së masave për ndryshimin e kësaj situatë, jemi të detyruar të sjellim në vëmendjen tuaj konstatimet dhe rekomandimet e përmendura edhe në raportin vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011³:

“Institucioni i Avokatit të Popullit në pozicionin e kujdestarit të respektimit të së drejtës për informim, ka arritur në konkluzionin se, funksionimi i regjimit të informimit publik në vend vazhdon të ketë probleme të dukshme, arsye e cila, nxjerr nevojën e ndryshimeve dhe përmirësimeve në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Ndryshimet e mundshme të ligjit duhet të konsistojnë në:

- Zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim, dhënien e informacionit, duke përfshirë personat fizikë, ose juridikë që përmbushin funksione publike, ose administrative (p.sh. kompanitë private që kanë monopole, ose koncesione për furnizimin me ujë, energji elektrike etj).

- Shtesën e kritereve përjashtimore, që lidhet me parashikimin e një listë shteruese të kritereve për mosdhënien e informacionit. Ky kriter shihet veçanërisht i nevojshëm në rastet e kërkesave të përsëritura, për të cilat është dhënë një shpjegim i plotë dhe përfundimtar.

3 Raporti për Veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2011

- Rishikimin e afateve për dhënien e informacionit. Këto afate duhet të jenë më të shkurtra dhe të unifikuara në afatin kohor që, përcaktohet për refuzimin, apo për përmbushjen e kërkesës për informim.

- Detyrimin për të orientuar kërkuesin të identifikojë dokumentet që kërkon, pasi administrata ka njohuri më të plota se çfarë dokumentesh zyrtare mban ajo, ose që, për sa të jetë e mundur, orientimin e kërkuesit tek subjekti kompetent që, duhet të japë informacionin e kërkuar sipas ligjit.

- Parashikimin shprehimisht në lehtësirat për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ato kërkohen nga personat me aftësi të kufizuara. Një parashikim që duhet shtuar është që, kërkuesit i jepen dokumentet në formatin e preferuar prej tij, duke përfshirë dhe formatin elektronik, përveçse kur kjo paraqet vështirësi teknike të konsiderueshme.

- Koston e pagesave për dhënien e informacionit, për të shmangur vendosjen e tarifave tepër të larta dhe abuzive, që efektivisht do të shërbenin si pengesë për realizimin e të drejtës për informim.

- Në caktimin konkret të sanksioneve dhe të dëmshpërblimit. Sanksionet për shkelje të dispozitave të ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", nuk janë të përcaktuara shprehimisht. Ndërkohë, lidhur me shpërblimin e dëmit, veç një parashikimi të përgjithshëm të dhënë në ligj, nuk ka rregullime specifike që, do të mundësonin zhdëmtimin real në rastet kur vërtetohet një gjë e tillë.

C. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë

Vështrim i përgjithshëm

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë përfaqëson në vetvete, dy të drejta vetjake themelore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton në nenin 24 të saj aspekte të ndryshme të këtyre të drejtave, siç është e drejta e fesë dhe e bindjeve, apo mënyra e shprehjes së këtyre bindjeve. Duke u konsideruar si një liri individuale, ajo përfshin të drejtën për të mos u detyruar, ose ndaluar për të marrë pjesë në një bashkësi fetare, ndalim që mund të vijë prej shtetit apo subjekteve privat, si dhe të drejtën e individit për të mos bërë publike bindjet e tij. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë përfaqëson një prej themeleve të një "shoqërie demokratike" dhe renditet ndër elementet më thelbësore të identitetit të besimtarëve dhe të konceptit të tyre për jetën, por është gjithashtu një gjë e çmuar për ateistet, agnostikët, skeptikët apo indiferentët.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 ka marrë në shqyrtim vetëm një ankesë, lidhur me të drejtën e besimit fetar, ku është pretenduar cënimi i saj, për shkak të mosveprimit të organeve përkatëse të administratës publike për eliminimin e shkakut që çonte në këtë cënim.

Si komunitete fetare sot në vend njihen zyrtarisht komuniteti fetar Mysliman, komuniteti Katolik, komuniteti Orthodhoks, komuniteti Bektashian, dhe komuniteti "Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë". Si bazë ligjore për këtë njohje shërbejnë nenet 10 dhe 24 të Kushtetutës, si dhe ligjet me ane të të cilave janë miratuar në Kuvend marrëveshjet e nënshkruara prej Këshillit të Ministrave dhe komuniteteve, apo bashkësive fetare përkatëse. Deri tani rezulton që, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me ligj marrëveshjet për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta me komunitetet fetare në vend, përkatësisht: Ligji Nr. 8902 datë 23.05.2002, Për ratifikimin

e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”; Ligji Nr.10056 Datë 22.01.2009, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”; Ligji Nr.10057 Datë 22.01.2009, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”; Ligji Nr.10058 Datë 22.01.2009, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”; Ligji Nr.10394 Datë 10.3.2011, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkësisë Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, ”.

Analizë e rasteve konkrete

Ankesa Nr. 201202736 Doc. një përfaqësues i lartë i një prej komuniteteve fetare në vend, ka paraqitur një ankesë në institucionin tonë, ku shprehet shqetësimi për mosreagimin e organeve përkatëse të administratës publike, ndaj ankesave të drejtuara për ndalimin e punimeve që ka realizuar një subjekt në afërsi të selisë së kësaj Asambleje, punime që kanë shkaktuar cënim dhe kufizim të ushtrimit të lirë të besimit përkatës fetar, si pasojë e bllokimit të hyrjes në seli.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj ankese nga ana jonë, i janë kërkuar shpjegime Kryeinspektorit të INUV Tiranë, Kryeinspektorit të Policisë Bashkiake, Tiranë, Komitetit Shtetëror të Kulteve, si dhe Drejtorisë së Monumenteve të Kulturës. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare në përgjigjen e saj, na ka informuar se nuk është konstatuar ndërhyrje në aspektin e fasadës të ndërtesës konkrete, ndërkohë që, Kryeinspektori i INUV, Tiranë, ka informuar mbi procedurat ligjore dhe masat ndëshkuese që janë marrë në vazhdim ndaj subjektit, i cili ka ndërtuar një shtesë anësore pranë selisë së komunitetit fetar. Kemi vënë në dijeni subjektin ankues për hapat e ndërmarra nga ana e INUV-së Tiranë, për pushimin e cënimit dhe nuk rezulton që shqetësimi të ketë vazhduar.

Konkluzione

Avokati i Popullit ka dhënë një kontribut të vazhdueshëm në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, parë kjo si në punën për hartimin e projektligjit “Për fenë”, edhe për hartimin e marrëveshjeve tip me komunitet fetare në Shqipëri. Megjithatë, konstatojmë se, edhe pse ka rreth dy vjet që është përgatitur projektligji “Për Fenë”, i cili rregullon në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, marrëdhëniet e shtetit me komunitetet fetare, procesi i tij i miratimit ka mbetur pezull, pa arritur të kemi sot një ligj specifik. Një risi për këtë vit është miratimi i Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Megjithatë, vërehet se në ndryshim nga përmbajtja e projektligjit fillestar, i cili parashikonte ndalimin e mbajtjes së simboleve fetare në shkollë, ligji aktual nuk jep përcaktim konkret për këtë çështje, duke u shprehur shkurtimisht se arsimi është laik. Ne kemi vlerësuar dhe gjykojmë se, politika e ndjekur nëpërmjet ligjit, kryesisht në arsimin parauniversitar, duhet të ketë si qëllim që, të akomodojë çdo njeri në mënyrën sa më të arsyeshme të mundshme, për të krijuar një klimë të përshtatshme, në të cilën fëmijët të mund të mësojnë dhe të jetojnë së bashku në harmoni.

Avokati i Popullit në kuadër të ndjekjes së problematikave që, lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë ka ndjekur së fundmi, me kujdes dhe vëmendje

të posaçme retorikat mes përfaqësuesve të komuniteteve fetare të veçanta. Duke qendruar larg konotacioneve konfliktuale të përdorura, Avokati i Popullit vlerëson se çështjet e brendshme të organizimit të vetë komuniteteve fetare nuk duhet të shërbejnë si elementë veçues, për të prishur harmoninë fetare që ekziston në vend, ndërmjet individëve të të njëjtit besim fetar, apo edhe të besimeve të tjera.

D. Kufizime të lirisë së personit

Veprimtaria e Policisë së Shtetit


Vështrim i përgjithshëm

Policia e Shtetit, si pjesë e administratës publike, përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit. Objektit i vecantë i veprimtarisë së saj, ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, e lidh atë në mënyrë të drejtpërdrejtë me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjatë vitit 2012, në Institucionin e Avokatit të Popullit janë administruara 234 ankesa për veprime dhe mosveprime të paligjshme të organit të Policisë së Shtetit. Pretendimet e ankuesve kanë qenë kryesisht për: torturë, keqtrajtime, shoqërime/arrestime e ndalime të padrejta, veprime arbitare, mosmarrje e mosndjekje të kallëzimeve, kontrole të paligjshme personale e banese, moszbulim i autorëve të veprave penale, ndalim për të dalë jashtë shtetit, gjopa të padrejta, për mosdhënie të informacioneve të kërkuara etj. Krahasuar me vitin 2011, konstatohet se numri i ankesave të qytetarëve, ka pësuar rritje të ndjeshme nga 119 në 234 raste. Vlen të theksohet se në mbi 50% të rasteve, veprimet e paligjshme të punonjësve të policisë lidhen drejtpërsërdrejt me trajtimin fizik të qytetarëve dhe me mënyrën e ndjekjes së kallëzimeve të bëra prej tyre. Më konkretisht, numri i ankesave sipas objektit të tyre ka qenë, 71 raste për torturë e keqtrajtime fizike, 29 raste për veprime arbitare, 43 raste për mosmarrje e mosndjekje të kallëzimeve, 9 raste për moszbulim të autorëve të veprave penale, 4 raste për kontrole të paligjshme të banesave dhe 78 raste kanë qenë të ndryshme. Për sa më sipër, Avokati i Popullit ka bërë 26 rekomandime për fillim hetimi dhe procedimi disiplinor për 77 punonjës policie. Nga këto 16 rekomandime janë për fillimin e hetimit ndaj 55 punonjësve të policisë me detyra e grada të ndryshme, të nivelit drejtues dhe zbatues, të cilët kanë konsumuar elementet e veprave penale të ndryshme, si vijon: 7 rekomandime për veprën penale të “Torturës”, 8 rekomandime për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitare” dhe 1 rekomandim për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”.

Në funksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit ka kryer dhe 70 inspektive, riinspektive dhe kontrole tematike në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit në vend. Janë hartuar dhe paraqitur 14 rekomandime, në lidhje me përmirësimin e standardeve të të drejtave dhe trajtimit të individëve që strehohen në këto institucione.

Ankesa për Policinë e Shtetit



Tematikat e ndjekura gjatë vitit 2012 kanë qenë si më poshtë :

1- Ndërtimi apo rikonstrukcioni i ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në të gjitha Komisariatet e Policisë së Shtetit, sipas kërkesave të ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, Letër-porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008 “Për njohjen e raportit vlerësues paraprak të delegacionit të CPT-së dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe Programit të Punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në **përbushje të Rekomandimit të 12 të KE**, për zbatimin e **rekomandimeve të Avokatit të Popullit** lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore dhe trajnimin e punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë.

2- Njohja e Ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe zbatimi me rigorozitet i kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe trajtimi dinjitoz i tyre.

3- Trajnimi i vazhdueshëm e periodik i punonjësve të policisë, me qëllim eliminimin e formave të keqtrajtimit të personave të shoqëruar dhe ndaluar të arrestuar si veprime të pa pranueshme dhe të dënueshme. Përveç kësaj, rëndësi më e madhe duhet t’u jepet metodave moderne, shkencore të hetimit penal, përmes investimeve në pajisje dhe trajnimit të personelit, në mënyrë që të mund të zmadhohet numri dhe lloji i provave të mbledhura në ngarkim të të pandehurit, duke minimizuar rëndësinë që ka në hetimin dhe gjykimin e çështjes pranimit ose jo prej tij i kryerjes së veprës penale..

4- Marrja e masave të nevojshme për të garantuar që çdo person i shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia, për çfarëdo arsye, informohet menjëherë në momentin e ndalimit për të drejtat që i njeh ligji procedural penal. Kjo gjë kërkon që në në momentin e ndalimit personit t’i njoftohen në mënyrë të përmbledhur të drejtat e tij dhe, më pas, në vendin ku do të merret në pyetje ose do të kryhen veprimet e tjera procedurale ti vihen në dispozicion materiale të shkurtra informuese në një gjuhë të kuptueshme për të, ku listohen të drejtat e personit të

shoqëruar, ndaluar arrestuar. Është detyrim i organeve të policisë së shtetit që të vërtetojnë përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.

5- Marrja e masave për korrigjimin e mangësive të konstatuara në librin e personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar me qëllim standardizimin sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*" dhe manualin "*Për Rregullat e trajtimit e sigurimit e të ndaluarve dhe arrestuarve në dhomat e sigurisë në njësitë policore*". Në libër të jenë të pasqyruara të gjitha veprimet e policisë, si koha dhe arsyeja e shoqërimit/ndalimit apo arrestimit, shenjat e lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet, vendi ku është mbajtur, koha kur personi ka mbërritur në mjediset e policisë, kur është informuar për të drejtat e tij, kur është pyetur, si dhe kur ka pasur kontakte me një anëtar të familjes, një avokat ose një mjek.

6- Sigurimi i zbatimit në praktikë të kërkesës ligjore, për njoftimin e familjarëve apo personit të besuar, ora e njoftimit të tyre, emri i të njoftuarit dhe numri i telefonit.

7- Sigurimi i ndihmës juridike që në momentin kur personit i privohet liria. Hapa të mëtejshëm duhet të merren, për të siguruar përfaqësim ligjor falas, për të gjithë kategorinë e personave që nuk kanë mundësi financiare për ta siguruar atë.

8- Sigurimi i ndihmës së detyrueshme juridike dhe psikologjike në rastet e arrestimit apo të ndalimit të një mituri, si dhe njoftimi i familjarëve të tij.

9- Marrja e masave për të siguruar në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit që të miturit të mos mbahen në të njëjtën dhomë me personat madhorë.

10- Marrja e masave të menjëhershme, për të siguruar në praktikë zbatimin e dispozitave të përcaktuara në manualin "*Për rregullat e trajtimit dhe të sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore*" që kanë të bëjnë me aksesin për t'u vizituar tek një mjek që në momentet e para të heqjes së lirisë, por jo me vonë se 24 orët e para.

11- Respektimi me korrektesë i dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe mos trajtimin e tyre fillimisht si të shoqëruar.

12- Heqja e sendeve që reflektojnë dhunë në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore dhe ato ku merren në pyetje personat e ndaluar dhe arrestuar.

13- Transferimi nga ambientet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të të gjithë të paraburgosurve ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit "*arrest në burg*" dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit të tyre në mungesë me "*burgim*".

14- Vendosja në ambientet e policisë, duke përfshirë edhe ato të sigurimit dhe shoqërimit, të posterave me të drejtat e personave të arrestuar, ndaluar dhe shoqëruar.

15- Pasurimi i programit të formimit të kursantit në Qendrën e Formimit Policor Tiranë, me njohuri të plota mbi të drejtat dhe liritë e individit.

16- Vendosja e kamerave të sigurisë në ambientet e shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit në të gjitha njësitë vendore të Policisë së Shtetit.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në zbatim të tematikës së mësipërme Avokati i Popullit ka konstatuar se organet e Policisë së Shtetit kanë patur disa arritje pozitive sikurse mund të përmendim:

- Bashkëpunimi i strukturave të policisë dhe hapje me shoqërinë civile, me të cilën janë lidhur disa marrëveshje;
- Marrjen e disa masave konkrete për zbatimin e Rekomandimit 12 të Komisionit të BE-së për zbatimin e Rekomandimeve të Avokati të Popullit;
- Miratimi i Programit të Punës nga Drejtori i Përgjithshme i Policisë së Shtetit në përmbyllje të Rekomandimit 12 të KE, për zbatimin e Rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore dhe trajnimin e punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë;
- Miratimi i plan-veprimeve konkrete nga Drejtoritë e Policisë së Qarqeve për strukturat në varësi të tyre për zbatimin e programit të cituar më sipër;
- Fillimi i trajnimeve të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë;
- Vendosja në pjesën më të madhe të organeve të saj të librit të ankesave të personave të shoqëruar, ndaluar, ose arrestuar;
- Reagimi pozitiv në vijim të rekomandimit të Avokatit të Popullit bërë gjatë viteve të mëparshme për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”;
- Ndërtimi në disa organe policie, si në Korçë e Durrës, të ambienteve të reja të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve bashkëkohore.

Krahas arritjeve pozitive janë konstatuar edhe një numër i konsiderueshëm problematikash që lidhen me kushtet e ambienteve të shoqërimit e të sigurisë, si dhe me mënyrën e zbatimit të ligjit nga punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë shoqërimit/ndalimit dhe arrestimit të shtetasve, të cilat çënojnë të drejtat dhe liritë e qytetarit. Këto problematika, janë adresuar në vazhdimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit, përfshirë raportin e institucioni të Avokatit të Popullit të vitit 2011, dhe është kërkuar zgjidhja e tyre në mënyrë të vazhdueshme e konstante. Në kushtet

e mungesës së masave për zgjidhjen e kësaj problematike jemi të detyruar të risjellim sjellim përsëri në vëmendjen tuaj:

“Lidhur me ambientet e shoqërimit ku mbahen personat e shoqëruar është konstatuar se: në pjesën më të madhe të Komisariateve dhe Stacioneve të Policisë në vend nuk ka ambiente shoqërimi/ ndalimitë ndara më vete, për meshkujt, femrat dhe të miturit, sipas konceptimit të bërë nga ligji nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Vetëm në Komisaritet e Policisë Korçë, Kukës, Gjirokastrë, Lezhë, Fier, Kavajë dhe Komisaritin e Policisë Nr.5 Tiranë, janë ndërtuar dhomat e shoqërimit të shtetasve sipas standardeve të parashikuara në ligj.

“Në Komisaritin e Policisë Gjirokastrë dhe Kukës është konstatuar se ndërmjet dhomave të shoqërimit të shtetasve janë vendosur Dhomat e Gjurmimit Teknik dhe Dhoma e Paraqitjes për Njohje. Ky projekt nuk duhet të ishte miratuar nga strukturat drejtuese të Policisë së Shtetit, pasi prezenca e tyre kompromenton rëndë ambientin e shoqërimit dhe cilësinë e personave të shoqëruar. Për sa më sipër, Avokati i Popullit ka rekomanduar spostimin e këtyre dhomave në një ambient tjetër, por deri më sot akoma këto rekomandime nuk kanë gjetur zbatim”.⁴

Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, ku fluksi i të shoqëruarve është më i madh, kanë filluar punimet për rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë, por akoma nuk është bërë e mundur vënia e tyre në funksionim.

Edhe më tej, gjendja mbetet e pandryshuar dhe ashtu siç vërehet edhe në Raportin 2011, “Në Komisaritin e Policisë Krujë, Elbasan, Burrel, Pogradec, Berat dhe Mallakastër ambientet e shoqërimit janë jashtë ndërtesës së komisaritatit, në ndërtesa një katëshe, me soletë të cilat janë të ftohta në dimër dhe të nxehta në verë dhe për pasojë e bëjnë të pamundur qëndrimin e të shoqëruarve në to. Këto ambiente janë dhe me lagështi, pa ndriçim natyral dhe pa tualet. Punonjësit e policisë na informuan se në periudhë dimri, të shoqëruarit i lënë nëpër korridore pasi është e pamundur që ata të qëndrojnë brenda tyre.

Në Komisaritin e Policisë Përmet, Shijak, Peqin, Tepelenë dhomat e shoqërimit janë rikonstruktuar me inisiativën e drejtuesve të këtyre komisariateve, por edhe pse ambienti i shoqërimit është i ndarë më vete për persona të mitur, femra dhe madhorë, përsëri nuk i plotëson standardet e përcaktuara në ligj, pasi mungojnë pajisjet e domosdoshme për qëndrim, si stola, karrike, apo tavolina.

Në disa Komisariate Policie, si në Burrel, Bulqizë, Sarandë dhe Vlorë dyert e dhomave të shoqërimit, ndarjet e korridoreve dhe dritaret janë prej zgare hekuri. Rreziku për jetën e të shoqëruarve në këto ambiente është i madh, pasi në to krijohen premisa për vetvarje të të shoqëruarve, siç edhe ka ndodhur më parë në Komisaritet e Policisë Lezhë dhe Durrës.

Vlen të theksohet fakti se para pak kohëve është bërë rikonstruksioni i Komisaritatit dhe Drejtorisë së Policisë, Qarkut Vlorë. Pavarësisht rekomandimit të veçantë që institucioni ynë ka bërë lidhur me rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit e të sigurisë së shtetasve në këtë komisaritat, është për të ardhur keq që brenda këtij rikonstruksioni nuk është menduar aspak për këto ambiente. Kjo gjë tregon nënoleftësimin nga Strukturat e Policisë së Shtetit të rekomandimeve tona, si dhe të të drejtave të shtetasve që mbahen në këto ambiente”.

4 Marrë nga Raporti 2011, fq. 35

Në të gjitha Komisaritet e Policisë është konstatuar se në plan-vendosjen e shërbimeve të policisë së rendit, i miratuar nga drejtuesit e këtyre komisariateve, punonjësit e policisë që kanë për detyrë mbikqyrjen e të shoqëruarve, ndaluarve, apo arrestuarve nuk janë në gjendje për ta kryer këtë detyrë, pasi janë të ngarkuar me shumë detyra të tjera. Sipas plan-vendosjes, shërbimi në këtë vend është i organizuar 24 orë nga ora 07.00 deri 07.00 të ditës pasardhëse. Kjo ngarkesë e punonjësit të policisë së rendit, e bën të pamundur mbajtjen e të shoqëruarve, ndaluarve dhe arrestuarve nën mbikëqyrje, me qëllim parandalimin e veprimeve që mund të rrezikojnë jetën e tyre, siç edhe ka ndodhur në disa komisariate policie (persona të shoqëruar janë vetëvarur), si dhe nuk përmbushin detyrimin ligjor për respektimin e të drejtave të të shoqëruarve, ndaluarve dhe të arrestuarve sipas parametrave të përcaktuar në ligj.

Për shkak të shumëllojshmërisë së detyrave që ka ky vend shërbimi, si dhe kohës së gjatë të punës prej 24 orë pa ndërprerje që kryen punonjësi i policisë i dislokuar në këtë vend, kemi bindjen se përpiluesit e plan-vendosjes së shërbimeve të policisë së rendit, e bëjnë atë në mënyrë formale, të pa studiuar mirë dhe të pa mbështetur në baza e mundësi reale. Është e pamundur fizikisht dhe psikologjikisht, që një punonjës policie t'i kryejë mirë të gjitha detyrat e ngarkuara sipas këtij plani, edhe në qoftë se shërbimi do të ishte i organizuar vetëm për 8 orë pune, dhe jo më për 24 orë sikurse bëhet. Mosverifikimi i bazueshmërisë dhe objektivitetit të plan-vendosjeve të shërbimeve të policisë së rendit, tregon mungesë kontrolli nga strukturat e Drejtorive të Policisë së Qarqeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ndaj organeve vendore të policisë lidhur me zbatimin e detyrave, të përcaktuara në ligj, në Letër-Porosi, Manual, Urdhëra, Udhëzime, Rekomandime e akte të tjera nënligjore.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës pas çdo inspektimi të bërë në dhomat e shoqërimit ka hartuar rekomandime të veçanta në lidhje me problematikat e konstatuara duke kërkuar ndërtimin apo rikonstruksionin e tyre, sipas konceptimit të bërë në ligjin nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit". Mirëpo, megjithë interesimin e Ministrisë së Brëndshme për këtë shërbim, ka mangësi të cilat lidhen kryesisht me mungesën e fondeve në buxhetin e kësaj ministrie.

Lidhur me mënyrat e trajtimit të shtetasve të shoqëruar, bazuar në kontaktin e drejtpërdrejtë me persona të shoqëruar, si dhe nga ballafaqimi i praktikave të punës së policisë me librat e shoqërimit të shtetasve, rezulton se, në shumë raste, janë shoqëruar në polici persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ "a" dhe "b" dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit". Vazhdohet të trajtohen si të shoqëruar persona që kanë kryer, apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si: vrasje, vjedhje, kundërshtim të punonjësve të policisë, persona që janë në kërkim, persona për shkak të konflikteve midis tyre, për prishje rendi, për rrahje, për dhunë në familje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor etj, megjithëse këta persona kanë qenë të identifikuar.

Grupet e personave të shoqëruar në mënyrë të paligjshme kategorizohen si më poshtë :

1- Personat që kanë kryer, apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si: vrasje, kundërshtim të punonjësve të policisë, vjedhje, prishje të rendit dhe qetësisë publike, rrahje, dhunë në familje, etj (Komisaritet e Policisë Peshkopi, Vlorë, Fier, Korçë, Ersekë, Shkodër, Krujë dhe në Komisaritin e Policisë Nr. 1, 2, 5 dhe 6 në Tiranë). Në këto raste policia duhet të veprojë sipas dispozitave ligjore, neni 253 i K.Pr.Penale.

2- Personat për të cilët lind nevoja për të marrë prej tyre informacion, për parandalimin e një rreziku, për të identifikuar persona që mund të kenë dijeni për rrezikun, apo incidentin dhe për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar

e drejta ligjore për “njoftim për paraqitje në polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë. (Komisariatet e Policisë Durrës, Elbasan, Peqin, Pogradec, Librazhd, Burrel, Shkodër, Pukë si dhe Komisariatet e Policisë 2 dhe 5 Tiranë).

3- Trajtohen si të shoqëruar edhe personat në kërkim. Vlen të theksohet se për këtë kategori personash ndaj të cilëve është nxjerrë urdhër ekzekutimi i një vendimi penal, si dhe në rastet kur një person ka kryer më parë, apo dyshohet si autor i mundshëm i një vepre penale (është fjala kur nuk jemi në kushtet e flagrancës), ai duhet të ndalohet sipas dispozitave ligjore parashikuar në nenin 464 të K.Pr.Penale. Kjo dukuri ndodh pothuajse në të gjitha Strukturat e Policisë në vend.

4- Personat e shoqëruar për shkak të një konflikti, veprim i cili nuk është i parashikuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Këto janë rastet që dominojnë pothuajse në të gjitha Komisariatet e Policisë në vend. Por meqënëse qëllimi i shoqërimit nga policia në këtë rast është parandalimi i ndonjë krimi të mundshëm ndërmjet të konfliktuarve, atëherë rritet rrezikshmëria që ky rast duhet të rregullohet në ligj, dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë. Rastet janë të shumta në të gjitha Strukturat e Policisë së Shtetit.

5- Personat e kapur në flagrancë, kur dihet se ndaj autorit të veprës penale që kapet gjatë kryerjes së veprës penale, apo menjëherë pas kryerjes së saj, duhet të bëhet arrestimi i tij sipas nenit 251 të K.Pr. Penale dhe pa e mbajtur atë në gjëndje shoqërimi 10 orë. (Komisariatet e Policisë Sarandë, Shkodër, Gjirokastrë, Tepelenë dhe Korçë).

6- Personat që tregojnë rrethana të dobishme për hetimin. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore e parashikuar në nenin 312 i K.Pr.Penale, duke i thirrur ata me urdhër, apo fletë- thirrje dhe paralajmëruar për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje, pa patur pengesë të ligjshme. Komisarati i Policisë Tepelenë, Vlorë, Fier, Lezhë, Kurbin, Librazhd si dhe Komisariatet e Policisë Nr.1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 Tiranë.

7- “Në të shumtën e rasteve arsyeja e shoqërimit në organin e policisë vazhdonë të jetë “për verifikim”. Kjo lloj arsyeje e shoqërimit është e përgjithshme dhe ka nevojë që të specifikohet konkretisht se për çfarë verifikimi konkret. Nga verifikimet e bëra në librat e shoqërimit dhe pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, arsyeja e shoqërimit shënohet “për verifikim” edhe kur në fakt personi shoqërohet për rastet e përmendura më lart.”⁵

Nga shqyrtimi i rasteve të mësipërme dhe pyetja e punonjësve të policisë, të cilët kishin urdhëruar shoqërimin e shtetasve në polici, rezultoi se këto shkelje të ligjit ishin pasojë e mosnjohjes së konceptimit të kritereve ligjore të shoqërimit të përcaktura në ligjin nr.9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Personat e arrestuar dhe të ndaluar, nuk duhen regjistruar në librin e shoqërimit sikurse ndodh shpesh herë, por në librin e personave të arrestuar dhe të ndaluar.

“Librat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të shtetasve janë modeluar sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, por konstatohet se ka raste që

shtetasit e shoqëruar nuk regjistrohen në librin e shoqërimit të shtetasve ose rubrikat e tij nuk plotësohen sipas kërkesave të përcaktuara në ligj.

Më konkretisht, rubrika e njoftimit të familjarëve, përsëri nuk plotësohet saktë, pasi shkruhet "u njoftua familja" dhe nuk hidhen të plota të dhënat e personit që mori njoftim. Njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit, për shoqërimin e tij në polici dhe arsyet ligjore, përbën detyrim ligjor për punonjësit e policisë, i cili është parashikuar në nenin 107 të ligjit "Për Policinë e Shtetit". Punonjësit e policisë pretendonin se bëhej njoftimi i familjarëve, mirëpo fakti që nuk pasqyrohet në libër ky veprim, lë vend për dyshime.

Vërehet se të shoqëruarve, në të gjitha organet e policisë ju bëhet kontrolli personal dhe ju hiqen e bllokohen sendet personale. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 106, pika 3 të ligjit nr.9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", në të cilin është parashikuar se: "Punonjësi i policisë bën kontrollin dhe këqyrjen fizike, me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve, ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse". Ndërsa lidhur me bllokimin e sendeve personale, në nenin 108 të ligjit "Për Policinë e Shtetit" është përcaktuar se: "Sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike".

Gjithashtu konstatohet se në rastet kur shtetasve të shoqëruar u hiqen dhe bllokohen sendet personale nga punonjësit e policisë nuk mbahet dhe nuk u jepet poseduesve procesverbali përkatës. Ky veprim vjen në kundërshtim me; nenin 108, paragrafi i dytë të ligjit nr.9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" ku thuhet se: "Punonjësi i Policisë që vepron, harton procesverbalin e caktuar, i cili i jepet poseduesit për t'u njohur me të"; nenin 37/3 të Kushtetutës, ku thuhet se: "Askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij, ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik"; nenin 202 e vijues të K.Pr.Penale ku parashikohet se: "Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale, gjykata merr vendim për kontrollin personal...". Në rast flagrance, ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur dhe që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 299 të K.Pr.Penale.

Gjatë inspektimit konstatohet se në disa raste të shoqëruarve u merren gjurmët daktiloskopike (të gishtave). Punonjësit e Policisë justifikohen me faktin se marrja e gjurmëve përdoret si mjet identifikimi duke u bazuar në nenin 103, pika 5 e Ligjit Nr.9749 dt.04.06.2007 "Për Policinë Shtetit". Ky qëndrim është i pabazë pasi të gjithë personave që i'u merren gjurmët e gishtave lihen të lirë përpara se të vijë përgjigjja nga Instituti i Policisë Shkencore. Kjo tregon se marrja e gjurmëve të gishtave nuk përdoret si mjet identifikimi, por për t'i përdorur ato si model krahasimi me gjurmët e gjetura në ngjarje të pazbuluara. Këto veprime vijnë në kundërshtim me nenin 3 dhe 16 të ligjit nr. 9887, dt. 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Në disa komisariate vërehet se në ambientet e shoqërimit ku mbahen shtetasit e shoqëruar, nuk ka postera me të drejtat ligjore të të shoqëruarve. Shkeljet e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nga policia, vijnë për faktin se nga punonjësit e policisë ka mungesë të njohurive në zbatim të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", të veprimtarisë së institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut, ligjit për Avokatin e Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera

Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), si dhe të Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Ky nivel i kufizuar njohurish reflektohet në performancën e dobët të efektive të Policisë së Shtetit, veçanërisht atyre të rolit bazë. Madje në disa raste njohja e përciptë e ligjit ose mosnjohja e tij ka qenë burimi kryesor i ngjarjeve dhe shkeljeve të rënda, si rezultat i të cilave punonjës të veçantë të Policisë së Shtetit janë ndëshkuar me masa disiplinore, ose janë dërguar për ndjekje penale.

Avokati i Popullit gjykon se, parandalimi i rasteve të mësipërme që vijnë për shkak të mosnjohjes së ligjit, është një detyrë që ngarkon me përgjegjësi një sërë organesh të administratës shtetërore dhe të Policisë së Shtetit, ku një rol të veçantë luajnë institucionet e formimit arsimor dhe trajnues të efektive të policisë.

Në takimet e zhvilluara me drejtues të Qendrës së Formimit Policor në Sauk Tiranë, Avokati i Popullit ka vërejtur se, pavarësisht përpjekjeve për rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe programeve që zhvillohen, në zbatim edhe të rekomandimeve të vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit, programet arsimore dhe trajnuese ndaj kategorive të veçanta të punonjësve të Policisë së Shtetit, vazhdojnë të mbeten të varfra mbi njohuritë që ato japin për të drejtat e njeriut, institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e promovimin e këtyre të drejtave si dhe me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë. Për rrjedhojë, duhet të vazhdojë të mbetet prioritet i strukturave të mësipërme pasurimi i kurrikulave akademike me tema dhe problematika mbi të drejtat e njeriut.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit shpreh gatishmërinë dhe përkushtimin për t'u ofruar strukturave të policisë së shtetit asistencë dhe trajnime, me mundësitë dhe ekspertizën që ai disponon, që do të synojnë rritjen e shkallës së njohjes dhe ndërgjegjësimin e strukturave .

Për problemet e konstatuara Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar gjithë strukturave të Policisë së Shtetit zgjidhjen e tyre të menjëhershme. Sa më sipër i është rekomanduar edhe Qendrës së Formimit Policor për të bashkëpunuar me qëllim promovimin e të drejtave të njeriut edhe në këtë Qendër Formimi".⁶

"Lidhur me ambientet e sigurisë (paraburgimit), ku mbahen personat e ndaluar dhe arrestuar, nga inspektimet e bëra gjatë vitit 2012 në të gjitha Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë në vend është konstatuar se vetëm në Komisariatet e Policisë Kukës, Korçë, Gjirokastër, Lezhë, Fier, si dhe në Komisariatet e Policisë Kavajë dhe atë Nr. 5 Tiranë dhomat e sigurisë plotësojnë parametrat ligjorë lidhur me sipërfaqen dhe kushtet e qëndrimit (Ligji Nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe Manuali "Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore"). Dhomat plotësonin normat dhe parametrat teknikë të parashikuar, **për personat e arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte 10 metër katror, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².**

Në të gjitha dhomat dhe në korridore kishte të vendosur postera për të drejtat e personave të ndaluar dhe arrestuar. Ishin vendosur pajisjet dhe orenditë e nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj. Brenda ambienteve kishte pajisje audiovizive (kamera) për survojimin e mbajtjen në kontroll të personit të arrestuar, apo të ndaluar.

⁶ Raport Vjetor 2011, faqe 38-40.

Personave të arrestuar, apo ndaluar u ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili sigurohej me shpenzimet e veta. Kishin mundësi për mbajtjen e higjienës personale, si dhe u lejohej të mbanin letër dhe laps për të shkruar, pastë e furçë dhëmbësh, pastë rroje tubet dhe brisqe rroje të plastifikuar. Kishte mundësi të korrespondecës me telefon, letër etj. Gjithashtu ata merrnin nga Komisariati i Policisë sapun, detergjentë, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve, ose peshqir dhe mjete të tjera për ruajtjen e higjienës vetjake e të ambientit ku qëndronin. Dritaret e dhomave mundësonin qarkullimin mjaftueshëm të ajrit.

Duhet theksuar gjithsesi se, edhe në dhomat e sigurisë të ndërtuara rishtaz, nuk ishin parashikuar dhe ndërtuar ambiente ajrimi më vete e për rrjedhojë personave **të ndaluar dhe/ose arrestuar**, nuk u garantohej ajrim sipas kërkesave të parashikuara në aktet normative (jo më pak se dy orë në ditë). Për më tepër, dhomat nuk kishin ambient të posaçëm për ushtrimin e rriteve fetare, apo aktivitete të tjera. Brenda dhomave të sigurisë kishte shumë elementë teknikë, **të cilët nuk ishin sipas parametrave të përcaktuara në Manual.**

Të arrestuarit dhe të ndaluarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhërin e Përbashkët Nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej me nënkontraktor dhe seroivej brenda gjithë parametrave të përcaktuar në ligj. Për të ndaluarit dhe të arrestuarit që ishin bartës të sëmundjeve ngjitëse, ishin parashikuar ambiente më vete, të ndarë dhe izoluar nga të tjerët.

Në pjesën më të madhe të të Drejtorive dhe Komisariateve të Policisë, ku është përcaktuar se duhet të ketë dhoma sigurie, dhomat janë të trashëguara nga ish-dhomat e Paraburgimit të para viteve 90-të dhe janë të pa lyera, pa ndriçim, pa dushe, pa krevatë, pa dyshek, pa çarçaf, si dhe pa orenditë e nevojshme si: karrige, stola apo tavolinë.

Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë edhe pse ka filluar rikonstruksioni i dhomave të sigurisë, akoma nuk është bërë e mundur vënia e tyre në përdorim. Shqetësuese mbetet situata në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat, pasi nuk ka asnjë dhomë sigurie. Të gjithë personat e ndaluar dhe arrestuar qëndrojnë në ambientet e paraburgimit të IEVP, Berat. Në disa Komisariate Policie ambientet e sigurisë janë në dhoma nëntokë dhe për pasojë kanë probleme të lagështisë dhe në disa raste janë edhe tërësisht të amortizuara si p.sh: në Komisaratin e Policisë Lushnje.

Nuk janë konstatuar raste ku të arrestuarit e mitur të mbahen së bashku me të arrestuarit madhorë.

Në Komisaritet e Policisë, Shkodër, Sarandë, Tropojë, Pukë mungojnë posterat informativë për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia.

Për të gjitha problemet e konstatuara gjatë inspektimeve, institucioni i Avokatit të Popullit ka paraqitur rekomandime duke kërkuar zgjidhjen e problematikave ekzistuese në dhomat e sigurisë.

Avokati i Popullit vëren se, megjithëse rekomandimet e tij janë vlerësuar si të bazuara e janë pranuar nga drejtuesit e Drejtorive të Policisë në Qarqe, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, ato nuk janë realizuar në pjesën më të madhe me pretendimin se “nuk disponojmë fondet e nevojshme”.

Lidhur me mënyrën e trajtimit të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar, duhet thënë se institucioni

i Avokatit të Popullit ndjek me prioritet ankesat e shtetasve që pretendojnë se mbi ta është ushtruar dhunë fizike nga punonjës të Policisë së Shtetit, në ambientet e sigurisë dhe hetimit. Gjatë këtij viti është konstatuar se janë shtuar rastet e ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike nga punonjës të Policisë së Shtetit, për të cilët u është rekomanduar organeve të prokurorisë fillimi i hetimit penal.

Trajtimi i shtetasve në këto ambiente, duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në Kushtetutë, Aktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, K.Pr.Penale, si dhe në zbatim të të gjitha akteve të tjera ligjore e nënligjore ndaj individëve që i'u është privuar liria. Në aktet e mësipërme parashikohet se përdorimi i torturës, dhunës, trajtimit degradues, diskriminues, jo human, apo çnjerëzor, përfshirë edhe dhunën verbale, si kërcënime, fyerje, (e cila krijon përshtypjen dhe imazhin e frikës, pasigurisë për jetën e shëndetin e të ndaluarve dhe arrestuarve, apo dhe të familjarëve të tyre), janë veprime të dënueshme dhe duhen të parandalohen nga çdo institucion i administratës publike..

Në praktikën e deritanishme rezulton se: në një numër të konsiderueshëm të rasteve është e pamundur të provohet pretendimi për ushtrim dhune, për faktin se ambientet e sigurisë ku mbahet i ndaluari dhe/ose i arrestuari nuk monitorohen me kamera.

Avokati i Popullit e ka konsideruar procesin e monitorimit filmik të ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit, si masë parësore për parandalimin e rasteve të torturës. Për rrjedhojë, procesi i mbikqyrjes së këtyre ambienteve me anë të kamerave është një veprim i domosdoshëm për arsyet e mëposhtme:

1- Mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit;

2- Mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të shoqërimit e të sigurisë dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm lidhur me masat disiplinore, apo penale që duhet të merren ndaj personave përgjegjës;

3- Dokumentimi filmik është një element, mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna, apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe objektive në rekomandimet, apo raportet përkatëse të institucioneve monitoruese të pavarura;

4- Monitorimi filmik gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarve dhe arrestuarve përbën një avantazh për të shmangur pretendime të personave për marrjen me dhunë të dëshmimeve dhe deklaratave, të cilat venë në dyshim profesionalizmin e policisë dhe të të gjithë procesit hetimor.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit duke përshëndetur nismën e fundit të Policisë së Shtetit për vendosjen e kamerave monitoruese në ambientet publike, shtron si nevojë imediate instalimin e tyre brenda institucioneve të Policisë së Shtetit, duke e parë të lidhur ngushtë këtë proces me parandalimin e rasteve të dhunës, dokumentimin e saj, si dhe evitimin e akuzave të pabazuara ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2012 përsëri është konstatuar se në shumicën e Komisariateve të Policisë nuk respektohen kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr.9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe Kodin e Procedurës Penale për ndalimin dhe arrestimin, pasi trajtohen si të shoqëruar edhe personat që kanë

kryer, apo dyshohen se kanë kryer vepra penale. Vetëm në Komisarlatin e Policisë Nr.5 Tiranë, për një periudhë 2 mujore ishin ndaluar dhe arrestuar 15 shtetas të dyshuar si autorë të veprave penale. Këta shtetas ishin trajtuar fillimisht si të shoqëruar mbi 6 orë secili dhe më pas janë kryer veprimet procedurale të arrestimit, apo ndalimit të tyre.

Duke vendosur në procesverbalet e arrestimit dhe të ndalimit orën e përpilimit të procesverbaleve të arrestimit apo ndalimit dhe jo orën faktike, kur ju është privuar liria në fakt, atyre nuk ju llogaritet në kohën e paraburgimit dhe më pas edhe atë të vuajtjes së dënimit, koha e qëndrimit si të shoqëruar, gjatë së cilës policia bën verifikime, apo veprimet e ndryshme procedurale, kohë e cila mund të shkojë deri në 10 orë. Në bazë të neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë, ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit, ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi, ose ndalimi.

Mbajtjen në këtë gjendje punonjësit e policisë e justifikojnë me mendësinë se, “në qoftë se do t’i arrestojnë personat që në momentin e parë, atëherë nuk mund të kryejnë asnjë veprim procedural, për të provuar veprën e kryer”. Ky qëndrim dhe justifikim nuk ka mbështetje ligjore, përkundrazi bëhet në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale. Sipas neneve 30 dhe 294 të K.Pr.Penale, policia gjyqësore, atributet e të cilës i kanë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, “edhe pas referimit të veprës penale te prokurori, ka të drejtë të kryejë me inisiativën e vet funksionet e tij ligjore si: të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprës penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal”.

Ky fenomen vazhdon të ekzistojë, ndonëse për këtë problem që në vitin 2009 është bërë rekomandim dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nxori Letër-Porosinë Nr.1328, dt. 23.11.2009 “Për respektimin dhe garantimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të personave gjatë veprimitarisë së Policisë së Shtetit”. Në pikën 2 të saj parashikohet që personat e dyshuar si autorë të veprave penale dhe ata të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, të mos trajtohen e mbahen si të shoqëruar, por ndaj tyre të aplikohet menjëherë masa e arrestit në flagrancë, apo e ndalimit.

Vërehet se gjatë këtij viti përsëri janë konstatuar raste (në Komisarlatin e Policisë Nr. 3 Tiranë dhe në Komisarlatin e Lushnjës), ku të arrestuarve të mitur, r të mos u jetë siguruar mbrojtja e detyrueshme me avokat, si dhe ndihma (asistenca) psikologjike, siç parashikohet në nenet 35 e 49 të K.Pr.Penale.

Punonjësit e policisë e justifikojnë mungesën e psikologut me arsyetimin se ky funksion nuk është i përfshirë në organikën e Komisarlateve, por vetëm në atë të Drejtorive të Policisë së Qarqeve. Në disa raste, distanca e madhe mes komisarlateve dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve e bën të pamundur praninë e tij. Konstatohet se ka drejtori policie që këtë funksion, ende nuk e kanë parashikuar, sepse nuk ka kërkesa për t’u punësuar në këtë vend pune. Avokati i Popullit i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të marrë të gjitha masat, për prezencën e psikologut dhe të avokatit në çdo rast ku kryhen veprime procedurale me të mitur, pasi të gjitha veprimet që kryhen pa prezencën e tyre vijjnë në kundërshtim me kërkesat e K.Pr.Penale të parashikuara në nenet 35, 37, 48 dhe 296/1.

Janë konstatuar raste që në dhomat e sigurimit mbahen persona të paraburgosur ndaj të cilëve ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, si dhe persona të ndaluar për ekzekutimin e vendimeve

penale me burgim të formës së prerë, të dhënë në mungesë. Ata nuk dërgohen në kohë në institucionet e paraburgimit dhe ato të burgimit në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për shkak të pengesave që krijon vazhdimisht kjo Drejtori. Koha e qëndrimit të tyre në ambientet e policisë pas caktimit të masave të sigurimit varionte nga 1, deri 5 ditë.

Të ndaluarit dhe të arrestuari, brenda 24 orëve të para të ndalimit apo arrestimit, i ushtrohen në ambientet e policisë një kontrolli të detyrueshëm mjekësor lidhur me sëmundjet që mund të kenë, veçanërisht sëmundjet ngjitëse, të cilat përbëjnë rrezik për ta dhe për personat e tjerë të ndaluar..

Në disa Komisariate/Drejtori Policie mungojnë formularët informues për të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar, apo arrestuar kur këta janë shtetas të huaj, në gjuhën angleze.

Ekspozimi i posterave për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar, apo arrestuar nga policia është konstatuar në pjesën më madhe të Drejtorive dhe Komisariateve të Policisë në vend.

Në disa Komisariate Policie nuk ka libra të veçantë për të ndaluarit dhe të arrestuarit, pasi ata, regjistrohen fillimisht në librat e shoqërimit duke u trajtuar si të tillë.

Për gjithë problematikat e konstatuara gjatë këtij viti, Avokati i Popullit dhe në funksion të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, i ka bërë disa rekomandime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, respektimi i të cilëve do të sillte parandalimin e torturës, keqtrajtimit, shkeljeve të ligjit nga punonjësit e Policisë së Shtetit si dhe plotësimin e standardeve në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë ku qëndrojnë shtetasit që ju privohet liria”.⁷

Problematika e mësipërme prezantohet nëpërmjet rasteve dhe rekomandimeve konkrete:

- Rasti i regjistruar me nr. dok. 201200056. Ky rast është regjistruar në bazë të ankesës së bërë nëpërmjet telefonit nga avokati i tre shtetasve, të cilët sipas tij ishin keqtrajtuar fizikisht nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Shkodër. Nga hetimi u konstatua se ankuesit ishin keqtrajtuar e dhunuar në mënyrë çnjerëzore nga punonjësit e policisë. Pretendimet e punonjësve të policisë se, ankuesit i kishin kundërshtuar me dhunë e goditur ata dhe mjetin e policisë, nuk ishin bindëse. Asnjë nga punonjësit e policisë nuk demostroi para ekspertëve tanë ndonjë pasojë (shenja apo gjurmë) të kundërshtimit të dhunshëm, apo goditjes të bërë atyre dhe mjetit të policisë nga ankuesit e arrestuar. Gjithashtu u konstatua se arrestimi i njërit prej ankuesve për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës” ishte bërë i kundërligjshëm sepse nuk kishte prova. Ky fakt ishte konstatuar edhe nga organi i prokurorisë, i cili kishte vendosur lirimin e menjëhershëm të tij.

U konstatua gjithashtu se nga punonjësit e policisë së shtetit nuk ishin zbatuar detyrimet ligjore që rrjedhin nga neni 118 i ligjit “Për Policinë e Shtetit”, për dhënien e ndihmës mjekësore të dëmtuarve. Ngjarja e ndodhur në këtë rast për nga intensiteti dhe egërsia e dhunës ishte çnjerëzore dhe nga përmbajtja ishte kriminale sepse përmbante elementët e veprës penale të “Torturës”.

⁷ Raporti Vjetor 2011, fq. 40-46

Për këto arsye iu rekomandua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër fillimi i ndjekjes penale në ngarkim të 9 punonjësve të Komisarariatit të Policisë Shkodër, *për veprën penale të "Torturës" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 86 dhe 25 i K.Penal, të ndryshuar.*

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër na informoi se, e pranoi rekomandimin tonë dhe regjistroi procedimin penal për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare" parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Gjithashtu ju rekomandua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër fillimi i ecurisë disiplinore ndaj OPGJ, *për arrestimin e paligjshëm të njërit prej ankuesve. Për këtë rekomandim na informoi se do të analizonte rastin në përfundim të hetimeve. Deri më sot nuk na është kthyer përgjigje përfundimtare për sa më sipër.*

- Rasti i regjistruar me nr. dok. 201202913. Ky rast filloi në bazë të ankesës së bërë nga një shtetase, e cila pretendonte se në datën 24.06.2012, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Durrës kishin keqtrajtuar fizikisht bashkëshortin e saj. Për shkak të dëmtimeve të rënda që i ishin shkaktuar nga punonjësit e policisë, ai ishte shtruar në kirurgjinë e Spitalit Rajonal Durrës, për ekzaminim dhe mjekim.

Nga provat e administruara gjatë hetimit të bërë rezultoi se, ankuesi ishte dhunuar fizikisht nga një punonjës i policisë kriminale dhe kanosur me armë, duke i shkaktuar dhimbje të forta dhe për pasojë edhe vuajtje të rënda fizike e mendore.

Gjatë hetimit u konstatua se punonjësit e Komisarariatit të Policisë Durrës e mbanin atë të lidhur me pranga në krevat. Ndonëse ishte në gjëndje shëndetësore të rënduar dhe merrte mjekime e serum, në pjesën më të madhe të kohës punonjësit e policisë e mbanin atë të *lidhur me pranga pas krevatit*. Sipas punonjësve të policisë të nivelit drejtues e zbatues, mbajtja e tij me pranga të lidhur pas krevatit ishte e parashikuar në Manualin e "Për rregullat e trajtimit dhe të sigurimit të të ndaluarve dhe të arrestuarve në njësitë policore". Ata deklaruan se manuali parashikon që, kur dhomat janë të pasigurta, atëherë me qëllim që i arrestuari i sëmurë të moslargohet, mbahet i lidhur me pranga pas krevatit.

Nga studimi i kuadrit ligjor në fuqi, rezultoi se procedura e mbajtjes të prangosur të personave të arrestuar, apo ndaluar nga policia e shtetit në kushte spitalore, nuk është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe çënon rëndë të drejtat themelore të individëve. Një procedurë e tillë ka qënë e parashikuar shprehimisht në Manualin "Për rregullat e trajtimit dhe të sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore" miratuar me Urdhrin Nr.64 dt.25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në vitin 2011 Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit shfuqizimin e pikës 2, të paragrafit 5, të Manualit "Për rregullat e trajtimit dhe të sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore" miratuar me Urdhrin Nr.64 dt.25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Rekomandimi u pranua dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me Urdhrin nr. 736, datë 27.09.2011 miratoi Manualin e "Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore". Në kreun e VII të tij, pika 5.2, parashikohet se: "Në rast se dhoma/ambienti spitalor nuk përmbush kushtet e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren masa të tjera shtesë për ruajtjen dhe sigurim e të arrestuarit/ndaluarit.

Këto masa planifikohen dhe zbatohen në varësi dhe në proporcionalitet me shkallën e rrezikshmërisë që paraqet personi, precedentët penal që ka, gjendjes shëndetësore, shkallën e dëmtimeve fizike të tij, kohën e qëndrimit të tij për trajtim mjekësor, etj”.

Pra, në Manualin e ri të cituar më sipër nuk parashikohet më e drejta e policisë për të mbajtur të lidhur me pranga në njërën dorë pas krevatit të fjetjes personin e arrestuar, ose ndaluar që ndodhet për kurim në qendra spitalore. Parashikimi në Manualin e ri i shprehjes se, “Në rast se dhoma/ambienti spitalor nuk përmbush kushtet e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren masa të tjera shtesë për ruajtjen dhe sigurim e të arrestuarit/ndaluarit”, nuk do të thotë që ai të lidhet me pranga pas krevatit, sikurse është kuptuar dhe vepruar në këtë rast nga punonjësit e policisë. Ky parashikim do të thotë që në këto raste nga drejtuesit të shtohet numri i punonjësve të policisë që të bëjnë ruajtjen dhe sigurimin e të arrestuarit ose të ndaluarit të shtruar në qendrën spitalore.

Mbajtja e lidhur me pranga në hekurat e krevatit të shtetasit të arrestuar ishte një veprim që përbën trajtim çnjerëzor dhe degradues, veprim që bie ndesh me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe për të cilin ka një qëndrim të konsoliduar tashmë edhe nga GJEDNJ-ja nëpërmjet disa vendimeve gjyqësore

Theksojmë gjithashtu se në më shumë se një rast edhe Komiteti i Parandalimit të Torturës (KPT) të Këshillit të Europës është shprehur se praktika e mbajtjes të prangosur në spital e personave të burgosur, është një akt degradues ndaj individëve dhe duhet zëvendësuar me masa të tjera alternative sigurie. Në mënyrë të qartë ky qëndrim është mbajtur në Raportin e Dytë të Përgjithshëm të KPT-së (CPT/inf (92)3), ku midis të tjerash thuhet se, citojmë: “Të burgosurit e dërguar në spital për t`u trajtuar nuk duhet të lidhen fizikisht në shtretërit e tyre të spitalit ose në pajisje të tjera për arsye ruajtje. Mundet dhe duhet të gjenden mjete të tjera që të plotësojnë kënaqshëm nevojat e sigurisë”. Ky përfundim ka ardhur si rezultat i shumë konstatimeve të këtij Komiteti gjatë vizitave në vendet anëtare të Këshillit të Europës, ku objekt ka qenë trajtimi i personave të cilëve u është kufizuar liria.

Në përfundim të hetimit të këtij rasti arritëm në konkluzionin se ankuesit i ishte shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, ..”për t`iu mos u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.”

Për sa më sipër, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të 21 punonjësve të Komisarariatit të Policisë Durrës për veprën penale të “Torturës” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 86 dhe 25 i K.Penal, të ndryshuar.

Organi i prokurorisë na informoi se ka filluar ndjekjen penale për këtë rast për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, por nuk na ka dërguar informacion për përfundimin e hetimeve.

- Rasti i filluar me iniciativë pas bërjes publike në media, i regjistruar me nr. dok. 201200930, që bën fjalë për trajtimin çnjerëzor të katër shtetasve nga punonjësit e policisë të Komisarariatit nr.2 Tiranë. Nga hetimi i këtij rasti rezultoi se, në datën 18.02.2012, rreth orës 02.45, pasi ankuesit kishin dalë nga një lokal, në afërsi të pallatit me shigjeta në Tiranë, i quajtur “Makuba”, janë keqtrajtuar fizikisht nga disa punonjës policie të patrul-

lës së përgjithshme, efektiv të Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë. Për shkak të plagëve e dëmtimeve të pësuarra të arrestuarit ishin dërguar në Spitalin Ushtarak Tiranë, për ndihmë mjekësore. Pasojat e dhunës u provuan edhe nga Aktet e Ekspertimit Mjeko-Ligjor, të bëra me kërkesën tonë.

Justifikimi i punonjësve të policisë se ankuesit i kishin kundërshtuar me dhunë e goditur ata dhe për këto arsye ndaj tyre ishte përdorur forcë, nuk ishte bindës. Ky pretendim u rrëzua edhe nga fakti se, asnjë nga punonjësit e policisë nuk demostroi para ekspertëve tanë ndonjë shenjë dhune (në trupat e tyre) të ardhur si pasojë e kundërshtimit të dhunshëm apo goditjes të bërë atyre nga të arrestuarit. Punonjësit e policisë kishin dëmtime vetëm në duar (si fryrje dhe enjtje). Këto dëmtime vërtetohnin në mënyrë indirekte se, veprimet e punonjësve të policisë ndaj të arrestuarve kanë qenë të dhunshme.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti arritëm në konkluzionin se ankuesit ishin keqtrajtuar fizikisht dhe pa asnjë shkak nga punonjësit e policisë, duke iu shkaktuar vuajtje të rënda fizike, deri në humbjen e ndjenjave.

Ankuesve i'u ishte shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës, sipas të cilit: *“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”*, nga neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, i cili parashikon se: *“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimit ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”*, si dhe të drejtat ligjore të garantuara nga ligji *“Për Policinë e Shtetit”*, neni 1, sipas të cilit: *“Misioni i Policisë është të ruaj rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”*.

Për shkeljet ligjore të përshkruara më sipër iu bë rekomandim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për fillimin e ndjekjes penale ndaj punonjësve të policisë për veprën penale të *“Torturës”* e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86, e 25, të K.Penal, i ndryshuar. Rekomandimi u pranua dhe organi i prokurorisë filloi hetimet.

- Rasti i regjistruar me nr. dok. 201203387. Ankuesi pretendonte se, në datën 04.09.2012, rreth orës 23.15, ka qenë duke ecur në rrugë për në banesën e tij. Papritur ai është ndaluar nga disa punonjës të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë dhe pa i thënë asnjë fjalë i është bërë kontroll personal, por nuk i kanë gjetur asnjë send të ndaluar nga ligji. Më pas e kanë shoqëruar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, pa i thënë asnjë arsye. Në polici i janë marrë shenjat e gjurmëve të gishtave e të duarve, është fotografuar, i janë marrë shënime gjeneralitetet dhe ishte pyetur me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, si dhe gjithçka që lidhej me ngjarjet e ndodhura në zonën ku ai banonte. Kur ankuesi kishte deklaruar se ai nuk kishte dijeni për atë çfarë kërkonin punonjësit e policisë, këta të fundit e kanë dhunuar fizikisht duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit me sende të forta me qëllim që ai të jepte informacione. Pasojat e dhunës u provuan edhe nga Akti i Ekspertimit Mjeko-Ligjor, i bërë me kërkesën tonë. Pasi është mbajtur disa orë është lënë i lirë, por as në këtë moment atij nuk i është thënë shkak ligjor dhe arsyeja e shoqërimit në polici. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se, shoqërimi i ankuesit në polici ishte i kundërligjshëm. Ky rast nuk parashikohet në aktet ligjore e nënligjore që bëjnë fjalë për shoqërimin si, në nenin 11, pika 6 dhe 101, pika 1, të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*; Urdhërin

e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.711, datë 11.10.2007 “Për zbatimin e kërkesave të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me përdorimin e forcës dhe trajtimin e personave të shoqëruar, Letër - Porosinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1328, datë 23.11.2009 “Për respektimin dhe garantimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të personave gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit”.

Kontrolli personal që i ishte bërë të shoqëruarit ishte në kundërshtim me ligjin. Ai përbën shkelje të hapur të të drejtës kushtetuese të paprekshmërisë personale të personit të garantuar nga neni 37/3, i Kushtetutës dhe ndërkohë vjen në kundërshtim me nenet 202, e vijues të K.Pr. Penale, nenin 106, pika 3, dhe nenin 109, pika 4, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Pyetja e të shoqëruarit në polici, me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, si dhe gjithçka që lidhej me ngjarjet e ndodhura, ishte e pa mbështetur në ligj dhe në kundërshtim me nenin 297, të K.Pr.Penale dhe nenin 100, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Marrja e shenjave të gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve e të shoqëruarit ishte në kundërshtim me nenin 103, pika 5, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Ndërkohë ky veprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me nenin 6, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Ky veprim i policisë nuk gjen as mbështetje në aktet nënligjore, sikurse është Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.777, datë 22.04.2007 “Mbi procedurat që do të ndiqen për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të personave të shoqëruar ose të ndaluar/arrestuar”.

Këto veprime të punonjësve të policisë vijnë në kundërshtim edhe me nenin 6/1, të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit. Në bazë të nenit 11/12 të Rregullores së cituar më sipër, këto veprime të punonjësve të policisë përbëjnë shkelje të rënda disiplinore, pasi punonjësit e policisë kanë shkelur e abuzuar me kompetencat ligjore të Policisë së Shtetit.

Nga ana tjetër, dhuna e ushtruar ndaj ankuesit i ka cënuar atij të drejtën themelore të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut” si dhe nga neni 1 i ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Për shkeljet ligjore të përshkruara më sipër iu bë rekomandim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për fillimin e ndjekjes penale ndaj punonjësve të policisë për veprën penale të “Torturës” të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 86, e 25, të K.Penal, i ndryshuar. Rekomandimi u mirëprit dhe organi i prokurorisë filloi hetimet.

- Rasti i regjistruar me nr. 201202899 dok. Ky rast u regjistrua me iniciativë pas bërjes publike në media të vrasjes së dy vëllezërve dhe plagosjes së katër personave të tjerë në lagjen Marrnaq, në fshatin Qelës të rrethit Pukë në datën 29.06.2012. Sipas medias, kjo tragjedi ndodhi për shkak të mosveprimit të organeve policisë për ndjekjen konform ligjeve të problemeve që kishin patur dy familjet e përfshira në konflikt.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti u provua se krimi kishte ndodhur edhe si pasojë e moskryerjes së detyrave ligjore nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Pukë. Ata megjithëse

kishin marrë dijeni për ndodhjen e dy veprave penale disa ditë më parë se të ndodhte ngjarja tragjike, nuk morën asnjë masë ligjore për administrimin, hetimin e kallëzimit të bërë nga familjarët e viktimave dhe për referimin e veprës penale në organin e prokurorisë. Qëndrimet e punonjësve të policisë, në këtë rast e Shefit të Komisarariatit dhe e inspektorit të policisë së zonës, duke kryer dhe moskryer me dashje disa veprime, ishin në kundërshtim me ligjin dhe përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës që i'u ishte ngarkuar atyre nga dispozitat e KPrP dhe ligji "Për Policinë e Shtetit", njëri si drejtues i Komisarariatit të Policisë dhe të tjerët, duke përfshirë edhe atë vetë, si oficerë të policisë gjyqësore. Këto veprime dhe mosveprime të tyre kanë sjellë pasoja të rënda interesave të ligjshme të shtetasve duke humbur jetën dy persona dhe plagosur katër të tjerë. Me veprimet dhe mosveprimet e tyre ata kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" në bashkëpunim, të parashkuar nga nenet 248 e 25 të K.Penal, të ndryshuar.

Për këtë rast u bënë tre rekomandime, respektivisht:

1. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë:

a) Fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të disa punonjësve të Komisarariatit të Policisë Pukë, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" të kryer në bashkëpunim, të parashkuar nga nenet 248 e 25 të K.Penal.

b) Marrjen e masës ndaluese nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të parashkuar nga neni 240/1/a i K.P.Penale "pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", duke pezulluar nga detyra Shefin e Komisarariatit të Policisë Pukë dhe oficerin e policisë gjyqësore deri në përfundimin e hetimeve.

Ky rekomandim u pranua, organi i prokurorisë filloi ndjekjen penale për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" të kryer në bashkëpunim, të parashkuar nga nenet 248 e 25 të K.Penal ndaj 4 punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Pukë, si Shefit të Komisarariatit, Shefit të Parandalimit dhe Hetimit të Krimeve të Lehta në këtë komisarariat, inspektorit të Krimeve të Rënda dhe inspektorit të policisë së zonës.

Gjithashtu mbi bazën e kërkesës së prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, vendosi pezullimin e tyre nga detyra deri në përfundim të hetimeve.

2. Rekomandimi drejtuar Komisarariatit të Policisë Pukë, për t'i referuar menjëherë organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë, veprat penale të kallëzuara nga njëri prej familjarëve të viktimave. Rekomandimi u pranua duke bërë referimin e veprave penale organit të prokurorisë.

3. Rekomandimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nëpërmjet të cilit u kërkua:

a) Të merren të gjitha masat e nevojshme për kapjen sa më shpejtë të bashkëautorëve të dyshuar të kësaj ngjarjeje, të cilët duke qënë të lirë dhe të armatosur vazhdojnë të përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike.

b) Analizimin me objektivitet, me transparencë dhe luajalitet të shkaqeve që çuan në ndodhjen e masakrës në fshatin Qelëz të rrethit Pukë në datën 29.06.2012 dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative.

c) Fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të policisë, që kanë bërë shkelje ligjore, por që nuk kanë përgjegjësi penale.

ç) Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha organet e Policisë së Shtetit, me qëllim që ngjarje të tilla, të mosreferimit të veprave penale në Prokurori dhe të mosndjekjes konform ligjit të kallëzimeve të marra nga shtetasit, të mos përsëriten në të ardhmen.

Rekomandimi u pranua përfshirë pezullimin nga detyra deri në përfundim të hetimeve të katër punonjësve të policisë .

- Rasti i filluar me iniciativë pas bërjes publike në media, i regjistruar me nr. dok. 201203243, që bën fjalë për ngjarjen e datës 15 Gusht 2012 ku mbeti i vrarë një shtetas nën masën e sigurisë arrest shtëpie. Banesa e këtij shtetasi, ishte në ruajtje nga dy efektive policie të Komisarariatit të Policisë Elbasan por kjo masë sigurie e policisë nuk pengoi aspak dy autorët të hyjnë brenda në banesë për të kryer krimin.

Komisariati i Policisë Elbasan duhet të zbatonte vendimin nr. 635/83 akti datë 12.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili ngarkonte këtë Komisarariat Policie për të marrë masa për të ruajtur banesën e zgjedhur nga i pandehuri dhe të mbikqyrte ekzekutimin e kësaj mase sigurimi, duke caktuar forca të policisë për ruajtjen e banesës në vazhdimësi. Punonjësit e policisë nuk duhet të lejonin që i pandehuri të komunikonte me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që ishin përcaktuar në vendimin e gjykatës.

Nga hetimi i këtij rasti u konstatua se Komisariami i Policisë Elbasan, nuk kishte bërë një Plan-Vepri sipas objektit të punës, apo një strategji **për zgjidhjen e problemeve të caktuara në situata të tilla**. Instruktazi u jepej punonjësve të policisë verbalisht nga Specialisti i Informacionit të Komisarariatit të Policisë sipas gjykimit të tij. Nga kqyrja e Librit të Planizimit të Shërbimit rezultoi se instruktazhi i punonjësve të policisë ishte bërë dhe me shkrim nga Specialisti i Patrullës së Përgjithshme, por jo sipas rubrikës “Për detyrat që jepen gjatë instruktazhit”, pasi ai nuk ishte konkret, me detyra të qarta dhe specifike për çdo vend shërbimi. Këto veprime ishin në kundërshtim me nenin 25 pika 5 të Rregullores së Brendëshme të Policisë së Shtetit dhe procedurave, standardeve të normuara për planifikimin e shërbimit policor, në të cilën është përcaktuar se, “*Plane të veprimt ose operacionale harton çdo strukturë policie, sipas objektit të punës, me qëllim zbatimin e një strategjie ose programi, si dhe për zgjidhjen e problemeve të caktuara, të çështjeve apo të situatave të veçanta*”.

Mosmarrja dhe vlerësimi i çertifikatës së trungut familjar të personit me masë arrest në shtëpi, bëri të mundur që për rreth një vit e gjysëm punonjësit e policisë, lejuan të hyjnë dhe dalin në banesën e shtetasit të vrarë çdo person duke u mjaftuar nga njohja dhe marrëdhëniet e krijuara me pjestarët e familjes së viktimës. Mungesa e Planit të Vendosijes së forcave të policisë dhe i Skemës së Ruajtjes së Objektit tregoi një neglizhencë dhe paaftësi të patolerueshme të punonjësve të policisë në sektorët përgjegjës, të cilat u bënë shkak për cënimin e të drejtës themelore të njeriut, siç është e drejta e jetës .

Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim të hapur dhe me nenin 4, pika 10 dhe 12 të Rregullores së Brendshme të Policisë së Shtetit dhe procedurave e standardeve të normuara për planifikimin e shërbimit policor, në të cilat shprehimisht thuhet se eprori duhet: *“Të japë urdhra/udhëzime të qarta që kanë lidhje me detyrën dhe, si epror, të sigurohet që vartësi i tij i ka kuptuar”*, si dhe *“Të kontrollojë zbatimin e urdhrave të dhëna ndaj vartësve, si dhe kryerjen e detyrës/shërbimit”*.

Në përfundim të këtij hetimi u arrit në konkluzionin se, veprimet e kryera nga punonjësit e policisë të Komisarariatit dhe Drejtorisë së Policisë Qarkut Elbasan nuk ishin kryer sipas ligjit, duke sjellë si pasojë vrasjen e personit në kushtet kur ai ishte nën ruajtjen e forcave të policisë, në zbatim të një vendimi të gjykatës..

Meqenëse organi i prokurorisë kishte filluar procedimin penal për këtë ngjarje dhe kishte nxjerrë urdhër ndalimi për dy punonjësit e policisë, për veprën penale të *“Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”* në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79/dh e 25 e K.Penal, referuar nenit 14 të Ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*, ju rekomandua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, fillimi i procedimit disiplinor për personat përgjegjës. Rekomandimi u pranua dhe për këtë ngjarje u ndëshkuan me masa disiplinore dhjetë punonjës policie.

- Rasti i regjistruar me nr. 2012000795 dok. Ky rast është regjistruar në bazë të ankesës së bërë nga një shtetase, e cila pretendonte se në datën 13.02.2012, i kishin shkuar në shtëpi disa punonjës të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë dhe kishin shoqëruar padrejtësisht dy djemtë e saj. Sipas ankueses, policia i ka shoqëruar djemtë e saj, sepse gjatë natës kishte ndodhur një vjedhje. Gjithashtu ajo pretendonte se, sa herë që ndodhnin vjedhje në lagjen ku ajo banonte, policia shoqëronte djemtë e saj dhe i pyeste si të dyshuar lidhur me to.

Nga verifikimet e bërë rezultoi se, shoqërimi i dy djemve të ankueses nga policia ishte bërë pasi ishin marrë disa informacione operative për aktivitetin e mundshëm të tyre kriminal në lidhje me disa vjedhje të ndodhura në lagjen Nr. 1 Shkozë. Sipas policisë, këta shtetas ishin persona me precedent kriminal dhe duke qenë të tillë, shoqërimi i tyre ishte bërë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe pa i cënuar të drejtat.

Megjithëse punonjësit e policisë theksonin, se shoqërimi i tyre ishte bërë konform akteve ligjore e nënligjore, në fakt nuk referonin asnjë dispozitë ligjore konkrete se ku e kishin bazuar këtë veprim.

Pas hetimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se, shoqërimi në ambientet Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë i dy shtetasve nga punonjësit e policisë ishte i kundërligjshëm, sepse ishte bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe të akteve nënligjore që kanë dalë në bazë e për zbatimin e tij dhe konkretisht me, nenet 11, pika 6 dhe 101, pika 1, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*; Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.711, datë 11.10.2007 *“Për zbatimin e kërkesave të ligjit “Për Policinë e Shtetit” lidhur me përdorimin e forcës dhe trajtimin e personave të shoqëruar”*; Letër-Porosinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1328, datë 23.11.2009 *“Për respektimin dhe garantimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të personave gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit”*.

Nga shqyrtimi i këtij rasti, por edhe i disa rasteve të tjera u konstatua fakti se, megjithëse ligji i ri “Për Policinë e Shtetit” ka mbi 5 vjet që ka hyrë në fuqi, ky ligj dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë e për zbatim të tij, lidhur me shoqërimin e shtetasve në organet e Policisë, nuk njihen e zbatohen nga punonjësit e policisë.

Mosnjohja e ligjit sjell pasoja të rënda për të drejtat kushtetuese e ligjore të shtetasve që çënohen nga veprimet arbitrare të punonjësve të policisë si dhe rrit mundësinë e përsëritjes së shkeljeve ligjore. Nga ana kjo gjë dëmton rëndë imazhin e besimin që publiku ka për organin e Policisë, si dhe marrëdhëniet e këtij organi me institucionet e tjera kushtetuese dhe gjykatat.

Për këtë rast ju rekomandua Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë dhe Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë:

1. Fillimi i ecurisë disiplinore dhe dhënia e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë bërë shoqërimin në ambientet e policisë të dy shtetasve.
2. Diskutimin si fenomen të këtij rasti me qëllim që shkelje të tilla ligjore të mospërsëriten në të ardhmen.
3. Marrjen e masave të nevojshme dhe të menjëhershme për njohjen dhe zbatimin nga drejtuesit dhe efektivat e Policisë të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, veçanërisht akteve të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, që trajtojnë problemin e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë.

Rekomandimi u pranua në të gjitha pikat e tij.

- Rastet e regjistruara me iniciativë nr. 201203770 dok. dhe 201203807 dok. Gjatë periudhës kohore Shtator-Tetor 2012 një grup personash, ish të dënuar politik të regjimit komunist organizuan një grevë urie në një ambient të improvizuar me çadra ndërmjet pallateve të banimit në hyrje të rrugës “Medar Shtylla” Tiranë.

Greva e tyre u bë publike nga media, e cila pasqyronte në mënyrë të vazhdueshme problematikat dhe shqetësimet e tyre. Ndër të tjera nga media u ngrit edhe shqetësimi i mungesës së shërbimit mjekësor në ambientet e grevës së urisë gjatë ditëve të para të fillimit të saj, por pas bërjes publike të këtij lajmi u morën masat e nevojshme nga institucionet shëndetësore, duke organizuar shërbim mjekësor me kohë të plotë (24 orë).

Grevistët e urisë kërkuan në mënyrë të vazhdueshme prezencën dhe ndihmën e Avokatit të Popullit për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Avokati i Popullit mendon se mjeti i duhur për të trajtuar dhe zgjidhur probleme që shqetësojnë qytetarët apo grupe të caktuara interesi, është dialogu social mes administratës publike dhe qytetarëve. Është pikërisht për shkak të këtij vizioni dhe në zbatim të misionit të tij kushtetues që Avokati i Popullit urdhëroi ngritjen e një grupi pune, i cili shkoi pranë grevistëve, dëgjoi dhe regjistroi të gjitha pretendimet dhe ankesat e tyre, si dhe monitoroi në mënyrë të vazhdueshme

mbarëvajtjen e grevës. Në zbatim të këtyre detyrimeve ligjore Avokati i Popullit vizitoi dhe takoi disa herë grevistët dhe koordinatorët e tyre në ambientet e grevës, në spital dhe në zyrë.

Ashtu si edhe për çështje të tjera të ndjeshme të shoqërisë shqiptare, Avokati i Popullit zhvilloi një konsultim të gjerë me të gjitha palët dhe grupet e interesit, në kuadër të gjetjes së zgjidhjeve ligjore e të pranueshme nga palët. Avokati i Popullit në mënyrë të vazhdueshme e të përsëritur nxiti palët, e veçanërisht Qeverinë për të bashkëbiseduar dhe gjetur zgjidhje afatshkurtra dhe afatgjata lidhur me pagesën e dëmshpërblimit për të përndjekurit.

U sugjerua ngritja e një grupi pune ndërrikasterial për evidentimin dhe trajtimin e kësaj problematike. U theksua gjithashtu se një qasje pa paragjykime dhe me gjakftohtësi në trajtimin e kërkesave të grevistëve, përveç se do të qetësonte këtë situatë, do të jepte edhe një shembull pozitiv të menaxhimit me një frymë civile të problematikave të tilla të mprehta.

Duhet vënë në dukje se atmosfera që shoqëroj grevën e urisë nuk ishte ajo e duhura për nxitjen e dialogut. Megjithatë, pavarësisht nga mendimet e qytetarëve, apo një grupi të caktuar qytetarësh, administrata publike nuk duhet për asnjë moment t'i shmanget këtij dialogu për çfarëdo lloj rrethane apo arsye.

Kësaj here organet e administratës publike munguan në 'takimin me qytetarët'.

Ankesat e grevistëve të urisë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit kishin të bënin me mungesën e dëmshpërblimit ligjor për këtë kategori si dhe shkeljen e të drejtave të tyre në kuadrin e grevës së urisë prej veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Për kërkesat me karakter ekonomik, në datën 15.10.2012 Avokati i Popullit i dërgoi një material shkresor Ministrin të Drejtësisë, Ministrin të Financave, Ministrin të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrin të Shëndetësisë, për dijeni Kryeministrit, në të cilin i bëhej një ekspozitë e plotë të gjithë problematikës që mbartin kërkesat e paraqitura nga ana e këtij grupi interesi, të kompleksitetit dhe mënyrave të zgjidhjes së tyre si dhe të detyrave që dilnin për institucionet shtetërore, pjesë e administratës publike.

Nga hetimi i pretendimeve të grevistëve për shkelje të të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit, gjatë zhvillimit të grevës së urisë si: futjen e policëve në çadrën e tyre, bërjen e kontrollit dhe nxjerrjen jashtë çadrës të disa sende të tyre, si bidona me çaj, glukozë, pako me sheqer, pako me trisol e pako me kafe, si dhe për ndërprerjen e takimeve me familjarët, me koordinatorët e grevës dhe me median, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se:

1. Aktet normative në fuqi nuk parashikojnë dhe rregullojnë me dispozita të veçanta të drejtën për dhe mënyrën e zhvillimit të grevës së urisë. Për këtë problem iu sugjerua Ministrisë së Drejtësisë që të shikojë mundësinë e përgatitjes së një projekti ligji dhe dërgimin e tij për miratim në Kuvend me qëllim plotësimin e këtij vakumi ligjor.

2. Veprimet e policisë të kryera me grevistët duke ushtruar kontroll dhe larguar sendet të cilat mund të përbënin rrezik për jetën dhe shëndetin e grevistëve, i konsideruam që në fillim si të drejta dhe të bazuara në ligj. Fakti që në këtë ambient u krijuan precedente të tilla, si dy raste vetëdiegie të grevistëve dhe një rast tjetër tentativë për vetëdiegie na tronditi pa masë të

gjithëve, por edhe na krijoi bindjen se vlerësimi ynë kishte qenë i drejtë, ashtu si kishte qenë i drejtë edhe rekomandimi ynë se prania e forcave të policisë në ambientet e grevës së urisë, në radhë të parë duhet të siguronte jetën dhe shëndetin e grevistëve nga do veprim që rrezikon jetën dhe shëndetin e tyre.

3. Largimin nga policia të lëngjeve dhe sendeve të tjera, si sheqer, trisol dhe kafe të gjetura në çadrën ku zhvillohet greva e konsiderojmë si një veprim të padrejtë dhe të pa bazuar në ligj, ndërsa moslejimin më pas nga ana e policisë të futjes së lëngjeve (çajit), sheqerit, trisolit dhe kafes në ambientet e grevës e konsideruam jo ligjore dhe jo humane .

4. Megjithëse grevistët kanë shpallur grevën e urisë, ata nuk kanë shpallur grevën e etjes. Vendimi i tyre për të protestuar në këtë mënyrë është personal dhe duhet respektuar nga çdo organ i administratës shtetërore. Duke mos lejuar futjen e lëngjeve dhe për rrjedhojë edhe përdorimin e tyre, të cilat janë një nga elementët bazë të jetës, atyre u rrezikohet seriozisht jeta. Duke vepruar në këtë mënyrë, nuk justifikohet qëllimi i policisë, për të cilin janë vendosur aty, sigurimi dhe garantimi i të drejtës së jetës së tyre nga rreziqet e brendshme, apo edhe të jashtme. Këtë veprim të kryer nga punonjësit e policisë ndaj grevistëve e konsideruam si shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut të garantuara nga kushtetuta, konventat ndërkombëtare dhe ligjet tona. Në nenin 21 Kushtetutës parashikohet se jeta e personit mbrohet me ligj. Pra Kushtetuta jonë është shprehur qartë për mbrojtjen e jetës me ligj dhe për garantimin e kësaj të drejte themelore dhe më të rëndësishme të njeriut kanë detyrim në radhë të parë organet e administratës publike dhe policia si pjesë e saj. Sipas nenit 1/2 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", *Misioni i Policisë është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut*". Ndërsa sipas nenit 4/1 të këtij ligji, *Policia e ka për detyrë (përgjegjësi) të mbrojë jetën e njerëzve,*". Me veprimet e kryera nga punonjësit e policisë nuk kontribuuan në garantimin e jetës dhe të shëndetit të grevistëve, por, e rrezikuan më tepër atë.

Policia pretendoi se ndalimi i futjes së lëngjeve dhe materialeve të tjera, prej të afërmve, ose personave të tjerë brenda ambienteve të grevës së urisë bëhej për shkak të dyshimit lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes dhe rrezikshmërinë që ato mund të kishin për jetën dhe shëndetin e grevistëve. Kjo mënyrë zgjidhje, në gjykimin e institucionit tonë, ishte e papërshtatshme dhe jo proporcionale, në raport me qëllimin që mendohej të arrihej. Një mënyrë zgjidhjeje, të cilën i'a sugjeruam policisë dhe që garantonte furnizimin e grevistëve me lëngje, pa rrezikuar gjithashtu garantimin e jetës së tyre, ishte blerja e tyre në markete/farmacitë në prani të punonjësve të policisë dhe të një mjeku, gjithmonë të pranishëm në ambientet e grevës së urisë.

5. Ndërprerjen e takimeve të grevistëve me koordinatoret e grevës dhe familjarët e tyre e vlerësuam si një masë jo korrekte. Në gjendjen shëndetësore dhe psikologjike që ata ishin, e kishin shumë të nevojshme mbajtjen e lidhjeve me koordinatoret e grevës dhe familjarët. Për këtë ju kërkua policisë heqja e ndalimit, pasi do të ndikonte në të mirë të shëndetit mendor të grevistëve.

6. Edhe ndërprejen e komunikimit të grevistëve me organet e medias, duke i larguar këto të fundit nga çadra, apo duke mos lejuar gazetarët të futen, apo të afrohen në çadrën e grevës, kur këta kërkoheshin nga grevistët, e konsideruam jo korrekte dhe jo ligjore. Ky veprim çënon të drejtën e shprehjes së grevistëve për të folur dhe për tu shprehur, garantuar nga neni 22/1 i Kushtetutës. Ndërkohë konstatuam gjithashtu se ky veprim i policisë çënon edhe lirinë e

shtypit, e radios dhe e televizionit të garantuar nga neni 22/2 i Kushtetutës.

7. Kërkesën e grevistëve për largimin e punonjësve të policisë nga ambientet e grevës nuk e vlerësuam të drejtë. Duke mbajtur në konsideratë precedentët e ndodhur në ambientet e grevës, dy rastet e vetëdiegies dhe një rast tentative për vetëdiegie të grevistëve, menduam që shërbimet e policisë duhet të ishin të pranishme në këtë ambient. Qëllimi i pranisë së tyre në këtë ambient, duhet të ishte sigurimi i jetës dhe i shëndetit të grevistëve nga rreziqet e brendshme e të jashtme dhe parandalimi e veprave kriminale ndaj jetës dhe shëndetit të tyre.

Pavarësisë mosekzistencës së dispozitave në të drejtën e brendshme lidhur me grevën e urisë dhe procedurave që ndiqen për mbarëvajtjen e saj, ekzistojnë një numër i madh aktesh dhe marrëveshesh ndërkombëtare të cilat përcaktojnë rregulla sjellje si për personat që zhvillojnë grevën e urisë, ashtu edhe për personat të cilët mbikqyrin dhe garantojnë zhvillimin e saj. Midis akteve më të rëndësishme ndërkombëtare lidhur me grevën e urisë mund të përmenden:

1. *“Deklarata për Grevën e Urisë (Deklarata e Maltës e vitit 1991 e rishikuar në vitin 1992)”*, miratuar nga Asambleja e 43-të Botërore e Mjekësisë mbajtur në Maltë, në Nëntor 1991, e rishikuar nga Asambleja e 44-të Botërore e Mjekësisë mbajtur në Marbella të Spanjës, në Shtator 1992 dhe nga Asambleja e 57-të Botërore e Mjekësisë, mbajtur në Pilanesberg të Afrikës së Jugut, në Tetor 2006”.

Sipas nenit 1 të kësaj deklaratë” grevat e urisë janë shpesh një formë e protestës nga njerëzit që nuk kanë mënyra të tjera për të bërë të njohura kërkesat e tyre.

Në pjesën udhëzime për menaxhimin e grevistëve të urisë parashikohet se: *“Mjekët duhet të vlerësojnë kapacitetin mendor të individëve. Kjo përfshin verifikimin e aftësisë mendore të individëve, me qëllim që individët e paaftë mendërisht të mos lejohen të bëjnë grevë urie.*

Mjekët duhet të bisedojnë me grevistët e urisë në privatësi dhe larg dëgjimit të gjithë njerëzve të tjerë dhe duhet të respektojnë konfidencialitetin. Ata duhet të bëjnë një ekzaminim të plotë të grevës së urisë që në fillim të saj dhe duhet t’u shpjegojnë pasojat dhe implikimet mjekësore që mund të vijnë prej saj.

Mjekët duhet të binden se refuzimi për ushqim, ose trajtim është zgjedhja vullnetare e individit. Grevistët e urisë duhet të mbrohen nga shtrëngimi. Mjekët shpesh mund të ndihmojnë për të arritur këtë dhe duhet të jenë të vetëdijshëm se shtrëngimi mund të vijë nga grupi i kolegëve, autoritetet, apo të tjerët. Mjekët, ose personeli tjetër i kujdesit shëndetësor, nuk mund të ushtrojnë presion të panevojshëm të çdo lloji të grevisti i urisë për të pezulluar grevën. Kujdesi, apo trajtimi i grevistit të urisë nuk duhet të kushtëzohet me pezullimin e grevës së urisë.

Të ushqyerit artificial mund të jetë i përshtatshëm nga ana etike nëse grevistët e urisë e pranojnë atë në mënyrë të ndërgjegjshme. Ajo gjithashtu mund të jetë e pranueshme nëse individët kanë lënë paraprakisht udhëzime për ta refuzuar atë.

Të ushqyerit me forcë nuk është etike dhe e pranueshme. Edhe në qoftë se ka për qëllim të përfitojnë, të ushqyerit e shoqëruar nga kërcënimet, detyrimi me forcë apo përdorimi i kufizimeve fizike është një formë e trajtimit çnjerëzor dhe degradues.

2. *“Deklarata e Tokio-s - Udhëzime për mjekët lidhur me torturën dhe trajtimin mizor, çnjerëzor ose degradues apo ndëshkimit në lidhje me ndalimin dhe burgosjen”, miratuar nga Asambleja e 29-të Botërore e Mjekësisë, mbajtur në Tokio të Japonisë, në Tetor 1975 dhe rishikuar nga sesioni i 170-të i Këshillit të Asamblesë Botërore të Mjekësisë, mbajtur në Divonne-Les-Bains, të Francës, në Maj 2005. Në pikën 6-të të saj theksohet se: Kur i burgosuri refuzon ushqyerjen dhe mjeku e konsideron të aftë për të gjykuar, në mënyrë të qartë dhe racionale lidhur me pasojat e këtij veprimi, ai/ajo nuk duhet ushqyer në mënyrë artificiale. Vendimi lidhur me aftësinë e të burgosurit për një vendim-marrje të tillë duhet të konfirmohet nga të paktën edhe nga një mjek tjetër. Mjeku duhet t'i shpjegojë të burgosurit pasojat e refuzimit të ushqimit.*

3. Rekomandimi Nr. R (96) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Në pikën 60-të të tij përshkruhet refuzimi i trajtimit mjekësor të grevistëve të urisë. Kjo pikë e Rekomandimit parashikon se: *“Në rastin e refuzimit të trajtimit, mjeku duhet t'i kërkojë deklaratë me shkrim pacientit, në praninë e një dëshmitari. Mjeku duhet t'i japë informacion të plotë pacientit lidhur me përfitimet e mundshme nga mjekimi, alternativat e mundshme terapeutike si dhe ta paralajmërojë për rreziqet që sjell refuzimi i trajtimit mjekësor. Në çdo rast, duhet që pacienti të kuptojë në mënyrë sa më të plotë situatën e tij. Nëse të kuptuarit pengohet nga faktorë të tillë si: gjuha që flet pacienti, duhet të kërkohet një përkthyes me përvojë”.*

Sa më sipër, rezulton e qartë se kushtet e grevës së urisë i vendosin vet grevistët, ndërsa menaxhimin e grevës e bëjnë vetëm mjekët dhe jo punonjësit e policisë, apo ndonjë autoritet tjetër shtetëror. Sipas akteve të përmendur, rezulton se grevistët e urisë vendosin vet edhe për ushqyerjen artificiale të tyre, por ndalohet ushqimi me forcë. Ndërkohë nga përmbajtja e tyre rezulton se grevistët e urisë nuk mund të pengohen për të përdorur lëngje të tilla që kanë si përbërës sheqerin si: çaj, serum (glukozë), kafe, apo ujë me trisol. Gjithashtu ndalohen veprimet kërcënuese, kufizimet fizike e veprime të tjera të kryera nga mjekët, apo ndonjë autoritet tjetër shtetëror me qëllim ndërprerjen, ose pezullimin e grevës së urisë.

Si raportuam edhe më lart, në rastin në shqyrtim policia mori përsipër “menaxhimin e grevës së urisë”. Ajo padrejtësisht u hoqi grevistëve çajin, glukozën, trisolin, sheqerin, kafën dhe ndonjë ilaç që ata kishin për përdorim si dhe pengoi rifutjen e tyre në ambientet e grevës.

Theksojmë se, ndonëse këto veprime të policisë u kryen në prezencën e mjekëve, këta të fundit dhe institucionet shëndetësore heshtën përballë këtij qëndrimi të kundërligjshëm. Sikurse u përshkrua më sipër, aktet ndërkombëtare dhe rajonale ngarkojnë mjekët me detyrën e menaxhimit të grevës së urisë dhe jo policinë.

Për të bërë të mundur rivendosjen e të drejtave dhe lirive të grevistëve të urisë dhe medias nga institucioni i Avokatit të Popullit u bënë tre rekomandime respektivisht:

1. Rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të cilit iu kërkua:

a) *“Marrjen e masave të nevojshme me cilësinë e organit epror për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërligjshme të kryera nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë ndaj grevistëve të urisë dhe konkretisht:*

b) Lejimin e futjes në ambientin e grevës së urisë të lëngjeve, sheqerit, kafes, trisolit etj të kërkuara nga grevistët dhe për rrjedhoj edhe të përdorimit të tyre.

c) Lejimin e grevistëve të urisë për t'u takuar me familjarët dhe e të afërmit e tyre.

ç) Lejimin e koordinatorëve të grevës që të takohen me grevistët.

d) Lejimin e grevistëve që të ushtrojnë të drejtën kushtetuese të shprehjes në shtyp, radio e televizion.

e) Lejimin e shtypit, radios dhe televizionit që të ushtrojnë të drejtën kushtetuese të informimit të publikut".

Është e rëndësishme të theksojmë se ky rekomandim u zbatua menjëherë nga strukturat dhe shërbimet e policisë që ishin të dislokuara me shërbim në ambientet e grevës.

2. Rekomandimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nëpërmjet të cilit u kërkua:

a) Të analizohet rasti i shkeljes të së drejtave të grevistëve të urisë nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të nxirren përgjegjësitë administrative.

b) Të njihen drejtuesit dhe punonjësit e Policisë së Shtetit me aktet ndërkombëtare e rajonale që trajtojnë grevën e urisë, të cilat i kemi përshkruar më sipër dhe të trajtohen lidhur me mënyrën e sjelljes së tyre në rastet e grevave të urisë".

3. Rekomandimi drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, nëpërmjet të cilit u kërkua:

a) Të analizohet rasti i moskryerjes së rregullt të detyrës nga mjekët e shërbimit të urgjencës për menaxhimin e grevës së urisë të organizuar nga disa ish të dënuar politik të regjimit komunist.

b) Të merren masat e nevojshme për njohjen e personelit mjekësor me aktet ndërkombëtare e rajonale që trajtojnë grevën e urisë, të cilat i kemi përshkruar më sipër dhe të trajtohen lidhur me mënyrën e menaxhimit të grevave të urisë".

Eshtë për tu përgëzuar pranimi i rekomadimeve të Avokatit të Popullit dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrit të Shëndetësisë për marrjen e masave të nevojshme për njohjen e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe personelit mjekësor me aktet ndërkombëtare e rajonale që trajtojnë dhe menaxhojnë grevën e urisë. Kështu, në fund të muajit shkurt 2013, do të mbahet një konferencë nga institucioni i Avokatit të Popullit me titull "Roli i personelit mjekësor, punonjësve të Policisë së Shtetit dhe IEVP-ve në monitorimin dhe menxhimin e grevave të urisë", me pjesëmarrjen e personelit mjekësor, punonjësve të Policisë së Shtetit dhe punonjësve të administratës të IEVP-ve. Në këtë konferencë do të jenë pjesëmarrës dhe ekspertë ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Përmirësimi i legjislacionit

Gjatë këtij viti është bashkëpunuar me strukturat e Policisë së Shtetit lidhur me sigurimin (integriteti fizik i të ndaluarit/arrestuarit) e të arrestuarve e të ndaluarve nga Policia e Shtetit, pasi sikurse është theksuar edhe më parë detyra e Policisë së Shtetit, për ruajtjen dhe sigurimin e të arrestuarve dhe të ndaluarve, derisa ndaj tyre të caktohet masa e sigurimit nga gjykata, nuk parashikohet në ligjin nr. 9749 datë 04.06.2007 “Për Policinë Shtetit”. Në asnjë dispozitë të këtij ligji, duke përfshirë edhe nenin 4, të tij ku janë parashikuar përgjegjësitë (detyrat) e Policisë së Shtetit, nuk përmendet përgjegjësia e këtij organi për të siguruar këtë kategori personash. Kjo problematikë ka qenë vijuese dhe e pa zgjidhur, pasi sjellim në vëmendjen tuaj se edhe në raportin e vitit 2011 kemi konstatuar se:

“Ky shërbim, sipas legjislacionit në fuqi, i është ngarkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe organeve të saj vartëse. Policia e Shtetit po kryen këtë detyrë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Madje hartimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i manualit për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, është refuzuar me argumente juridike nga ana jonë, pasi një akt i tillë nuk ishte i autorizuar nga ligji “Për Policinë e Shtetit”. Për të zgjidhur këtë problem ligjor, nga ana jonë është rekomanduar ndryshimi i nenit 4, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Nga eksperiencia e viteve të fundit gjatë ndjekjes së ankesave dhe kryerjes së inspektimeve kemi konstatuar se në organet e policisë shoqërohen në mënyrë të vazhdueshme një numër i konsiderueshëm personash për shkak të konflikteve të ndryshme me njëri-tjetrin si rrahje, fyerje, shqetësime etj. Ky veprim i organeve të policisë, duke shoqëruar këtë kategori personash në këto raste, përveç qëllimit të mirë që ka për parandalimin e ngjarjeve më të rënda që mund të vijnë, në fakt nuk ka mbështetje ligjore. Për legjitimitimin e këtij veprimi kemi sugjeruar ndryshimin e ligjit “Për Policinë e Shtetit” duke shtuar rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë të parashikuara në nenin 101 të tij”⁸.

Përsa më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit hartoi Programin e Punës, për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave në përmbushje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Në programin e punës përcaktoheshin masa dhe detyra konkrete që duhet të merreshin për realizimin e rekomandimeve të mësipërme. Për disa nga këto detyra u vendosën edhe afate. Grupi i punës i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij plani, bashkëpunoi me ekspertët e Avokatit të Popullit. Fillimisht grupi i punës u njoh me Raportin e Veçantë “Për nivelin e zbatimit të Rekomandimeve të Avokatit të Popullit” ku janë evidentuar problematikat e sipërshënuara: Në përfundim grupi i punës, në bashkëpunim me ekspertët e Avokatit të Popullit dhe aktorë të tjerë nga shoqëria civile, përgatitën draftin përfundimtar dhe e dërguan në Kuvend.

Konkluzione

Policia e Shtetit vazhdon të ketë problematika që lidhen me shkeljen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve si: cënimin e integritetit fizik, raste torture, keqtrajtimi fizik e psikologjik gjatë kryerjes së veprimeve policore e procedurale; privim të lirisë personale prej shoqërimit në

8 Raporti Vjetor 2011, fq. 57

organet e policisë pa shkaqe ligjore, ose mosregjistrimin e saktë të kohës së arrestimit, apo ndalimit të tyre;

Kemi evidentuar raste kur nga punonjësit e policisë nuk merren, administrohen dhe ndiqen konform ligjit kallëzimet penale, ankesat apo kërkesat e bëra nga shtetasit;

Infrastruktura e ambienteve të shoqërimit dhe sigurimit në pjesën më të madhe të organeve të policisë është jashtë standardeve ligjore dhe nuk ofron kushtet minimale të qëndrimit dhe jetesës së personave që mbahen në to;

Nuk janë zbatuar afatet për ndërtimin, ose rikostruksionin e ambienteve të shoqërimit ose sigurisë sipas përcaktimeve të bërë në Programin e Punës së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në zbatim të Rekomandimit 12 të BE-së;

Nuk ka përfunduar ende trajnimi i të gjithë punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë;

Nuk ka përfunduar ende procesi i vënies në funksionim të librave për administrimin e ankesave të personave të shoqëruar, arrestuar ose ndaluar;

Nuk ka përfunduar ende procesi i monitorimit me kamera të ambienteve të shoqërimit, sigurisë dhe hetimit;

Nuk janë afishuar në të gjitha komisariatet e policisë postera me të drejtat e personave të ndaluar e arrestuar;

Rekomandohet:

Trajnimi në vazhdimësi i punonjësve të policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Përveç kurseve të organizuar në Qendrën e Formimit Policor, të organizohen konferenca, seminare e takime me pjesëmarrjen e institucioneve dhe shoqërisë civile që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

Zgjerimi i bashkëpunimit të strukturave të Policisë së Shtetit me shoqërinë civile, me qëllim monitorimin e situatës së respektimit të të drejtave të njeriut në organet e policisë;

Kritja e buxhetit të Policisë së Shtetit me qëllim ndërtimin apo rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në të gjitha organet e policisë sipas programit të miratuar;

Vendosja e posterave me të drejtat e shtetasve në të gjitha ambientet e policisë, si në ato ku mbahen personat e shoqëruar, ndaluar, apo arrestuar, ashtu edhe në në zyrat e punonjësve të policisë, me qëllim informimin e personave të ndaluar lidhur me të drejtat e tyre si dhe për të shërbyer si kujtesë e vazhdueshmë për respektimin e ligjit;

Ushtrimi i kontrolleve të vazhdueshme nga organet eprore në strukturat vendore të policisë me objekt monitorimin e veprimtarisë së policisë për zbatimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura

Vështrim i përgjithshëm

Veprimtaria e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë rregullohet nga Kushtetuta në nenet 166-176 dhe në Ligjin nr. 9210, date 23.03.2004 "Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë". Verifikimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të ushtarakëve është realizuar nëpërmjet pranimit të ankesave në zyrën e Avokatit të Popullit si dhe me organizimin e vizitave në disa reparte ushtarake. Qëllimi i këtyre vizitave është për të parë në vend respektimin e të drejtave dhe lirive të ushtarakëve si dhe marrja kontakt me ushtarakët për t'i krijuar atyre lehtësi në paraqitjen e ankesave dhe kërkesave. Për vitin 2012 janë regjistruar 88 kërkesa dhe ankesa nga subjekte që janë efektive ushtarakë apo ish ushtarakë. 84 raste janë përfunduar dhe 4 raste janë ende në shqyrtim. Nga rastet e hetuara gjatë vitit 2012, rezultoi se 38 prej tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive, 7 kanë qenë jashtë kompetencës tonë dhe 39 kanë qenë të pabazuara në ligj. Objekti i ankesave të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë kryesisht:

- Për mos zbatim dhe zvarritje në dhënien e pensionit suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- Për kompesimin e qirasë së banesave.
- Për zvarritje të procedurave në trajtimin e kërkesave të shtetasve drejtuar Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut.
- Për mos respektim të të drejtave lidhur me kohën e punës dhe të pushimit.
- Për trajtimin me uniformë në kundërshtim me normat ligjore të miratuara.

Analizë e rasteve konkrete

Një numër jo i vogël ankesash adresuar institucionit të Avokatit të Popullit ka pasur si objekt rillogaritjen e gabuar të pensioneve. Është fakt se me vendime gjyqësore të formës së prerë, disa ushtarakë kanë fituar të drejtën për të marrë pensionin suplementar. Këta ushtarakë kanë depozituar ankesa në institucionin e Avokatit të Popullit duke pretenduar se nga ana e sigurimeve shoqërore po bëhet rillogaritja e pensionit, me efekte negative në kundërshtim me kërkesat e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë shkak Avokati i Popullit në Janar 2012 i rekomandoi Ministrin të Financave rregullimin ligjor me qëllim që neni 29 i Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura,..." të zbatohet sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Rekomandimi i Avokatit të Popullit ende nuk ka marrë një përgjigje e për rrjedhojë problemi mbetet ende pa një zgjidhje ligjore përfundimtare.

Një problem i cili mendojmë se prek një numër të madh ushtarakësh, është ai i sigurimit të banesës, kompesimit të qerasë së banesës dhe ushqimit si dhe e drejta e parablerjes për objektet,

së bashku me trojet funksionale, të cilat dalin të lira nga ristrukturimi i F.A (nenet 21, 38 dhe 39 të Ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004, "Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.) Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes ky problem mbetet të zgjidhet nëpërmjet:

a) Rritjes së fondit të dhënies së kredive për strehim nga buxheti i shtetit, i cili deri tani ka qenë i kufizuar. Për vitin 2012 kjo shumë ka qenë e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave të ushtarakëve, në krahasim me numrin e madh të kërkesave për strehim. Për këtë qëllim u sugjerua rritja e fondit të kredisë për strehim për ushtarakët e Forcave të Armatosura, si dhe gjetja e formave të tjera duke bashkëpunuar me organet lokale të pushtetit vendor për të bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të strehimit.

b) Strehimit të ushtarakëve në ambiente, të cilat dalin të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura.

c) Kompesimit të qerave të banesave dhe të ushqimit të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.07.2004, i cili në dijeninë tonë është në proces rishikimi.

Problem i trajtuar edhe më parë është shkelja e të drejtave lidhur me kohën e punës dhe pushimin. Ushtarakët janë ankuar se shpesh qëndrojnë me shërbim jashtë orarit normal të punës. Për këtë qëllim i kemi rekomanduar Shtabit të Përgjithshëm të F.A. të minimizohet qëndrimi jashtë orarit zyrtar. Në përgjigje të rekomandimit jemi informuar se nuk janë plotësuar nevojat e F.A me ushtarë profesionistë e për rrjedhojë ka pasur mbingarkesë me shërbim të personelit, ndonëse Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm, për të realizuar pushimet në ditët e shtuna ka bërë ndryshimin e programit stërvitor, duke kaluar nga katër cikle stërvitore në tre cikle stërvitore, me qëllim që të garantohet pushimi i ushtarakëve. Mbas çdo cikli stërvitor kryhen 15 ditë pushim.

Trajtimi me uniformë i ushtarakut është një nga të drejtat që i është njohur atij në Ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" si dhe në V.K.M. nr. 464, datë 02.07.2004. Në disa raste të marra në shqyrtim është konstatuar se nuk është respektuar e drejta e ushtarakëve për marrjen e normave të uniformës. Në përgjigje të rekomandimit tonë për këto raste, u informuam nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura se janë marrë masa për kompletimin e gjithë strukturave ushtarake me uniforma stërvitje dhe materiale të tjera.

Konkluzione

Ministria e Mbrojtjes është një nga institucionet e administratës publike ku kemi gjetur një partner të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale.

Krahasuar me vitin e mëparshëm vihet re përmirësimi i problematikave lidhur me shërbimin e kryer jashtë orarit normal të punës, ndërsa mbeten ende të pazgjidhura problematika të viteve të kaluara si: përmirësimi i kushteve të jetesës dhe të banimit, zvarritje në dhënien e pensionit suplementar, mos respektimi i të drejtave për marrjen e normave të uniformave të stërvitjes.

Një nga shqetësimet kryesore ka qenë dhe mbetet përmirësimi i kushteve të jetesës dhe të banimit të ushtarakëve. Avokati i Popullit ka rekomanduar rritjen e fondit të dhënies së kredive si dhe kalimi në fonde banese të objekteve që dalin të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura me qëllim strehimin e ushtarakëve.

Duhet të tentohet të zgjidhet në mënyrë përfundimtare problematika lidhur me përmirësimin e kushteve të jetesës dhe pajisjen e ushtarakëve me uniforma sipas ligjit. Rekomandimi Avokati i Popullit lidhur me këtë problematikë është pranuar nga Ministria e Mbrojtjes, por nga verifikimi në vend i këtij rekomandimi ka rezultuar se masat e marra nuk kanë qenë të plota.

E. Çështje të administrimit të drejtësisë

E drejta për një proces të rregullt ligjor

E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasit ndaj veprimeve të padrejta të organeve shtetërore nga njëra anë, dhe si detyrim i këtyre të fundit për të mos cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve pa respektimin e procedurave ligjore nga ana tjetër. Procesi i rregullt ligjor është një karakteristikë e pandashme e shtetit të së drejtës. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta për një proces të rregullt ligjor përmendet në mënyrë specifike në dy dispozita të saj. Neni 42, e rendit procesin e rregullt ligjor krahas të drejtave dhe lirive të shtetasve, ndërsa neni 131 shkronja " f ", e përcakton atë si një çështje juridiksioni për Gjykatën Kushtetuese. Në të dy dispozitat kushtetuese, ky parim i rëndësishëm shfaqet si një garanci kushtetuese për individët ndaj çdo privimi që mund t'u bëhen të drejtave të tyre themelore nga shteti, nëpërmjet organeve të tij vendimarrëse.

Procesi i rregullt ligjor nënkupton, jo vetëm ndalimin e veprimeve arbitrare që mund të kryejnë autoritetet shtetërore mbi lirinë, pronën dhe të drejtat e tjera kushtetuese e ligjore të individit, por edhe garantimin dhe zbatimin e procedurave të drejta dhe të ndershme gjatë procesit të hetimit, gjykimit si dhe ekzekutimit të plotë dhe brenda një afati ligjor të arsyeshëm të vendimeve përfundimtare të gjykatave.

Intitucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor

Vështim i Përgjithshëm

Në ankesat ndaj pushtetit gjyqësor, siç thuhet edhe në nenin 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" futen të gjitha rastet e ankesave, kërkesave ose njoftimeve, për rastet që shqyrtohen nga gjykatat e të gjitha shkallëve, për shkelje të të drejtave të njeriut që rrjedhin nga puna e administratës gjyqësore, vendimet e formës së prerë, dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Ankesat që i janë drejtuar Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 në lidhje me gjyqësorin konsistojnë në shkelje të kryera nga administrata gjyqësore dhe kanë lidhje me zvarritjen e padrejtë të gjykimeve, si dhe me procedurat gjyqësore. Ankesat e ardhura sipas rastit janë hetuar dhe janë

bërë ndërhyrjet e nevojshme duke synuar në nxjerrjen e shkaqeve të këtyre shkeljeve duke bërë edhe rekomandimet e duhura për ndreqjen, ose mos përsëritjen e këtyre shkeljeve në të ardhmen.

Gjatë vitit 2012 numri i ankesave që lidhen me pushtetin gjyqësor kanë ardhur në rritje, duke arritur një total prej 685 ankesash nga të cilat për 570 ka përfunduar procedura e shqyrtimit të tyre dhe për 115 rastet të tjera vazhdon shqyrtimi.

Nga analiza e bërë rezulton se ndaj vendimeve gjyqësore kanë qënë 250 raste, për shkeljen e të drejtave të gjyqësorit janë 39 raste, për zvarritje në procedurat gjyqësore në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore kanë qënë 40 raste, për zvarritje në procedurat gjyqësore ndaj Gjykatave të Apelit janë 21 raste, dhe për zvarritje procedure gjyqësore nga Gjykata e Lartë janë 29 raste, 179 raste janë për mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore dhe 2 raste për zvarritje nga administrata gjyqësore.

Nga 570 raste ankesash të shqyrtuara gjatë këtij viti rezulton se në 143 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesve, në 250 raste ankesat kanë qënë ndaj vendimeve gjyqësore, në 68 raste kanë qënë jashtë kompetencave të institucionit, në 97 raste ankesat kanë qënë të pa bazuara në ligj, në 12 raste ankesat janë pushuar, pasi ankuesit kanë hequr dorë nga ankesa.

Vendin kryesor të ankesave të ardhura edhe gjatë këtij viti e zenë ato që kanë lidhje me zvarritjet e padrejta të gjykimeve dhe shkeljen e procedurave gjyqësore. Pas verifikimit të ankesave, kur shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore janë konstatuar si të padrejta janë bërë rekomandime për shpejtimin e këtyre gjykimeve si dhe marrjen e masave për mospërsëritjen e këtyre problematikave..

Ankesa kanë ardhur gjatë këtij viti në lidhje me shkeljet e kryera nga organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, duke pretenduar se personat kanë mbaruar vuajtjen e dënimit dhe nga organet e prokurorisë nuk janë dërguar urdhrat e ekzekutimit ku të përcaktohet afati përfundimtar i vuajtjes së dënimit .

Një grup tjetër ankesash kanë pasur objekt pretendimet se gjyqtarë të veçantë janë përfshirë në veprime korruptive, apo kanë pasur njëanshmëri në gjykimet e çështjeve. Gjithashtu janë paraqitur ankesa ndaj noterëve dhe avokatëve privat duke pretenduar shkelje ligjore në veprimtarinë e tyre. Në të gjitha rastet ankesat i janë dërguar për kompetence shqyrtimi Ministrisë së Drejtësisë ose KLD-së për verifikim dhe marrjen e masave disiplinore ndaj tyre ose Dhomës Kombëtare të Avokatisë, apo Dhomës Kombëtare të Noterëve sipas rastit.

Gjatë këtij viti janë depozituar ankesa edhe ndaj Institutit të Mjekësisë Ligjore, i cili nuk pranon kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor me grup ekspertësh për zgjidhjen e problemeve të ndryshme gjyqësore. Nga ana jonë mbi bazën e ankesës dhe të dokumentacionit të paraqitur është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor me grup ekspertësh dhe instituti ka vendosur kryerjen e veprimit të kërkuar në bazë të kërkesave të ligjit.

Gjatë këtij viti ka pasur pak ankesa, të cilat kishin për objekt kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatave dhe ndërhyrjen e institucionit për prishje, ose anulimin e tyre. Këto raste nuk janë shqyrtuar prej institucionit, por janë sqaruar menjëherë ankuesit se institucioni

i Avokatit të Popullit nuk mund të shqyrtojë ankime kundër vendimeve të gjykatave dhe se e vetmja rrugë ligjore për kundërshtimin e një vendimi gjyqsor është t'i drejtohesh një gjykate më të lartë, brenda afatit ligjor dhe duke zbatuar procedurën e caktuar.

Një grup tjetër fare i vogël ankesash kanë pasur për objekt transferimin e personave të dënuar, shtetas shqiptarë, nga burgjet e shteteve të treta, për në Shqipëri. Edhe këta ankues janë sqaruar menjëherë në lidhje me procedurat ligjore që duhen ndjekur për transferimin e tyre, ose personave të autorizuar prej tyre nga shteti ku ata janë dënuar, në Republikën e Shqipërisë, për të vuajtur dënimet me burgim të dhëna nga gjykatat e huaja.

Problematika e mësipërme prezantohet me disa raste konkrete si vijon :

- Rasti nr. dec. 201200053, shtetasi I.S. ankohet ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zvarritje gjykimi dhe shkeljen e procedurave gjyqësore gjatë gjykimit të një çështje civile kundra D.R.S.SH Tiranë me objekt shfuqizimin e aktit administrativ nr.47/20, datë 30.04.2009 për llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se për gjykimin e kësaj çështje ishin zhvilluar 8 seanca gjyqësore dhe duke analizuar shkaqet e shtyrjes së tyre dhe faktin se ankuesit i është ndërprerë pensioni i pleqërisë mbi 3 vjet, moshën e tij (77 vjeç) dhe se ai me ato të ardhura jetonte dhe nuk kishte burim tjetër jetese, iu dërgua një Rekomandim për shpejtimin e këtij gjykimi. Trupi gjykues pasi analizoi rekomandimin e dërguar nga ana jonë mori masat e nevojshme dhe përfundoi çështjen brenda një afati të arsyeshëm..

- Rasti nr. dec. 201201522, ku ankuesi A.P. nga Shkodra ankohet ndaj një vendimi gjyqësor penal datë 12.03.2012 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku janë gjykuar e dënuar në mungesë 53 persona për veprën penale të kultivimit të lëndës narkotike të kryer në bashkëpunim në bazë të nenit 283/2, të K.Penal, ku ata janë dënuar secili me 5 vjet burgim. Ankuesi na sqaron se ndaj këtij vendimi gjyqësor, të gjykuarit kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, dhe pretendohet prej tij se gjatë gjykimit në shkallë të parë nga Gjykata janë lejuar shkelje të rënda në procedurat gjyqësore, dhe dënimi i tyre u duket i padrejtë. Nga ana jonë pasi u bënë verifikimet e nevojshme u bë monitorimi i këtij gjykimi në Gjykatën e Apelit Shkodër, në bazë të procedurave gjyqësore, u kërkua zbatimi korrekti i procedurave të gjykimit të kësaj çështje penale, për respektimin e të drejtave ligjore në gjykim dhe në përfundim Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin e saj datë 20.12.2012 vendosi prishjen e vendimit gjyqësor datë 12.03.2012 të Gjykateës së Shkallës Parë dhe pushimin e gjykimit. Gjykimi i kësaj çështje evidentoi edhe nevojën për një përmirësim në legjislacionit penal. Sipas legjislacionit penal të B.E. përqidja minimale e THC- së të canabis sativa për aplikimin e dënimit penal në rast konstatimi duhet të jetë në masën 0.2%,ose 0.3% ndërsa dispozitat ligjore tek ne këtë përqindje e parashikojnë me 01.%. Avokati i Popullit është duke studiuar mundësitë për të bërë rregullimet e nevojshme legjislative në mënyrë që legjislacioni penal, edhe lidhur me këtë problematikë, t'i përafrohet standardit të BE.

- Rasti nr. dec. 201202306, shtetasi L.A. nga Tirana ankohet ndaj Komunës Vaqarr në Rrethin e Tiranë, e cila ka vendosur prishjen e një objekti fetar, (xhami) të ndërtuar pa leje në token e tij në fshatin Vaqarr. Nga verifikimet e kryera rezultoi se toka e pretenduar nga ankuesi nuk ishte marrë në pronësi private sipas procedurave ligjore, dhe

kërkesave të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën" dhe se toka nuk ndodhej e regjistruar në Z.V.R.P.P. Tiranë, në bazë të rregullave të vendosura nga legjislacioni në fuqi. Po kështu rezultoi se ankuesi nuk dispononte leje për ndërtimin e këtij objekti dhe nga ana tjetër ndaj aktit administrativ të Komunës Vaqarr me datën 14.05.2012 kishte depozituar një kërkesë-padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kishte caktuar seance gjyqësore me datë 19.06.2012, ora 10.00. Në këto kushte dhe në bazë të kërkesave të nenit 14, të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Populli", nga ana jonë u ndërprejnë veprimet e mëtejshme meqenëse e njëjta çështje po shqyrtohej në të njëjtën kohë edhe nga Gjykata.

- Rasti nr.dec.201200068 ku shtetasi S.H. ankohet ndaj vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili pretendon se është marrë në shkelje të procedurave ligjore dhe kërkohet ndërhyrja e këtij institucioni në Gjykatën e Apelit Durrës, për shpejtimin e gjykimit. Në këtë drejtim ankuesi pretendon se masa e dënimit të dhënë nga shkalla e parë është vuajtur prej tij, pasi ndaj tij Gjykata ka dhënë si masë sigurimi arrest në shtëpi dhe dënimi prej 1 vit e 6 muaj burgim është plotësuar plotësisht. Nga verifikimi i kryer rezultoi se ankesa e tij ishte e drejtë dhe nga ana jonë iu rekomandua Gjykatës Apelit Durrës, shpejtimi i procedurave gjyqësore të gjykimit dhe në përfundim kjo Gjykatë mori në konsiderat pretendimet e ankuesit dhe rekomandimin e dërguar nga institucioni ynë dhe në përfundim vendosi prishjen e vendimit gjyqësor dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues në gjykatën e Shkallës së Parë Durrës.

- Rasti nr. dec. 201203608, shtetasi S.G. ankohet ndaj Gjykatës Apelit Shkodër, për zvarritje gjykimi dhe shkeljen e procedurave gjyqësore, në gjykimin e një çështje penale, ku ndaj vendimit gjyqësor është ankuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës. Gjykata e Apelit Shkodër, na njofton se kjo çështje ndodhet në radhë për gjykim dhe shkaku i vonesës së gjykimit qëndron në faktin se në Gjykatën e Apelit Shkodër, janë larguar 2 gjyqtarë prej dy vjetësh dhe ata nuk janë zëvendësuar me gjyqtarë të tjerë. Nga ana jonë iu dërgua Rekomandim Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së duke bërë prezent shqetësimin dhe situatën për ngarkesën e madhe të punës të kësaj gjykate, me qëllim që të merren masa për zëvendësimin e tyre..

- Rasti nr. dec. 201200141, me inisiativë është filluar një çështje në lidhje me përmirësim dhe plotësim legjislacioni për rastet kur Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg gjen shkelje të KEDNJ, apo protokolleve të saj të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Në Kodin e Procedurës Civile, u bënë ndryshimet përkatëse në nenin 494, të tij duke shtuar një dispozitë tjetër të rasteve për rishikim vendimi nga Gjykata e Lartë. Në një Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për këtë problem është kërkuar që edhe në nenin 450, të Kodit Procedurës Penale, të shtohet një dispozitë tjetër që individi të ketë të drejtë të kërkojë rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, në rastet kur çështja e tij është shqyrtuar dhe pranuar nga Gjykata e Strasburgut. Ky rekomandim u vlerësua i drejtë dhe u pranua nga Ministria e Drejtësisë duke hapur rrugën për ndryshimet e nevojshme në Kodin e Procedurës Penale.

- Rasti nr. dec. 201202767, shtetësja Xh.M. ankohet ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zvarritje gjykimi dhe shkeljen e procedurave gjyqësore në gjykimin e një çështje penale, që zhvillohet ndaj saj për veprën penale të falsifikimit të dokumentave

zyrtare të parashikuar nga neni 186/1, të K.Penal. Në bazë të kërkesave të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", nga ana jonë u kërkuar respektimi i procedurave gjyqësore.

- Rasti nr. dec. 201202519, shtetasi Sh.A. ankohet ndaj Kryetarit të Komunës Luz i Vogël në Kavajë, i cili në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe pa leje të organeve kompetente ndërton shkallë të reja tek ndërtesa e Komunës dhe nga ky ndërtesim pa leje çënohet në pronësi ankuesi Sh.A., i cili në katin e parë të ndërtesës së Komunës ka një lokal privat që ndodhet poshtë zyrave të Komunës. Ndaj këtyre veprimeve të paligjshme të kryera nga Kryetari i Komunës Luz i Vogël, ankuesi ka ngritur një kërkesë padi civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke kërkuar pushimin e cënimit në pronësi dhe prishjen e shkallëve të ndërtuar pa leje. Ndërkohë Gjykata me një vendim të ndërmjetëm të datës 21.06.2012, ka vendosur pezullimin e punimeve të mëtejshme nga Komuna Luzi i Vogël. Për shkeljet e konstatuara në rastin konkret nga Kryetari i Komunës Luz i Vogël, nga ana jonë iu dërgua Rekomandim Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të ushtruar kontroll mbi veprimtarinë ligjore të përdorimit të fondeve publike nga Kryetari i kësaj Komune.

- Rasti nr. dec. 201201797, shtetësja E.P. ankohet ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje gjykimi dhe shkeljen e procedurave gjyqësore në gjykimin e një çështje civile, rezultoi se ndaj vendimit nr. 2348, datë 14.12.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ankuesja E.P. ka paraqitur rekurs duke kërkuar prishjen e tij si vendim i pabazuar në ligj. Nga verifikimi i bërë rezultoi se dosja në fjalë ndodhej e regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë me nr. 00426/11 akti, datë 23. 02.2011 dhe kërkohej nga institucioni ynë ndihma për shpejtim gjykimi, duke paraqitur si shkaqe ligjore moshën e saj mbi 70 vjeç, problemet shëndetësore jo të mira e shkaqe të tjera. Nga ana jonë duke analizuar shkaqet dhe rrethanat e paraqitura nga ankuesja iu bë një Rekomandim Gjykatës së Lartë me objekt "shpejtim gjykimi", i cili u vlerësua, dhe u vendos shqyrtimi i çështjes brenda një afati të shkurtër ku në përfundim u vendos "mos pranim i rekursit të paraqitur".

Konkluzione

Vazhdojnë të konstatohen raste të shkeljes së procedurave të gjyimit të çështjeve prej gjykatave të të dyja shkallëve.

Nuk është konkretizuar ende puna lidhur me zbatimin e rekomandimit që Avokati i Popullit i drejtoi Ministrisë së Drejtësisë (rekomandim i pranuar) për ndryshimin e dispozitave të nenit 450 të K.Pr.Penale, duke parashikuar si shkak për rishikimin e një vendimi të formës së prerë vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që konstaton shkelje të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve të saj.

Nga ankesat e ardhura rezultoi se në Kodin e Procedurës Penale, ka vend për t'u studiuar dhe hartuar një shtesë në lidhje me të drejtën, që të parashikohet e drejta e familjarëve ose e trashgimtarëve ligjor të viktimave për të zgjidhedhur, ose vendosur një avokat mbrojtës privat, për të mbrojtur të drejtat, liritë, dhe interesat e ligjshme të viktimave nga kryerja e krimit gjatë gjykimeve penale në Gjykatë. Në bazë të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, këto të drejta i mbron organi i prokurorisë. Prania dhe pjesëmarrja e një avokati mbrojtës privat

të vendosur nga familja e viktimave dhe verifikimi i pretendimeve të tij nga gjykata, do vendosë një raport më të drejtë midis palëve në gjykimin penal dhe do luftohen edhe rastet e fenomenit të korrupsionit që vërehen në praktikë dhe pretendohen nga familjarët e viktimave.

Nuk është konkretizuar ende puna lidhur me zbatimin e rekomandimit që Avokati i Popullit i drejtoi Ministrisë së Drejtësisë (rekomandim i pranuar) për zbatimin e kërkesave të nenit 46 dhe 52 të K.Penal duke hapur shkollat të edukimit për të miturit nën 14 që kanë kryer krime dhe për të cilët ligji nuk parashikon marrjen e tyre në përgjegjësi penale.

Veprimtaria e Prokurorisë

Vështrim i përgjithshëm

Prokuroria, funksionon pranë sistemit gjyqësor dhe si organ i centralizuar, ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Objekti i veprimtarisë së saj lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në procesin penal.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë ushtrimit të detyrës në trajtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë, ka treguar kujdes në ruajtjen e pavarësisë duke respektuar me rigozitet dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

Gjatë vitit 2012, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në shqyrtim 308 ankesa drejtuar organit të Prokurorisë, nga të cilat janë përfunduar 287 ankesa dhe mbeten për shqyrtim 21 ankesa. Nga ankesat e përfunduara, 21 ankesa kanë qënë të pabazuara, 161 ankesa jashtë kompetence, 30 ankesa jashtë juridiksionit, 74 ankesa të zgjidhura në favor dhe 1 ankesë me heqje dorë të ankuesit.

Problematikat e rasteve të trajtuara gjatë kësaj periudhe konsiston në:

Së pari: Moszbatimin e procesit të rregullt ligjor, për shkak të veprimeve të padrejta të kryera nga Prokuroria e që kanë çenuar të drejtat e shtetasve në procesin penal dhe për të respektuar procedurat ligjore.

Ankesat e shtetasve në këtë drejtim kanë konsistuar në: Zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale, sidomos për rastet kur çështja është kthyer nga gjykata; në rastet e zëvendësimit të prokurorëve, ose oficerëve të policisë gjyqësore më e theksuar kjo, për hetimet e procedimeve penale të kryera nga policia gjyqësore e Policisë së Shtetit; në vonesa për kthimin e përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet e drejtësisë të shteteve të huaja; në mosrespektimin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale që bën fjalë për regjistrimin e njoftimit të veprave penale, kur edhe pse njihet personi që i atribuohet vepra penale, nuk regjistrohet emri i tij; në arrestimin dhe ngritjen e akuzës të padrejtë; në marrjen e vendimit të padrejtë për mosfillim të procedimeve penale, apo pushime të çështjeve penale për arsye të mosverifikimit të kallëzimit, apo moskryerjes së hetimeve të gjithanshme, sidomos për veprat penale të "Falsifikimit të dokumentave" për pronësinë, "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor"; për mosnjohje të palëve në procesin penal me vendimet për zgjatjet e afatit të hetimit të procedimit penal etj.

Së dyti: Mosrespektimin e detyrimit të informimit, i cili është parë si një nga të drejtat themelore vetiake të individit. Në këto raste, organi i Prokurorisë nuk i ka njoftuar shtetasit për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e kallëzimit penal të bërë prej tyre; nuk ju ka kthyer përgjigje, ose ka kthyer atë me vonesë për “kërkesa apo memorie me shkrim” të paraqitura nga palët gjatë hetimit (jashtë afatit prej 15 ditë, që parashikon pika 2 e nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale); nuk iu ka dhënë kopje të akteve të kërkuara, sidomos për ekspertimet e ndryshme si, autoteknike, mjeko-ligjore, tekniko-grafike të nënshkrimit etj, duke shkelur kërkesat e parashikuara në nenin 105 të Kodit të Procedurës Penale.

Së treti: Moskryerjen e veprimeve të nevojshme prej prokurorëve që merren me ekzekutimin e vendimeve penale, me pasojë qëndrimin e të dënuarit në paraburgim ose burgim, më tepër se koha e vuajtjes së dënimit të përcaktuar në vendimin e gjykatës. Në disa ankesa, shtetas të ndryshëm të dënuar, janë ankuar ndaj Prokurorive për nxjerrje me vonesë të Urdhërit për ekzekutimin e vendimeve penale që kanë marrë formë të prerë. I tillë është rasti me nr.201200254, i filluar me iniciativë nga Avokati i Popullit për ish të dënuarit M.S. dhe E.J, të cilët vuanin dënimin në I.E.V.P Korçë. Për këtë arsye, i kemi Rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm “Vlerësimin, nxjerrjen dhe marrjen e masave të menjëhershme, për ekzekutimin e urdhërave të ekzekutimit pas vendimit penal të formës së prerë të marrë nga gjykata, sidomos për personat e dënuar me masë sigurimi “Arrest në burg”. Rekomandimi është pranuar dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka larguar prokurorin O.E, nga sektori i ekzekutimit të vendimeve penale.

Në disa raste, shtetasit janë ankuar për mbajtje padrejtësisht në mjediset e spitalit të burgut të personave të afërm të familjeve të tyre, në një kohë që duhej të transferoheshin në një Institucion Psikiatrik të specializuar, jashtë sistemit të burgjeve. Raste të kësaj natyre janë ato me nr.201100104, dhe nr.201102285. Kështu shtetasi U.S nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së rrethit, për mbajtjen padrejtësisht në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, të djalit të tij A.S prej muajit Mars të vitit 2009, edhe pse gjykata kishte vendosur caktimin e masës mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”. Mbi këtë shqetësim i është Rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm “Marrja e masave për ndryshimin e urdhërit të ekzekutimit të marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të vendimit nr.435 datë 25.03.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim kalimin e shtetasit A.S. nga mjediset e Qendrës Spitalore të Burgjeve Tiranë, në një Institucion Psikiatrik, jashtë sistemit të burgjeve”. Për këtë rekomandim nuk është kthyer përgjigje nga Prokuroria, edhe pse gjendja shëndetësore e të sëmurit është duke u rënduar.

Në ankesën e tij shtetasi H.B. nga Kavaja, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për mbajtje padrejtësisht në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, për të cilin gjykata kishte vendosur masë sigurimi “Shtrim i përkohshëm në spitalin psikiatrik”. Hetimi administrativ i kryer nga Avokati i Popullit, arriti në përfundimin se prokurori i çështjes D.N, nuk kishte nxjerrë Urdhërin e ekzekutimit në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.173 datë 26.07.2011. Prokuroria ka përsëritur ankimin në Gjykatën e Apelit, edhe pse kërkesa nuk është pranuar, duke theksuar faktin se “Objekti i aij gjykimi përbën gjë të gjykuar”. Vetëm më datën 24.01.2012 nga Prokurori është urdhëruar lirimi i shtetasit P.B. nga Qendra Spitalore e Burgjeve Tiranë, pas qëndrimit të paligjshëm të tij, prej 7 muajsh në atë institucion. Mbi këtë shqetësim, i kemi Reko-

manduar Prokurorit të Përgjithshëm "Fillimin e hetimit ndaj prokurorit D.N, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës". Rekomandimi ynë nuk u mor **në konsideratë, duke i konsideruar si të ligjshme veprimet e kryera nga prokurori. Veprime**, apo mosveprime të organit të Prokurorisë për këto raste vijnë në kundërshtim me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut datë 10 Dhjetor 1948, si dhe përbëjnë shkelje të nenit 46 Pika 2 të Kodit të procedurës Penale, neneve 15 dhe 28 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë si dhe nenit 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në rekomandimet tona drejtuar Prokurorisë, kemi insistuar për faktin se GJED-NJ, personat me çrregullime të shëndetit mendor i shikon si persona të paaftë dhe të cënueshëm, e për rrjedhojë atyre duhet t'u sigurohet një trajtim i duhur mjekësor, përshtatshmëri e ndihmës dhe përkujdesit mjekësor, në një Institucion Psikiatrik të specializuar, jashtë sistemit të burgjeve. Mendojmë se roli i Prokurorit të Sektorit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale duhet të jetë më aktiv, ç'ka do të thotë që ai duhet të zbatojë me korrektësi dispozitat ligjore, dhe jo vetëm të presë vendimet që kanë marrë formë të prerë nga gjykata, por t'i ndjekë ato në vazhdimësi dhe të marrë masat për tërheqjen e tyre menjëherë në gjykatë.

Së katërti: Mosrespektimin e dispozitave procedurale që bëjnë fjalë për "Disponimin e provës materiale", parashikuar nga neni 190 i Kodit të Procedurës Penale. Në këto raste shtetasit i janë drejtuar organit të Prokurorisë, lidhur me trajtimin e sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë hetimit, të cilat në disa raste u janë kthyer me vonesë personave të interesuar, ose i është lënë gjykatës për të marrë vendim për disponimin e tyre. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit M.B. nga Delvina, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për moskthimin e pompës 30 kg, i sekuestruar si send provë materiale dhe i vjedhur nga shtetasit F.M etj. Organi i Prokurorisë nuk i ka kthyer sendin shtetasit M.B. që në fazën e hetimit, edhe pse nuk dëmtohej zgjidhja e çështjes, (në një kohë që shtetasit i nevojitej për punën), kërkesë kjo e parashikuar në nenin 190 pika 2 e K.Pr.Penale.

Së pesti: Veprime të dhunshme të punonjësve të policisë ndaj shtetasve ose të dënuarve, me pasoja në shëndetin e të dëmtuarve.

Gjatë këtij viti Avokati i Popullit ka filluar me inisiativë, hetimin e 8 rasteve kur punonjësit e policisë së shtetit apo të burgjeve, kanë kryer veprime të dhunshme ndaj shtetasve, ose të dënuarve me pasoja në shëndetin e tyre, për veprën penale "Tortura" ndërsa në 9 raste të tjera për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare". Prokuroria, pas marrjes në shqyrtim të Rekomandimeve i ka pranuar ato në 11 raste, në 4 raste janë refuzuar dhe 2 rekomandime janë pa përgjigje. pas Rekomandimit për fillimin e hetimit për veprën penale të "Torturës", Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë ndryshuar kualifikimin e veprës në "Shpërdorim detyrë" apo "Kryerje të veprimeve arbitrare", dhe në përfundim është vendosur pushimi i çështjes penale, ose pezullimi i hetimit.

Së gjashti: Mungesë bashkëpunimi në përpilimin dhe plotësimin e kallëzimeve penale. Në ankesën me nr.201201906 shtetësja E.T nga Berati, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila nuk kishte pranuar kallëzimin e saj, pasi kishte të meta në mënyrën e formulimit. Nga ana e jonë, ankuesja E.T. është njohur me të drejtën e bërjes së kallëzimit sipas nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale, duke i cituar jo vetëm përmbajtjen e dispozitës ligjore, por dhe është sqaruar lidhur me formën e kërkuar nga ligji, për kallëzimin penal që shtetasit i drejtohen Prokurorisë.

Në ankesën me nr.201203087 shtetësja D.K. nga Rubiku, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për vendim mosfillimi të padrejtë të procedimit penal, për “fyerje” të bërë nga shtetasi A.F. Ankuesja është sqaruar jo vetëm për të drejtën e ankimit në gjykatë sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale, por dhe është njohur në mënyrë të hollësishme me përmbajtjen e dispozitave procedurale, që bën fjalë “I dëmtuari akuzues” dhe mënyrën e përpilimit të kërkesës që duhej të paraqiste në gjykatë.

Në ankesën me nr.201200349 shtetasi GJ.M. nga Mirdita, ka kërkuar caktimin e avokatit mbrojtës, por pas shqyrtimit të rastit ai është informuar për pozitën e tij procedurale në procesin penal, si deklarues për rrethana të dobishme për hetimin dhe jo në cilësinë e të “Dëmtuarit akuzues”. Ankuesi u sqarua për faktin se mbrojtja e tij në seancë gjyqësore realizohet nga organi i akuzës.

Një tjetër grup ankesash lidhen me moskthim të përgjigjeve ose kthim me vonesë për letrat (ankesat) drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme. I tillë është rasti i ankesës me nr.201201818, e shtetasit E.S nga Tirana, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, për moskthimin e përgjigjes së ankesës së datës 05.02.2012, për pushim të padrejtë të çështjes penale për vrasjen e vajzës së tij H.S. Pas komunikimit të Ndihmës Komisionerit të Avokatit të Popullit me prokurorin që kishte në shqyrtim ankesën, është bërë i mundur takimi i tij me ankuesin E.S, dhe marrja e pretendimeve këtij të fundit.

Në ankesën me nr.201202284 shtetasi H.SH nga Laçi, ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme për moskthim të përgjigjeve të ankesave lidhur me zvarritjen e hetimit të procedimit penal nr.305 të vitit 2006, që bënin fjalë për vrasjen e djalit të tij B.SH, hetimet e të cili ishin pezulluar në vitin 2007.

Ndërsa në rastin e ankesës me nr.20120535 të shtetasit XH.P. nga Tirana, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, kjo e fundit jo vetëm që i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë pas shqetësimit të ankuesit, por e ka analizuar atë dhe i ka Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr.4831 të vitit 2010, për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, me pasojë vdekjen e vajzës së tij S.P”.

Analizë e rasteve konkrete

Në ankesat e shqyrtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit për vitin 2012, përkatësisht me nr.201201130, nr.201203724, nr.201201045, nr.201202174, nr.201200504, nr.201202628 etj, shtetasit janë ankuar për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale. I tillë është rasti i ankesës së shtetasës P. M. nga Vlora, për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr.85 filluar në datën 08.01.2011, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”. Edhe pse kishte kaluar mbi një vit, hetimet e atij procedimi penal nuk ishin përfunduar. Për rrjedhojë i Rekomanduam Prokurorisë, marrjen e masave për përshtypimin e kryerjes së veprimeve hetimore dhe përfundimin e hetimit, por nga ajo Prokurori nuk është kthyer përgjigje.

Në ankesën me nr.201200504 shtetasi S.D. nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr.3661 të vitit 2011, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” në ngarkim të tij. Pas këtij konstatimi shtetasi, ka kundërshtuar

në gjykatë si të padrejtë vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit marrë nga Prokuroria, i cili është pranuar. Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës ka konstatuar se prokurori ka vepruar në kundërshtim me nenet 323 dhe 324 të K.Pr.Penale, për zgjatjen e afatit të hetimit, pasi në vendim nuk është argumentuar kompleksiteti, apo pamundësia objektive për të hetuar çështjen penale tej afateve të përcaktuara. Në vendimin e saj gjykata gjithashtu, ka vënë theksin në respektimin me përpikmëri dhe rigorozitet të të drejtave të personit në procesin penal, të njohura nga Kushtetua e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNJ, pavarësisht cilësisë së tij si i pandehur.

Në ankesën me nr.201203724 shtetësja L.Y. nga Patosi i Fierit, ankohej ndaj asaj Prokurorie për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.91 filluar në datën 31.01.2012, për veprën penale të "Shkaktimit të vetvrasjes" e mbetur në tentativë. Vetëm pas gjashtë muajve, organi i Prokurorisë ka konkluduar duke vendosur në datën 26.07.2012, pushimin e hetimeve, të cilin duke e konsideruar si të padrejtë, kallëzuesja e ka kundërshtuar në gjykatë.

Në ankesën me nr.201201045 shtetasi F.S. nga Lezha, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi e cila kishte zvarritur në mënyrë të padrejtë hetimin e procedimit penal nr.91/1 datë 15.04.2011, për veprën penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese, ndaj të miturit", në ngarkim të punonjësve të policisë, për vrasjen e djalit të tij A.S. Për kë rast, është komunikuar me drejtuesit e Prokurorisë, me qëllim përshpjektimin e kryerjes se veprimeve hetimore dhe përfundimin e hetimit.

Në ankesën me nr.201202174, shtetësja L.XH. nga Vlora, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal 930 të vitit 2011, për veprën penale "Falsifikim të dokumentave" dhe "Shpërdorim detyre", ndaj shtetasit E.B, ish regjistruar në Z.V.Rr.P.P.Vlorë.

Në ankesën me nr.201202628 shtetasi B.P. nga Elbasani, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr.245 të vitit 2011, për veprat penale të "Vjedhjes", "Shkatërrimit të pronës" dhe "Shpërdorim të tokës".

Në ankesën me nr.20120220, shtetësja A.M. nga Elbasani, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për akuzë të padrejtë për veprën penale të "Ushtrimit të prostitucionit" të vajzës së saj të mitur S.M. Rasti është ndjekur duke informuar drejtuesin e Prokurorisë, dhe pasi janë kryer hetime objektive, në përfundim është vendosur pushimi i akuzës ndaj të miturës.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të shtetasve për këtë periudhë, është konstatuar se hetimet e procedimeve penale për të cilat nuk njihej autori, zgjatën në mënyrë të pajustificuar dhe pa u kryer hetime të gjithanshme, duke përfunduar në pezullimin e hetimit. Po ashtu, nuk bëhen analiza të përbashkëta të Prokurorisë me Policinë Kriminale, për ecurinë e veprimeve të mëtejshme nga kjo e fundit, me qëllim zbulimin e autorëve të veprave penale dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore. Të tilla janë rastet e ankesave me nr.201201443 e shtetasit S.I nga Tirana, për vjedhje të mallrave në dyqan, në vlera të konsiderueshme; ankesa me nr.201201454 e shtetasit N.L. nga Lezha, për vjedhje me dhunë të një sasive të hollash prej 800.000 lek etj.

Në disa raste të ankesave është konstatuar se organi i Prokurorisë ka vendosur në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar, mosfillimin apo pushimin e procedimit penal, sidomos për veprën penale "Falsifikimi i dokumentave" për pronësinë, "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor"

me pasojë vdekje të personit. Kemi konstatuar se jo në pak raste verifikimi i kallëzimeve penale të shtetasve bëhet formal ose tej afateve të pëcaktuara në urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm

Në ankesën me nr.201200852, i është Rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm "Shfuqizimi i vendimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.197 datë 10.09.2010 për veprën penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" me pasojë vdekjen e shtetasit të mitur E.N.Z, hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë". Rekomandimi është marrë në shqyrtim dhe është pranuar duke filluar hetimin e procedimit penal.

Në ankesën me nr.201201423, i është Rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm "Shfuqizimi i vendimit të pezullimit të hetimit të procedimit penal nr.1811 e vitit 2008 për veprën penale "Falsifikimi i dokumentave", hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë". Rekomandimi është marrë në shqyrtim dhe është pranuar nga Prokuroria.

Në ankesën me nr.201201641, më datën 13.02.2012 i është Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan "Shfuqizimi i vendimit të pushimit të akuzës datë 08.07.2011, në ngarkim të pandehurit K.SH, për veprën penale "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur", marrja e masave për zvarritje të pajustificuara dhe përfundimin e shpejtë të hetimit të procedimit penal nr.1433 të vitit 2010". Rekomandimi pasi është marrë në shqyrtim është pranuar dhe nga Prokuroria janë kryer veprime të tjera hetimore si: ekspertimi i ADN-së të pandehurit, etj.

Në ankesat e shqyrtuara me nr.20120188, nr.201201384, nr.201203668, nr.201202615, nr.201203268, etj, është konstatuar mosinformim i pales së interesuar për ecurinë e trajtimit dhe mënyrës së zgjidhjes të kallëzimit penal, që ata i drejtojnë organit të Prokurorisë.

Në ankesën me nr.201202615 shtetasi R.B. nga Gjirokastra, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për arsye se nuk e ka vënë në dijeni lidhur me kallëzimin penal të datës 17.06.2011, për veprën penale "Ekspertimi i rremë", për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Në ankesën me nr.201202668 i është Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë "Analiza e rastit të ankesës së shtetasit E.P. nga Tirana, për mosvënien në dispozicion të akteve të procedimit penal dhe njoftim me vonesë, të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.365 të vitit 2011, marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë". Ankuesit jo vetëm që nuk i janë dhënë aktet e kërkuara, por dhe njoftimi për vendimin e mosfillimit të procedimit penal është bërë pas 10 muajve, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 291pika 2 të K.Pr.Penale ku thuhet se: "Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim, ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit". Megjithë kërkesën tonë të përsëritur, Prokuroria nuk i ka kthyer përgjigje Rekomandimit.

Në ankesën me nr.201203268, shtetasi A.H nga Vlora ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi, e cila nuk e kishte njoftuar lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal të datës 29.09.2011, për veprën penale "Shkatërrim prone". Nga verifikimi i kryer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezultoi se Prokuroria kishte orientuar policinë gjyqësore të Policisë së Shtetit për verifikimin e kallëzimit, por meqenëse nuk ishte realizuar ky veprim e ka kaluar përsëri tek Prokuroria, pa u njoftuar ankuesi.

Në ankesën me nr.201203688, shtetasi R.R. nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj nuk i ka kthyer përgjigje disa “kërkesave, apo memorieve me shkrim” të bëra prej tij, gjatë fazës e hetimit paraprak të procedimit penal nr.2740 të vitit 2010, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”. Pas kundërshtimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, gjykata ka pranuar kërkesën e ankuesit dhe i ka kthyer aktet Prokurorisë për fillimin e hetimit të procedimit penal. Në përfundim të hetimeve, organi i Prokurorisë përsëri ka vendosur pushimin e çështjes penale, ndaj të cilës ankuesi do të bënte ankim në gjykatë.

Në ankesa të tjera, shtetasit i janë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, për mosdhënie nga organi i Prokurorisë të akteve të ndryshme si, kopje të vendimit të pushimit të çështjes penale, të aktit të ekspertimit tekniko-grafik të nënshkrimit etj. E tillë është ankesa me nr.201200325 e shtetasit A.D. nga Elbasani, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për mosdhënie të akteve të procedimit penal nr.1987 të vitit 2010 si, vendimin e pushimit të çështjes, aktin e ekspertimit mjeko- ligjor nr.503 datë 17.11.2011 dhe procesverbalin e ekzaminimit të kufomës së vajzës së tij V.V. Pas takimit të Ndhmës Komisionerit me ankuesin dhe Prokurorin e çështjes, shtetasi A.D ka marrë fotokopje të akteve të kërkuara.

Në ankesën me nr.201200523 shtetasi XH.M nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për moskryerje të ekspertimit daktiloskopik të gjurmëve, krahasimit të tyre me persona të dyshuar dhe mosdhënie të aktit të ekspertimit. Pas pezullimit të hetimit dhe dërgimit të akteve të procedimit penal në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, nga ana jonë janë administruar aktet e kërkuara dhe mandej i janë vënë në dispozicion ankuesit .

Në ankesën me nr.201203056, të shtetasve Q.H, S.B dhe A.L. i është Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Fillimi i hetimit për veprën penale të “Torturës”, në ngarkim të 9 punonjësve të Komisarariatit të Policisë Shkodër E.T, H.GJ, A.R etj. Nga hetimi i këtij rasti u konstatua se të tre ankuesit ishin trajtuar në mënyrë çnjerëzore nga punonjësit e policisë. Dy prej tyre kishin shënja të dukshme dhune, të cilat jo vetëm që janë fiksuar në procesverbalin e kqyrjes së jashtme të personave dhe fotografi, por edhe në konkluzionet e aktit të ekspertimit mjeko- ligjor të datës 08.01.2012. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, informoi se kishte filluar ndjekjen penale ndaj punonjësve të policies, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”.

Me iniciativën e Avokatit të Popullit, është hetuar rasti i ankesës me nr.201203911, e shtetasit J.J. nga Barbadosa e Karaibeve, akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave, apo vizave”. Gjatë kontrollit personal të tij, nga policia gjyqësore e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare dhe Migracionit në Durrës, nuk është administruar me procesverbal sipas rregullave, çanta e madhe e shpinës me tesha e sende të tjera vetiake, por është lënë në një nga zyrrat e asaj drejtorie. Nga kryerja e hetimit administrativ të pavarur rezultoi se në atë zyrë në mënyrë të paligjshme, mbaheshin çanta e valixhe me tesha, të shtetasve të tjerë të huaj, praktikë e cila ndiqej prej vitesh në atë drejtori. U morën masat duke dërguar sendet vetiake të të paraburgosurve në I EVP Durrës, si dhe duke vënë në dijeni drejtuesit e Prokurorisë. Krahas kësaj, u bë Rekomandimi Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me qëllim “*Marrjen e masave në zbatim të dispozitave procedurale për ruajtjen, administrimin dhe pasqyrimin në dokumente të sendeve vetiake të ndaluarve apo arrestuarve, sidomos për shtetasit e huaj*”.

Për vitin 2012, shtetas të ndryshëm kanë paraqitur me shqetësim ankesat e tyre ndaj organit të Prokurorisë, për moskryerje të hetimeve objektive për veprat penale të "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor" dhe "Mjekim të pakujdesshëm", me pasoja vdekjen e pjestarëve të familjeve të tyre, apo dëmtim të shëndetit. Këto ankesa janë vlerësuar nga Avokati i Popullit si një shqetësim qytetar dhe për pasojat tejet të rënda që ato sjellin.

Të tilla janë rastet e ankesave me nr.2012.3190, nr.201202039, nr.201203704, nr.201203269 etj. Në ankesën e tij shtetasi N.M, nga Shkodra, ankohej ndaj Prokurorisë, pasi në mënyrë të padrejtë ka lënë të lirë me masë sigurimi "Arrest në shtëpi", autorin e veprës penale drejtuesin e mjetit A.D, edhe pse pasoja ka qënë me vdekje.

Shtetasi M.K. nga Fieri, në ankesën e tij me nr.201202039 ankohej ndaj Prokurorisë, e cila në mënyrë të padrejtë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për dëmtimin e shkaktuar djalit të tij S.K nga vepra penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor". Pas kundërshtimit në gjykatë të vendimit të marrë nga Prokuroria, kjo e fundit në përfundim të hetimeve ka vendosur pushimin e hetimeve, pasi sipas aktit të ekspertimit mjeko ligjor, dëmtimi i shkaktuar ishte i lehtë.

Në ankesat me nr.201203641, nr.201203405, nr.201200685, nr.201202254, nr.201202741 etj, shtetasit janë ankuar ndaj Prokurorisë për vepra penale që rrezikojnë jetën apo shëndetin, në fushën e mjekësisë, i tillë është rasti i ankesës së shtetases S.H. nga Tirana, i cili ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit, për mjekim të pakujdesshëm me pasojë vdekjen e vëllait të tij K.H. Pas kryerjes së hetimit adminsitrativ, u arrit në përfundim se kërkesa e tij ishte e drejtë dhe për këtë i kemi Rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm "Fillimin e hetimit për veprën penale të "Mjekimit të pakujdesshëm" ndaj mjekes J.K". Rekomandimi është pranuar dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar hetimin e procedimit penal duke kryer hetimet e nevojshme.

Shtetësja M.H. nga Kuçova, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për zvarrijte të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr.239 të vitit 2012 për veprën penale "Mjekim i pakujdesshëm" me pasojë vdekjen e djalit të saj A.H. Nga ana e jonë, janë kryer verifikimet e nevojshme dhe jemi informuar se pas ardhjes me vonesë të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nga I.M.L Tiranë, janë duke u zhvilluar hetime për mjekët, të cilët janë marrë me mjekimin dhe trajtimin e shtetasit A.H, në urgjencën e Spitalit Rajonal Berat.

Për rastet e ankesave të mësipërme kemi konstatuar se nga Prokuroritë në rrethe, kryhen ekspertime autoteknike me konkluzione të nxituara dhe aspak objektive. Familjarët e viktimave, apo të dëmtuarit nga këto vepra penale, nuk njihen me ecurinë e hetimeve, me vendimet përkatëse për kryerjen e ekspertimit apo konkluzionet e akteve të ekspertimit. Në raste të tjera, nuk merren në konsideratë kërkesat, apo pretendimet e tyre për kryerje të ekspertimeve me grup ekspertësh, pasi ekspertimi i mëparshëm nuk ka qënë korrekt, për hetime të njëanshme duke favorizuar autorët e veprave penale si, drejtuesin e mjetit, apo mjekun dhe personelin tjetër mjekësor.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të shtetasve, janë ndeshur raste kur nga organ i Prokurorisë është vendosur fillimi i hetimit të procedimit penal, kryesisht për "Falsifikim të dokumenteve" që lidhen me pronësinë, edhe pse vepra penale për të cilën është filluar hetimi është parashkuar. I tillë është rasti i ankesës me nr.201203725 e shtetasit N.R. nga Fieri.

Nga ana tjetër, shtetasit kanë paraqitur ankesa ndaj Prokurorisë për mosfillim të procedimit penal, pasi është parashkruar vepra penale. Të tilla janë ankesat me nr.201203725 dhe ankesa dhe nr. 20120111. Ankuesit janë sqaruar me përmbajtjen e nenit 66 të Kodit Penal, i cili bën fjalë për "Parashkrimin e ndjekjes penale", duke i adresuar ata për ngritjen e padisë civile në gjykatë. Ka patur dhe raste të fillimit të hetimit të procedimit penal nga organ i Prokurorisë, me dokumente fotokopje dhe jo origjinale, siç është rasti i ankesës me nr.201201236 e shtetasit P.B. nga Gjirokastra.

Konkluzione

Marrëdhëniet me organin e Prokurorisë kanë qënë përgjithësisht korrekte, bashkëpunuese, ku përmendim për kompetencën dhe trajtimin profesional të kërkesave dërguar nga Avokati i Popullit, Drejtorinë e Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme.

Megjithatë, ndërsa konstatohet mirëkuptim në kthimin e përgjigjeve të kërkesave të Avokatit të Popullit për shpjegime, apo informacione të rastit, nga ana e organit të Prokurorisë në rrethe nuk kthehen përgjigje për disa nga Rekomandimet e paraqitura dhe veçanërisht për ato që lidhen me mënyrën e përfundimit të hetimit të procedimit penal, filluar mbi bazën e Rekomandimit të Avokatit të Popullit.

Veprimtaria e Zyrave të Shërbimit Përmbartimor Shtetëror

Vështrim i përgjithshëm

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996, (K.Pr.C.) i ndryshuar, dhe ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, (Kodi Civil) i ndryshuar, parashikojnë veprimet procedurale, dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjeve prej Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror dhe atij Privat. Rregullat e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor parashikohen në Ligjin nr. 8730, datë 18.01.2011, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor" dhe nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat". Organet e administratës publike në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv kanë detyrimin për bashkëpunim me Shërbimin e Përmbartimor Gjyqësor sikurse parashikohet në nenin 523, të K.Pr.C. si dhe në aktet nënligjore. Sjellja në vëmendje e problematikave që hasen sot gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv, rritja e përgjegjshmërisë së organeve që kanë për mision ekzekutimin e këtyre titujve, respektimi i parimeve mbi të cilat mbështetet puna e Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor në procesin e ekzekutimit, ushtrimi i përgjegjësive prej organit përfaqësues të Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor, respektimi i parimit të ligjshmërisë sikurse është parashikuar në nenin 9, të K.Pr.Administrative prej institucioneve dhe organeve debitorë, apo palëve të treta në procesin e ekzekutimit, kanë qënë dhe janë në fokus të punës të Avokatit të Popullit me qëllim mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Referuar parashikimit të nenit 2, të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, misioni për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv i është ngarkuar Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor, i cili funksionet e veta i kryen nëpërmjet përmbartuesve gjyqësor. Parimi i ligjshmërisë, objektivitetit si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj i subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, si parime bazë të punës së Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor, në një numër jo të

vogël rastesh, nuk respektohen me rigorozitet prej këtij Shërbimi, si dhe debitorit apo personave të tretë, të cilët sipas urdhrit të ekzekutimit, apo ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Veprimtaria e përmbaruesve gjyqësor në pjesën më të madhe të rasteve të shqyrtuara e në shqyrtim prej institucionit të Avokatit të Popullit nuk karakterizohet nga profesionalizmi dhe paanësia. Mbajtja e një qëndrimi të tillë prej organit që ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv si dhe personit të ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutiv, nuk vjen në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për rrjedhojë çënimimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati, të arsyeshëm, është hasur dhe haset shpesh.

Numri ankesave me objekt mosekzekutimin e vendimeve përfundimtare të gjykatave të depozituara gjatë vitit 2012 ka arritur një total prej 199 ankesash. Subjektet ankues, në 88 raste kanë pretenduar shkeljen e kësaj të drejte nga organet e Administratës Publike, për 13 raste nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Privat dhe për 98 rastet të tjera nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror. Shqetësuese është kjo situatë veçanërisht kur organet e administratës shtetërore/publike pa asnjë shkak ligjor refuzojnë përmbushjen e detyrimeve të vendosura me vendime gjyqësore të formës së prerë, të dhëna gjatë vitit 2012, por dhe në vitet e mëparshme. Me organe të administratës shtetërore/publike kuptojmë : Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe organeve të tjera si: Avokaturën e Shtetit, Prefekturën e Qarkut Durrës, Këshillin i Qarkut Gjirokastrë, Bashkinë Tiranë, Pogradec, Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, AKKP-në, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, Fier, Mirditë, Korçë, Pogradec, ALUIZN-in Vlorë, Lezhë, Këshillin e Qarkut Kukës, INUV, Qarku Dibër, INUK Tiranë, Shërbimin Kombëtar i Punësimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Drejtorinë e Shëndetit Publik Pukë, Universitetin Bujqësor Kamëz, Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Gardën e Republikës, Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Inspektoriatin Qëndror Teknik, Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtorinë e Policisë, Qarku Kukës, Degën e Tatimeve Tiranë, Drejtorinë e Spitalit Ushtarak, Tiranë, Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Fier, Drejtorinë e Spitalit Gjirokastrë, Policinë Bashkiake Vlorë, Agjensinë e Sigurimeve Shoqërore Mat, Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, Rektoratin e Universitetit të Sporteve Tiranë, Universitetin Politeknik Tiranë, ZQRRPP, Zyrën Arsimore Pogradec, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Tiranë.

Në lidhje me ankesat si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të Shërbimit Shtetëror të Përmbarimit rezulton se numri më i madh i ankesave të trajtuara gjatë vitit 2012 është ndaj Zyrës së Përmbarimit Tiranë, gjithsej 30 ankesa. Po kështu, rezulton se 13 ankesa janë kryer ndaj Zyrës së Përmbarimit Fier, 7 ndaj Zyrës së Përmbarimit Vlorë, 7 ndaj Zyrës Përmbarimit Durrës, 8 ndaj Zyrës së Përmbarimit Shkodër, 5 ndaj Zyrës së Përmbarimit Elbasan, 4 ndaj Zyrës së Përmbarimit Gjirokastrë, 4 ndaj Zyrës së Përmbarimit Krujë, 3 ndaj Zyrës së Përmbarimit Lezhë, 3 ndaj Zyrës së Përmbarimit Pogradec, 2 ndaj Zyrës së Përmbarimit Berat, 3 ndaj Zyrës së Përmbarimit Kurbin, 2 ndaj Zyrës së Përmbarimit Kavajë, 2 ndaj Zyrës së Përmbarimit Tropojë, 1 ndaj Zyrës së Përmbarimit Pukë, 1 ndaj Zyrës së Përmbarimit Mirditë, 1 ndaj Zyrës së Përmbarimit Mat, 1 ndaj Zyrës së Përmbarimit Dibër, 1 ndaj Zyrës së Përmbarimit Lushnje.

Në numrin e përgjithshëm të ankesave vendin kryesor e zënë ankesat ndaj institucioneve buxhetore për mos përmbushjen e detyrimit për pagimin e pagës, rikthimin e ankuesit në detyrë, apo detyrimin e një organi të kryej veprime të caktuara, sikurse është vendosur nga Komisioni i Shërbimit Civil, apo Gjykata

Në kundërshtim me detyrimin e vendosur nga gjykata apo Komisioni i Shërbimit Civil, titullarët e institucioneve buxhetore, nuk kanë realizuar pagesën e menjëhershme të detyrimit monetar. Përfaqësuesit e organeve debitore, në pak raste, deklarojnë se kanë filluar shlyerjen e detyrimit në të holla, duke dorëzuar në favor të palës gjyqituese shuma modeste nga 5000 deri 10.000 lekë në muaj. Kjo "zgjdhje" e dhënë prej tyre, në kushtet kur është sa 1/10 apo 1/15 e detyrimit mujor të vendosur përbën mospërmbushje të vendimit të gjykatave dhe i shkakton dëme të mëtejshme interesave të personave, të cilëve gjykatat u kanë njohur të drejtën.

Në situatën e krijuar për shkak të mosdorëzimit të borxhit prej institucioneve qendrore dhe vendore, ndaj subjekteve gjyqituese, ka qenë dhe është e nevojshme rritja e përgjegjshmërisë së administratës publike lidhur me përmbushjen, ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në mënyrë efektiv e të arrirë, brenda një afati të arsyeshëm. Këtij qëllimi i ka shërbyer dhe inicimi prej institucionit të Avokatit të Popullit i nxjerrjes nga Këshilli i Ministrave të një akti nënligjor, konform nenit 589 të K.Pr.C., , për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Këshilli i Ministrave nxori Udhëzimin nr. 2, datë 18.08.2011, "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit*", botuar në Fletoren Zyrtare nr.133, datë 28.09.2011, akt i cili në përmbajtje ka përcaktime të cilat vijnë në kundërshtim me dispozitat ligjore të K.Pr.C. për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv si dhe krijojnë premisa për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm. Për të bërë të mundur përmirësimin e kësaj situatë ligjore i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën nr. K3/S8-6 Prot, datë 26.03.2012, Ministrisë së Financave, për dijani Këshillit të Ministrave, me shkresën nr. K3/S8-9 Prot, datë 28.08.2012, ndryshimi i Udhëzimit nr. 2, datë 18.08.2011, "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit*". Ende edhe sot nuk ka asnjë reagim zyrtar lidhur me rekomandimin

Duhet pranuar fakti se shumat që shteti ka vënë në dispozicion të ekzekutimit të titujve ekzekutive janë në nivele tepër të ulta ndërsa është rritur numri i çështjeve në ngarkim të institucioneve buxhetore duke rritur në këtë mënyrë dhe faturën financiare që duhet paguar prej shtetit. Kjo situatë bën të nevojshme ringritjen e grupeve të punës për evidentimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të paekzekutuar, me palë debitore Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe marrjen e masave për ekzekutimin sa më parë të këtyre vendimeve, sikurse ka ndodhur me nxjerrjen e Urdhërit nr. 98, datë 14.07.2003, prej Kryeministrit. Në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet rekomandimeve tona jemi përpjekur e do të përpiqemi të tërheqim vëmendjen e Qeverisë dhe administratës shtetërore, me qëllim dhënien e një zgjidhje të drejtë dhe të përhershme problemit të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore. .

Për sa i përket numrit të rekomandimeve lidhur me shkelje të konstatuara, institucion i Avokatit të Popullit ka paraqitur gjatë këtij viti 46 rekomandime prej të cilave për 24 raste nuk i është kthyer përgjigje lidhur me rekomandimin. Edhe në ato raste kur është kthyer përgjigje për rekomandimin, nuk rezulton të jetë ekzekutuar vendimi përfundimtar i gjykatave dhe rivedosur në vend e drejta e fituar.

Analizë e rasteve konkrete

Ndër rastet më tipike të cilat pasqyrojnë problematikën e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vlen të përmendim, :

Rastin me nr.doculive 201202483. Në procesin e shqyrtimit të këtij rasti është rekomanduar me shkresën nr. K2/S65-2 Prot, datë 18.06.2012, Ministrit të Drejtësisë : *“Marrja e masave ligjore për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas titullit ekzekutiv, Vendimit nr.2022, datë 11.04.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhënë në favor të shtetasit S.M.”.*

Edhe pse është kërkuar me shkresën K2/S65-4 Prot, datë 28.09.2012, ende deri më sot nuk është bërë e mundur kthimi i përgjigjes prej Ministrit të Drejtësisë.

Rastin me nr.doculive 201200094. Në procesin e shqyrtimit të këtij rasti është rekomanduar me shkresën nr. K2/D2-8 Prot, datë 28.02.2012, Sekretarit të Përgjithshëm, të Këshillit të Ministrave : *“Marrja e masave ligjore për zbatimin e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 3354, datë 04.05.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhënë në favor të shtetases D.T.”.*

Deri më sot nuk është bërë e mundur përmbushja e detyrimit të vendosur sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë në fjalë dhënë në favor të gjyqfitueses D.T.

Rastin me nr.doculive 201201648. Rekomanduar me shkresën nr. K2/A54-7 prot, datë 02.10.2012, Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, marrja e masave për dorëzimin e detyrimit në të holla, sikurse vendosur me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë nr. 5394, datë 09.07.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në favor të gjyqfituesit A.Xh. Edhe pse detyrimi është vendosur qysh në vitin 2007, jepet shembull jo pozitiv prej organit më të lartë legjislativ për përmbushjen e detyrimeve të rrjedhura sipas ligjit.

Rastin me nr.doculive 201201055, nr.201201159, nr.201201827, nr.201201828, nr. 201201829, nr. 192602012dhe nr.201202429. Në këto raste i është rekomanduar palës debitore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, marrja e masave për përmbushjen e detyrimeve të vendosura sipas titujve ekzekutiv, të cilat konsistojnë në detyrimin për rikthimin e gjyfituesit në vendin e mëparshëm të punës, pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë, apo detyrim për nxjerrje akti. Në kthimin e përgjigjeve, pala debitore, justifikon në mënyrë të paligjshme detyrimet e vendosura, duke mos bërë të mundur deri më sot përmbushjen tërësisht të detyrimeve të vendosura për secilin rast.

Rastin me nr.doculive 201201884. Në procesin e shqyrtimit të këtij rasti është rekomanduar me shkresën nr. K2/R17-2 Prot, datë 18.11.201, Drejtorit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, marrja e masave për shqyrtimin e kërkesës së gjyqfituesit R.I. për shqyrtimin e kërkesës në lidhje me njohjen e së drejtës të pronësisë si edhe kthimin dhe/ose kompesimin e pronës së pretenduar prej 170 dynym, sikundër vendosur me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë nr. 4544, datë 03.06.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr.2421, datë 20.12.2010. Pa asnjë shkak të ligjshëm nuk është bërë e mundur prej AKKP përmbushja e detyrimit të vendosur, qëndrim i cili ka shkelur dhe shkel parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Rastin me nr.doculive 201200033 dhe nr. 201200166. Rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit, respektivisht me shkresën nr. K2/M1-5 Prot, datë 16.04.2012, : Marrja e masave për rikthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm të punës si dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë, konform vendimit gjyqësor nr. 195, datë 18.01.2008, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhënë në favor të ankesit M.C., si dhe me shkresën nr. K3/G3-5 Prot,

datë 10.04.2012, marrjen e masave për nxjerrjen e aktit administrativ në zbatim të Vendimit nr.21, datë 24.01.2009, të KSHC, dhënë në favor të ankesit G.K. Në të rastet pa asnjë shkak Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit, nuk përmbush detyrimet e vendosura, duke shkelur në këtë mënyrë parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Rastin me nr.doculive 201200490. Rekomandur me shkresën nr. K2/N6-8 Prot, datë 21.03.2012, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si dhe Gardës së Republikës marrja e masave për rivendosjen në vend të së drejtës së ankuesit N.K., sikurse përcaktuar në dispozitivin e Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 554, datë 11.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë. Pa asnjë shkak të ligjshëm nuk është përmbushur dhe nuk përmbushet detyrimi i vendosur për rivendosjen e ankuesit në posedim të pasurisë së tij të paluajtshme. Gjithashtu për këtë rats është rekomanduar Zyrës së Përmbarimit, Vlorë, përmbaruesit gjyqësor të çështjes, kryerja e veprimeve përmbare për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor për mundësimin e vënies në posedim të pasurirës së paluajtshme nga ana e gjyqfituesit N.K. Zyra e Përmbarimit, Vlorë, nuk ka bërë të mundur ushtrimin e funksioneve të veta sikurse parashikuar në K.Pr.C. për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 554, datë 11.03.2010, qëndrim i cili ka detyruar ankuesin t'i drejtohet Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Rastin me nr.doculive 201200967. Në procesin e shqyrtimit të këtij rasti është rekomanduar palës debitore, Prefektura e Qarkut, Durrës, me shkresën nr. K3/G6-8 Prot, datë 10.05.2012, përmbushja e detyrimit sikurse vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Krujë, me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë nr. 368, datë 13.07.2005, për rikthimin e gjyqfituesit G.M. në detyrën e mëparshme si dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit të tij pa papunë. Pa asnjë shkak pala debitore, Prefektura e Qarkut, Durrës, nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimet e vendosura, duke shkelur në këtë mënyrë parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Konkluzione

Vazhdon të mbetet problematikë e pazgjidhur ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave. Vazhdon të konstatohet moskryerja e veprimeve prej përmbaruesve gjyqësor për dënimin me gjobë të debitorit si dhe çdo personi të tretë, të cilët në procesin e ekzekutimit refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose veprojnë në kundërshtim me ligjin dhe vendimet e gjykatave.

Pavarësisht pengesave në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rastet e kallzimit penal në organin e prokurorisë për kryejnë e veprës penale të pengimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, janë tepër të rralla.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, megjithëse ka marrë dijeni për qëndrimin e përmbaruesve gjyqësor, nuk ka kryer ushtrimin e kompetencave sikurse është parashikuar në nenin 31, dhe 35/dh, të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 : "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Gjyqësor" dhe nuk ka kallzuar për ndjekje penale personin e ngarkuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile apo penale të formës së prerë. Kujtojmë se, në bazë të ligjit nr.8510, datë 15.7.1999, "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore", në cilin parashikohet përgjegjësia dhe detyrimi i këtyre organeve dhe i punonjesve të tyre, në rastet kur u shkaktojnë dëme pasurore dhe jopasurore personave fizike apo juridike, privatë, vendas apo të huaj. Ky ligj bën pjesë në ato ligje që nuk kanë gjetur zbatim dhe nuk kanë justifikuar qëllimin e ligjvënësit.

Duhet të përmirësohet më tej niveli i bashkëpunimit midis Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Gjyqësor dhe organeve të tjera si Ministria e Financave, Policia e Shtetit, Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor apo Kombëtar, organet e pushtetit vendor, etj.

Krahas problematikave ka pasur edhe raste të reagimit të bashkëpunimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e problematikave të procesit të ekzekutimit. Vlen të **përmendet reagimi i Ministrisë së Drejtësisë** që bazuar në Rekomandimet e Avokatit të Popullit për nxjerrjen e Udhëzimeve lidhur me “Caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve, gjatë procesit gjyqësor”, sikurse parashikuar në nenin 105/a të K.Pr.C. dhe “Për zhvillimin e ankandit të pasurive të paluajtshme, në procesin e ekzekutimit të tiujve ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, parashikuar në nenin 573/4 të K.Pr.C. me udhëzimin nr. 4 dhe 5 dt. 12.12.2012 bëri të mundur rregullimin e kësaj situate problematike

Ndihma ligjore falas

Legjislacion shqiptar njeh dhe garanton për shtresat në nevojë Shërbimin Ligjor falas të ofruar nga shteti. Në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për Ndhmën Juridike përcaktohen kushtet, lloji i ndihmës ligjore që do jepet si dhe mënyrat dhe procedurat që duhet të ndiqen për përfitimin e ndihmës ligjore. Sipas dispozitave të këtij ligji të drejtën për të përfituar ndihmë juridike falas nga shteti e kanë të gjithë personat që për shkak të pamundësisë financiare, nuk kanë mundësi të zgjedhin vet një avokat mbrojtës privat, ose që kanë mbetur pa të. Në këtë kategori përfshihen automatikisht personat që përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale.

Gjatë vitit 2012 në institucionin tonë kanë ardhur gjithsej 55 ankesa dhe kërkesa për përfaqësim ligjor pasi ankuesit pretendonin se nuk kishin mundësi për të marrë një avokat privat. Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar midis institucionit tonë dhe Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, si organi i cili në bazë të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për Ndhmën Juridike”, vlerëson dhe miraton kërkesat për ndihmë ligjore falas të drejtuara nga individët, të gjitha këto raste i janë referuar këtij komisioni. Paralelisht me referimin e kërkesës është njoftuar ankuesi që në rast të refuzimit të kërkesës mund t’i drejtohej për ndihmë edhe shoqatave të tjera (OJQ) të cilat ofrojnë këtë lloj ndihme ligjore dhe me disa prej të cilave institucioni i Avokatit të Ppopullit ka marrëveshje bashkëpunimi.

F. E drejta e Pronës

Vështrim i Përgjithshëm

Problemet e pronësisë në tërë kompleksitetin e tyre ende mbeten sfida të vazhdueshme për shoqërinë shqiptare.

Informaliteti në tjetërsimin e pronave të paluajtshme, në krijimin e titujve të pronësisë, vonesat e dëmshpërbimit në rastet e shpronësimeve për interesa publike, legalizimi dhe urbanizimi i zonave informale, procesi i papërfunduar i kthimit të pronave të paluajtshme, moskthimi i pasurive të luajtshme, zvarritja e kompensimit financiar apo fizik të të shpronësuarve, problemet që dalin gjatë regjistrimit fillestar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me

dokumentacionin dhe hartat shoqëruese, zvarritjet në shqyrtimin administrativ të vlefshmërisë së titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore nga Komisionet Vendore pranë Prefektit të çdo Qarku dhe pasiguria juridike që gjenerohet nga to, reflektohet në ankesat e shumë individëve.

Në krahasim me vitin e kaluar konstatojmë, se aktorë të tillë të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes dhe garantimit të pronës private, si Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave dhe Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kanë konsoliduar autoritetin e tyre ligjor në ushtrimin e funksioneve të tyre ligjore.

Vendi ynë përveç legjislacionit të brendshëm me dinamikën e tij, ka miratuar të gjitha dokumentet kryesore që u referohen të drejtave të njeriut, duke filluar nga Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e O.K.B.-së në Dhjetor të vitit 1948, me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe deri tek Protokollin Shtesë nr.1 të kësaj konvente.

Në të gjitha këto akte, pa përjashtim, e drejta e pronës private dhe mbrojtja nga privimi arbitrar i saj, konsiderohet si një nga të drejtat më fundamentale të njeriut në shoqërinë moderne dhe atribut i shtetit të drejtës.

Procesi i njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe legjislacioni mbi të cilën mbështetet korrigjimi i një padrejtësie nëpërmjet rivendosjes të ligjshmërisë dhe drejtësisë, ka qënë dhe mbetet një nga prioritetet e veprimtarisë së Avokatit të Popullit në mbështetje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të të shpronësuarve nga veprimet ose mosveprimet e parregullta dhe të paligjshme të administratës publike.

Nga ankesat dhe kontaktet direkte të stafit me individët, konstatohet se në shumë raste nuk u hapen dyert e organeve të administratës publike qëndrore apo vendore për të bashkëpunuar me ta, për t'i dëgjuar, për t'u siguruar informacionin dhe sqarimet e nevojshme. Kjo praktikë mos-komunikimi, padija e ligjit dhe mungesa e kulturës ligjore për mënyrat e fitimit, mbrojtjes dhe humbjes së pronësisë, i bën qytetarët tepër konfuzë në pretendimet e tyre dhe mosbesues për rrugët që ju këshillohen për zgjidhjen e shqetsimeve të tyre të ligjshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga fakti, se forca e tij buron nga përdorimi i arsyes, bindjes dhe nga njohja publike, ka trajtuar të gjithë individët me humanizëm, qytetari dhe mirësjellje, duke ruajtur konfidencialitetin dhe ka tentuar në përmirësimin e lidhjes së individëve me administratën.

Përpjekjet tona kanë synuar trajtimin e ankuesve në mënyrë të paanëshme, që do të thotë të ndërmarrësh veprime procedurale bazuar në normat ligjore dhe rregullin, të kthesh përgjigje në kohën e duhur dhe me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

Në vitin 2012, individë dhe grupe individësh kanë adresuar ankesa dhe problematika të ndryshme, të cilat pavarësisht organit për të cilit ankohen, si ndaj AKKP-së, ZRPP-ve, Komunave dhe Bashkive, Komisioneve të Verifikimit të Ligjshmërisë së Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut apo gjykatave, të përbashkët kanë shqetësimin për mbrojtjen e pronës dhe të drejtave reale mbi to, përfitimin nga ndarja e tokës bujqësore dhe nga procesi i kthimit

e kompensimit të pronave, nga e drejta e parablerjes së objekteve të ndërtuara mbi trojet e tyre, nga dëmshpërblimi për shpronësimet për interesa publikë e tjera, pranë institucionit janë protokolluar dhe shqyrtuar 515 ankesa, kërkesa apo njoftime për të drejtën e pronës, si dhe 32 të tjera të mbartura nga viti 2011.

Janë trajtuar dhe zgjidhur në favor të të interesuarve 231 të tilla, që i korrespondojnë 43 % të totalit. Është hequr dorë nga ankuesit, ose janë pushur për qëndrim inaktiv për më shumë se tre muaj nga 32 ankesa të tjera dhe pjesa tjetër kanë rezultuar jashtë juridiksioni dhe kompetencave, si dhe të pabazuara në ligj.

Pjesa më e madhe e ankesave drejtuar Avokatit të Popullit, lidhen me aktivitetin e Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nga të cilat 43 janë zgjidhur në favor të ankuesve, në prej 8 të tjerave është hequr dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm nga vetë individët ndërsa të tjerat kanë qenë të pabazuara në ligj ose me probleme mbivendosje pronash e tjera që duhen zgjidhur në rrugë gjyqësore.

Analizë e rasteve konkrete

Për një informacion më të detajuar të kësaj problematike, ju referohemi ankesave të mëposhtme:

Me ankesën me nr. **201202442**, qytetari ankohet ndaj ZRPP-se Kuçovë për moslëshimin e Çertifikatës së Pronësise së një banese, pasi vendimi origjinal gjyqësor i formës së prerë, ku sanksionohej e drejta e tij e pronës ndodhej pranë Policisë së Qarkut. Nga ana jonë u kontaktua me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e cila e përcolli vendimin gjyqësor origjinal pranë Zyrës Vendore Kuçovë duke i hapur rrugën ankuesit për t'u pajisur me aktin përkatës së pronësisë.

Ndërsa me ankesën nr. **201201782**, ankuesja ngrinte shqetsimin për moskthim përgjigje nga ZRPP-ja Tiranë, lidhur me kërkesën për heqjen e urdhërimit për kufizimin e veprimeve mbi pasurinë e bashkëshortit të saj, prona e të cilit gabimisht ishte bërë objekt shqyrtimi gjyqësor midis palëve të treta. Ndërhyrja jonë pranë organit administrativ gjeti mirëkuptimin e Regjistruesit, i cili urdhëroi heqjen e kufizimit mbi pronën e paluajtshme.

Ankesa me nr. **201202608** e dy bashkëpronarëve kishte si objekt zvarritjet në rregjistrimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë që detyronte të paditurit (gjyqumbës) t'i njihnin si pronarë ankuesit (paditësat gjyqfitues) për pasurinë lokal tregtie dhe truallit mbi të cilin ishte ndërtuar dhe detyrimin e ZVRPP-së Tiranë të çregjistronte nga regjistri përkatës hipotekor pasurinë e regjistruar në emër të të paditurve dhe lëshimin e çertifikatës së pronësisë në emër të paditësave, dy bashkëpronarëve ankues. Pas kërkesave tona për shpjegime regjistruesi bëri me dije, se vendimi gjyqësor u regjistrua në volumet përkatëse në emër të pronarëve gjyqfitues.

Pozitivisht është zgjidhur dhe ankesa me nr. **201202880** e ankuesës nga qyteti bregdetar me pretendimin e mos-lëshimit të çertifikatës së pronësisë nga ZRPP-ja për një banesë të rikonstruktuar në vitin 1977 nga i biri, me leje ndërtimi. Regjistruesi e ftoi ankuesen të paraqitej pranë sporteleve të Zyrës Vendore për të tërhequr çertifikatën.

Vlen për t'u përmendur dhe evidentuar realiteti, se marrëdhëniet e bashkëpunimit institucional në fushën e trajtimit të ankesave të individëve për të drejtat, apo interesa të ligjshme të pretendura si të shkelura nga Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ato vendore të rretheve, për vitin 2012 kanë qenë normale.

Ndikim, saktësime dhe risi pozitive në procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka sjellë dhe Ligji nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", cili shfuqizoi Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, duke garantuar më tej tagrat e pronarëve legjitimë dhe parandalon në të njëjtën kohë, cënimet nga organet e administratës publike gjatë vendimmarrjes së tyre, qoftë normative apo individuale, vendimmarrje e cila prek dhe pengon subjektet në përdorimin lirisht të pronës.

Në shumë raste qytetarët ankohen për veprime të padrejta apo të paligjshme të punonjësve të këtyre zyrave që kanë sjellë pasoja në mbivendosje pronash.

Në ZRPP-të ka ende shumë për të berë lidhur me shpejtësinë e trajtimit të ankesave, me rritjen e nivelit të transparencës, në sqarimin e saktë të individëve për dokumentacionin dhe procedura që duhen ndjekur, etj.

Por në asnjë rast, nga shqyrtimi administrativ të ankesave nuk ka rezultuar që mbivendosjet të jenë produkt i veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme e të pandërgjegjshme të regjistruarëve të zyrave vendore.

Mbivendosjet e pronave janë krijuar si rezultat i vendimeve gjyqësore, të vendimeve të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe të ish komisioneve të tokave bujqësore në Komuna dhe Bashki, që kanë kaluar në pronësi të familjeve bujqësore trojet apo tokat që ishin objekt i Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar.

Këto pasoja janë rrjedhim i veprimeve të nxituara dhe jo profesionale të organeve të ngarkuara nga ligji për kalimin e pronësisë, të cilat pa bërë verifikimet e duhura japin, kthejnë në pronësi apo pjestojnë prona që pjesërisht apo tërësisht janë të regjistruara në emër të pronarëve të tjerë, duke krijuar në fakt një konflikt të ri pronësie.

Mos njohja e ligjit dhe mos përgatitja e dokumentave të duhura për rregjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, janë shkak që mosveprimet e ZRPP në rrethe, një pjesë e madhe e individëve i konsiderojnë shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Sidoqoftë ankuesit janë orientuar rast pas rasti dhe i'u është sugjeruar rruga dhe mënyra e veprimeve që duhet të bëjnë, përfshirë dhe ndjekjen e rrugës gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë në rastet e mbivendosjeve së pasurive.

Një mangësi tjetër e karakterit administrativ që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keqkuptime në marrëdhëniet tona me ankuesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve, të informacionit dhe në përcjelljen e kopjeve të dokumentacionit të kërkuar nga disa ZZPP në rrethe, brënda afateve ligjore.

Një tjetër problem që shqetëson ngrupe të veçanta të pronarëve të rinj është tejzgjatja e procesit të regjistrimit fillestar sistematik në disa zona të veçanta kadastrale, si në Ujin e Ftohtë Vlorë, Sarandë, Korçë e gjetkë, që po kryehet nga subjekti kontraktor “UTE-Tracasa & Inypsa” dhe që nuk mundëson përpilimin e Kartelës së Pronësisë dhe Hartës shoqëruese, akte që pengojnë pajisjen e të interesuarve me certifikatë pronësie.

Një pjesë tjetër e ankesave për të drejtën e pronës, kanë lidhje me veprimtarinë e **Agjencisë Qëndrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**.

Mbas 20 viteve të fillimit të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave subjekteve të shpronësuara nga aktet ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marra me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti pas datës 29.11.1944 vihet re rrallimi i ankesave dhe i objektit me këto praktika.

Ndikim pati dhe përfundimi i veprimtarisë së Agjencisë në datën 31.12.2012 për efekt të afatit të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 55/2012, datë 10.05.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar”, i cili zgjati afatin e veprimtarisë së AKKP-së, Tiranë, rifilloi shqyrtimi i ankesave të subjekteve të shpronësuara.

Vendin kryesor e mbajnë kërkesat e individëve për t’u njohur me ecurinë apo vonesat e shqyrtimi administrativ të dosjeve të tyre të depozitura pranë AKKP-së Tiranë.

Ankesat e rregjistruara në 6 mujorin e parë të vitit 2012, tilla si ato me nr. 201201688, 201201281, 201202252, 201201830 e të tjera, morrën përgjigje nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, se dosjet ndodhen pranë atij organi, në Sektorin e Pranimit të Vlerësimit Paraprak sipas Qarqeve dhe vendimmarrja pritet të merret me miratimin nga Kuvëndi i Shqipërisë i Projekt-ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar” .

Informacionin e kërkuar nga individët pas hyrjes në fuqi të ndryshime ligjore, e kanë marrë nga AKKP-ja praktikant me nr. 201203673, 201203003, 201203210, 201202779 e të tjera.

Me ankesën me nr. 201201719, qytetari ankohet për zvarritje nga AKKP-ja në shqyrtimin administrativ të kërkesës për njohjen, kthimin ose kompensimin e pronës. Në përgjigjen e tij, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, sqaron se vendimi i ish-KVKKP-së Tiranë, ka marrë formë të prerë duke bashkangjitur një kopje të tij.

Të njëjtin trajtim ka edhe ankesa e qytetares me nr. 201203580.

Problematike vazhdon të mbetet ankesa me nr. 201001390, e mbartur dhe trajtuar në Raportin e Vitit 2011, me të cilën ankuesi kreditor, parashtronte pretendimet për zvarritje të pamotivuar në

ekzekutimin e vendimit nr.10508, dt.23.07.2007 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku detyrohet KKKP-ja të nxjerrë vendim në formën e kërkuar nga ligji dhe kthimin e një sipërfaqe trualli, ndërkohë që është ekzekutuar vetëm pagimi nga qeveria shqiptare i dëmit moral.

Duke parë qëndrimi i AKKP-së Tiranë ndaj rekomandimit të institucionit për ekzekutimin e vendimit nr.10508, dt.23.07.2007 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk ka ndryshuar, çështja ju relatua nga Avokati i Popullit Komisionit të Këshillit të Ministrave në B.E., si organ që ndjek ekzekutimin e vendimeve të gjykatës së cituar më lart.

Një pjesë e ankesave kundërshtojnë vendimet e AKKP-së të marra në vite dhe që në mungesë të aplikimit të ankimit administrativ dhe në gjykatë janë kthyer në Tituj Ekzekutivë.

Ka patur gjithashtu një numër ankesash nga individë të cilët nuk rezultojnë tu jenë drejtuar komisioneve për njohjen e së drejtës për kthimin dhe kompesimin e pronës brenda afateve ligjore dhe pas kalimit të këtij afati kanë kërkuar ndihmë nga institucioni i Avokati i Popullit. Të gjithë këta persona janë informuar se, i vetmi organ i cili mund të bëjë rivendosjen në afat të së drejtës është gjykata. Brenda kësaj kategorie futen edhe kërkesat e përsëritura të Shoqatës "Bregdeti", të "Shoqatës së Pronarëve Qeparo", përfaqësuese të ish pronarë të tokave në Himarë dhe fshatrat rreth saj, si dhe të individëve nga e njëjta zonë. Këto ankesa në thelb kërkojnë rregullimin ligjor dhe njohjen e të drejtës së pronësisë për atë kategori personash, të cilët nuk i janë drejtuar Komisioneve, pasi nuk disponojnë dokumente pronësie, ndonëse janë banorë autoktonë dhe posedojnë në mënyrë të qetë e të vazhdueshme prej një kohe mjaft të gjatë prona të paluajtshme. Në mungesë të dokumentacionit të kërkuar me akte nënligjor për aplikim në AKKP-në Tiranë, u kemi shpjeguar se zgjidhja e kësaj problematike bëhet vetëm nëpërmjet procedurave gjyqësore.

Të tjerë persona janë ankuar, se nuk ju njihet vërtetimi gjyqësor i faktit juridik të pronësisë së paluajtshme nga AKKP-ja dhe ZRPP-të, janë sqaruar se pas datës 01.11.1994, kur hyri në fuqi Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", paragrafi i fundit i nenit 193 të këtij Kodi parashikon, se këto lloj vendimesh gjyqësore, ku në gjykim mungon parimi i kontradiktetit, nuk regjistrohen.

Prej vitit 2011 vazhdon ende pa zgjidhje ankesa me nr. 2011020223 për një konflikt pronësie pranë një rezidence qeveritare. Të ndodhur para faktit të mosreagimit zyrtar nga organet kompetente, Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandim Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për ndërprerjen e veprimeve të paligjshme ndaj pronarëve të trojeve dhe sipërmarrësve të ndërtimit, si dhe zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe jemi në pritshmëri të qëndrimit përfundimtar dhe zyrtar për zgjidhjen ligjore të mosmarrëveshjes civile.

Problematike mbeten dhe ankesat e përsëritura të Shoqatës "Bregdeti", të "Shoqatës së Pronarëve Qeparo", përfaqësuese e pretendentëve për ish pronarë të tokave në Himarë dhe fshatrat rreth saj, si dhe të individëve nga e njëjta zonë.

Në mungesë të dokumentacionit të kërkuar nga V.K.M. nr. 255, datë 13.04.2010 "Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuar, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompesimit të pronës" për aplikim në AKKP-në Tiranë, janë venë në dijeni, se në mungesë të tyre, problemin mund ta bëjnë objekt gjykimi gjyqësor

Këshilli i Ministrave me Vendimin e tij nr. 405, datë 27.06.2012 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të Drejtave të pronësisë 2012-2020" dhe të planit të saj të veprimit", parashikon futjen në rrugën e duhur të zgjidhjes perfundimtare të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, integrimin e zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara, përfundimin e regjistrimit fillestar të të gjitha pasurive dhe dixhitalizimin e sistemeve. Strategjia shfrytëzon gjetjet dhe rekomandimet e Memorandumit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, nga analiza e të cilit del e nevojshme një zgjidhje gjithëpërfshirëse e problemit të të drejtave të pronësisë, bazuar jo vetëm në sfidat aktuale që Shqipëria po kalon, por dhe në eksperiencat e ngjashme të vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Europës.

Problematik mbetet kompensimi financiar i të shpronësuarve për pamjaftueshmëri të burimeve monetare të destinuar për ta.

Një numër i madh ankesash të depozituara gjatë vitit 2012 prej ish pronarëve nga rrethe të ndryshme të vendit, posedues të vendimeve të ish Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Zyrate Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kompensimin financiar, kishin të bënin me pamundësinë objektive të përfitimit monetar për shkak të parashikimeve në V.K.M. nr.192, datë 09.03.2011 "Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve në të holla për vitin 2011". Në gërmën "dh" të pikës 4të kësaj VKM-je përcaktohej si një nga dokumentatat për aplikim "prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët," si kusht që përfaqësuesi ligjor të tërheqte vlerën financiare, në emër e për llogari të të gjithë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar.

Në mendimin tonë, rregullimi i parashikuar në këtë VKM lidhur me përfitimin e kompensimit financiar, bie në kundërshtim si me parimet kryesore të institutit të përfaqësimit, nenet 64-78 të Kodit Civil, dhe me dispozitat për detyrimet solidare, nenet 423-435 të të njëjtit Kod. E drejta e kompensimit, ka si qëllim, të mbulojë dëmin që ish-pronarët kanë pësuar si pasojë e shtetëzimit, shpronësimit, konfiskimit e të tjera dhe në radhë të dytë, kompensimi të shërbejë për rivendosjen e së drejtës, ku struktura e kompensimit njeh kthimin e gjëndjes së parë të marrëdhënies juridike që ekzistonte para shtetëzimit, shpronësimit, konfiskimit dhe kur kjo formë nuk është e mundur, të aplikohet zëvendësimi i dëmit nëpërmjet kompensimit. Shteti shqiptar kishte detyrimin që t'i kthente pasurinë, jo vetëm të shpronësuarit, por edhe të gjithë trashëgimtarëve të trashëgimlënësve. Rivendosja e kësaj të drejte të shkelur në cdo rast nuk mund të interpretohet si detyrim i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për pjestuar pasurinë e ish-pronarëve dhe për t'ja kthyer atë secilit prej trashëgimtarëve.

Vetëm pasi të pjestohet pasuria e trashëgimlënësit dhe të formohen pjesët takuese të çdo trashëgimtari, sipas nenit 356 të Kodit Civil, këta të fundit mund të hyjnë në marrëdhënie me shtetin për t'u kompensuar veç e veç dhe në pajtim me nenin 16 të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 "Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", ndryshuar.

Ky qëndrim i institucionit të Avokatit të Popullit gjen mbështetje edhe në Vendimin Unifikues nr.6 datë 24.01.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohet se, se : "Përderisa nuk është pjestuar pasuria e fituar me vendimi të K.K.K.Pronave, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin se, me vendimin e dytë të K.K.K.Pronave me nr.114, datë 28.08.1997 që ka kompensuar njërin nga trashëgimtarët..... shteti ka përmbushur detyrimin e tij ligjor

kundrejt të gjithë debitorëve (trashëgimtarëve), pasi kompensimi nuk mund të bëhet vetëm për njërin nga trashëgimtarët, kur prona dhe pjesët përkatëse nuk janë ndarë nga gjykata.

Meqënëse në këtë rast kompensimi i është bërë njërit prej trashëgimtarëve dhe konkretisht të paditurit..... trashëgimtarët e tjerë, ndërmjet të cilëve edhe paditësja.....mund t'ia kërkojnë atij pjesën e pasurisë trashëgimore me padinë objekt gjykimi.

Nuk është në kompetencën e K.K.K.Pronave të caktojë pjesët e trashëgimisë dhe të ndajë pasurinë ndërmjet tyre. Detyra e këtyre komisioneve është përcaktimi i mënyrave dhe masave për kthimin apo kompensimin e pronës së ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre (neni 1 i ligjit nr.7698, datë 15.04.1993).

Marrëdhënia juridike e krijuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse është ajo e trashëgimisë dhe jo ajo e detyrimit....."

Për sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit duke e konsideruar si të rëndesishëm rregullimin e këtij problemi, si dhe duke vlerësuar se ekzistonin mospërputhje me Kodin Civil në fuqi, bazuar edhe në ankesat me nr. **201203803** dhe **201201652**, në mbështetje të nenit 63 të Kushtetutës së Shqipërisë që sanksionon të drejtën e Avokatit të Popullit të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike, me shkresën nr. K3/P30-6, datë 26.06.2012 i rekomandoi Ministrit të Drejtësisë, që :

"Në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit financiar ish pronarëve, të gjejë zbatim të saktë dhe të plotë Vendimi Unifikues nr.6 datë 24.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe e drejta e secilit trashëgimtar të të shpronësuarit, si kreditorë solidarë, të kërkojë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë, pagimin e të gjithë detyrimit në të holla, duke liruar debitorin ndaj gjithë kreditorëve, në bazë të paragrafit të dytë të neni 428 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë".

Reagimi i Ministrit të Drejtësisë, z. Eduard Halimi, me shkresën e tij nr. 4466/1 Prot, datë 10.10.2012, ishte pozitiv duke konfirmuar, se :

".....Rekomandimi juaj është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit "Për përcaktimin e rregullave dhe kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve në të holla, për vitin 2012, i cili do të miratohet nga Këshilli i Ministrave pas përfundimit të procedurës së konsultimit të jashtëm".

Kompesimi financiar ka filluar në vitin 2005, duke llogaritur vlerën e kompesimit, bazuar në hartën e vlerës së pronës në nivel të njërive të pushtetit vendor, por metodika e zgjedhur nuk rezultoi e saktë lidhur me përcaktimin e vlerës reale të pasurisë, sepse nuk përmbante kritere koherente dhe vlerat e gjeneruara prej saj nuk përkojnë me vlerën e tregut.

Neni 23 i Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave", i ndryshuar, parashikon krijimin e Fondit të Kompensimit të Pronave nga të ardhurat buxhetore, proces që pritet të përfundojë në vitin 2015. Nisur nga ritmet e deritanishme të pagesave vjetore ku përfitues janë disa dhjetra të shpronësuar dhe nga ndryshimet e përvitshme të procedurave të përcaktuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, perspektiva nuk duket shumë optimiste kur në pritje të kompensimit janë disa mijëra trashëgimtarë.

Edhe këtë vit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në datën 31.07.2012, pas shqyrtimit të ankesës së M. P dhe të tjerë kundër Shqipërisë, konstatoi shkeljen e neneve 6 dhe 13 të Konventës

Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të nenit 1 të Protokollit Shtesë nr. 1 të Konventës, lidhur me mos-ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që akordojnë kompensime ish-pronarëve, pavarësisht masave të përgjithshme të sugjeruara në vendimet e saj të mëparshme në çështje të tjera analoge dhe vendosi penaltete dhe detyrimin që shteti shqiptar brënda 18 muajve nga data që vendimi do të marrë formë të prerë, duhet të sigurojë të drejtën e kompensimit për të gjithë ish-pronarët.

Vazhdojnë të konstatohen cënime të të drejtës mbi pronën, nëpërmjet mosrespektimit të normave të Ligjit nr. 8651, dt. 22.12.2009 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

Konkretisht, shkeljet vërehen në trajtimin e rasteve të ndryshme në lidhje me moskryerjen me transparencë të procedurave të shpronësimit, me disakordanca mes shpronësimeve në fakt në terren me ato të deklaruara në aktin nënligjor, kundërshtime të çmimit të tokës të shpronësuar dhe për vonesa në dhënien e dëmshpërblimit.

Kështu me ankesat me nr. 201202093, nr. 201200803, nr. 20120087 dhe nr. 201203552 grupe banorësh të fshatrave të ndryshëm kërkonin vlerësim të ri në përcaktimin e tokave të shpronësuar nga H/C i Banjës dhe nga segmenti rrugor Tiranë-Elbasan, për të cilat u udhëzuan, që në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 8651, dt. 22.12.2009 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", t'i drejtoheshin gjykatës ..

Një qytetare me ankesën me nr. 201202781 kërkonte t'i jepej fund zvarritjeve për likuidimin e vlerës së shpronësimit të tokës për ndërtimin e segmentit rrugor Levan-Vlorë, sipas VKM-së nr. 269, datë 05.02.2008 dhe Ligjit nr. 8651, dt. 22.12.2009 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" Pas kërkesave tona të përsëritura Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, me shkresën nr. 378/1 Prot, datë 24.09.2012 sqaron, se zonja dhe bashkëpronarët e tjerë duhet të paraqitnin dokumentata ligjore të pronësisë, sipas pikës 2 të VKM-së nr. 1056, datë 22.12.2010 pranë Autoritetit për të bërë të mundur tërheqjen e vlerës së shpronësimit.

Edhe çështja e shpronësimit të një sipërfaqe trualli brënda qytetit me vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 201202775 dhe nr. 201202, pas kërkesave tona morri konfirmimin, se shqetsimi ishte legjitim dhe se procedura ka mbetur pezull në Ministrinë e Brëndshme pasi fondet e shpronësimit përballohen nga buxheti i Bashkisë.

Këta dhe ankesa të tjera tregojnë, se problemi i shpronësimeve ose kufizimeve të të drejtës të pronës vetëm për interesa publike shoqerohet me problem, te cilat duhet të kryhen me kujdes, në bashkëpunim me pronarët dhe përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

Problematike mbeten ankesat e individëve lidhur me mospërfitimin e dëmshpërblimit për shtëpitë të përmytura në qarkun e Shkodrës në fund të vitit 2010.

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 842 datë 06.12.2011 "Për miratimin e vlerës së kompesimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut

dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës”, por një akt i tillë nuk është parashikuar për familjet e prekura nga e njëjta fatkeqësi natyrore në pasuritë e paluajtshme.

Lidhur me çështjen, Avokati i Popullit ka patur një korrespondencë zyrtare me të gjitha institucionet dhe organet shtetërore të përfshira në vlerësimin e dëmeve dhe përpunimin e dokumentacionit zyrtar, me qëllim të miratimit të një akti nënligjor, i cili do të parashikonte dhe rregullonte të gjitha kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së shumave të dëmshpërblimit për të gjitha subjektet përfitues dhe ka hartuar një Raport të Veçantë, dërguar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, ku është pasqyruar problematika e përmbytjeve në Shkodër si dhe çështja e dëmshpërblimit të banorëve të prekur.

Me nismën e Avokatit të Popullit, në muajin shkurt të vitit 2012, u inicua çështja me nr. 201200911, duke kërkuar informacion nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nga Kryetari i Komitetit Kombëtar të Digave të Larta dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, për masat e marra, kontrollet e ushtruara për garantimin e normave, kushteve teknike dhe të sigurisë të mekanizmave të shkarkimit, tuneleve dhe kanaleve të largimit të ujrave dhe të digave të H/C-ve, kryesisht në zonën veri-lindore të vendit duke patur parasysh, se e drejta e jetës dhe e pronës së shtetasve shpesh kërcënohet nga veprimtari apo objekte që përbëjnë burim rreziku të shtuar dhe me qëllim për t’u paraprirë fenomeneve që mund të ndodhnin nga situata të ndryshme atmosferike, siç mund të ishte shkrirja e menjëhershme e borës.

Nga përgjigjet zyrtare, konfirmohej, se ndërhyrjet emergjente në zgjerimin e Urës së Drinit, uljet në shtratet e zhavoreve dhe sistemimi me prita malore në zonë, kontrolli në tunelet e shkarkimit, daljet e tyre dhe kanalet e largimit të ujrave, investimet në rehabilitimin e digave të rezervuarëve me financimet e Bankës Botërore, puna dhe gadishmëria e Bordeve të Kullimit e të tjera masa garantojnë sigurinë e plotë të tyre.

Një grup tjetër ankesash, gjatë vitit 2012, janë ato që kanë të bëjnë me problemin dhe procedurat e tjetërsimit të tokave bujqësore të ish-kooperativave dhe ish-Ndërmarrjeve Bujqësore, bazuar në Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8853, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, i ndryshuar, Ligjin nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, VKM-në nr. 230, datë 22.07.1991 “Për krijimin e komisioneve të tokave”, VKM-në nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar, me VKM-në nr. 306, datë 30.06.1994 “Për masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i HEC-ve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë” e të tjera.

Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” e përfundoi veprimtarinë e tij në datën 15.9.2012.

Nga data e mësipërme deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 58/2012, datë 17.05.2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”, kur Komisionet Vendore pranë Prefektit të çdo Qarku rifilluan veprimtarinë e tyre, ankesave të individëve për vonesa në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve për kufinj të tokave ndërmjet personave fizikë ose juridikë dhe pushtimet e tokave ju kthyem përgjigje se Komisionet nuk funksiononin deri në një ligj të ri.

Në kushtet kur Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" ndaloi rindarjen e tokave bujqësore të pandara, krijimit të titujve të rinj të pronësisë mbi të (toka, të cilat do kalonin në fondin fizik për kompensimin në natyrë të të shpronësuarave) dhe mbarimit të funksioneve dhe veprimtarisë së komisioneve të tokave, u krijua një boshllëk ligjor për rastet e subjekteve që për arsye të ndryshme nuk kishin përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi, ju ishin pushtuar tokat bujqësore nga të tretët, kishin mbivendosje, nuk ishin pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi apo në Përdorim e të tjera

Në këto rrethana të gjitha ankesat ishin të pabazura në ligj ose jashtë kompetencave dhe juridiksionit.

Me Ligjin nr. 58/2012, datë 17.05.2012 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar" dhe atë me nr. 57/2012 datë 17.05.2012 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore" është krijuar një situatë ligjore krejtësisht e re.

Një rast tipik është ankesa me nr. 201202021 e një grupi banorësh të një pallati shumëkatësh, me të cilën bëjnë prezent mosndërhyrjen e strukturave të Bashkisë në ndalimin dhe rivendosjen e sigurisë teknike dhe garantimin e jetës dhe pronës nga ndërhyrjet skandaloze të një personi fizik në strukturat e katit të parë.

Në mungesë të reagimit të Bashkisë, ju dërgua rekomandim Kryetarit të saj, ku i kërkohej : *Ushtrimin e përgjegjësiave dhe kompetencave ligjore nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor në Bashki.... për marrjen e masave të gjithanëshme organizative dhe teknike për rivendosjen e plotë të sigurisë teknike sipas parametrave ndërtimorë dhe ekspertizave të plota, në apartamentin e katit të parë të Pallatit nr..... Strehimin e familjeve të rrezikuara në jetën dhe pronën e tyre të pallatit në banesa të tjera, deri në përfundimin e punimeve të mësipërme.*

Kryetari i Bashkisë ju përgjigj rekomandimit me një vendim administrativ për ngritjen e menjëherëshme të grupit të punë me ekspertë të fushës së ndërtimit për të marrë të gjitha masat teknike në vendosjen e normalitetit strukturor ndërtimor në rastin në fjalë.

Për sa i takon ankesës me nr. 201200221 të një grupi banorësh nga fshati, që nuk lejoheshin të hynin lirisht në tokat të tyre bujqësore nga ushtrimi detyrave ushtarake të Brigadës të Stërvitjes Bazë, pasi e vlerësuam si të bazuar në ligj, kërkuam nëpërmjet rekomandimit ndërprejten e cënimeve ndaj pronës private. Në përgjigjen e saj, organi e vlerësoi pjesërisht rekomandimin : *"...e konsiderojmë prioritet vijimin e procesit të shpronësimit dhe do të minimizojmë përdorimin e sipërfaqeve jashtë planvendosjes të QSI-së për qëllime stërvitore".*

Një praktikë tjetër pronësie, por që ka të bëjë me veprimtarinë e Agjencive të Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale, është ajo me nr. 201203197 ankesë e një qytetari ndaj Drejtorisë Rajonale për zvarritje në procesin e legalizimit të një objekti.

Drejtori i Drejtorisë Rajonale, në përgjigjen e tij bënte me dije, se leja e legalizimit të qytetarit ishte e gatshme dhe mund ta tërhiqte në çdo kohë.

Një nga problemet që shqetsoi rreth 2600 qiramarrës në banesat e të shpronësuarve gjatë vitit 2012 ishte **Akti Normativ nr. 3 datë 01.08.2012** "Për lirimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar".

Në muajin Nëntor 2012 pranë Avokatit të Popullit u depozituan një numër i konsiderueshëm ankesash nga Shoqatat e "Qiramarrësve të Banesave Shtetore Pronë Private" në Tiranë dhe Durrës dhe nga individë, të cilët pretendonin antikushtetushmërinë e Aktit Normativ dhe kërkonin ndërhyrje të institucionit tonë në lidhje me trajtimin me strehim të familjeve të pastreha.

Në këto ankesa, evidentoheshin momente ku vihej në dyshim kushtetueshmëria e këtij akti normativ, bazuar dhe në jurisprudencën që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka zhvilluar në vite në drejtim të trajtimit ligjor të marrëdhënies ndërmjet pronarëve të ligjshëm dhe qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar.

Në këto kushte Avokati i Popullit i përcolli Kryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Kryetarit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe deputetëve të pavarur një memo lidhur me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr.3 datë 1.08.2012.

Në të nënvizohej fakti, se akti normativ i nxjerrë nga Këshilli i Ministrave është një akt i cili krijon problematika të thella duke patur rrezik potencial, krijimin e konflikteve të reja sociale.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit procedura për nxjerrjen e Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr.3 datë 1.08.2012 dhe përmbajtja e tij, evidentonin momente të rëndësishme të mospajtueshmërisë së tij me dispozitat kushtetuese.

Bazuar në vendimet e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, kompetenca për rregullimin e marrëdhënies mes pronarëve të ligjshëm dhe qytetarëve të pastrehë, i është lënë Kuvendit të Shqipërisë, i cili duhej të bënte plotësimet e nevojshme në ligjin "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, por që nuk u zbatuan nga organi legjislativ. Në të kundërt, ishte Këshilli i Ministrave, përmes nxjerrjes së Aktit Normativ nr.3, datë 1.08.2012, që mori përsipër një kompetencë të Kuvendit të Shqipërisë.

Në vlerësimin e avokatit të Popullit edhe përmbajtja e Aktit Normativ ishte problematik dhe nuk ofronte një trajtim të drejtë kësaj shtrese të qiramarrësve. Në vlerësimin e institucionit tonë ky akt normativ nuk merrte parasysh situatat e vecanta dhe specifike të një pjese të madhe të personave të cilat prekeshin prej këtij akti, si psh. fakti se një pjesë e banorëve në banesat e të shpronësuarve rezulton, se janë pronarë legjitimë, pasi i kanë fituar ato me kontrata formale shitjeje të pasurisë të paluajtshme dhe të regjistruara. Largimi i tyre nga banesat nga Akti Normativ nuk është gjë tjetër veçse një shpronësim i ri pa shpërblim.

Një analizë e fakteve sa më sipër si dhe arsytimi ligjor në lidhje me problematikat e Aktit Normativ ju dërguan Kuvendit por nuk pati asnjë llojë reagimi lidhur me të

Nga anatatjetër Gjykata Kushtetuese, pas gjykimit të kërkesës të "Shoqatës së Qiramarrësve në Shtëpitë Shtetore ish Pronë Private", vendosi rrëzimin e saj duke i hapur rrugë ekzekutimit të detyrueshëm të Aktit.

Një rekomandim ende pa përgjigje është ai që i takon trajtimit të ankesës me nr. **201203547**, të qytetarit nga Shkodra, i cili prezantoi shqetësimin lidhur me mos-kompensimin e pasurive të

luajtshme të shpronësuara, të shtetëzuara apo të konfiskuara, sanksionuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 9235 dt. 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, ku parashikohet, se : *"Kthimi dhe kompensimi i pronës së luajtshme kryhet me ligj të veçantë"*, detyron qeverinë të marrë masat e duhura për hartimin e Projektligjit.

Nëpërmjet këtij projektligji, të shpronësuarve do t'u krijoheshin hapësirat ligjore për kompensimin e pasurive të luajtshme dhe do të përcaktoheshin kushtet e kriteret për kompensim. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson, që në relacionin shtet-të shpronësuar, boshllëku ligjor duhet mbushur në favor të realizimit të të drejtave të pronësisë të këtyre të fundit.

Ligji për kompensimin e pronave të luajtshme do t'i jepte fund pabarazisë të deritanishme para ligjit, një forme diskriminimi ekonomik dhe pasigurisë juridike të një kategorie të shpronësuarish nga sistemi i kaluar.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me praktikën e saj gjyqsore dhe sugjerimet e rekomandimet e saj në trajtimin e ankesave të shtetasve shqiptarë, ka patur impakt në problemin e kthimit dhe kompensimit të pronave duke e vlerësua këtë proces si paksa problematik, me shkeljet e të drejtës së pronës, me mungesën e garancive ligjore që duhet të ofrojë sistemi i brëndshëm shqiptar, duke propozuar ngritjen e mekanizmave ligjore, administrative dhe financiare për përmirësimin e procesit në tërësinë e tij.

Po ashtu, Kushtetuta jonë me anë të parimeve themelore që ajo parashikon, ka krijuar kushtet e duhura për të garantuar te drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Kështu, Neni 181, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon, se : *"Kuvëndi, brënda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41"*

Në VKM nr.405, datë 27.06.2012 "Për miratimin e strategjisë ndërdikasteriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012-2020 dhe të planit të veprimit" në Kapitullin 1, "Vështrim i përgjithshëm i gjëndjes aktuale" pika 1.2, nënvizohet, se *"Shteti merr përsipër, me ligj, detyrimin për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave ndaj të gjitha subjekteve të shpronësuara gjatë regjimit komunist"*.

Në zbatim të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të Kushtetutës së Shqipërisë, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të saj, ku parashikohet, se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"*, dhe në vijim të nenit 24/a, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku nënvizohet, se : *"Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose nga ligjet e tjera, ka të drejtë t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve"*, me shkresën tonë nr. K3/D59-4 Prot, datë 26.10.2012, ju rekomandua Ministrin të Drejtësisë për : *"Përgatitjen e Projekt-Ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme" në referim të nenit 5 të Ligjit nr. 9235, date 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" dhe kalimin për miratim në Kuvëndin e Shqipërisë"*.

Iniciativa e lartpërmendur duhet të përmbushë detyrimet e parashikuara në Ligjin organik shqiptar, realizimin konkret nga strukturat shtetërore të të drejtave të ish-pronarëve, si edhe për ta përqasur atë me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Jurisprudencën

e Gjykatës së Strasburgut e cila mbikqyr respektimin dhe përmbushjen e dispozitave të Konventës nga shtetet që e kanë ratifikuar atë, një nga të cilat është edhe Shqipëria

Evidentojmë faktin, se deri në përfundimin e këtij Raporti nuk kemi asnjë përgjigje zyrtare nga Ministri i Drejtësisë.

Konkluzione

Ndonëse ka pësuar një ulje numri i ankesave me objekt tokën, kthimin dhe kompensimin e saj, vazhdojnë të regjistrohen ende një numër i madh ankesash me këtë objekt. Zvogëlimit të këtyre problematikave mendojmë se do t'u shërbente:

- -Nxjerrja e aktit nënligjor për kompesimin financiar të të shpronësuarve për vitin e kaluar (2012) në bazë të Ligjit nr. 10 239, datë 25.02.2010 "Për krijimin e fondit special të kompesimit të Pronave"
- Bërja publike e fondit të kompesimit fizik sipas V.K.M. nr. 1077, datë 18.06.2008 "Për krijimin e fondit të kompesimit fizik nga fondi pyjor dhe kullosor".
- Bërja publike e fondit të kompesimit fizik sipas V.K.M. nr. 868, datë 18.06.2008 "Për krijimin e fondit të kompesimit fizik nga fondi i tokës bujqësore".

G. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës

Vështrim i përgjithshëm

Institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë misionit kryesor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtës për mbrojtjen shoqërore të punës, si dhe është fokusuar në politikat e punësimit të shtresave vulnerabël të shoqërisë.

Kushtetuta, Konventat e Ratifikuara të Republikës së Shqipërisë, Kodi i Punës, Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil", si dhe dispozita të tjera ligjore e nënligjore përbëjnë bazën ligjore për rregullimin e marrëdhënieve të punës, për t'i mbrojtur punëmarrësit nga largimet abuzive nga puna.

Gjatë vitit 2012 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur rreth **297** ankesa, në të cilat është pretenduar shkelje e marrëdhënieve të punës nga ana e administratës publike, qendrore dhe vendore.

Nga këto raste rezultojnë të mbyllura rreth 249 ankesa, prej të cilave, në 63 raste pretendimet e ankuesve lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës rezultojnë të pabazuara. 111 ankesa kanë rezultuar jashtë juridiksionit dhe kompetencës për shqyrtim nga ana e zyrës tonë si dhe 42 ankesa rezultojnë të zgjidhura në favor të ankuesve. Gjithashtu, Lidhur me shkeljen e të drejtave të punës për punëmarrësit kemi hartuar në ankesa të veçanta rreth 28 rekomandime

nga të cilat, 6 ankesa rezultojnë me rekomandime të pranuar dhe 22 të tjera rezultojnë me rekomandime të refuzuara si dhe 5 ankesa rezultojnë me ndërprerje të shqyrtimit për shkak të braktisjes së procedimit administrativ nga vetë ankuesit. Ndërkohë, pjesa tjetër e ankesave (48 ankesa) janë ende në proces shqyrtimi nga ana jonë.

Gjatë këtij viti një numër i konsiderueshëm ankesash janë prezantuar nga punëmarrës në cilësinë e punonjësve të Bashkisë Tiranë, QSUT-ja dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale, të cilët kanë kundërshtuar largimin e tyre nga puna nga këto organe, si dhe mospërfitim të të drejtave financiare në bazë të Kodit të Punës. Në kushtet kur marrëdhëniet e punës së këtyre punonjësve janë rregulluar në bazë të dispozitave ligjore të Kodit të Punës dhe kontratave individuale të lidhura në punë, është vënë re se gama e punonjësve të larguar shtrihet nga edukatorët e çerdheve/kopshteve, mësues, infermierë, sanitare, shoferë, magazinierë, mirëmbajtës, specialistë, deri në drejtues të Drejtorive.

Në vijim, ankesa të tjera më këtë objekt kanë referuar paligjshmëri për largime nga puna nga ana e Prefekturave, Ministrive të ndryshme pranë organit të ekzekutivit, Drejtorive Arsimore të Rretheve, Subjekteve Juridike, Qendrave Spitalore, Rektorëve të Universiteteve Publike, etj.

Nga trajtimi i këtyre rasteve janë evidentuar të dhëna problematike të natyrës juridike, të cilat në jo pak raste kanë qenë pjesë e rekomandimeve tona. Shumë prej këtyre problematikave që kërkojnë zgjidhje jemi munduar t'i përfshijmë në propozimet për ndryshimet legjislative në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, "*Për statusin e nëpunësit civil*", i ndryshuar, që Institucioni i Avokatit të Popullit i dërgoi Departamentit të Administratës Publike si dhe në materialin e dërguar nga ana jonë në muajin Maj 2012, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për vlerësimin "*Mbi marrëdhëniet e punës në administratë dhe mënyrën e zbatimit të procedurave nga ana e saj*",

Analizë e rasteve konkrete

Pas hetimit dhe trajtimit të ankesave nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit ka rezultuar se:

1. Për shkak të mënyrave të ndryshme me të cilat interpretohen dispozitat e Kodit të Punës në drejtim të pretendimeve të qytetarëve për rikthim në punë të punëmarrësit, kundërshtimit të zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme, me zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të justifikuara, zyra jonë ka gjykuar se këto pretendime mund të zgjidhen vetëm në rrugë gjyqësore dhe si të tilla nuk i ka hetuar në themel. Kryesisht, trajtimi me rekomandime nga ana jonë ka argumentuar procesin e mosrespektimit të elementëve të rregullt ligjorë në drejtim të masës së dëmshpërblimit për shkak të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës; cënimit të së drejtës për t'u dëgjuar, mosinformimin për çdo rast të punëmarrësit për aktet administrative ndaj tij për masa disiplinore nga punëdhënësi.
2. Është vënë re se nga ana e organeve të administratës publike, në veçanti asaj të Bashkisë Tiranë, ka pasur një numër të madh rastesh të zgjidhjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme, pa respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në Kodin e Punës dhe nga ana tjetër, referenca ligjore e përdorur për të arsyetuar apo motivuar zgjidhjen e marrëdhënieve

të punës ka qenë në shumë raste e njëjtë. Përgjithësisht për këto raste nga punëdhënësi është përdorur si argument për zgjidhjen e kontratës së punës suprimimi i vendit të punës si rrjedhojë e ristrukturimit të institucionit, ndërkohë që punonjësit kanë pretenduar se janë zëvendësuar me persona të tjerë.

3. Veçanërisht në drejtim të masës së dëmshpërblimit që përfitojnë punëmarrësit, në të gjitha rastet e monitoruara nga zyra jonë e për të cilat janë bërë rekomandime, nuk është respektuar detyrimi i shpërblimit të vjetërsisë në punë nga organet e administratës, në bazë të nenit 145/152 të Kodit të Punës, duke përmendur si shkak mungesën e fondeve ose duke mos e sqaruar aspak. Konkretisht në ankesën me Nr. **Doculive 201200020**, janë prezantuar një grup prej 70 punonjësish të Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale Tiranë, të cilët janë larguar nga puna në kundërshtim të plotë me dispozitat e Kodit të Punës, pa përfituar asnjë efekt financiar nga Bashkia Tiranë apo ndërmarrja në varësi të saj.

Për sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit, është sensibilizuar menjëherë në drejtim të kërkesave të ligjshme të punonjësve të larguar dhe i është drejtuar për shpjegime Bashkisë Tiranë, Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale, dhe Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Qytetit. Pasi kemi marrë sqarimet përkatëse nga të tre këto organe, jemi bindur për vërtetësinë e pretendimeve të punëmarrësve, se organet në varësi të Bashkisë Tiranë nuk kanë vepruar në respektim të Kodit të Punës, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Në këto kushte ju kemi rekomanduar organeve përgjegjëse të administratës publike zbatimin e drejtë dhe respektimin e dispozitave të neneve 138, 139, 144, 145, 148, 155 të Kodit të Punës, në drejtim të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit e Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale.

Lidhur me këtë rekomandim, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Qytetit, ka refuzuar argumentet e këtij rekomandimi në përgjigjen e dërguar, duke sqaruar se Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 21, datë 19.11.2011, në pikën 3 ka përcaktuar vetëm transferimin e funksioneve të kryera nga pjesa buxhetore e Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale, në drejtim të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Qytetit, lidhur me funksionin e varrezave.

Për sa më sipër, kjo Drejtori ka refuzuar transferimin e punonjësve me pretendimin se ata kanë mbetur të lidhur me punëdhënësin e parë.

Në përfundim të hetimit dhe trajtimit të kësaj ankese, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konkluduar se rekomandimi i zyrës tonë është zbatuar pjesërisht nga Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale. Pra, punonjësve të larguar ju është ofruar e drejta e përfitimit të pagës për tre muaj dhe janë zbardhur aktet shkresore si detyrim i punëdhënësit që largon punëmarrësin nga puna.

Për sa i përket rekomandimit për dhënien e shpërblimit të vjetërsisë në punë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vënë re se nuk është zbatuar nga punëdhënësi, pasi NSHF-ja pretendonte se për efekt të mungesës së buxhetit nuk e ka zbatuar këtë gjë. Në këto kushte, kemi pajisur me kopje të rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit ankuesen duke i rekomanduar zgjidhjen në rrugë gjyqësore të mosmarrëveshjes.

4. Janë vënë re në mënyrë të përsëritur se punëmarrësit të cilët kanë pasur kontrata pune me afat të pacaktuar janë lidhur kontrata me afat të caktuar. Për shkak të interpretimeve të ndryshme juridike që i bëhet dhe nga ana e gjykatave, nenit 151 të Kodit të Punës punëmarrësit i nënshtrohen një procedure jo të rregullt për nënshkrimin e kontratave të reja, pa marrë parasysh përvojën e gjatë në punë pranë të njëjtit punëdhënës. Për problematikën e konstatuar më sipër mund të përmendim rastet me **Nr. Doculive 201200048, 201200086**, etj. Pasi kemi kontaktuar me ankuesit dhe kemi marrë dokumentacionet që vërtetohin pretendimet e tyre, kemi argumentuar menjëherë me rekomandim ekzekutimin e detyrimeve nga organet në varësi të Bashkisë Tiranë, në bazë të Kodit të Punës.

Për këto raste është rekomanduar zbatimi i drejtë dhe respektimi i dispozitave të neneve 94, 143, 145, 155 të Kodit të Punës që rregullojnë mënyrën e zgjidhjes së marrëdhënieve në punë dhe pasojat e saj.

Në rekomandimet e Avokatit të Popullit u theksua se nga ana juridike, në mungesë të një marrëveshjeje midis palëve, koha e provës nuk mund të ishte më e gjatë se tre muaj dhe çdo lloj marrëveshjeje që parashikonte një afat të tejzgjatur ishte e pavlefshme. Në vijim u argumentua se sipas parimit të mirëbesimit, punëmarrësi merrej në kohë prove në punë vetëm një herë. Pra, muajin e katërt pavarësisht nga vullneti i punëdhënësit për të rimarrë në provë të njëjtin punëmarrës, palët gjendeshin të lidhura nga një kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar, zgjidhja e se cilës kryhej sipas neneve 143, 144, etj., të Kodit të Punës. Për më tepër, nëse punëdhënësi pranonte ofrimin e shërbimit të punëmarrësit kundrejt një pagese edhe pas mbarimit të afatit, konsiderohej se palët kishin ndryshuar kontratën duke e kthyer në kontratë me afat të pacaktuar (Prezumim ligjor). Në këtë rast, e njëjta kontratë vazhdonte midis palëve deri sa ato ta zgjidhin duke respektuar rregullat e zgjidhjes së kontratës pa afat të caktuar.

Për sa më sipër, kemi vënë re se nuk ishin respektuar në asnjë rast afatet e njoftimit për largimet nga puna, shpërblimi për pushimet vjetore të pakryera (neni 94, paragrafi 5 i Kodit të Punës), si dhe shpërblimi i vjetërsisë në punë (neni 145 Kodi i Punës).

Në përgjigje të argumenteve të parashtruara nga zyra jonë, është vënë re se nga organet në varësi të Bashkisë Tiranë janë mbajtur qëndrime të gabuara, jo vetëm për faktin se argumentet juridike të sjella në vëmendje në rekomandimet e dërguara kanë qenë të detajuara dhe tejet të sakta, por dhe për faktin se situatat e prezantuara kanë qenë të mirëpërcaktuara brenda dispozitave të Kodit të Punës, si të drejta absolute të punëmarrësve, pas mbarimit të kontratës me kohë prove dhe vijimit të marrëdhënieve të punës me punëdhënësin.

5. Në disa raste nuk është respektuar procedura e zgjidhjes së kontratës të punës nga punëdhënësi (neni 144 i Kodit të Punës), duke mos njoftuar paraprakisht punëmarrësin që të informohet mbi arsyet e largimit dhe të parashtrijë argumentat kundërshtues që mund të ketë. Kështu, në nenin 144 të Kodit të Punës parashikohet për punëdhënësin respektimi i një procedure të caktuar të zgjidhjes së kontratës. Çdo punëmarrës ka të drejtën për t'u informuar menjëherë me shkrim nga punëdhënësi për arsyet e zgjidhjes së kontratës së punës. Në shumicën e ankesave, qytetarët pretendojnë cenimin nga punëdhënësit të së drejtës për të vënë paraprakisht në dijeni punëmarrësin për zgjidhjen e kontratës së punës dhe se punëmarrësi përgjithësisht nuk dëgjohet në procesin administrativ.

Procedurat e zgjidhjes së kontratës së punës, mosrespektimi i afatit të njoftimit dhe qëndrimi i gabuar që mbajnë organet e administratës publike në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës, sic është sjellë vazhdimisht në vëmendjen e organeve të administratës prej rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, sjellpër pasojë dëmshpërblimin financiar të tyre në një masë deri në 6 muaj pagë..

Gjithashtu, në referim të rasteve për mosrespektimin e procedurave për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës përmendim edhe ankesën me Nr. **Doculive 201201900** që ka të bëjë me rastin e një mjeku në Spitalin Rajonal të Sarandës, i akuzuar për veprën penale “Korrupsion pasiv”, për të cilin ishte nxjerrë akti administrativ “*Pezullim nga detyra deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë*”, në një kohë që fajësia e tij nuk ishte provuar ende me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Pasi konstatoam se pezullimi i mjekut nga detyra ishte bërë në kundërshtim të dispozitave ligjore në fuqi rekomanduam Drejtorit të Spitalit Rajonal Sarandë “*Konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ për pezullim nga detyra të mjekut J.Q., deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata dhe rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës*”.

Në përgjigje të këtij rekomandimi jemi vënë në dijeni se Drejtori i Spitalit e rimori në punë këtë mjek dhe pas një muaji i dorëzoi urdhrin për ndërprerjen e menjëhershme të punës “*Për shkelje të rënda të etikës, rregullave të funksionimit të institucionit dhe për fyerje personale ndaj drejtuesit të institucionit*”. Pas riparimit të ankesës jemi konstatoam se urdhri për largim nga puna ka qenë i pambështetur në prova dhe fakte dhe i parregullt. Nuk i është dhënë as mundësia e shpjegimeve sipas Kodit të Punës, si dhe në kundërshtim me ligjin nuk janë respektuar afatet ligjore të njoftimit.

Pas ankesës së përsëritur të këtij shtetasi ju drejtuam Ministrisë së Shëndetësisë për zgjidhjen e shkeljeve të konstatuara dhe I rekomanduam marrjen e masave. Nga ana e kësaj ministrie nuk kemi ende një përgjigje.

6. Mosrespektimi i afateve të njoftimit, pas kohës së marrjes në prove, është arsyetuar në disa raste nga punëdhënësit se i referohen nenit 153 të Kodit të Punës, cilësuar si “*Zgjidhje e menjëhershme e kontratës në punë*. Mendojmë se në shumë raste nuk kuptohet qartë detyrimi që përmban dispozita e nenit 143 të Kodit të Punës lidhur me afatin e njoftimit. Në vlerësimin tonë, afati i njoftimit i mundëson punëmarrësit që pasi i është njoftuar vendimi për zgjidhjen e kontratës së punës të ketë një periudhë kalimtare deri në zgjidhjen përfundimtare të saj gjatë së cilës ai mund të kërkojë dhe gjejë një punë tjetër, duke zvogëluar kështu problemet financiare dhe shoqërore që krijon largimi nga puna. Këtë qëndrim, mban dhe Gjykata e Lartë në vendimin unifikues Nr.19, datë 15.11.2007, në të cilin konkludohet se: “*Në parim palët duhet të respektojnë afatet e njoftimit dhe zgjidhja e menjëhershme e kontratës është e ndaluar, megjithatë përjashtimi është se ajo lejohet për shkaqe të justifikuara (neni 153) dhe në këtë rast pala që ka zgjidhur kontratën nuk ndëshkohet, pavarësisht mosrespektimit të afatit.*”

7. Problematikë tjetër është zgjidhja e marrëdhënieve të punës në kundërshtim me ligjin si dhe mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave e cila krijon pasoja financiare të cilat arrijnë shuma të konsiderueshme. Për pasojë përgjegjësia për vendimarrjen e jashtëligjshme dhe fatura financiare që rrjedh prej saj nuk duhet t’i faturohet organit të administratës por duhet të jetë më së shumti përgjegjësi individuale e titullarit të organit, si personi që merr

vendimin dhe që ka detyrimin ligjor për zbatimin e ligjit. (Mund të përmendim ankesat me Nr. Doculive 201200099, 201203471, 201203505).

8. Problematikë që vazhdon të mbartet ndër vite janë edhe procedura e ndjekura për transferimin apo ndryshimin e vendit të punës për stafin mësimor, problematikë e cila në asnjë rast nuk ka gjetur zbatim në vendimmarrjen individuale të Drejtorive Arsimore apo të Zyrave Arsimore.

Rasti me Nr. Doculive 201201516, ka të bëjë me ankesën e një grupi pedagogësh të një iniversiteti të cilët kundërshtojnë urdhrin për transferimin e personelit akademik në Filialin e uinversitetitë” ndaj Rektorit të këtij universiteti Z.Mit’hat Mema.

Lidhur me ankesën në fjalë, rezulton se në mënyre kolektive janë transferuar në një qendër tjetër pune 8 pedagogët në Filialin e universitetit me urdhrin që mban dt. 27.03.2012, dhe i detyrueshëm për t’u zbatuar në datë.02.04.2012. Kjo me qëllim të plotësimit të nevojave të universitetit në funksion të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies në këtë filial.

Në vijim lidhur me trajtimin e kësaj ankese, (problematika e së cilë është bërë pjesë edhe e pasqyrimin në mediat vizive), kemi ndërmarrë një rekomandim për *“Revokimin si absolutisht të pavlefshëm të Urdhrit Nr 27/2 datë 27.03.2012 me objekt “transferimin e personelit akademik në filialin e universitetit”*.

Në përgjigje të këtij rekomandimi nga ana e rektorit u hodh poshtë çdo argument i dhënë nga ana jonë, duke u justifikuar me të gjitha mënyrat se ka zbatuar ligjin, si dhe duke na gjykuar të njëanshëm për qëndrimin tonë. Aktualisht, rasti i transferimit të këtij grupi pedagogësh është bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor, për të cilën pritet dhënia e një vendimi përfundimtar nga gjykata.

9. Krahas ankesave dhe problematikave të trajtuara më sipër, për respektimin, zbatimin sa më të drejtë dhe efikas të legjislacionit në fuqi kemi ndërmarrë edhe rekomandime në të cilat kemi propozuar shkarkimin e drejtuesve të institucioneve kur kemi konstatuar shkelje flagrante të dispozitave ligjore. Konkretisht, (ankesa me Nr. Doculive 201201736), Me inisiativën e Avokatit të Popullit, është bërë në datën 10-12.04.2012, një inspektim në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës, Kamëz, Tiranë. Ky inspektim merr shkas nga ankesa e bërë nga disa gra ish të strehuara në këtë Qendër, si dhe nga transmetimi i një kronike shfaqur në emisionin Fiks-Fare, për trajtimin dhe kushtet e orfuara në këtë institucion.

Në kontakte me drejtuesen e këtij institucioni na u shpjegua se Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, është një institucion i ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.36, datë 23.03.2010, në mbrojtje të grave të dhunuara dhe pa asnjë përkrahje. Gratë dhe fëmijët akomodohen në këtë institucion të shoqëruar nga Policia e Shtetit, me urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje nga gjykata nga e gjithë Shqipëria. Ky institucion është konceptuar si një Qendër e hapur ku gratë janë të lira të lëvizin gjatë ditës dhe fëmijët frekuentojnë shkollën afër qendrës.

Në intervistat me gratë e strehuara, por referuar edhe kronikës së emisionit Fiks-Fare, për gratë e larguara 10 ditë më parë nga kjo Qender, u ngritën nga ana e tyre problemet që kishin të bënin

me mungesën e asistencës juridike nga institucioni për shkak të mungesës në organikë të një juristi. Gjithashtu gratë pohuan se lëvizja e tyre jashtë qendrës ishte e pasigurtë, pasi ato nuk shoqëroheshin nga asnjë person i stafit kur zhvilloheshin seancat e tyre gjyqësore, apo edhe kur shoqëronin fëmijët në shkollën afër qendrës.

Kjo situatë kishte sjellë si pasojë edhe incidentin me shtetasen H.B e cila në muajin shkurt, afër qendrës ishte goditur nga bashkëshorti me thikë, goditje e cila i kishte shkaktuar humbjen e njërit sy. Ajo pohoi se vazhdonte të ishte e kërcënuar nga kunati i saj, dhe për këtë arsye ajo nuk dilte më jashtë rrethimit të institucionit. Gjendja e saj psikologjike ishte e rënduar, pasi ajo ishte fyer dhe ofenduar (para incidentit), shumë herë nga drejtuesja e qendrës edhe në sy të fëmijëve të saj.

Një tjetër fakt skandaloz që na u vu në dispozicion nga njëra prej punonjëseve, ishin edhe pjesë të shkëputura të një "Ditari Bordi", që mbahet rregullisht nga punonjës të qendrës. Në këtë ditar punonjëset përshkruajnë çdo ditë në vija të përgjithshme, çdo gjë që ndodh në këtë qendër duke pasqyruar edhe porositë e drejtoreshës, dhe firmoset nga edukatorët dhe kujdestarët turn pas turni. Në proces-verbalin e dt.17.10.2011, te pjesa Urdhër nga Drejtoresha, pika 2, shkruhej: "Suzana është e dënuar për të mos dalë në takimin e radhës të datës 22.10.2011 për tu takuar me djalin dhe vajzën e saj." Në proces-verbalin e dt.13.10.2011, te pjesa porosi për stafin, pika 4 shkruhet: "Banoret do të komunikojnë një herë në muaj me familjarët, në prani të një përfaqësuesi të stafit."

3. Përvec sa më sipër, u pranua u pretenduar dhe u pranua edhe nga vetë drejtoresha fakti i moslejimit të telefonave celularë brenda ambjentëve të kësaj qendre, kjo me pretendimin e ruajtjes së sigurisë grave. Kur drejtoreshës i kërkua se në çfarë pike të rregullores apo urdhër e mbështet këtë kufizim, na paraqitnin një fotokopje të një urdhri të brendshëm me nr.54 prot, dhe që mban datën 01.04.2012, pra të para 10 ditëveve cili urdhëronte që **"gratë të kontrollohen fizikisht sa herë kthehen në qendër pasi kanë dalë gjatë ditës, kjo për të evituar futjen e objekteve të rrezikshme dhe të dëmshme"**.

Në vlerësimin tonë urdhri binte ndesh me nenin 37/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon: "Askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik".

Gjithashtu në VKM nr.505, datë 13.07.2011 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të perkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jo publike", standarti nr.3 parashikon: "Ofruesi i shërbimeve ti trajtojë ata me respekt dhe dinjitet. Të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e abuzimit apo diskriminimit." "Ofruesit e shërbimeve të nxisin dhe praktikojnë tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin pa bërë diskriminim....."

Në gjykimin tonë kishte mospërputhje të konceptimit të ngritjes së qendrës dhe mënyrës së administrimit, menaxhimit dhe administrimit të saj nga drejtuesja e këtij institucioni. Nga njëra anë thuhej se kjo qendër është e hapur për mbështetjen dhe lehtësimin e vuajtjeve që këto gra dhe nëna kanë përjetuar nga bashkëshortët e tyre, dhe nga ana tjetër ndaj tyre merren masa drastike, si ndërprerje të vakteve të ushqyerjes, moslejimi komunikimi me familjarët apo edhe kufizim vetëm brenda qendrës të aparatit celular. Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit ndaj grave që kanë ngritur shqetësimin në videon e paraqitur në media si dhe ndaj disa

prej atyre që strehohen aktualisht në qendër, ka patur trajtim neglizhues, dhe është përdorur dhunë psikologjike me qëllim kërcënimin, friksimin dhe manipulimin e tyre, nga drejtuesja e qendrës.

Nisur nga shkeljet e konstatuara më sipër kemi ndërmarrë një rekomandim Drejtuar Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ku propozuam ndër të tjera edhe shkakimin nga detyra të drejtoreshës së qendrës duke zgjidhur menjëherë kontratën e punës, për shkaqe të justifikuara në bazë të nenit 153 të K.Punës.

Në përgjigje të rekomandimit, jemi informuar se prej datës 09.05.2012 është komanduar në detyrën e drejtorit përgjegjësja e qendrës me profesion punonjëse sociale.

Gjithashtu, lidhur me problematikën më sipër mund të përmendim edhe ankesën me Nr. Docu-live 20104183. Rezultoi se TV ORA NEËS nëpërmjet emisionit "Alarm", ka transmetuar një kronikë lidhur me largimin e disa punonjësve nga puna, pranë Spitalit Rajonale Lushnjë, por në datë 14.12.2012, kameramani dhe gazetarja gjatë ushtrimit të detyrës janë dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht, duke u shtyrë, goditur dhe kërcënuar nga vetë drejtori i spitalit si dhe persona pranë tij.

Pas këtij incidenti Avokati i Popullit referuar Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, në mënyrë të menjëhershme ka filluar me inisiativë trajtimin e këtij rasti për të cilin në datë 15.12.2012, kemi marrë edhe autorizimin për ndjekjen e një procedure hetimore.

Në vijim të trajtimit të këtij rasti nga ana jonë, u ngrit një grup pune, i cili shkoi në Lushnjë në datë 17.12.2012, dhe mori një takim me Drejtorin e Spitalit Rajonal të Lushnjës lidhur me ngjarjen që u publikua në media, ku na u tregua se: ishte provokuar prej operatorit të televizionit, i cili nuk pronte të fikte kamerën duke shqetësuar edhe disa persona të cilët prisnin pacientët, dhe në një moment kishte humbur qetësinë dhe kishte përdorur ndaj kameramanit fjalë fyese. Për sa më sipër, nga analizimi i të gjithë rrethanave të kësaj ngjarje nga pamjet filmike e dëgjimin e debatit, deklaratimet e gazetares dhe të drejtorit, pasi konstatuam shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 8503 datë 30.06.1999, "Për të drejtën e informimit", si dhe të Ligjit Nr. 9131 datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", me një rekomandim drejtuar Ministrin të Shëndetësisë, propozuam "Shkarkimin nga detyra dhe largimin nga puna të z. A. S, duke zgjidhur menjëherë kontratën e punës për shkaqe të justifikuara në bazë të nenit 153 të K.Punës". Nga një takim që Avokati i Popullit pati me Ministrin e Shëndetësisë, midis të tjerash u vu në dijeni se do të ndërmerreshin masat për largimin nga detyra të Drejtorit të Spitalit Rajonal Lushnjë por ende nuk kemi marrë një përgjigje zyrtare nga kjo ministri lidhur me zbatimin e rekomandimit.

9. Në vijim, krahas zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës për respektimin e marrëdhënieve të punës punamarrës-punëdhënës jemi fokusuar edhe në nxitjen e punësimit lidhur me përfshirjen në programet e formimit profesional të pjesëtarëve të minoritetëve e në veçantë ndaj komunitetit Rom.

Një pjesë e madhe e popullësisë rome në moshë pune, vuajnë papunësinë. Disa prej tyre, kryesisht merren me punë të rëndomta, por edhe kjo mënyrë e fitimit të të ardhurave për mbijetesë, është e përkohshme. Prandaj, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom dhe të Planit të Kombëtar të Veprimit 2010-2015, ka dalë si një çështje imediate punësimi i pjesëtarëve të minoritetit Rom në përshtatje me kërkesat bashkëkohore të tregut të punës.

Kjo do të sillte një përmirësim të gjendjes ekonomike të familjeve dhe integrimin e tyre në shoqëri si dhe do të garantonte shanse të barabarta. Për sa më sipër, nëpërmjet rekomandimit drejtuar Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta kemi kërkuar:

1. Përfshirjen në vazhdimësi, me prioritet, të pjesëtarëve të minoritetit Rom në programet e formimit profesional.
2. Punësimin në vazhdimësi, me prioritet, të personave në moshë pune të minoritetit Rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që ky minoritet të mos ndihet i diskriminuar.

Në përgjigje të këtij rekomandimi informohemi se Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndërmarrë nisma konkrete për hartimin e politikave nxitëse dhe lehtësuese për komunitetin Rom, me synim nxitjen e punësimit të tyre si dhe kualifikimin, trainimin dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Kjo politikë ka qenë gjithmonë një prioritet edhe në kuadër të zbatimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare "*Për përmirësimin e kushteve të jetesës së Minoritetit Rom*". Në vitin 2011, në krahasim me vitin 2010, numri i punëkërkuësve të papunë nga ky komunitet është rritur me 10 %, shifër kjo që tregon ndërgjegjësimin e tyre për t'u paraqitur pranë zyrave të punësimit dhe për të përfituar nga shërbimet e ndryshme, që ofrohen veçanërisht për grupet e veçanta, ku bën pjesë edhe komuniteti Rom.

Aktualisht zbatohen 2 programe, që kanë prioritet punësimin e punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta:

1. VKM nr.48 datë 16.01.2008, "*Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë, në vështirësi*". Sipas këtij programi punëdhënësit që punësojnë me kontratë një-vjeçare punëkërkuës të papunë në vështirësi, mund të përfitojnë një financim për një vit, në masën 100% të sigurimeve të detyrueshem shoqërore të kontributit të punëdhënësit, një financim për katër muaj në masën 100% të pagës minimale në shkallë vendi. Në kategorinë e punëkërkuësve të papunë në vështirësi sipas këtij programi, konsiderohen edhe personat nga komuniteti Rom

2. VKM nr.27 datë 11.01.2012, "*Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta*". Ky program synon të nxisë drejtuesit dhe menaxheret shqiptarë të bëjnë përpjekje për të punësuar punëkërkuëse të papuna femra nga grupet e veçanta. Kjo mbështetje konsiston në financimin e masës së detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe katër paga minimale në shkallë vendi, ku në femrat nga grupe të veçanta bëjnë pjesë edhe femrat rome.

Në Urdhërin nr.782 datë 04.04.2006, "*Për tarifatat e sistemit të formimit profesional*", i ndryshuar,

është parashikuar që tarifat e regjistrimit për punëkërkesit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit dhe duan të ndjekin kurse profesionale të formimit profesional të ofruara nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik janë falas për grupet e veçanta, ku përfshihen edhe punëkërkesit e papunë rom.

Sipas të dhënave statistikore të tregut të punës në vite për punëkërkesit e papunë nga komuniteti rom dhe egjiptian, të cilat na janë dërguar, konstatohet se në vitin 2011 numri i punëkërkesve të papunë rom dhe egjiptian të regjistruar në Zyrat Rajonale të Punësimit ka qenë më i lartë se në vitin 2010. Konkretisht në vitin 2010 ka qenë 6970, ndërsa në vitin 2011 ka qenë 7666. Janë trajnuar falas gjatë vitit 2011 pranë qendrave publike 217 persona, nga 62 të trajnuar në vitin 2010.

Konkluzione

Sikundër është theksuar në Progres-Raportin e Shqipërisë për vitin 2012, *“reformimi i Administratës Publike për të garantuar meritokraci, efikasë dhe transparencë mbetet një nga 12 prioritetet kyçe të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Pjesa më e madhe e vendeve të punës ende nuk caktohen përmes një procesi përzgjedhjeje në bazë merite. Kombinuar me zëvendësimet e shpeshta të stafit, ky qendrim paraqet pengesa serioze për ruajtjen e memories institucionale dhe për zhvillimin e një sistemi profesional të administratës publike.”*

Për sa më sipër, mbetet ende punë për të bërë me qëllim:

Ngritjen e kapaciteteve të punonjësve në administratën publike, përgjegjës për ndjekjen e procedurave për largimin nga puna, me qëllim që të realizohet zbatimi i drejtë i procedurave të parashikuara në ligj dhe që u garanton punëmarrësve të drejtat e parashikuara me ligj.

- Hartimin e rekomandimeve për nxitjen politikave të punësimit për shtresat në nevojë.
- Monitorimin në vijimësi të Administratës Publike për ligjshmërinë dhe zbatimin sa më të drejtë të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, *“Për statusin e nëpunësit civil”*.

H. E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore

Vështrim i përgjithshëm

Të drejtat për të përfituar nga fusha e sigurimeve shoqërore janë të drejta, të cilat qytetarët i realizojnë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila në pikën 1 të nenit 52, nënvizon se: *“Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”*. Marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore rregullohen nëpërmjet Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Duke qenë se realizimi i këtyre të drejtave është me rëndësi imediate për qytetarët, ato duhet që të realizohen shpejt, në mënyrë efikase dhe pa zvarritje.

Gjatë vitit 2012, pranë Institucionit tonë janë depozituar dhe trajtuar 282 ankesa. Janë përfunduar 262 ankesa, të cilat kanë rezultuar: 97 ankesa të pabazuara, 1 ankesë jashtë juridiksioni, 27 jashtë kompetence, 127 të zgjidhura në favor të ankuesve, 10 rekomandime të pranuar. Janë në proces shqyrtimi 20 ankesa.

Shtetas të ndryshëm kanë pretenduar për shkelje të të drejtave për shkak të mosllogaritjes së drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë, për masën e ulët të këtyre pensioneve, për datën e lidhjes së pensionit të pleqërisë, zvarritje në lidhjen e pensionit të pleqërisë apo dhe të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore etj.

Një ndër problematikat e trajtuara nga institucioni ynë, ka qenë edhe ajo e një numri ankesash, të shtetasve të cilët gëzojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe pension suplementar. Në ankesat e depozituara me objekt diskriminimin e bërë në rilloaritjen e masës së pensionit rezulton se ankuesit kanë përfutur pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe suplementar me Ligjin nr.8087 datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe Ligjin nr. 8661 datë 18.09.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit". Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", sipas pikës 2 të nenit 29 të këtij ligji është bërë rilloaritja e masës së këtyre pensioneve dhe kjo masë jo vetëm është ulur në mënyrë drastike, por këta persona janë shpallur edhe debitorë ndaj Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Duke e konsideruar këtë ndryshim të masës së pensionit si cënim të të drejtave të tyre të ligjshme të fituara, institucioni ynë, vendosi pranimet e ankesave dhe shqyrtimin e tyre, për të konstatuar problematikën që derivon nga përmbajtja e këtij Ligji. Pas kryerjes së një hetimi të plotë dhe analizës së legjislacionit që rregullon këtë lloj marrdhënie u drejtua Ministria e Financave me rekomandimin për plotësimin e nenit 29 të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë". Gjatë gjithë këtij viti kemi bërë kërkesa të vazhdueshme për t'u informuar lidhur me qëndrimin e mbajtur për këtë rekomandim, por nuk morëm asnjë përgjigje. Së fundmi, në muajin Janar 2013 nga Ministria e Financave na u kthye një përgjigje, ku na informon se kjo problematikë është në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Nga interesimi ynë pranë Gjykatës Kushtetuese, u informuam se lidhur me propozimin tonë për plotësimin e nenit 29 të ligjit të sipërcituar nuk është depozituar asnjë kërkesë. Pranë asaj gjykate Shoqata e Xhenierëve Ushtarakë të Shqipërisë ka depozituar kërkesë me objekt: Shfuqizimin si antikushtetues të Ligjit nr.10367 dt. 23.12.2010 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit Nr.5 dt. 10.11.2010, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.10142 datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM-së.nr.793 dt. 24.09.2010 "Për zbatimin e Ligjit nr.10142 dt. 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar

të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”. Gjykata Kushtetuese ende nuk është shprehur me vendim lidhur me këtë çështjeje.

Në këto kushte do të vazhdojmë t’i kërkojmë Ministrisë së Financave të shprehet dhe të vlerësojë rekomandimin tonë lidhur me të drejtat e mohuara personave që përfitojnë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe atë suplementar.

Një tjetër problematikë vijuese ka qenë edhe ajo e masës së ulët të kategorisë së pensionistëve që kanë përfituar pension te parakohshëm në vitet 1993,1994, problematikë e prezantuar edhe në Raportet Vjetore të Avokatit të Popullit 2010 dhe 2011. Sjellim në vëmendje se Avokati i Popullit në vitin 2009 iu drejtua me rekomandim Ministrit të Financave. Pas kërkesave tona të vazhdueshme, më datë 15.06.2012 jemi informuar se në cilësinë e institucionit propozues dhe hartues të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, kërkesa jonë i ishte dërguar për kompetence Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili kishte ngritur një grup pune dhe përgatitur një projekt-vendim të Këshillit të Ministrave “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve të punonjësve buxhetorë të caktuara gjatë vitit 1993-1994”. Pas shqyrtimit të këtij projekt-vendimi Ministria e Financave na informoi se pas diskutimit dhe shqyrtimit të problemit me institucionet përkatese, rezultoi se projekt-vendimi i paraqitur mbart efekte financiare të konsiderueshme të papërbalueshme për buxhetin e shtetit dhe mbetet për t’u rishqyrtuar në një kohë të dytë.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të vazhdojë ta ndjekë në vazhdimësi këtë problematikë deri sa të mundësohet një zgjidhje e drejtë dhe e përshtatshme.

Analizë e rasteve konkrete

Nga trajtimi i ankesave, janë konstatuar raste të shkeljes së të drejtave të qytetarëve për përfitime të ndryshme nga skema e sigurimeve shoqërore.

-Ankesa me **nr.doculive 201200194**, e cila bën fjalë për mospërfitim të shtesës në masën e pensionit të pleqërisë për dy ish pilotë fluturues në grupin e helikopterëve të Policisë së Shtetit. Pas shqyrtimit të këtij rasti, rezultoi se pavarësisht se Ligji nr.9128 datë 29.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, i ndryshuar, ua njeh të drejtën për të përfituar trajtim të veçantë financiar edhe kategorisë së pilotëve fluturues në grupin e helikopterëve të Policisë së Shtetit, ai nuk gjente zbatim, pasi nuk kishte asnjë akt nënligjor specifik me të cilin të rregullohej situata e kësaj kategorie.

Duke marrë shkas nga kjo ankesë, pas shqyrtimit të këtij rasti, kemi konstatuar se janë shkelur të drejtat e subjekteve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji. Në këto kushte, iu drejtua me rekomandim Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme për: “Nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr.9128 datë 29.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, i ndryshuar. Pas rekomandimit tonë, i cili u pranua si i drejtë dhe i bazuar, nisi procedura e miratimit të Projekt-vendimit “Për procedurat dhe masën e trajtimit të veçantë financiar të pilotëve dhe teknikëve fluturues me helikopter, në pension, në Drejtorinë

e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Gardën e Republikës”, i cili u miratua me VKM nr.477 datë 25.07.2012. Sipas këtij vendimi, dokumentacioni i plotë për përfitimin e trajtimit të veçantë përgatitet nga strukturat e burimeve njerëzore dhe të financës të njësisë buxhetore, i dërgohet për shqyrtim, sipas përkatësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit apo Gardës së Republikës dhe këto ia dërgojnë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku shtetasit përfitues kanë vendbanimin e tyre.

Ankesa me **nr.doculive 201202289**, e një shtetasi nga qyteti i Tiranës, i cili ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për mosllogaritjen e pensionit familjar dhe mospagimin e shpenzimeve gjyqësore. Ankuesi, pasi kishte ndjekur rrugën administrative dhe atë gjyqësore, i ishte drejtuar asaj drejtorie për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, por kishte marrë përgjigje se ato shpenzime nuk i paguheshin. Ndërsa lidhur me kërkesën për rillogaritjen e masës së pensionit familjar nuk kishte marrë asnjë përgjigje.

Institucioni ynë, në analizë të vendimeve gjyqësore, duke i konsideruar të drejta ankesat e këtij shtetasi, i rekomandoi Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë: *“Dhënien e menjëhershme të pagesës së shpenzimeve gjyqësore këtij shtetasi si dhe rillogaritjen e masës së pensionit familjar ”*, rekomandim i cili u pranua. Ankuesit i’u rillogarit pensioni familjar dhe përfitoi shpenzimet gjyqësore.

Gjatë trajtimit të ankesave me **nr. doculive 201200753 dhe 201200751**, të cilat bëjnë fjalë për dy ish punonjës të Shërbimit Informativ të Ushtrisë, me objekt: mosnjohjen e vjetërsisë së punës në sektorë civile për periudhën 2004-2008 pranë Shërbimit Informativ të Ushtrisë, kemi konstatuar se nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë kjo periudhë nuk i ishte marrë parasysh në llogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Në këto kushte drejtuam rekomandimin për: *“Njohjen e vjetërsisë së punës në sektorë civilë për periudhën 01.09.2004 – 01.04.2008, në llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi”*.

Rekomandimi ynë u pranua dhe për të dy shtetasit, pas dërgimit të formularit të pagës mesatare referuese neto dhe vjetërsisë së shërbimit për efekt rillogaritje nga Drejtoria e Shërbimit Informativ të Ushtrisë, iu bë rillogaritja e masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke u përfshirë edhe periudha e punës së bërë në sektorë civilë.

Gjatë trajtimit të ankesës me **nr.doculive 201203383**, e cila bën fjalë për ndërprerje të dhënies së kompensimit të energjisë elektrike në masën e pensionit familjar të një shtetasi me banim në Durrës, pas ndërmjetësimit tonë institucional me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, ankuesit iu rinjoh e drejta e përfitimit të kësaj të drejte dhe emri i tij u vendos në listën e përfituesve të muajit Tetor për dhënien e kompensimit të energjisë elektrike dhe përfitimi iu dha për 9 muaj, për periudhën Shkurt - Tetor 2012.

Ankesa me **nr.doculive 201203602**, e një shtetaseje nga qyteti i Burrelit, e cila ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër për mosllogaritjen e shtesës në masën e pensionit pas njohjes së viteve të punës. Duke e konsideruar të drejtë shqetësimin e kësaj shtetase, ne kërkuam pranë asaj drejtorie të bëhej rillogaritja e masës së pensionit të pleqerisë. Pas ndërhyrjes sonë u bë i mundur rishqyrtimi i pensionit të saj duke e rritur atë me 1/4.

Ankesa me nr.doculive 201200624, e një shtetasi nga qyteti i Tiranës, i cili megjithëse kishte depozituar të gjitha dokumentat ligjore për rillogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, nuk i ishte bërë e mundur kjo rillogaritje. Në kushtet e zvarritjes së kësaj rillogaritjeje, ankuesi kërkoi ndihmën tonë, për më tepër që ai ishte në proces gjyqësor dhe i kërkohet një vërtetim për masën e pensionit të parakohshëm. Pasi konstatuam se ankuesit i ishte shkelur kjo e drejtë, iu drejtua me rekomandim Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për rillogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të këtij shtetasi. Rekomandimi ynë u pranua dhe nga ana e asaj drejtorie u rillogarit pensioni në masën e 19288 lekëve në muaj.

Konkluzione

Për përmirësimin e situatës së ankesave lidhur me përfitimet nga skema e sigurimeve shoqërore, me fokus të vecantë tek pensionet rekomandojmë që të trajtohen me prioritet çështjet e mëposhtme:

-Rishikimin dhe rivlerësimin e masës së pensionit minimal në shkallë vendi, pasi aktualisht është e pamjaftueshme për përballimin e një jetese normale,

- Rivënien në vend të së drejtës së shkelur të pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensioneve suplementare për një kategori të caktuar ushtarakësh të Forcave të Armatosura, punonjës të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm,

-Trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve përgjegjës pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me qëllim shmangjen e gabimeve në llogaritjen e masave të pensionit të pleqërisë.

-Përmirësimin e nenit 62 të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

I. E drejta për arsimim

Vështrim i Përgjithshëm

Në referim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 59 "Objektiva sociale", pika "ç", "Arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë", më tej Ligjit 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Avokati i Popullit ka treguar sensibilitet maksimal në trajtimin e rasteve, të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, ku janë konstatuar veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke cënuar të drejtën e shtetasve për tu arsimuar.

Sot ballafaqohemi më një mjedis shoqëror dhe arsimor gjithnjë e më konkurrues, i cili, përtej problemeve që mund të shfaqen, shtyn studentët t'i drejtohen dijes për të qenë më të suksesshëm. Përpjekjet e viteve të fundit për të pasur një sistem renditjeje/pikëzimi të përbashkët për

universitetet, krahas akreditimit, ishin nismë shumë e dobishme, por ajo duhet të përfshijë të gjitha universitetet shqiptare.

Çdo institucion që është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij sistemi është e nevojshme jo vetëm të njohë situatën dhe nevojat, por edhe të gjejë rrugët dhe përcaktojë politikat e duhura për përmirësim pasi dobësitë e këtij sistemi do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin dhe zhvillimin afatgjatë të të vendit.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve në vitin 2012 ka bërë që në dyert e institucionit të Avokatit të Popullit të paraqiten grupe të interesuara si mësues, nxënës, studentë si dhe komuniteti i prindërve, të gjithë komponentë shumë të rëndësishëm për evidentimin e rasteve të të metave dhe dobësive në sistemin arsimor. Ankesa të trajtuara në total kanë qënë 83, ku rezulton se 54 prej tyre janë të përfunduara, 29 ende në shyrtim, 15 të pabazuara, 4 jashtë juridiksioni, 16 jashtë kompetence, 15 të zgjidhura në favor, 2 rekomandime të pranuar, 2 rekomandime të refuzuara.

Kryesisht problematikat në fushën e arsimit kanë qënë të natyrave të ndryshme ku spikasin marrëdhëniet e punës, pra kërkesa në rritje për punësim e të rinjve që mbarojnë studimet e larta, dhe kërkojnë të sistemohen si mësues në shkolla të ndryshme të vendit, pushime nga puna, transferime për shkak të reformave apo uljes së numrit të nxënësve në shkolla kopshte apo çerdhe (kryesisht në rrethe) etj. Gjithashtu ankesa ka pasur edhe në lidhje me vlerësimet jo korrekte në konkurse të ndryshme -etj.

Analizë e rasteve konkrete

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve shprehet se, të drejtat e njeriut të adoleshentëve duhet të promovohen në mënyrë që ata të gëzojnë standartet më të larta të mundshme shëndetësore. Si pasojë shtetet duhet të garantojnë të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për arsimim në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social ose forma të tjera të diskriminimit. Metodot, kurrikulat dhe burimet arsimore duhet të shërbejnë për zgjerimin e të kuptuarit dhe respektimin e individëve të ndryshëm pavarësisht nga orientimi i tyre seksual ose identiteti gjinor, duke përfshirë edhe nevojat e veçanta të nxënësve, studentëve, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjeve të tyre.

Pas konstatimeve të bëra nga ana jone në çështjen e filluar "Ex officio" me nr.201202398, i rekomanduam Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

- *Përfshirjen në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social, apo trajtim ç'njerëzor lidhur me orientimin seksual ose me identitetin gjinor.*
- *Trajnimin e stafit akademik për moslejimin e çdo forme diskriminimi duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore për shkak të përkatësisë së tyre seksuale.*
- *Ministria e Arsimit dhe Shkencës si përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standarteve në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë,*

(neni 63 i ligjit nr.9741, dt.21.05.2007, i ndryshuarar) të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të menjëherëshme për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke respektuar parimet e sipërcituara.

Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Arsimit dhe Shkencës na informon se rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit, përpunohen me objektivat dhe masat e parashikuara në planin e masave "Politikat e mosdiskriminimit në arsim". Ministria e Arsimit dhe Shkencës është angazhuar që në bashkëpunim me institucionet arsimore të programojë, të zbatojë, dhe të monitorojë realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planit, në dobi të krijimit të një mjedisi të sigurt në shkollë pa fyerje, përjashtim social apo trajtim të papërshtatshëm për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Kjo ministri është e angazhuar në bashkëpunim e dhe me institucionet e arsimit të lartë në vend, të zbatojë realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit të masave "Për mosdiskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor 2012-2014".

Nga ankesat e paraqitura pranë institucionit tonë nga pjesëtarë të komunitetit rom, kemi konstatuar se shumica e tyre ishte e pashkolluar ose vetëm me arsimin fillor, si dhe fëmijët nuk ndiqnin shkollën. Arsimimi i pjesëtarëve të këtij minoriteti, duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat më efikase për integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Niveli i ulët arsimor është problem serioz, që pengon integrimin e këtij komuniteti me shoqërinë. Shumica e fëmijëve rom janë analfabetë, dhe kjo për shkak të vështirësive gjuhësore që kanë fëmijët në klasë të parë (për shkak së këta fëmijë flasin gjuhën rome), të gjëndjes tejet të vështirë ekonomike të familjeve të tyre, të largësisë që kanë me vendbanimet e tyre nga institucionet shkollore si dhe të mentalitetit të gabuar të prindërve.

Për adresimin e këtij problemi u fillua hetim "Ex officio" me nr.201200670. Pas konstatimeve të bëra nga ana jonë i rekomanduam Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës: "Marrjen e masave për ngritjen e klasave përgatitore për arsimin parashkollor, për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve Rom në të gjitha nivelet e arsimit, dhe për bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të ndërgjegjësuar pjesëtarët e komunitetit Rom për moslargimin e fëmijëve të tyre nga ndjekja e shkollës. "Në përgjigje të këtij rekomandimi, informohemi se Ministria e Arsimit ka një plan të detajuar veprimi për përfshirjen me prioritet të fëmijëve romë dhe egjiptian në kopshte dhe shkolla. Eshtë rishikuar dhe buxhetuar "Plani i veprimit për arsimimin e fëmijëve romë" dhe për realizimin e tij, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore raportojnë periodikisht në MASH.

Për të ndjekur në vijimësi problematikat e tyre jetësore, deri në zgjidhjen përfundimtare, ekspertë të Avokatit të Popullit më datë 18.05.2012, kryen një inspektim pranë ambjenteve të ish- Repartit Ushtarak Sharrë, Tiranë, ku janë strehuar 8 familje rome. Gjatë këtij inspektimi, u konstatua se fëmijët e tyre nuk frekuentonin shkollën. Nga intervistat e marra rezultoi se ishin 35 fëmijë, nga të cilët 20 të grupmoshave nga 1 deri në 5 vjeç dhe pjesa tjetër (15 fëmijë) deri në moshën 14 vjeçare. Asnjë prej këtyre fëmijëve nuk ishin të regjistruar në shkolla, për të ndjekur arsimin 9-vjeçar. Për këtë arsye i drejtuam një Rekomandim Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë dhe për dijeni Ministrit të Arsimit dhe Shkencës : "Për marrjen e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të komunitetit Rom, të vendosur pranë ish- repartit Ushtarak, Sharrë,

Tiranë, në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit aktual të tyre". Në përgjigje të këtij rekomandimi vihem në dijeni se MASH, në zbatim të objektivave për përmirësimin e situatës arsimore të minoritetit rom si dhe të politikave të saj, ndër të tjera ka krijuar të gjitha hapësirat ligjore për të mundësuar jo vetëm regjistrimin e fëmijëve të këtij komuniteti, por edhe ndjekjen hap pas hapi të frekuentimit dhe përparimit të tyre në shkollë.

Nisur nga një kronikë e shfaqur në emisionin "Fiks Fare" në Top Channel, të një konflikti midis disa nxënësve dhe mësuesve, Avokati i Popullit, në datën 14-16.02.2012 kreu një inspektim në Institutin e Nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi", Tiranë. Në përbërje të grupit të inspektimit u përfshi edhe një eksperte psikologe, e cila kishte si qëllim të paraqesë gjetjet nga vlerësimi psikologjik i kryer gjatë këtij inspektimi. Vlerësimi psikologjik u bazua në kontaktet e marra përkatësisht me Drejtorin, Zv/drejtoreshën, kujdestarin, psikologjen, mësueset e përmendura në videon e shfaqur në emision, si dhe me nxënësit e klasës ku ishin marrë prononcimet. Si materiale mbështetëse u shfrytëzuan materiali video i përcjellë në media, relacionet e shkruara të përgatitura nga drejtori e psikologjia, si dhe fotokopjet e ditareve të mbajtura nga zv/drejtoresha mbi konfliktet midis nxënësve dhe mësuesve, kujdestarit e drejtorit. Nga vlerësimi, rezultoi se ndaj nxënësve që kanë ngritur shqetësimin në videon e paraqitur në media, ka patur trajtim neglizhues dhe është përdorur dhunë episodike fizike e psikologjike me qëllim kërcënimin, friksimin dhe manipulimin e tyre. *Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201200670. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone i është rekomanduar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:*

- *Marrja e masave për rikonstrukcionin e pjesshëm të godinës që shërben si konvikt duke evituar lagështirën në shumë prej dhomave të fjetjes si dhe të kaldajës që shërben për ngrohjen e saj. Rinovimin e paisjeve hotelerike si dollape dhe komodina për dhomat e fjetjes pasi janë shumë të amortizuara. Shtimin në organikë të kujdestarëve, e domosdoshme kjo për këtë kategori fëmijësh dhe kujdesin ndaj tyre. Kalimin e palestrës së Fakultetit të Mjekësisë që gjendet në ambientet e brendshme të institutit në përdorim të këtij të fundit.*
- *Trajnimitin e stafit pedagogjik të Institutit mbi arsyet dhe faktorët themelorë që motivojnë dhunën ndaj fëmijëve, me qëllim ndërjegjësimin mbi qendrimin e ligjit, e mbi të drejtat e fëmijëve për paprekshmëri fizike dhe psikike. Trajnimitin e stafit pedagogjik të Institutit me shprehitë e mësimdhënies së mirë dhe mënyrat alternative të disiplinimit të fëmijëve. Ngritjen e një sistemi për raportimin, regjistrimin dhe trajtimin e të gjitha rasteve që përfshijnë dhunën në institucion.*
- *Trajnimitin e psikologes së Institutit mbi menaxhimin e stresit e të konfliktit tek stafi dhe nxënësit, si dhe mbi shërbimin e përshtatshëm psikologjik që duhet ofruar. Krijimin e një zyre të shërbimit psikologjik në institut.*

Në përgjigje të këtij rekomandimi u vumë në dijeni se MASH do të marrë të gjitha masat për realizimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit me nr doc nr.201204016 ka paraqitur një ankesë shtetasi Haki Veza, prind i njerit prej nxënësve të shkollës 9 vjeçare "Haki Dardani", Tiranë, i cili shpjegon se që prej 5 vitesh nxënësit dhe prindërit e tjerë si ai, janë të shqetësuar për dhunën që ushtrohet nga një nxënës me probleme nervore, i cili ushtron dhunë ndaj nxënësve

të tjerë të klasës. Jo vetëm kaq por ai është shkaktar i prishjes së oreëve të mesimit. Në muajin Dhjetor dy javë nxënësit braktisën shkollën në shenjë proteste për përjashtimin nga shkolla të këtij nxënësi të dhunshëm dhe problematik. Ne ju drejtuam Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si dhe Drejtorisë Rajonale Arsimore, Tiranë për zgjidhjen sa më parë të kësaj situate e cila rrezikonte jetën e fëmijëve të tjerë në këtë shkollë.

Në përgjigje të këtij problemi autoritetet arsimore sqaruan se: "Ky rast dhe fenomeni është i njohur për autoritetet rajonale të kësaj drejtorie dhe se nga ana e tyre janë konsumuar të gjitha rrugët e mundshme ligjore dhe personale për zgjidhjen e saj, por pa rezultat pasi në baze të ligjit "Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH" arsimi 9-vjeçar është një arsim i detyrueshëm dhe si i tillë nxënësit e shkollave 9-vjeçare nuk mund të përjashtohen nga shkolla. Drejtoria nga ana e saj ka rezauruar të gjitha rrugët e mundshme ligjore në polici, prokurori, Ministri, familje e nxënësit por pa zgjidhje."

Menduar ta veçonim këtë rast pasi ishte specifik në trajtimin e tij. Nga njëra anë ligji e parashikon arsimin 9-vjeçar të detyrueshëm duke patur tendencës edhe të integritit të personave me probleme të ndryshme mendore dhe fizike në komunitet, por nga ana tjetër nuk ka parashikuar sanksione kur problematika specifike që rrezikojnë jetën e fëmijëve të tjerë të gjejnë zgjidhje me ngritje të qëndrave të specializuara të cilat mungojnë në Shqipëri.

Konkluzione

Avokati i Popullit vlerëson se tekstet e reja shkollore, metodat e mësimdhënies, përmirësimi i legjislacionit, hartimi i Planeve Strategjike kanë ndikuar në ngritjen e shërbimeve arsimore, kreditimin e këtyre institucioneve etj. Liberalizimi i universitetit është për tu vlerësuar por duhet treguar kujdes në qasje të barabarta për grupet vulnerabël dhe pakicat e ndryshme (romët, egjiptianët et) që frekuentojnë këto auditore. Këto problematika kërkojnë monitorim të mekanizmave të ngarkuar me ligj për zbatimin e standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, një vëmendje më e madhe duhet të tregohet ndaj bazës materiale dhe infrastrukturës fizike me qëllim përmirësimin e cilësisë së përgjithshme. Ndërkaq, sa u përket teksteve shkollore dhe mjeteve të tjera didaktike apo edhe kualifikimit bashkëkohor të stafit mësimdhënës duhet të përfshihen në mënyrë periodike dhe koherente në trajnime dhe programe të ndryshme aftësuese me qëllim futjen e praktikave më të mira si brënda shkollës ashtu edhe ndërmjet shkollës dhe komunitetit të gjërë.

J. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim

Vështrim i përgjithshëm

Sigurisht që një nga të drejtat e njeriut të konsideruara mjaft të rëndësishme e cila në një plan kompleks merr rëndësi të veçantë në kuadër të së drejtës së jetës, është e drejta e individit për strehim. Problematika në fjalë vazhdon të mbetet ende një problem i mprehtë, serioz dhe mjaft shqetësues i shoqërisë shqiptare. E drejta për strehim është shprehur në formën e një objektivit social për t'u përmbushur, neni 59, kreu V, në Kushtetutën e Shqipërisë:

1- a-... shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe me mjetet që disponon synon punësimin në kushte të përshatshme të të gjithë personave të aftë për punë...

b-...plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim. etj,"

2- Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohet drejtpërdrejtë në gjykatë.", si dhe ligji nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e zonave urbane", e në zbatim të tij V.K.M. nr. 814, datë 03.12.2004, "Për caktimin e normave të strehimit", si dhe vendimi "Për dokumentat dhe procedurat që duhet të ndjekin përfituesit nga ky ligj.",

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 ka shqyrtuar 265 raste me këtë problematikë, nga të cilat 110 janë mbyllur së shqyrtuari jashtë juridiksionit dhe kompetencës, si dhe 141 të tilla të mbyllura në favor të ankuesve, ndërkohë që vijojnë të jenë në shqyrtim e sipër 21 raste të tjera të paraqitura. Gjithashtu janë hartuar e përcjellë pranë organeve përkatëse 12 Rekomandime, është investuar në problematika të veçanta me objekt mospërfitimin e aplikantëve nga programet sociale të strehimit.

Analizë e rasteve konkrete

Gjendja e rëndë e komunitetit Rom në lidhje me strehimin si dhe mospërfshirja në skemën e ndarjes së banesave për të pastrehët e këtij komuniteti është një fakt publik. Strehimi për disa javë në ambientet e Institucionit të Avokatit të Popullit të mëse 65 anëtarëve të komunitetit Rom, në fillim të vitit 2012, vuri në vëmendjen e opinionit të gjerë problemin e pazgjidhur të strehimit të kësaj kategorie shtetasish, të cilët ndodhen në kushte tejet të vështira banimi, me hapësira të pamjaftueshme, e në ambiente shpesh të përshatura e jo të ndërtuara për këtë qëllim, gjë që vë në diskutim edhe vetë ekzistenca fizike e tyre.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga shtetas të këtij komuniteti dhe jo vetëm, Avokati i Popullit i ka orientuar të interesuarit të regjistruhen pranë bashkive respektive për përfitimin e statusit të **të pastrehit, me qëllim që sipas kapaciteteve financiare që disponohen prej institucioneve të administratës publike qendrore dhe vendore, të mund të përfitohet nga fondi i banesave sociale apo programet e ndryshme që aplikojnë organet e pushtetit vendor.** Në këtë kontekst, duhet theksuar se megjithëse legjislacioni në fushën e strehimit synon të mbrojë shtetas në nevojë, parashikon kritere për përfitimin e strehimit të cilat përgjithësisht janë të vështira për tu përmbushur prej të pastrehëve, vecanërisht kriteret që përcaktojnë një nivel të caktuar të ardhurash financiare për të garantuar shlyerjen e kredisë së banesës. Lidhur me këtë fakt, mund të thuhet se përgjatë takimeve të zhvilluara në qendra urbane me ankues të ndryshëm, në pjesën më të madhe të rasteve një asistencë të tillë e kërkojnë pikërisht kategori shtetasish (ndër më kryesoret përfshihet pikërisht komuniteti rom) që nuk kanë mundësi të sigurojnë të ardhura në nivelin e kërkuar për të **garantuar kredimarrjen e për rrjedhojë kjo shtresë, më nevojtarja, mbetet "de facto" pa mundësi përfitimi.**

Për sa më sipër, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Punëve Publike dhe Transportit, z. Sokol Olldashi ndryshimin e ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane", i ndryshuarj, duke kërkuar në mënyrë specifike

parashikimin e dispozitave të veçanta për komunitetin rom, dispozita që do të mundësonin përfshirjen e tyre reale në skemën e përfitimeve pasi situata e tyre e vecantë ekonomike sociale e kulturore kërkon një tajtim të vecantë, “diskrimini pozitiv” me një kohëzgjatje të caktuar, jo të përhershme. Në përgjigje të këtij Rekomandimi, Ministri na informoi se ligji parashikon dispozita të njëjta për të gjithë qytetarët, pa diskriminuar kategori ose grupe të veçanta të shoqërisë dhe në mendimin e tij romët gëzojnë të njëjtat shanse dhe të njëjtat mundësi për të përfituar nga ndihma që ofron shteti. Pavarësisht opinionit të mësipërm, institucioni i Avokatit të Popullit mendon se mosdiskriminimi në ligj nuk garanton gëzim të njëjtë të të drejtave prej të gjithë shtetasve pasi për kategoritë dhe grupet më në nevojë, sic është pa dyshim komuniteti rom, është “ngjarje e sigurt” mospërmbushja e kriterëve, qoftë edhe minimale, që përcakton ligji. Për këtë shkak ritheksojmë bindjen tonë se është domosdoshmëri që në kushtet kur një kategori/grup jaën dukshëm të pafavorizuar, kjo kategori duhet të trajtohet si një kategori prioritare.

Gjithashtu, në vijim të impenjimit institucional të Avokatit të Popullit sa i përket zgjidhjes përfundimtare të problemit të strehimit të disa familjeve të komunitetit rom në ambientet e Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat-Tiranë, materializuar ndër të tjera me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 02.02.2012, nga ana jonë është ndjekur në vazhdimësi problematika e sistemit brenda standarteve të ambienteve në fjalë, ku përveç inspektimeve të herë pas herëshme i është rekomanduar Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, plotësimi i kushteve të përshtatëshme për jetesë në këto ambiente, ku pritej të strehoheshin disa familje të komunitetit Rom. Duke qenë se nuk pati asnjë qëndrim zyrtar lidhur me rekomandimin tonë, me shkresën e datës 10.06.2012, kemi kërkuar nga ana e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që të shprehej lidhur me masat e ndërmarra, por sërish nuk kemi patur një përgjigje zyrtare.

Më pas, duke u nisur nga ankesat e vazhdueshme të familjeve që duhet të strehoheshin pranë këtyre ambienteve, me shkresën e datës 04.09.2012, i kemi rekomanduar sërish Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta zgjidhjen përfundimtare të çështjes së përmirësimit të kushteve të jetesës së familjeve Rome në ambientet e Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat-Tiranë, duke e konsideruar si një çështje shumë emergjente, me qëllim integrimin e tyre në jetën sociale të vendit. Institucioni i Avokatit të Popullit sërish nuk mori një përgjigje zyrtare nga ana e kësaj Ministrie, pavarësisht se me shkresën e datës 16.10.2012, kërkuam që të mbahej një qëndrim zyrtar ndaj Rekomandimit tonë.

Në datën 09.01.2013, një grup ekspertësh të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë inspektuar sërish gjendjen e ambienteve të këtij vend qëndrimi, gjatë të cilit janë konstatuar të njëjtat mangësi dhe problematikat e lartpërmendura, për të cilat ne kishim rekomanduar në vazhdimësi marrjen e masave konkrete, në zbatim edhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 02.02.2012. Po ashtu, u konstatua se nuk ishin kryer investimet e duhura, përveç furnizimit me ujë, dhe se kushtet e banimit ishin shumë të rënda, duke marrë parasysh edhe temperaturat e ulëta të sezonit. Në funksion të zgjidhjes përfundimtare të sa më sipër, Avokati i Popullit i është drejtuar Kryeministrit për ushtrimin e autoritetit të tij institucional, me qëllim marrjen e masave të menjëhershme dhe të përshtatshme nga autoritetet shtetërore për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve në këtë vend qëndrim.

Në vijim të këtij rekomandimi, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në dt. 18.02.2013 na bën me dije se ka parashikuar fondin prej 8,000,000 lekë për ndërhyrje

fillestare, i cili do të pasohet nga një fond prej 22,000,000 lekësh të parashikuara në fushat e investimit për të kryer rikonstrukcionin e këtyre ambjenteve në vazhdimësi.

-Probematikat e dala pas nxjerrjes dhe zbatimit të Aktit Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 1.08.2012, "Për lirimimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar".

Numri i ankesave të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit nga familjet e pastreha, të cilat banojnë në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar, ka njohur një rritje progresive menjëherë mbas nxjerrjes së Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave me nr. 3, datë 1.08.2012, "Për lirimimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar" dhe veçanërisht pas miratimit nga Kuvendi të aktit normativ, për shkak të pasojave që ka sjellë zbatimi i tij.

Avokati i Popullit vlerëson se kthimi i pronës pronarëve të ligjshëm si dhe krijimi i të gjitha kushteve që prona të gëzohet në mënyrë të plotë dhe të qetë është dhe mbetet nga njëra anë një detyrim kushtetues dhe ligjor i qeversisë dhe na ana tjetër detyrim moral e ligjor i të gjithë shoqërisë dhe shtetasve.

Pavarësisht qëllimit pozitiv për të rregulluar një padrejtësi shoqërore, zgjidhja e kësaj problematike do të duhej të ishte e plotë dhe përfundimtare duke marrë parasysh jo vetëm rivendosjen e të drejtave të mohuara të shtresës së ish pronarëve por edhe trajtim të njëjtë dhe të barabartë, në mbështetje me Kushtetutën dhe ligjet, të atyre qytetarëve të cilët zbatimi i këtij Akti Normativ duhej tu garantonte me të njëjtat kushte si qytetarëve të tjerë më parë, të drejtën e strehimit.

Numri i ankesave dhe problematikat që kanë dalë në momentin e miratimit dhe menjëherë pas fillimit të zbatimit të këtij akti kanë rikonfirmuar edhe njëherë vlerësimin tonë se vendimmarrje të tilla të rëndësishme duhet në do rast të paraprihen nga studime të thelluara, serioze dhe transparente të cilat do të duhej të garantonin se zgjidhjet e propozuara zbusin konfliktet sociale të shoqërisë pa rrezikuar të krijojnë të tjera apo të shtojnë problematikat ekzistuese. .

Akti Normativ i Këshillit të Ministrave nr.3 datë 1.08.2012, pasi rregullon në detaje pjesën e procedurave për kthimin e pronave si dhe përcakton organet përgjegjëse për ndjekjen e tyre, parashikon edhe mënyrën e trajtimit me strehim, të qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar.

Konkretisht, akti normativ ofron këto mënyra me anë të të cilave, do të realizohet strehimi i këtyre subjekteve:

1. Kreditim nga ana e Bankës Kombëtare Tregtare, në kushtet deri në 30 vjet, me 0% interes.
2. Trajtim me strehim në banesa sociale nga këshillat bashkiakë, duke pasur përparësi në programet e banesave sociale për qira.

3. Për persona të moshuar, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, kur nuk dëshirojnë, me deklaram me shkrim, sistemim me qira apo, sipas verifikimit të kryer, janë të paaftë të kujdesen për vete, bëhet sistemimi me strehimin e tyre në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta.

Për të vlerësuar re efektivitetin e aplikimi të dispozitave të këtij akti normativ dhe mundësitë reale të përfitimit të strehimit prej personat e prekur , i jemi drejtuar përkatësisht:

- Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe Ministrit të Financave, për dhënien e informacionit zyrtar, mbi mundësitë e trajtimit të këtyre familjeve me kredi 0% interes, si dhe për trajtimin e tyre me banesa sociale. Është kërkuar gjithashtu informacion, në lidhje me mjaftueshmërinë e fondeve të parashikuara për kredi, pas rialokimit në buxhetet vendore, për përballimin e gjendjes së krijuar.

- Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për dhënien e informacionit, mbi mundësitë e sistemimit me strehim të personave të moshuar, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta. Informacioni është kërkuar mbi numrin e këtyre qëndrave, kapacitetin e tyre dhe kapacitetin aktual pritës të tyre.

- Entit Kombëtar të Banesave, për dhënien e informacionit për çështjet, sa më poshtë vijon:

1. Cili është numri i qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar, emrat e të cilëve i janë dërguar nga ana juaj, BKT-së për kreditim, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 1, të aktit normativ?
2. Cili është numri i qytetarëve të pastrehë, të listuar nga EKB dhe dërguar në BKT, deri më 5 Shtator 2012, sipas përcaktimit të bërë në nenin 2, të aktit normativ?
3. Në sa raste ju janë dërguar njoftime respektive nga ana e pronarit të pronës apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ligjor, për moslirimin dhe mosdorëzimin e banesës nga qytetarët përdorues të saj?
4. Sa është numri i urdhërave të ekzekutimit të lëshuar nga ana e Gjykatës kompetente, bazuar mbi kërkesën tuaj për këtë qëllim?
5. Në sa raste ka ndodhur deri tani, verifikimi i nevojshëm sipas kushteve të parashikuara në nenin 6, të aktit normativ? Si kanë përfunduar këto verifikime?

Po kështu, i jemi drejtuar Bashkisë Durrës dhe Bashkisë Tiranë, me kërkesa për shpjegime, lidhur me mundësitë e tyre reale për të trajtuar kërkesat e shumta të qiramarrësve në banesat e ish pronarëve, me banesa sociale.

Në përgjigjen e dhënë me shkresën nr.2619/3 datë 11.01.2013, nga ana e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me informacion e kërkuar, ndër të tjera

sqarohet se, në kuadër të procesit të decentralizimit, shërbimet e përkujdesit shoqëror kanë kaluar në varësi të qeverisjes vendore. Në bazë të legjislacionit të nxjerrë për këtë qëllim, brenda dy viteve janë transferuar 19 institucione rezidenciale shërbimesh, nga të cilat katër qendra publike të shërbimeve rezidenciale për të moshuarit (Kavajë, Gjirokastër, Fier, Shkodër).

Ndërkohë, për plotësimin e të gjithë nevojave në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, kjo ministri konfirmon se, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror, administron Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë, me një kapacitet 40 përfituesish, ku aktualisht janë sistemuar 32 përfitues.

Enti Kombëtar i Banesave, në përgjigjen e dhënë me shkresën nr.5352/1 datë 20.12.2012, sqaron rolin që ai ka si organ në zbatim të përcaktimeve të bëra në aktin normativ, të sipërcituar, duke bashkëngjitur disa tabela ku jepen të dhëna mbi informacionin e kërkuar nga ana jonë. Më konkretisht, EKB-ja ka dërguar në BKT, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 1, të aktit normativ, 1066 emra dhe sipas përcaktimeve të bëra në nenin 2, të aktit normativ, 3295 emra. Pra, një total prej 4381 emrash.

Ndërkohë, si total kërkesash pronarësh, të dorëzuara në EKB, për periudhën kohore 5.11.2012-19.12.2012, rezultojnë 543 kërkesa. Numri total i kërkesave të EKB-së, për lëshim urdhëri ekzekutimi në gjykatat respektive ka rezultuar 370, ndërsa numri i urdhërave të ekzekutimit të tërhequra nga EKB-ja është 213. Ende sot e kësaj dite nuk është dërguar informacioni i kërkuar nga ana e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe Ministrisë të Financave. Informacioni i kërkuar nuk është dërguar ende, as nga Bashkia Durrës dhe as nga Bashkia Tiranë.

Sipas ankesave të paraqitura prej familjeve qiramarrëse në pronat e ish pronarëve rezulton se:

- Në gjendjen e tyre aktuale edhe pse kanë aplikuar pranë BKT-së për të marrë kredi me 0% interes, sikurse parashikon akti normativ, nuk kanë mundur t'a përfitojnë atë, pasi sipas bankës, nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e kësaj kredie.
- Megjithëse kanë aplikuar për trajtim me banesë sociale, jo vetëm nuk kanë përfituar një trajtim të tillë, por edhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga ana e bashkive respektive, për këtë problem.
- Një pjesë jo e vogël e këtyre familjeve qiramarrëse, kanë në përbërje të tyre, individë, shpesh herë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, individë të papunë, individë pensionistë pa asnjë përkrahje tjetër, apo edhe ish të dënuar politikë të regjimit komunist, pa përjastuar familjet ku të ardhurat që merren në krahasim me numrin e pjestarëve përbërës, janë minimale

Për më tepër, rezulton se bashki të caktuara (sikurse Bashkia Kuçovë), kanë kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit me kërkesa konkrete, për të mundur trajtimin me banesa, apo kredi të këtyre familjeve, pasi ato vetë nuk disponojnë mundësi financiare, apo banesa sociale, për t'i trajtuar familjet përkatëse qiramarrëse sipas parashikimeve të aktit normativ.

Duke bashkëpunuar edhe me shoqërinë civile, për të arritur në një konkluzion sa më real për gjendjen e krijuar dhe rrugët e mundshme të zgjidhjes së saj, së fundmi, jemi vënë në dijeni për korrespondencën që Qendra “Res Publica”, ka patur me një sërë bashkish në vend, për këtë problem. Sipas kësaj korrespondence, rezulton se:

Bashkia Berat ka konfirmuar me shkresën nr.2001/1 datë 9.11.2012 se, nuk ka përfituar asnjë fond të posaçëm nga buxheti i shtetit, për zbatimin e efekteve të Aktit Normativ nr.3 datë 1.08.2012. Nuk ka planifikim për ndërtim banesash, pasi ka mungesë fondesh dhe se, aktualisht kjo bashki nuk disponon asnjë apartament të lirë.

Bashkia Shijak, me shkresën nr.876/1 datë 7.11.2012, konfirmon se, nuk ka përfituar asnjë fond të posaçëm nga buxheti i shtetit, për zbatimin e efekteve të Aktit Normativ nr.3 datë 1.08.2012. Nuk ka planifikim për ndërtim banesash, pasi ka mungesë fondesh dhe se, aktualisht kjo bashki disponon vetëm 2 banesa sociale, ndërkohë që numri i qytetarëve në pritje për të përfituar një banesë të tillë është 295, pa përfshirë këtu numrin e qiramarrësve në banesa ish pronarësh.

Bashkia Çorovodë, me shkresën nr.1072 datë 1.11.2012, konfirmon se, nuk ka përfituar asnjë fond të posaçëm nga buxheti i shtetit, për zbatimin e efekteve të Aktit Normativ nr.3 datë 1.08.2012. Nuk ka planifikim për ndërtim banesash, pasi ka mungesë fondesh dhe se, aktualisht kjo bashki nuk disponon banesa sociale.

Bashkia Vlorë, me shkresën nr.2929 datë 5.11.2012, konfirmon se, nuk ka përfituar asnjë fond të posaçëm nga buxheti i shtetit, për zbatimin e efekteve të Aktit Normativ nr.3 datë 1.08.2012. Edhe pse është hartuar një program 10 vjeçar për strehimin social, nuk ka planifikim për ndërtim banesash, pasi ka mungesë fondesh dhe si shkak tjetër citohet mosregjistrimi i pronave të Bashkisë. Aktualisht kjo bashki nuk disponon banesa sociale për t'i vënë në dispozicion të kësaj kategorie të pastrehësh.

Bashkia Pogradec, me shkresën nr.756/1 datë 31.10.2012, konfirmon se, nuk ka përfituar asnjë fond të posaçëm nga buxheti i shtetit, për zbatimin e efekteve të Aktit Normativ nr.3 datë 1.08.2012. Ka mungesë fondesh për ndërtim dhe se, nuk ka në dispozicion banesa sociale.

Bashkia Gjirokastrë, me shkresën nr.2503/1 datë 31.10.2012, konfirmon se, Bashkia Gjirokastrë nuk ka përfituar fonde për ndërtim banesash për këto familje, si dhe nuk ka planifikuar fonde në buxhetin e saj, për strehimin e familjeve të kësaj kategorie.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, bazuar në informacionin e dërguar prej institucioneve shtetërore si dhe vlerësimet e vetë organeve të qeverisjes vendore, pavarësisht se akti normativ synon trajtimin e qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar, me kredi me 0% interes, apo me banesa sociale që do t'u jepen nga qeverisja vendore, si dhe sistemimi i të moshuarve, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta aplikimi në kushtet aktuale i këtyre objektivave do të jetë shumë i vështirë. Aq më tepër, evidentohet si e pareaalizueshme, mënyra e sistemimit të të moshuarve, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta, sipas shifrave që zyrtarisht jepen për këtë qëllim nga ministria e linjës.

Për sa më sipër, në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit i ka rekomanduar me shkresën nr.K1/B36-7 datë 15.02.2013, Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Sali Berisha, realizimin e inisiativës legjislative, për ndryshimin dhe përmirësimin e bazës ligjore, që do të mundësojë trajtimin me strehim në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, të individëve, apo familjeve qiramarrëse, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara.

Ankesa me **nr. doc. 20120062**, shqyrtuar me iniciativë duke marrë shkas nga situata e krijuara nga largimi i vendstrehimit të përkohshëm të disa prej familjeve Rome, përkatesisht në Babrru dhe në Tiranë, kushtet ekstreme të jetesës të vështirësuara edhe më shumë nga stina e dimrit, Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua me rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile, si dhe Kryetarëve të Bashkive dhe Kryetarëve të Këshillave Bashkiakë në të gjithë vendin, me objekt "Për marrjen e të gjitha masave të mundshme organizative për përgatitjen e vend-strehimeve apo vend-qëndrimeve provizore për grupe të tilla në nevojë emergjente, si pjestarë të komunitetit Rom, personave endacakë apo të pastrehë dhe këdo tjetër që kërkon ndihmë nga organet e pushtetit vendor, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre, veçanërisht të fëmijëve".

Ankesa me **nr. doc. 20120623**, është paraqitur nga shtetasi T.M. banues në fshatin Sheshaj, me anë të së cilës shpreh pretendimin e tij ndaj Bashkisë Rrëshen për mosveprim ndaj kërkesave të tij lidhur me zgjidhjen e problemit të strehimit. Konkretisht, ankuesi shprehej se në Janar të vitit 2004, për shkak të fatkeqësive natyrore shtëpia e tij u bë e pabanueshme. Në këtë moment ai është strehuar tek të afërmit e tij, ndërkohë që nga ana e pushtetit lokal, është identifikuar problemi duke hartuar dhe dokumentacionin përkatës, për t'u trajtuar më pas nga fondet e emergjencës, por pa u realizuar një gjë e tillë tashmë prej disa vitesh. Për efekt të shqyrtimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit në datë 23.02.2012, ka kërkuar shpjegime nga Bashkia Rrëshen dhe Prefektura e Qarkut Lezhë, mbi pretendimet e paraqitura. Në përgjigje Kryetari i Bashkisë Rrëshen vinte në dijeni se, Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 10, datë 02.04.2004 kishte vendosur t'i propozonte Këshillit të Qarkut Lezhë, përfitimin nga ana e ankuesit të një ndihme financiare në masën 40-50% të shumës së dëmit. Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën e tij me nr. 290/1 prot. datë 01.03.2012, theksonte se në kuadër të vendimit të Këshillit Bashkiak që ankuesit t'i akordohej një ndihmë shtetërore në masen 40-50 % të dëmit të shkaktuar, kishin përcjellë dosjen pranë Drejtorisë së Emergjencave Civile. Duke marrë shkas nga nisma e Prefektit të Qarkut Lezhë për të përcjellë dosjen në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, nga ana e Avokatit të Popullit, me qëllim të shmangies së zvarritjeve të mëtejshme të shqyrtimit të procedurave për dhënien e ndihmës financiare për riparimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e ankuesit, i rekomandua Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, duke vënë në dijeni edhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, shqyrtimin sa më parë të kësaj praktike.

Ankesa me **nr. doc. 201200670**, dërguar nga ana e anëtarëve të Komunitetit Rom, lidhur me mos zgjidhjen e problemit të strehimit, ku ankuesit shpreheshin se së bashku me familjet e tyre, jetonin në baraka, pra në kushte tejet të vështira jetese, pa plotësuar asnjë nga nevojat minimale të jetës së përditshme. Ankuesit pretendonin se megjithëse kishin kaluar mbi 15 apo 20 vjet që jetonin në Tiranë, nuk kishin mundur dot të zgjidhin problemin e strehimit të tyre, pavarësisht kërkesave të herë pas herëshme dhe dorëzimit të dokumentacionit pranë Bashkisë Tiranë. Nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, në funksion të shqyrtimit të kësaj çështje, u kërkuar shpjegime nga Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social pranë Bashkisë Tiranë,

në përgjigje të së cilës, drejtuesi i strukturës në fjalë sqaronte, se nga të dhënat që dispononte Bashkia Tiranë, rezultonte si më poshtë:

- 50 ankues nuk figuronin të regjistruar në programin elektronik si të pastrehë. Pra kjo kategori e ankuesve duhet të drejtohej pranë njësisë vendore ku ishin të regjistruar, me qëllim plotësimin e formularit të strehimit.
- 20 ankues kishin plotësuar formularin e strehimit pranë njërive bashkiake dhe duhet të vijonin me fazën e dytë të aplikimit, që lidhej me dorëzimin e dokumentacionit sipas programit të përzgjedhur.
- 31 ankues kishin aplikuar për fazën e dytë, e më pas referuar legjislacionit në fuqi, do të ishte Këshilli Bashkiak në cilësinë e organit vendimarrës, i cili do të vendoste për aplikantët fitues. Pas kësaj korrespondence, kemi kthyer përgjigjet përkatëse sipas grupeve të sipërcituara, duke i orientuar ankuesit lidhur me rrugën ligjore që duhet të ndiqnin.

Ankesa me **nr. doc. 201200999**, e dërguar nga shtetasi M.A. banues në fshatin Pezë-Helmës, ku paraqitej problematika e dëmtimit të shtëpisë së tij nga reshjet e fillim vitit 2011. Ankuesi ndër të tjera shprehte shqetësimin e tij për mospërfitim nga fondet e emergjencës për riparimin e dëmeve të shkaktuara në shtëpinë e tij, duke pretenduar se i mohohet një e drejtë që i takon sipas akteve ligjore në fuqi. Lidhur me çështjen në fjalë, është dërguar dokumentacioni respektiv nga ana e Komunës Ndroq për dëmet e shkaktuara nga shëmbjet e dherave gjatë reshjeve. Në funksion të shqyrtimit të kësaj çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, për të kërkuar shpjegime dhe informacion mbi trajtimin e kësaj çështje, por nuk kemi patur asnjë reagim zyrtar nga ana e tyre, ndërkohë që nga ana e Komunës Ndroq, është dërguar dosja e plotë dhe dokumentacioni respektiv për dëmet e shkaktuara nga shëmbjet e dherave gjatë reshjeve. Në këto kushte, nga ana e Avokatit të Popullit, me qëllim të shmangies së zvarritjeve të mëtejshme të shqyrtimit të procedurave për dhënien e ndihmës financiare për riparimin e dëmeve të shkaktuara ndaj banesës së ankuesit, me shkresën e datë 22.05.2012, i ka Rekomanduar Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, “Për dijeni” Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, me qëllim shqyrtimin sa më parë të çështjes në fjalë, si dhe mbajtjen e një qëndrimi zyrtar lidhur me pretendimet e parashtruara në shkresat tona zyrtare. Në përgjigje të këtij Rekomandimi, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, na bëhej me dije predispozicioni për asistimin me ndihmë financiare në favor të ankuesit gjatë vitit 2012, në varësi të fondeve që disponoheshin.

Lidhur me ankesën me **nr. doc. 20122422**, shqyrtuar me iniciativë nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, është marrë shkas nga njoftimet në mediat e shkruara për fatkeqësinë e ndodhur në familjen Z. të fshatit Xathë në rrethin e Pukës, si pasojë e marrjes flakë të shtëpisë ku kjo familje jetonte prej vitesh. Bazuar në sa më sipër, si dhe në ushtrim të kompetencave që Avokatit të Popullit i jepen referuar dispozitave përkatëse të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kjo çështje është shqyrtuar me iniciativë, me qëllim që të ndiqeshin procedurat ligjore nga ana e organeve të ngarkuara, gjendjen e një zgjidhje të përshtatshme në një kohë sa më të shpejtë të ishte e mundur. Lidhur me rastin e parashtruar, Avokati i Popullit në funksion të nevojës urgjente për angazhim të përbashkët të strukturave

shtëterore për hartimin sa më parë të dokumentacionit ligjor dhe akordimit të një ndihme emergjente për familjen Z., me shkresën e datës 04.06.2012, ka Rekomanduar hartimin e dokumentacionit ligjor dhe akordimin e ndihmës emergjente për familjen Z. në fshatin Xathë, të rrethit Pukë, drejtuar Kryetarit të Komunës Blerim, Pukë, Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Prefektit të Qarkut Shkodër.

Konkluzione

Vazhdon të mbetet një problematikë shumë e mprehtë sociale dhe ligjore përmbushja e kërkesave të strehimit të shtetasve dhe vecanërisht e grupeve në nevojë. Është e domosdoshme që vecanërisht për komunitetin Rom për shkak të pamundësisë për të përfituar nga programet e strehimit, sugjerojmë sërish që në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane", të parashikohen dispozita kalimtare të kufizuara në kohë, për këtë kategori shtetasish pasi parashikimet ligjore të tanishme nuk ëkrijojnë asnjë mundësi reale që ata të mund të përfitojnë prej pikëzimit favorizues.

Përsa i përket zgjidhjes së problematikave që solli miratimi dhe zbatimi i Aktit Normativ nr. 3 datë 1.08.2012, Avokati i Popullit vlerëson se është imperative t'u garantohet individëve, apo familjeve qiramarrëse të pastreha, banuese në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara:

1. Kreditimi me interes 0 %, me shumën përkatëse të të hollave për përfitimin e një banese në tregun e lirë, direkt nga ana e shtetit, në favor të tyre, pa kaluar në procedurat bankare, sikurse parashikohet aktualisht në legjislacionin specifik në fuqi, ose daljen garant nga ana e shtetit, për shumën e kredisë që, do të përfitohet në këto kushte nga ana e aplikuesve në BKT.
2. Alokimi sa më i shpejtë i fondeve të mjaftueshme nga buxheti i shtetit, organeve të qeverisjes vendore për ndërtimin e banesave sociale me të cilat, do të trajtohen me përparësi individët, apo familjet qiramarrëse të pastreha, banuese në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara, sipas kërkesave specifike të bashkive.

Realizimi i këtyre zgjidhjeve kërkon ndryshim dhe përmirësim të legjislacionit ekzistues specifik, që rregullon këto çështje, apo në rastin më të mirë nxjerrjen e një akti tjetër normativ nga ana e Këshillit të Ministrave, që do të adresonte dhe rregullonte këtë problematikë, e cila po rezulton emergjente.

K. Ndihma ekonomike

Vështrim i përgjithshëm

Ndihma ekonomike si përcaktim ligjor parashikohet në ligjin "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", nr. 9355, dt. 10.03.2005 (i ndryshuar), si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji. Gjatë vitit 2012, 98.800 familje shqiptare janë trajtuar me ndihmë ekonomike të plotë e të pjesshme, kryesisht në zonat verilindore e veriore të vendit, në qytet e në fshat. Ndihma ekonomike, për shumë familje shqiptare përbën mjetin e vetëm të jetesës, e megjithatë lidhur me

të drejtën për të përfituar ndihmë ekonomike, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, janë depozituar 51 ankesa, ku shtetas të ndryshëm kanë pretenduar mosdhënien e së drejtës për të përfituar ndihmë ekonomike, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, si dhe ankesa për mundësim të përfitimit të pagesës së ndihmës ekonomike, për ata persona që nuk e përfitojnë atë, për arsye të ndryshimit të vendbanimit. Janë përfunduar 48 ankesa, prej të cilave kanë rezultuar: 27 ankesa të pabazuara, 13 jashtë kompetence, 7 të zgjidhura në favor të ankuesve, 1 rekomandim i pranuar. Janë në proces shqyrtimi 3 ankesa.

Një nga problemet që lidhet me ndihmën ekonomike është edhe mosdeklarimi i minimumit jetik në Shqipëri. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, sindikata dhe organizma të tjera jo qeveritare kanë bërë në vite kërkesa të vazhdueshme për të shpallur zyrtarisht minimumin jetik, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje, apo qoftë dhe prononcim për këtë problem. Kjo çështje kërkon zgjidhje, pasi minimumi jetik, nuk është vetëm një tregues që lidhet me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, por bazuar në të, përcaktohen edhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes shoqërore.

Në kushtet e mospërmbushjes së këtij detyrimi të rëndësishëm ligjor i cili ka impakt të jashtëzakonshëm në jetën e shumë qytetarëve e famljeve që i përkasin shtresës më pak të mbrojtur e më në nevojë, më datë 06.12.2012 i jemi drejtuar përsëri Kryeministrit të Shqipërisë, për të rimarrë në konsideratë rekomandimin e propozuar nga ana jonë për ngritjen e një grupi pune për studimin dhe përcaktimin e nivelit minimal të standartit të jetesës në Shqipëri. Jemi ende në pritje të qëndrimit ndaj këtij rekomandimi.

Avokati i Popullit një ndër prioritetet e punës së tij, ka edhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri. Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij komuniteti, kërkon koordinim ndërinstitutional, me rëndësi thelbësore për mbrojtjen më efektive të të drejtave të komunitetit Rom. Disa pjesëtarë të komunitetit Rom, kanë paraqitur shpesh herë shqetësimin për e përfitimit nga programet e mbrojtjes sociale. Të gjithë ankuesit janë shprehur se jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike, duke mos plotësuar asnjë nga nevojat minimale të jetesës së përditshme. Në këto kushte, ata i drejtohen njësisve të qeverisjes vendore për të përfituar nga skema e mbrojtjes sociale, për të përfituar ndihmën ekonomike.

Një nga problematikat e prezantuara pranë Avokatit të Popullit, si nga pjesëtarë të komunitetit Rom ashtu edhe nga organizata jofitimprurëse të vetë këtij komuniteti apo që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e tyre, lidhet me faktin se familjet rome të cilat kanë vendbanimin e tyre të mëparshëm në fshat dhe që janë regjistruar në qytet pas datës 1 Gusht 1991, kanë pengesa në përfitimin e ndihmës ekonomike.

Arsyeja e mospërfitimit të ndihmës ekonomike nga pjesëtarët e këtij komuniteti, është parashikimi i dhënë në pikën 3 të Kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787/2005 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike" (i ndryshuar). Sipas këtij përcaktimi familjet që kanë vendbanimin në qytet, të regjistruara në zyrat e gjendjes civile pas datës 1 Gusht 1991 dhe që venbanimin e mëparshëm e kanë patur në fshat duhet të provojnë me vërtetim të vulosur nga kryetari i komunës apo bashkisë, nga kryeplaku i fshatit dhe përgjegjësi i zyrës së kadastrës, se nuk disponojnë tokë në pronësi, sipas vendimit të komisionit të ndarjes së tokës, duke qenë se janë larguar nga vendbanimi para datës 1 Gusht

1991, për arsye pune. Kemi konstatuar se ky parashikim ligjor dëmton familjet rome, të cilat nuk kanë marrë tokë në pronësi, pavarësisht se mund të kenë lëvizur nga fshati në qytet para datës 1 Gusht 1991 jo për arsye pune. E njëjta problematikë konstatohet përsëri me familjet rome, të cilat kanë ndryshuar vendbanim pas datës 1 Gusht 1991 nga qyteti në qytet dhe që në momentin e lëvizjes kanë qenë të punësuar në vendbanimin e ri. Edhe ky parashikim ligjor dëmton familjet rome, pasi ndryshimi i vendbanimit ka ndodhur jo për arsye pune.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në dt. 18.02.2013, na bën me dije se do të krijohet një grup i përbashkët pune për të identifikuar rrugët dhe instrumentat e duhur për të mundësuar Rekomandimin e Avokatit të Popullit.

Me iniciativën e Avokatit të Popullit, në mbështetje të nenit 27 të Ligjit 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, është hartuar një Raport i Veçantë *“Varfëria dhe kontributi i programit të Ndhmës Ekonomike në reduktimin e saj, si dhe veprimtaria e Avokatit të Popullit lidhur me të”*, i cili është dërguar pranë Kuvendit të Shqipërisë në muajin Korrik 2012 dhe ende nuk është shqyrtuar.

Analizë e rasteve konkrete

Disa nga ankesat e përmendura më poshtë pasqyrojnë më qartë pretendimet e shtetasve të ndryshëm lidhur me skemën aktuale të ndihmës ekonomike.

Ankesa me nr.doculive **201202933**, është e një shtetasi me banim në Tiranë, i cili ankohej ndaj Njesisë Bashkiake nr.9 për mosdhënien e së drejtës për të përfituar ndihmë ekonomike. Ankuesi ka qenë përfitues i ndihmës ekonomike deri në vitin 2007, vit në të cilin i ishte ndërprerë kjo ndihmë, pasi ndodhej jashtë vendit për kuim dhe nuk ishte i pranishëm në tërheqjen e kësaj ndihmë brenda afatit të përcaktuar ligjor, 6 ditor. Pas kthimit të tij, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në Seksionin e Ndhmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale, por përsëri nuk i është dhënë e drejta e përfitimit të ndihmës ekonomike. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të bëra nga ankuesi, nuk kishte mundur dot të zgjidhte problemin e tij, pasi nuk ishte i qartë për arsyet e mospërfitimit të kësaj të drejtë. Pas ndërhyrjes sonë pranë njesisë bashkiake, morëm informacionin e kërkuar dhe sqaruam ankuesin se në vitin 2007 nuk i është vënë në dispozicion Zyrës së Ndhmës Ekonomike asnjë dokument që të vërtetojë faktin se ka qenë jashtë vendit për kurim, dokument i cili kërkohet sipas legjislacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike. Gjithashtu, e këshilluam që të paraqitej pranë sporteleve të Njesisë Bashkiake nr.9 për të aplikuar për përfitim të ndihmës ekonomike, pasi Udhëzimi nr.4 datë 24.04.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.338/3 datë 10.03.2006 “Mbi zbatimin e Vendimit nr.787 datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar”, kishte shfuqizuar Seksioni V.1, të Udhëzimit nr.338/3 në të cilin ishte përcaktuar afati 6 ditor për tërheqjen e masës së ndihmës ekonomike.

Me këtë objekt ankese, kemi trajtuar edhe shqetësimin e një shtetasi me banim në Korçë, me nr.doculive **201202377**, për ndërprerje të ndihmës ekonomike dhe mosdhënien e së drejtës për të aplikuar për të përfituar këtë ndihmë. Në përgjigjen e dërguar pas kërkesës sonë, Bashkia Korçë na informonte se ky shtetas ishte trajtuar me pagesën e ndihmës ekonomike për periudhën Tetor 1996- Korrik 2000. Më pas i është ndërprerë kjo ndihmë, pasi nuk është paraqitur brënda

6 ditëve të tërheqë ndihmën ekonomike. Kjo bazuar në pikën 10, gërma “e” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”. Për këto arsye, kjo familje nuk mund të trajtohej më me ndihmë ekonomike.

Duke u nisur nga fakti se për këtë çështje nga organe të qeverisjes vendore janë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me ndjekjen e procedurave për përfitim të ndihmës ekonomike pas ndërprerjes së kësaj ndihme për arsyen e mostërheqjes në afatin e përcaktuar (6 ditor), i dërguam një kopje të Udhëzimit nr.4 datë 24.04.2012 “Për disa shtësa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.338/3 datë 10.03.2006 “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 787 datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar”, i cili ka shfuqizuar Seksionin V.1, në të cilin ishte përcaktuar afati 6 ditor, me qëllim që Drejtoria e Përkrahjes Sociale dhe Strehimit të njihet me të gjitha aktet nënligjore të dala për zbatim dhe t’u kthehen përgjigje të bazuara ligjore qytetarëve për kërkesat e tyre nëse janë apo jo në kushte për të përfituar ndihmë ekonomike.

Në këto kushte, duke e konsideruar të drejtë shqetësimin e qytetarit, iu drejtuam me rekomandim Kryetarit të Bashkisë Korçë për: “Pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të duhur ligjor për përfitim të ndihmës ekonomike të këtij shtetasi si dhe të të gjithë shtetasve të tjerë, kur ndërprerja e ndihmës ekonomike u ka ardhur si pasojë e mostërheqjes së shumës së akorduar brenda afatit 6 ditor”. Pas këtij rekomandimi kemi patur një korrespondence me atë bashki lidhur me mënyrën se si do të procedohet me familjet që janë penalizuar për këtë arsye. Jemi në pritje të përgjigjes së tyre.

Ankesa me nr.doculive **201202359**, e një shtetase nga qyteti i Tiranës, pa asnjë të ardhur, jetonte në kushte të vështira ekonomike kryefamiljare me dy fëmijë të vegjël Ishte paraqitur pranë Njësisë Bashkiake nr.2 për të përfituar ndihmë ekonomike, por i ishte refuzuar dhënia e kësaj ndihme. Pas ndërmjetësimit tonë institucional me Njësinë Bashkiake nr.2, u informuam se Zyra e Ndihmës Ekonomike nuk kishte asnjë informacion për rastin e kesaj shtetase. Në përmbushje të detyrimit tonë kushtetues, i sugjeruam ankueses se për të zgjidhur çështjen e saj, të paraqitej pranë sporteleve të Njësisë Bashkiake Nr.2, për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar ndihmën ekonomike.

Konkluzione

Përcaktimi i minimumit jetik mbetet një detyrë ligjore dhe domosdoshmëri jetike për shtresa të caktuara të shoqërisë shqiptare. Ky vlerësim i Avokatit të Popullit ka dalë edhe prej Konferencës Kombëtare “Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, pjesë integrale e të drejtave të njeriut” mbajtur në datën 25 Qershor 2012, organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qeverisë, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, të trupës diplomatike të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe të një numri organizatash për të drejtat e njeriut.

Duhet të mendohet seriozisht për rrugët që do të mundësojnë përfitimin e ndihmës ekonomike nga komuniteti Rom pasi kjo përqindje vazhdon të jetë në shifra shumë të ulëta

Duhet të përshpejtohet puna e cila do të mundësojë krijimi e Regjistrimit Kombëtar Elektronik për hedhjen e të dhënave të Ndihmës Ekonomike i cili do të mundësojë evidentimin dhe shmangien e të gjitha rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike.

L. Mbrojtja e konsumatorit

Vështrim i përgjithshëm

Institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë misionit kryesor në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtës për mbrojtjen e konsumatorit, kjo jo vetëm për faktin se në nenin 56 të Ligjit Nr. 9902 datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar, Avokatit të Popullit i është caktuar një rol i veçantë për mbrojtjen e kësaj të drejte, por edhe për faktin se është e lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me standartin dhe cilësinë e jetës së konsumatorëve.

Duke ju referuar numrit të ankesave për vitin 2012, rezulton se e drejta e konsumatorit ka qenë mjaft e çënuar veçanërisht ndaj shërbimeve publike të ofruara nga Kompania "CEZ Shpërndarje sh.a.", dhe Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizime sh.a. në Tiranë e rrethë ndaj qytetarëve.

Përgjatë këtij viti në trajtimin e ankesave i kemi referuar dispozitave ligjore dhe kryesisht Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar, Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, Ligjit Nr.8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM-së Nr.1304, datë 11.12.2009, "Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës-Kanalizime sh.a.", por në veçanti dhe dispozitave të Kontratave Tip në fuqi ndërmjet palëve, të miratuara nga Entet mbikëqyrëse të operatorëve tregtarë, si dhe Udhëzuesit të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e konsumatorit (në bazë të shtjellimit të vitit 1999).

Bashkëpunimi ndër-institucional, me shoqëritë që ofrojnë shërbime publike (UK sh.a., dhe Kompania "CEZ Shpërndarje sh.a."), e drejta e informimit të konsumatorëve, trajtimi, verifikimi dhe konstatimi i ankesave brenda një afateve administrative, u ngrit me forcë gjatë fillimit të vitit 2012 nga Institucioni ynë, gjë që u pasqyrua në seancat e zhvilluara me operatorët përgjegjës të publikuara dhe në media.

Këtë vit për shkeljen e të drejtave të konsumatorit janë paraqitur rreth 445 ankesa, nga të cilat 331 ankesa rezultojnë të regjistruara me objekt ankimi Kompaninë "CEZ Shpërndarje sh.a.", dhe 120 ankesa rezultojnë të regjistruara për shkeljen e të drejtës së konsumatorit nga Ndërmarrjet e "Ujësjellës-Kanalizime sh.a." si dhe 4 ankesa për shoqërinë e telefonisë fikse "Alb-telekom".

Analizë e rasteve konkrete

Ankesat e trajtuara për shkeljen e të drejtës së Konsumatorit nga Kompania "CEZ Shpërndarje sh.a."

Për vitin 2012, janë regjistruar 331 ankesa me objekt ankimimi Kompaninë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, nga të cilat janë përfunduar rreth 268 ankesa dhe 63 ankesa janë ende në proces shqyrtimi. Nga ankesat e përfunduara rezultojnë se në 71 ankesa pretendimet e ankuesve kanë qenë të pabazuara, 37 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të shqyrtimit nga Institucioni i Avokatit të Popullit, 134 ankesa kanë përfunduar të zgjidhura në favor të ankuesve dhe në 7 ankesa është përfunduar procedimi administrativ për shkak të heqjes dorë së palëve të interesuara. Gjithashtu, edhe në 19 ankesa të tjera kemi hartuar rekomandime nga të cilat 15 rekomandime janë pranuar dhe rezultojnë të zbatuara plotësisht dhe 4 rekomandime janë refuzuar.

1) Ndër ankesat e paraqitura, problematike mbetet situata e mungesës së furnizimit me energji elektrike për disa zona të vendit për shkak se nuk janë bërë projekte për investime, ose në rastet kur ekzistojnë projektet nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së fondeve dhe vështirësive që është përballur këtë vit Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”

Fshati Val, Komuna Martanesh, (ankesa me Nr. Doculive 201200964), në linjë ajrore 30 km larg qytetit të Tiranës, ndodhet në kushtet e një izolimi ekonomik dhe të gjithanshëm për të pasur një jetesë normale, pasi nuk furnizohet me energji elektrike që prej muajit shtator 2006. Dëmtimi i linjës në atë kohë, jo vetëm nuk ndërgjegjësoi asnjë strukturë përgjegjëse për të marrë masa konkrete në drejtim të ofrimit të shërbimit, por situata vijon të mbetet problematike dhe sot, kur “CEZ Shpërndarje sh.a.”, prej 3 vjetësh ka privatizuar ish OSSH sha.

Banorët kanë kërkuar disa herë takime për këtë problem, me instancat më të larta shtetërore dhe drejtuese duke filluar me Ministrat që kanë drejtuar Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (z. Genc Ruli, dhe z. Dritan Prifti), drejtuesit e Entit Rregullator të Energjisë, Kryeministrin, dhe “CEZ Shpërndarje sh.a.” Nga korrespondenca zyrtare me drejtuesit e ish-OSSH sh.a., ata janë informuar me shkresën me Nr. 800/1, të datës 05.02.2008, se OSSH ka akorduar fondin prej 1.950.402 lekë “Për ndërtimin e linjës ajrore për furnizimin me energji elektrike të fshatit Val” dhe tenderi për këtë objekt është zhvilluar në datë 07.02.2008. Megjithatë, rezultati ka qenë i tillë, që asnjë ditë nuk është ofruar furnizimi me energji elektrike. Përpjekjet e pushtetit vendor kanë vijuar sërish, duke insistuar me datë 12.01.2012, për t`u takuar me drejtuesit e lartë të Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a.”. Në takimin e zhvilluar me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të Entit Rregullator të Energjisë, banorëve u është thënë nga “CEZ Shpërndarje”, se kjo e fundit nuk disponon fonde dhe banorët duhet t`i drejtohen Qeverisë për të dhënë një kredi në drejtim të furnizuesit, me qëllim realizimin e këtij investimi.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke e vlerësuar situatën si tepër serioze dhe kritike, në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore ka ftuar Kompaninë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, Entin Rregullator të Energjisë dhe vetë përfaqësuesit vendor të zonës, për të parashtruar të gjitha pretendimet dhe versionin zyrtar përkatës.

Në këtë takim, përfaqësuesit e “CEZ Shpërndarje”, kanë pranuar ekzistencën e këtij problemi dhe vërtetësinë e të gjitha pretendimeve të prezantuara. Në vijim është sqaruar se, në një kohë të mëparshme është kryer investim i pjesshëm për shtrimin e linjave të transmetimit në drejtim të fshatit Val, por për mungesë fondesh projekti nuk u përfundua. Zvarritjet e vazhdueshme administrative për të përfunduar këtë investim dhe vjedhja që i`u shkaktua linjës së pjesshme të ndërtuar, kanë lënë në të njëjtat kushte këtë zonë.

Megjithatë, nga "CEZ Shpërndarje sh.a.", u bë e ditur se disponohet një projekt për këtë problem, në të cilin janë marrë parasysh dhe propozimet e banorëve të Komunës për zonat mbi të cilat do kalojë linja në vijë ajrore, por akoma më shqetësues mbetet fakti se kompania furnizuese nuk kishte një përgjigje lidhur me zërin e fondit që ishte parashikuar për t'u investuar në zbatim të projektit.

Lidhur me problematikën më sipër në vijim të trajtimit të këtij rasti, rekomanduam realizimin brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2012, të investimeve të planifikuara nga "CEZ Shpërndarje sh.a.", për banorët e fshatit Val, Komuna Martanesh, në bazë të plan investimit të miratuar nga ERE në vitin 2011. Në përgjigje të këtij rekomandimi nga Kompania "CEZ Shpërndarje sh.a.", jemi vënë në dijeni se: *"Linja TM Val Martanesh, e llogaritur me vlerë rreth 7.000.000 lekë nuk është pjesë e planit të investimeve për vitin 2012 të miratuar nga ERE. U raportua që kjo linjë është vjedhur dhe kërkohet të zëvendësohet me një tjetër linjë 5-6 km të gjatë, e cila do të furnizojë jo më shumë se 20 familje. Në të vërtetë ky fenomen është kthyer në problem për shoqërinë e shpërndarjes dhe ne kemi pritur që pushteti lokal të jetë bashkëpunues për eliminimin e këtij fenomeni, i cili po dëmton shoqërinë tonë dhe po çënon sigurinë e furnizimit të konsumatorëve. Megjithatë, me lëvrimin e fondeve të investimeve, do të dërgojmë në ERE propozimin për ta përfshirë këtë projekt në planin e investimeve."*

Sa më sipër, është kundërshtuar me përgjigjen zyrtare të dërguar nga ERE, me nr. 403/1 Prot., datë 23.05.2012, e cila sqaron se: *"ERE me vendimin Nr. 37 datë 05.04.2012, ka miratuar Planin e Rishikuar të Investimeve të "CEZ Shpërndarje sh.a.", për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014. Plani i investimeve që u paraqit në ERE nga Kompania "CEZ Shpërndarje sh.a.", u miratua pa asnjë ndryshim dhe si rezultat vendimi i sipërcituar nuk mund të cilësohet i papërshtatshëm. Së fundmi tërheqim vëmendjen tuaj se shoqëria "CEZ Shpërndarje sh.a.", ka detyrimin ligjor të furnizojë me energji konsumatorët e saj në çdo zonë dhe jo të përjashtojë ata nga investimet që duhet të kryhen. Mospërbushja e këtij detyrimi ligjor nga ana e shoqërisë Tuaj përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet nga ERE sipas përcaktimeve të nenit 64 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar."*

Në fshatin Val të Komunës Martanesh, situata vazhdon të mbetet e njëjtë, nuk është miratuar asnjë projekt për investime në këtë zonë dhe qytetarët vijojnë të përballen me mungesën e furnizimit me energji elektrike.

Komuna Fushë-Kuqe, Laç (ankesa me **Nr. Doculive 201201086**), prej rreth pesë vjetësh nuk merr furnizim me energji elektrike pasi është vjedhur linja e shpërndarjes së energjisë elektrike. Sipas sqarimeve të banorëve në datë 24.02.2009, janë vënë në dijeni nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes se: *"Drejtoria Zonale Burrel ka paraqitur një projekt-preventiv për ndërtimin e linjës 6 kE dhe kabinës së re shtyllore 100 kEa në Komunën Plepisht, Fushë e Kuqe. Nga ana e OSSH-së janë vënë re disa mangësi ku i është kërkuar Drejtorisë Zonale Burrel, plotësimi i tyre në projekt-preventiv. Drejtoria Zonale Burrel është paraqitur pranë OSSH me projekt-preventivin përfundimtar me Nr.161 Prot., datë 13.02.2009, mbi të cilin OSSH-ja ka bërë miratimin dhe delegimin e fondit përkatës për realizimin e këtij investimi. Drejtoria Zonale Burrel në vijim të këtij miratimi do të marrë të gjitha masat për realizimin e investimit"*.

Pas kësaj përgjigje të dhënë nga OSSH edhe pse u premtua realizimi i investimeve, nuk u ndërmor asnjë masë për furnizimin me energji elektrike. Në datë 29.10.2010, banorët ju drejtuan me një kërkesë Entit Rregullator të Energjisë ku kanë kërkuar zgjidhjen e kësaj situate. Në

përgjigje të shkresës Nr. 651/1 Prot., datë 29.10.2010, të dërguar nga ERE pranë Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, u kërkua një informacion mbi këtë situatë të krijuar si dhe mbi shkaqet e mosrealizimit të investimeve, megjithëse ishte akorduar fondi përkatës. Nga Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”, (Shkresa Nr.3919 Prot.), banorët janë vënë në dijeni se: “Për furnizimin me energji elektrike të 18 familjeve që banojnë në këtë komunë është rihartuar projekt-preventivi i linjës elektrike të TM, kabina elektrike dhe rrjeti shpërndarës i TU.”.

Lidhur me këtë rast Institucioni i Avokati i Popullit ndërmori një takim me Kompaninë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, Entin Rregullator të Energjisë dhe vetë përfaqësuesit vendorë të zonës problematike (takim i bërë publik edhe në mediat vizive), për të parashtruar të gjitha pretendimet dhe versionin zyrtar perkates. Në këtë takim, përfaqësuesit e “CEZ Shpërndarje sh.a.”, kanë pranuar ekzistencën e këtij problemi dhe vërtetësinë e të gjitha pretendimeve të prezantuara, por do të ndërmerrnin masat e nevojshme për hartimin e një projekti e nisjen e investimeve përkatëse pas miratimit edhe nga ERE.

Në vijim të trajtimit të kësaj ankese nga ana jonë, është rekomanduar marrja e masave të menjëhershme për realizimin e investimeve të parashikuara prej vitit 2009 brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2012, për furnizimin me energji elektrike të Komunës Fushë-Kuqe, Laç. Në përgjigje të këtij rekomandimi nga Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”, jemi vënë në dijeni se: “Gjendja në këtë zonë është vlerësuar pa furnizim me energji elektrike dhe është hartuar projekt-preventivi përkatës për kryerjen e këtij projekti. Ky projekt ka qenë për t’u zbatuar gjatë vitit 2011, por vështirësitë financiare më të cilat është përballur Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”, nuk kanë mundësuar zbatimin e tij. Sa më sipër, duke marrë parasysh gjendjen e furnizimit dhe ankesat e vazhdueshme nga banorët, projekti i furnizimit është përfshirë në planin e investimeve të vitit 2012, plan i cili është dërguar për miratim pranë Entit Rregullator të Energjisë”.

Në vijim të ndjekjes dhe trajtimit të këtij rasti nga ana jonë, nëpërmjet shkresës Nr. K3/N22-7 Prot., datë 10.05.2012, ju drejtuam ERE-s me një kërkesë për informacion nëse ishte ndërmarrë ndonjë masë për miratimin e këtij projekti e kur parashikohej nisja e investimeve për të. Nga kontaktet që kemi ndërmarrë me përfaqësues të ERE-s si dhe nga Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”, u vumë në dijeni se ishte miratuar plani i investimeve nga E.R.E., në shumën prej 4.5 milionë ALL për zonën e Fushë Kuqes, Laç. Në muajin Dhjetor 2012 ishte parashikuar nisja e procedurave për fillimin e punimeve, të cilat priteshin të përfundonin në fillim të vitit 2013. Për shkak të vështirësive financiare që u përball Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”, nuk u bë e mundur lëvrimi i kredisë përkatëse dhe investimet nuk u realizuan. Aktualisht, Zona e Fushë-Kuqes po përballet me mungesën e furnizimit me energji elektrike.

Situatë jo e favorshme për furnizim me energji elektrike është konstatuar edhe në **Komunën Ksamil dhe Bashkinë Himarë** (ankesat me Nr. Doculioe 201201072, 201201073). Kryetari i Bashkisë Himarë, zoti Gjergji Goro, në ankesën e prezantuar pranë Institucionit të Avokatisë të Popullit ngre problemin e furnizimit shumë të keq me energji elektrike për gjithë zonën e Himarës dhe fshatrat Dhërmi, Gjilek, Palasë. Gjendja faktike e rrjetit elektrik të tensionit të mesëm dhe të ulët, për shkak të amortizimit të tij, jep defekte të rënda gjithë kohës dhe për pasojë zona mbetet pa drita me ditë të tëra, por dhe kur ka energji elektrike ajo është me tension të ulët që varion nga 130v deri në 180v. Pasojat janë serioze si në drejtim të konsumatorëve, që janë banorë të kësaj zone, ashtu dhe për aktivitet tregtarë që përgatiten për sezonin turistik të verës.

Gjithashtu, edhe Kryetari i Këshillit të Komunës Ksamil ka paraqitur ankesën e tij ku sqaron se furnizimi aktual me energji elektrike është problematik dhe rrjeti shpërndarës është i amortizuar. Në këtë ankesë sqarohet se rrjeti aktual i energjisë, pa kryer asnjë investim nga ana e Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, nuk mund të mbulojë popullsinë në rritje të kësaj zone, pasi ai është planifikuar që para 50 vjetësh, kur zona nuk ka pasur zhvillimin e sotëm. Pasojat e kësaj situate janë të ndjeshme gjatë gjithë vitit, por bëhen akoma më problematike në sezonin turistik, kur ndërprerja e energjisë dhe tensioni i ulët kanë pasoja serioze për bizneset turistike dhe për vetë pushuesit.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke e parë situatën tepër serioze, ndërmori një takim pranë zyrave tonë me Kompaninë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, Entin Rregullator të Energjisë dhe vetë përfaqësuesit vendor të zonave Himarë dhe Ksamil, për të parashtruar të gjitha pretendimet dhe versionin zyrtar përkatës. Në këtë takim të bërë publik, përfaqësuesit e “CEZ Shpërndarje sh.a.”, kanë pranuar ekzistencën e problemeve me rrjetin shpërndarës dhe vërtetësinë e të gjitha pretendimeve të prezantuara.

Menaxheri i Mirëmbajtjes pranë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, sqaroi se mirëmbajtja e rrjetit për zonën e Himarës bëhet në stinën e pranverës dhe aktualisht prej 2 javësh, kanë filluar punimet. Megjithatë gjatë procedurave për mirëmbajtjen e rrjetit aktual kishin dalë dy probleme:

- Fibrat duhet të kalojnë nëpërmjet ullishtave të fermerëve private dhe kërkohej prerja e pemëve për të kaluar transetë e fidrave;
- Ndërkohë, “CEZ Shpërndarje” ka hasur në pengesa të tilla, sikundër është fenomeni i vjedhjeve të kabllit transmetues, duke u vjedhur rreth 4 km përcjellës.

Nga “CEZ Shpërndarje sh.a.”, u bë e ditur se me përfundimin e mirëmbajtjes së këtyre fibrave, që mendohej se deri në 15 maj 2012 do të kishin përfunduar punimet, situata do të ishte zgjidhur dhe zona nuk do të kishte probleme me furnizimin e energjisë. Nga punimet e mirëmbajtjes, mendohej se do të ulej numri i defekteve dhe do të përmirësohej cilësia e tensionit të furnizimit të energjisë. Strukturat e “CEZ Shpërndarje sh.a.”, kanë justifikuar gjendjen e krijuar në vijim me faktin se ritmet e zhvillimit janë shumë të larta për zonën e Himarës dhe fshatrat përreth dhe se kabinat elektrike lidhen në mënyrë të pakontrolluar nga konsumatorët. Ky problem ishte bërë i pamënaxhueshëm për kompaninë “CEZ Shpërndarje”, megjithëse vazhdimisht ishin bërë përpjekje për të mbajtur nën kontroll situatën.

Nga ana e përfaqësuesve të Entit Rregullator të Energjisë u kontestua informacioni i përcjellë mësipërm, lidhur me zgjidhjen e problemit me anë të mirëmbajtjes së rrjetit aktual, pasi ishte thënë se kjo zonë nuk mund të përballonte në vijim kërkesat e konsumatorëve në rritje me anë të rrjetit të vjetër ekzistues, qoftë ky dhe i mirëmbajtur. Për këtë gjë dhe për zgjidhjen përfundimtare të problemit, ERE ka theksuar nevojën se duheshin ngritur dy nënstacione për përballimin e ngarkesës së zonës, përkatësisht:

- a) në Orikum të qytetit të Vlorës, i cili do të mund të shpërndante dhe përballonte gjithë bregun jug-perëndimor;

b) një të dytë në qytetin e Sarandës, i cili do të përballonte këtë pjesë të vendit.

Gjithashtu, nga ERE u vu në dukje se ishte miratuar një plan investimi në drejtim të Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, për ndërhyrje në këtë zonë. Lidhur me këtë gjë, “CEZ Shpërndarje sh.a.”, sqaroi se janë kryer investime të shpejta dhe zona e Himarës është planifikuar për shtrirjen e rrjetit ABC.

Kompania ka kryer dhe proceset e tenderit për këtë qëllim, dhe është planifikuar së shpejti ngritja e nënstacionit të Orikumit. Perspektiva e këtyre punimeve në vlerën e 40 milion lekëve, do të jetë zgjidhja përfundimtare e problemeve, pasi janë menduar dhe dy nënstacione të tjera në vijim me linja 3 fazore, që do të ngrihen në Shën Vasil dhe Bunec.

Megjithë premtimet e mësipërme të përcjella nga përfaqësuesit e Kompanisë CEZ Shpërndarje, përfaqësuesit e Bashkisë Himarë që janë prezantuar në takimin e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, kanë insistuar në detajimin e situatës së rënduar, pasi kabinat e shpërndarjes në këtë zonë nuk plotësojnë kushtet minimale të parametrave, duke u bërë rrezik për jetët e banorëve, në disa raste mungojnë shtyllat për mbajtjen e linjave përcjellëse, duke bërë që linjat të zvarriten mbi rrugët e qytetit.

Për të gjithë këto probleme, pushteti vendor i qytetit të Himarës ka pretenduar se ka munguar totalisht bashkëpunimi i Kompanisë “CEZ Shpërndarje”, megjithëse disa herë i është kërkuar për të biseduar në takimet e organizuara.

Nga “CEZ Shpërndarje sh.a.”, u bë e ditur se për këtë qëllim kompania ka ngritur Drejtorinë e Marrëdhënieve me Pushtetin Lokal, strukturë e cila do të ketë dhe degë rajonale për Tiranën, Fierin, Shkodrën dhe Elbasanin.

Për sa i takon situatës së zonës së Ksamilit, “CEZ Shpërndarje” ka sqaruar se është hartuar një projekt para 3 vjetësh për këtë qëllim, dhe rrjeti i ri që do të ngrihet do të përmirësojë deri në 60% e furnizimit të tregut. Investimi i parashikuar nga “CEZ Shpërndarje sh.a.”, do të kapë vlerën e 160 milion lekëve dhe do të mbulojë zonën nga dalja e Sarandës deri në Butrint.

Në vijim, në sqarimet e dërguara nga “CEZ Shpërndarje sh.a.”, për rekomandimet tona me qëllim nisjen e punimeve brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2012, na është bërë e ditur se: *“Realizimi i planit të investimeve të “CEZ Shpërndarje sh.a.”, lidhet ngushtë me vendimet e ERE-s për çmimet e energjisë elektrike për vitin 2012 dhe për garancinë e kërkuar nga Bankat financuese të investimeve BERZH dhe IFC. Vendimet jo të përshtatshme lidhur me këto dy çështje kane sjellë për pasojë moslëvrimin e fondeve të investimeve nga bankat financuese. Aktualisht për zonat turistike Himarë-Ksamil, në planin e investimeve të miratuar prej ERE-s është planifikuar ndërtimi i 11 kabinave në TU me rrjetin ABC me vlerë 60 467 960 lekë: Linja TM 20kv dhe kabinat Ksamil me vlerë 160 000 000 lekë. Faza e parë e tenderimit ka filluar, por nuk mund të vijohet me tej për arsye të mungesës së fondeve për financim.”*

Referuar sa më sipër, për shkak të mungesës së lëvrimin të fondeve dhe situatës së vështirë financiare të krijuar, do të kemi të pamundur realizimin e planit të investimeve, që do të thotë që vetëm veprimtaria e mirëmbajtjes së rrjetit nuk do të mund të realizohet”.

2) Krahas zonave që përballen me mungesën e furnizimit me energji elektrike, problematikë e cila është mbartur gjatë viteve është edhe keqfaturimi i energjisë elektrike duke përfshirë mbifaturim dhe nënfaturim të sasisë së energjisë elektrike. Në ankesën me Nr. Doculive 201200401, shtetasi Q.D., është përballur me një mbifaturim ekstrem për periudhën Prill-Maj 2011, në sasinë prej 66.354 këh energji elektrike (në shumën prej 1.073.225 lekë). Sipas sqarimeve të ankuesit kjo sasi ka ardhur si pasojë e mosllogaritjes nga ana e Kompanisë “CEZ Shpërndarja sh.a.”, të gjendjes së sasisë së energjisë të konsumuar në sahatin e vjetër dhe për pasojë nga Kompania “CEZ Shpërndarja sh.a.”, i është bërë vendosja e konsumit 0 këh në datë 30.04.2011.

Pasi konstatuam se faturimi i kryer ndaj këtij shtetasi kishte ardhur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe me nenin 12 të Kontratës Tip të furnizimit me energji elektrike, rekomanduam marrjen e masave të menjëhershme nga Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”, për anulimin e këtij faturimi, kryerjen e rakordimeve përkatëse dhe korrigjimin e saj mbi bazë të konsumit real të sasisë së energjisë elektrike.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, nga Kompania “CEZ Shpërndarja sh.a.”, u vumë në dijeni se janë marrë të gjitha masat për anulimin e faturimit për periudhën Prill 2011 - Janar 2012. Pas kryerjes së verifikimit në vend të gjendjes në matës në datë 22.02.2012, si dhe riverifikimit në datë 27.02.2012, u llogarit diferenca e leximit për periudhën në të cilën janë anuluar faturat si dhe u llogarit fatura e korrigjuar për të njëjtën periudhë, përfshirë edhe konsumin e muajit Shkurt 2012, e trajtuar me bllokun e parë për çdo muaj.

3) Problematike e cila është mbartur edhe nga viti 2011 ka qenë masa administrative e gjobave për dëmtim matësi, të konstatuara nga vetë Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.”, Për trajtimin e këtyre ankesave kryesisht kemi vazhduar të veprojmë nëpërmjet seancave dëgjimore në ambientet e Entit Rregullator të Energjisë. Ajo çfarë pritej të ndryshohej për vitin 2012 nga Kompania “CEZ Shpërndarje sh.a.” duhej të ishte përmirësimi i gjendjes për analizën laboratorike të matësve të “prekur”, ku do të licensoheshin subjekte private të cilat do të kishin edhe përgjegjësinë e konstatimit, verifikimit dhe informimit të të interesuarve mbi dëmtimin e mundshëm të matësve. Pra, duke qenë se, supervizimi për analizë laboratorike dhe kolaudimi i matësve i është hequr kompanisë “CEZ Shpërndarje”, kjo gjë do të mund të sensibilizonte, ndërgjegjësonte edhe konsumatorët dyshues mbi gjendjen e aparateve të konstatuar si “të prekur”, por që ende nuk ka një ndryshim konkret për këtë problematikë.

4) Problematikë tjetër e konstatuar kanë qenë edhe ankesat ndaj konsumatorëve, të cilët rezultojnë debitorë, kjo për disa shkaqe:

a) Moskreditim të faturave të mëparshme të energjisë elektrike të paguara në bankë apo shërbimet postare kryesisht për periudhën 2007-2008.

b) Moslikujdim i detyrimeve nga ana e ish banorëve të mëparshëm të apartamenteve

c) Vonesa në pagesat e energjisë elektrike (detyrime të cilat janë likuiduar nëpërmjet sistemit bankar apo edhe filialeve të shërbimit postar) e për të cilat nuk është arkëtuar kamat-vonesa, por si detyrim është mbartur në vijim.

d) Raste kur ankuesit kanë banuar jashtë vendit e janë faturuar për tarifën e shërbimit e taksën e televizionit, e për të cilën nuk kanë pasur dijeni pasi pretendohet se kanë paraqitur kërkesa për zgjidhje të kontratës me ish OSSH-në apo edhe me Kompaninë “CEZ Shpërndarje sh.a.”.

Lidhur me këtë problematikë, kemi pasur komunikime të vazhdueshme, si nëpërmjet seancave dëgjimore ashtu edhe nëpërmjet rekomandimeve përkatëse drejtuar Entit Rregullator të Energjisë dhe Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a., me qëllim përmirësimin e situatës, që kishte ardhur si pasojë e rakordimit me vonesë nga vetë kompania e pagesave që bënin konsumatorët në bankat e nivelit të dytë.

5) Këtë vit, problematikë e madhe ka qenë edhe penalizmi i qytetarëve debitorë me ndërprerje të energjisë elektrike. Investigimi që kemi ndërmarrë, ka qenë kryesisht në drejtim të atyre zonave të cilat pretendonin se nuk rezultonin 100% debitorë dhe për të cilat pretendohet se bëhej dënim kolektiv për të gjithë banorët. Përmendim rastet për banorët e Fushë-Krujës (*ankesa me Nr. Doculive 201202670*), banorëve të kombinatit, Lezhës etj. Pas takimit të ndërmarrë me Drejtorin e Divizionit të Shpërndarjes pranë Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, u informuam se zona e Fushë-Krujës paraqitet si një ndër zonat më problematike përse i përket nivelit të lartë të humbjeve në rrjet dhe nivelit shumë të ulët të arkëtimeve. Në fund të muajit Maj dhe në vazhdim nga ana e Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, është ndërmarrë një fushatë intensive për ndërprerjen e abonentëve debitorë, duke synuar kështu edhe kthimin e rrjetit në gjendje normale për të siguruar një shërbim sa më cilësor për konsumatorët që janë pagues të rregullt të energjisë elektrike. Kjo ka qenë arsyeja që një pjesë e konsumatorëve të kësaj zone janë pa energji elektrike. Problem tjetër i cili ka shkaktuar ndërprerje të vazhdueshme të energjisë në këtë zonë është për shkak se konsumatorët e penalizuar me ndërprerje të energjisë elektrike për arsye të mospagesës së energjisë elektrike apo për shkak të lidhjeve të jashtëligjshme në rrjet, kanë protestuar duke hedhur vazhdimisht tela në linjat e tensionit të mesëm dhe duke provokuar shumë defekte në rrjet.

6) Për vitin 2012 krahas trajtimit të ankesave me problematika të ndryshme ndaj Kompanisë “CEZ Shpërndarje sh.a.”, janë paraqitur edhe disa ankesa nga Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar lidhur me ndërprerjen e masës së subvencionimit të faturave të energjisë elektrike. Me Ligjin Nr. 27/2012, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8626, datë 22.06.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, neni 12 i tij pësoi ndryshimet si më poshtë vijon: *“Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse. Masa, kriteret dhe procedurat e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave”*.

Me ndryshimet që pësoi ligji i mësipërm, Kompania “CEZ Shpërndarje” ka proceduar me subvencionimin e faturave të energjisë elektrike deri në fund të muajit Prill 2012. Pas kësaj date për të gjithë konsumatorët që gëzojnë statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, është proceduar me pagesën e plotë të faturave të energjisë elektrike deri në daljen e VKM-së përkatëse që të përcaktonte masën e subvencionit të këtyre faturave.

Në zbatim të ligjit më sipër, për nxjerrjen e akteve nënligjore, është miratuar VKM Nr. 404 datë 20.06.2012, *“Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, për personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”*

Referuar VKM-së më sipër është përcaktuar se:

- 1. Individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr.8626, datë 22.06.2000, "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestar, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike në masën 2000 lekë në muaj.*
- 2. Individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2000 lekë në muaj.*
- 3. Individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr. 8626, datë 22.06.2000, "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr. 8098 datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestar, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike në masën 1400 lekë në muaj.*
- 6. Masa e Kompensimit llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.*
- 7. Përfituesit, objekt i këtij vendimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike , të parashikuar në vendimin Nr. 565 datë 09.08.2006 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike.*

Duke ju referuar ankesave të paraqitura për këtë problematikë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ndryshimet ligjore kanë përkeqësuar gjëndjen e të drejtave të mëparshme për kategoritë e personave të verbër dhe paraplegjikë e tetraplegjikë, për më tepër është vënë re se zbatimi i dispozitave të Ligjit 26/2012 datë 05.04.2012 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8098 datë 28.03.1996 "Për statusin e të Verbërit" si dhe Ligjit Nr. 27/2012 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8626 datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", ka sjellë pasoja të menjëhershme të rënda për këto kategori, të cilat realisht gjenden në vështirësi ekonomike.

Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve dhe Shoqatën Kombëtare të Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë, i ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese një kërkesë me objekt "Shfuqizimin si antikushtetues të Ligjit 26/2012 datë 05.04.2012 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8098 datë 28.03.1996 "Për statusin e të Verbërit" si dhe të Ligjit Nr. 27/2012, datë 05.04.2012 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8626 datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", për të cilat është vendosur edhe kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Ankesat e trajtuara për shkeljen e të drejtës së Konsumatorit nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime sh.a.

Për vitin 2012, janë regjistruar 120 ankesa ndaj Ndërmarrjes së "Ujësjellës-Kanalizime sh.a.", nga të cilat janë përfunduar 100 ankesa dhe 20 ankesa janë ende në proces shqyrtimi. Nga ankesat e përfunduara rezultojnë se në 31 ankesa pretendimet e ankuesve kanë qenë të pabazuara, 17

ankesa kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të shqyrtimit nga Institucioni i Avokatit të Popullit, 28 ankesa kanë përfunduar të zgjidhura në favor të ankuesve dhe në 2 ankesa është përfunduar procedimi administrativ për shkak të heqjes dorë së palëve të interesuara. Gjithashtu, kemi hartuar edhe 18 rekomandime nga të cilat 7 rekomandime janë pranuar dhe rezultojnë të zbatuara plotësisht dhe 11 rekomandime janë refuzuar.

1) Gjatë këtij viti si problematikë në trajtimin e ankesave kemi konstatuar fenomenin e keqfaturimit të sasisë së ujit të pijshëm. Nga trajtimi dhe verifikimi në vend i ankesave rast pas rasti kemi konstatuar se abonentët janë nënfaturuar për një periudhë të gjatë kohe e më pas gjithë sasia e ujit e akumuluar është përfshirë në faturën e një muaji të vetëm. Kjo problematikë e cila rezulton e përsëritur në disa vite është kundërshtuar nga ana jonë nëpërmjet rekomandimeve përkatëse, pasi kemi konstatuar shkelje të interesave të ligjshme të konsumatorëve dhe dispozitave të kontratës së furnizimit me ujë të pijshëm (nenit 9 të saj). (Ankesa me **Nr. Doculive 201201746**)

Gjithashtu, në referim të shkeljeve të konstatuara më sipër kemi ndërmarrë me iniciative ex-officio hartimin e një rekomandimi (ankesa me **Nr. Doculive 201200067**), në të cilin kemi kërkuar gjetjen e një mundësie pagese me këste të detyrimit kur ai krijohet jo për faj të konsumatorëve, të cilët rezultojnë edhe të rregullt në pagesat e faturave mujore të ujit të pijshëm, por edhe që kanë pamundësi ekonomike për pagesën e këtyre faturave. Në përgjigje të këtij rekomandimi, nga "UKT sh.a.", jemi vënë në dijeni për kundërshtimin e lidhjeve të marrëveshjeve të tilla, pasi kjo praktikë ka rezultuar e pasuksesshme në vjeljen e detyrimeve përkatëse për abonentët debitorë dhe si e tillë është ndërprerë si procedurë prej vitit 2010.

2) Problematikë tjetër e konstatuar ka qenë situata për faturim të ujit në nivele të konsiderueshme edhe për persona që nuk banonin në apartamente. Në këtë kuptim kemi kërkuar nëpërmjet rekomandimeve ndërhyrjen e UKT-së për rivendojen në vend të të drejtës së shkelur ndaj konsumatorit si dhe krijimin e një mundësie sa më transparente për konsumatorët në ballafaqimin me matësin dhe faturimin e kryer. Për këto raste Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë verifikime në vend rast pas rasti, për të konkluduar nëse sasia e ujit ishte konsumuar dhe ekzistonte apo jo si gjendje në matës, me abonentët që nuk jetonin përkohësisht në banesat e tyre, dhe në rastet kur pretendimet e ankuesve kanë rezultuar të bazuara ku kemi kërkuar anulimin e këtyre faturimeve të cilat kishin krijuar në këtë mënyra edhe debi fiktive për abonentët (ankesa me *Nr. Doculive 201201489*).

3) Problematikë tjetër ka qenë edhe ndryshimi i faturimit. Prej fillimit të vitit 2012, kemi konstatuar se për abonentët të cilët në pamundësi vendosje matësi të ujit të pijshëm faturimi bëhej afrofe (me frymë sipas përbërjes familjare), por është konstatuar një rritje dhe ndryshim i menjëhershëm i këtij faturimi duke kaluar në një sasi tepër të lartë tarifimi. Pas verifikimeve në vend rast pas rasti për çdo abonent, i kemi rekomanduar "UKT sh.a.", pasi konstatuam shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, marrjen e masave për ndryshim faturimi dhe anulimin e gjithë faturimeve të kryera në mënyrë fiktive. Veçanërisht, kemi insistuar në rastet kur abonentit nuk ka në ngarkim persona të tjerë dhe në certifikatën e përbërjes familjare rezulton i vetëm (rasti me **Nr. Doculive 201202059**).

4) Problematikë tjetër gjatë këtij vitit kemi konstatuar edhe rastet lidhur me dublimin e kontratave të furnizimit me ujë të pijshëm, për të cilat ndaj "UKT sh.a.", abonentët rezultojnë

debitorë në një rën prej kontratave duke mos patur edhe dijeni se për të njëjtin sahat matës ka dy kontrata furnizimi. Lidhur me këto raste kemi ndërmarrë rekomandime dhe kemi kërkuar kryerjen e veprimeve përkatëse për rakordimin e detyrimeve të paguara nga konsumatori të vërtetuara me librezë në bazë të një kontrate të dytë, me detyrimet e kontratës që i takojnë abonentit si dhe kalimin e një rës kontratë në definitive dhe zgjidhjen e kontratës së dytë të hapur në mënyrë fiktive. (ankesa me nr.Doculive 201201487).

Krahas problematikave të përmendura më sipër, kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme edhe nëpërmjet rekomandimeve drejtuar E.Rr.U-së që të shqyrtohen, verifikohen dhe konstatohen rast pas rasti të gjitha ankesat e abonentëve dhe në rastet kur "UK sh.a." nuk ka reaguar pozitivisht ndaj një pretendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj të abonentit, kemi insistuar dhe kemi kërkuar të ndërmerren masat e nevojshme ligjore kundrejt Ndërmarrjes së "Ujësjetllës-Kanalizime sh.a.", duke vendosur edhe sanksione administrative apo monetare ndaj personave përgjegjës që janë bërë pengesë në ushtrimin e detyrave funksionale dhe që kanë dëmtuar interesat e ligjshme të konsumatorit. Gjithashtu, gjatë vitit 2012 komunikimi me "UK sh.a.", Fier është paraqitur problematik në nivel institucional, për shkak të zvarritjeve të tejzgjatura kohore për informimin dhe sqarimin tonë, në drejtim të ankesave që duheshin trajtuar nga "UK sh.a.", Fier.

Konkluzione

Institucioni i Avokatit të Popullit në të ardhmen do t'i kushtojë vëmendjen maksimale ankesave lidhur zbatimin sa më të drejtë të interesave të ligjshme të konsumatorit.

Për këtë qëllim do të vazhdojmë të rekomandojmë:

- Aktivitete intensive me entet rregullatore për mbikëqyrjen dhe respektimin e të drejtave të konsumatorëve për shërbimet publike të ofruara.
- Hartimin e marrëveshjeve për pagesa me këste të detyrimeve të krijuara jo për faj të konsumatorëve, të cilët rezultojnë edhe të rregullt në pagesat e faturave mujore të ujit të pijshëm apo edhe faturave të energjisë elektrike, dhe që kanë pamundësi ekonomike për pagesën e këtyre faturave.
- Krijimin e lehtësirave dhe mundësive nëpërmjet seancave ballafaqese midis shoqërive furnizuese dhe konsumatorit si hallkë ndërmjetëse për konstatimin dhe verifikimin e problemeve që dalin.
- Përmirësimin e shërbimit në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorit si dhe të insistojmë nëpërmjet rekomandimeve tona të shikohet mundësia edhe për përmirësimet në vijim të legjislacionit apo nxjerrjen e akteve nënligjore me qëllim gjetjen e zgjidhjeve konkrete për problematikat që paraqesin ankesat në drejtim të shërbimeve që ofrohen për këtë konsumatorë si dhe përfaqesin e legjislacionit kombëtar me standartet e kërkuara të "Acquis Communautaire".

M. E drejta për kujdes shëndetësor

Vështrim i Përgjithshëm

Kujdesi shëndetësor duhet të jetë i barabartë për të gjithë qytetarët duke siguruar standardet gjatë përmbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Kjo mundëson ofrimin e kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të kombit, gjinisë, racës, ngjyrës, fesë, gjendjes sociale, aftësive fizike dhe mendore, etj. Në vijim të përpjekjeve tona institucionale, kemi ndërmarrë nisma për evidentimin dhe vënien në dukje të të metave që ofrojnë shërbimet shëndetësore, si kusht parësor për të mënjeluar dukuritë negative dhe për të rritur me performanca serioze cilësinë e shërbimeve që ofrohen në qendrat tona spitalore.

Avokati i Popullit ka ushtruar veprimtarine e tij ne këtë fushë të te drejtave të njeriut, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e saj, bazuar në kuadrin ligjor si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.3766, datë 17.12.1963 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.8092, datë 21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor”, Ligjin Nr.7870 datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore ne Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.7895 datë 27.01.1995 neni 97, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’ etj

Veprimtaria e Avokatit të Popullit gjatë këtij viti, është fokusuar ne inspektime në Qendrat Spitalore Rajonale në shume rrethe të Shqipërisë si dhe në Qendrën Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Kujdesi shëndetësor është element i rëndësishem i së drejtës që ka çdo individ për të jetuar i sigurtë dhe i mbrojtur në vendin e tij.

Vëmendja dhe fokusimi i këtij procesi qëndron jo vetëm ne evidentimin e gjendjes se respektimit dhe zbatimit të ligjit, respektimin e të drejtave dhe lirive të individit në këto institucione spitalore, por dhe për vleresimin e funksionimit të strukturës institucionale, sipas standarteve të kërkuara konform ligjit.

Konkretisht për vitin 2012 ka pasur në total 77 ankesa apo raste me inisiativë (inspektime) në fushën e shëndetësisë. Na këto rezultojnë të përfunduara 62 ankesa, në proces shqyrtimi 15, të pabazuara 24, jashtë kompetencës 10, zgjidhur në favor të ankuesit 14, heqje dorë 1, rekomandime të pranuar 10, rekomandim të refuzuara 3. Problematikat e çështjeve që kanë të bëjnë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në varësi të saj kanë qënë kryesisht lidhur me vendimet për largimet nga detyra, problemet financiare të të larguarve, kërkesa Ministrisë së Shëndetësisë për tu kuruar jashtë shtetit, mungesa e ilaçeve në spitale si dhe kushtet infrastrukturore etj.

Analizë e rasteve konkrete

1. Në Spitalin Obsetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë

Prej disa vitesh në repartin e Pathologjisë Neonatale (reanimacioni i bebeve) punohet me ngarkesë shumë të madhe. Po t’i referohemi statistikave numri i femijeve të shtruar në këtë repart për vitin 2011 ishte 820 fëmijë, që do të thotë rreth 16 neonatë në ditë. Në këtë repart u

shërbehet fëmijëve shumë të vegjël dhe me rrezik shumë të lartë. Kjo situatë përballohet vetëm nga 16 infermiere dhe 7 mjekë. Ky personel i përgjigjet me shumë vështirësi synimeve për cilësinë e shërbimit. Aktualisht ky shërbim përballlet me një përmirësim të dukshëm të vdekshmërisë neonatale, çfarë do të thotë mbijetesë shumë të lartë të fëmijëve të lindur më pak se 1000 gram, dhe moshë barre 28 javëshe. Për të realizuar standartet e kërkuara është e domosdoshme të shikohet realizimi i kërkesave të paraqitura nga institucioni për shtimin e mjekëve dhe infermierëve në këtë shërbim. Në repartin e terapisë intensive të të porsalindurit, disponohen 20 shtreter (6 intensivë dhe 14 subintensivë). Aktualisht teknologjia në përdorim është mbi 7 vjeçare (ripërtëritja e teknologjisë duhet të bëhet çdo 5-7 vjet sipas standarteve ndërkombëtare), dhe mbi 30% e teknologjisë ekzistuese është jashtë funksionit:(e konsumuar, jo pjesë këmbimi) etj.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201200792. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar:

- Marrjen e masave për shtimin e numrit të mjekëve dhe infermierëve në repartin e Pathologjisë Neonatale pranë këtij spitali.
- Blerjen e paisjeve të reja (inkubator dhe radiant etj) për këtë shërbim për arritjen e standarteve të kërkuara.
- Shtimin në organikë të një punonjëseje sociale ose psikologe shumë e nevojshme dhe e domosdoshme në këtë institucion spitalor.

Ministria e Shendetësisë në përgjigjen e saj sqaron se për blerjen e paisjeve të reja do shihet mundësia e realizimit në buxhetin e vitit 2013 ndërsa me VKM këtij spitali i janë shtuar dy punonjës ku njëra do jetë psikologe dhe tjetra punonjëse sociale.

2. Në Spitalin Obsetrik Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldinei", Tirane

Në repartin e Pathologjisë Neonatale (reanimacioni i bebeve), ku aktualisht ky shërbim përballlet me një përmirësim të dukshëm të vdekshmërisë neonatale, çfarë do të thotë mbijetesë shumë të lartë të fëmijëve të lindur më pak se 1000 gram, dhe moshë barre 28 javëshe, nga inspektimi u konstatua mungesa e një psikologeje apo punonjëseje sociale, e domosdoshme kjo për pacientet e shtruara. Sipas statistikave ndërkombëtare 70% e grave pësojnë depresion pas lindjes së fëmijës. Shtimi në organikë e një punonjëseje të tillë do të lehtësonte këtë fenomen në rritje edhe në vendin tonë.

Nje problem shqetësues për pacientet e shtruara në këtë repart, ishin krevatet, të cilat nuk ishin funksionale dhe të rehatshëm.

-U shprehem edhe me lart, se në këtë spital, vijne shume paciente nga rrethet e tjera të vendit dhe kjo ndikon në buxhetin e këtij institucioni.

-Mungesa e fondeve, ka bërë që të mbetet ende pa u rikonstruktuar lavanteria.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201201145. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar:

- Shtimi në organikë të një punonjëseje sociale ose psikologe, shumë e nevojshme dhe e domosdoshme për këtë institucion spitalor.
- Shtimi i buxhetit, me qëllim përballimin e pacienteve të ardhura nga rrethet e tjera te vendit si dhe të rikonstruksionit të lavanterisë.

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj sqaron se problemi i punësimit të psikologes ose punonjëses sociale, do të zgjidhet brenda numrit të punonjësve të spitalit, duke bërë një ndryshim në strukturën e tij. Në planifikimin e investimeve te vitit 2013, do të shihet mundësia e planifikimit të financimit të rikonstruksionit të lavanterisë ose e kontraktimit të këtij shërbimi me kompani private. Për të zvogëluar fluksin e të sëmurëve që drejtohen në spitalet universitare, në kuader të reformës së nisur në drejtim të racionalizimit të shërbimeve, Ministria e Shëndetësisë është duke punuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, teknologjise mjekësore dhe trajnimit të stafit, në mënyrë që të sëmurëve t'ju ofrohet shërbimi në spitalet rajonale sa më pranë vendbanimit të tyre.

3. Në Spitalin Rajonal, Vlorë

Në pavionin e Kirurgjisë kishte mungesa të stafit mjekësor të kualifikuar dhe konkretisht mjek, nga 10 mjek që duhet të kishte personeli në pavionin e kirurgjise, kishte vetem 6. Mjetet e operimit dhe mjekimit ishin të amortizuara dhe kishin nevojë të rinovoheshin, në shumicën e dhomave të këtij pavioni ekziston lagështirë, mungesë ndriçimi, myk, probleme kanalizimesh, pra kishte nevojë për investime. Salla e Operimit kishte mungese të ujit të ngrohtë, koshat e plehrave në këtë sallë ishin të hapura, mungonte ndriçimi dhe nuk kishte mjaftueshëm qese izoluese për këmbët. Tualetet e urgjences ishin jashtë funksionit, pa ndriçim, me lagështire. Në pavionin e Pediatriisë, dhomat e katit të parë ishin me lagështirë, banjat e dhomave nuk kishin ndriçim, kishin myk, dhe kishte mungesë uji. Në pavionin e ORL sëmundjeve të syve, në të gjitha dhomat dhe korridor kishte lagështirë myk, dhe mungese ndriçimi. Ilaçet që mungonin në këtë pavion ishin Atropine, Azopti, Rulaskopik, Travatan. Shërbimi i Obsetrik-Gjinekologjisë ishte në gjëndje të vështirë, pasi ambjenti ku jepet ky shërbim është me shumë lagështirë. Në disa dhoma mungon ndriçimi, ngrohja e pavionit bëhej nepermjet kondicionereve, të cilët në shumicën e kohës nuk funksiononin. Mungonin detergjentet, të cilët në shumicën e kohës bliheshin nga vete mjekët dhe infermierët. Një problem shumë delikat dhe i pazgjidhur ishte problemi i asgjesimit të mbetjeve spitalore, të cilat groposeshim në një vend të caktuar nga Bashkia e qytetit dhe jo të digjeshin ne Krematorium, siç është detyrimi ligjor.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201201977. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar:

- Marrjen e masave për shtimin e numrit të mjekëve dhe të një radiologu në pavionin e Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal të Vlorës.
- Marrja e masave në lidhje me problemin e asgjesimit të mbetjeve spitalore, Gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë për drenazhimin e godinës në tërësi, në Spitalin Rajonal te Vlores,

me qëllim evitimin e lagështires në ambjentet e fjetjes dhe të ndenjës së pacientëve, zgjidhjen e problemit të sistemit të ngrohjes dhe ndriçimit.

- Për marrjen e masave për planifikimin në buxhet të fondit financiar, për furnizimin me detergjentet e nevojshem të cilët mungonin në të gjithë pavionet e Spitalit Rajonal të Vlorës.
- Marrjen e masave për përmirësimin e shërbimit të lavanterisë dhe guzhinës.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka kthyer përgjigje por Drejtori i Spitalit Rajonal, Vlorë në përgjigjen e tij sqaron se disa prej pikave të evidentuara nga ana jonë janë zgjidhur dhe për të tjerat shpreh angazhimin institucional për zgjidhje.

4. Në Spitalin Rajonal, Fier

Lavanteria e spitalit është shtetërore. Ky spital ka kërkuar nga ana ministrisë të privatizohet lavanteria dhe kuzhina por deri tani nuk është bërë asgjë. Muret në shumë vende ishin me lagështirë të madhe. Spitali nuk ka buxhet për djegiet e mbetjeve spitalore, gjë që përbën problem serioz të ndotjes së mjedisit. Një problem tjetër shqetësues ishte edhe mungesa në institucion e paisjeve hotelerike të cilat ishin shumë të amortizuara dhe konkretisht dollapët, krevatët, batanijet dhe çarçafët. Kushtet higjeno-sanitare lenë për të dëshiruar si dhe ka mungese të ndriçimit.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201201978. Pas konstatimeve të bëra, kemi rekomanduar:

- Marrja e masave në lidhje me problemin e asgjësimit të mbetjeve spitalore, Gjetjen e nje zgjidhjeje të shpejtë për drenazhimin e godinës në tërësi, në Spitalin Rajonal te Vlores, me qëllim evitimin e lagështires në ambjentet e fjetjes dhe të ndenjës së pacientëve, zgjidhjen e problemit të sistemit të ngrohjes dhe ndriçimit.
- Per marrjen e masave për planifikimin në buxhet të fondit financiar për furnizimin me detergjentet e nevojshem të cilët mungonin në të gjithë pavionet e Spitalit Rajonal të Vlorës.
- Marrjen e masave për përmirësimin e shërbimit të lavanterisë dhe guzhinës.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka kthyer përgjigje, por Drejtori i Spitalit Rajonal, Fier në përgjigjen e tij sqaron se problemet e rekomanduara nga ana jonë do jenë objekt i kërkimit dhe realizimit të fondeve për vitin 2013 nga Ministria e Shëndetësisë

5.Në Spitalin Rajonal, Berat

Pas kalimit të maternitetit si godinë më vete brënda ambjenteve të këtij spitali dhe konkretisht ne katin e parë, situata nuk ishte normale pasi dhomat e pacienteve ishin me nga 6 krevate, dhe vetëm me një tualet për të gjitha pacientet. Muret në shumë vende ishin me lageshtirë të madhe. Në repartin e Pathologjisë Neonatale (reanimacioni i bebeve) punohet me ngarkesë

shumë të madhe. Kjo pasi kishte vetëm një pediatre e cila i përgjigjej 24 orë të gjitha rasteve të urgjencave. Një problem tjetër shqetësues ishte edhe mungesa në institucion e paisjeve hotelerike të cilat ishin shumë të amortizuara dhe konkretisht dollapët, krevatët, batanijet dhe çarçafët. Kati i fundit i godinës ishte i amortizuar pasi në tavane të korridoreve dhe te tualetit, kishte lagështirë të madhe si rezultat i amortizimit të tarracës.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201202081. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar:

- Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve dhe plotësimin e nevojave, për të gjitha konstatimet që Avokati i Popullit parashtroi për Spitalin Rajonal të Beratit.

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj sqaron se do të merren masat e propozuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, mbështetur në prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë si dhe brënda mundësive të buxhetit të vitit 2013.

6. Në Spitalin Rajonal, Gjirokaster

Kishte mungesa në staf mjekësor të kualifikuar dhe konkretisht mjek anestezist dhe otojater. Shërbimi i obsetrik-gjinekologjisë është në gjëndje të vështirë, pasi ambjenti ku jepet ky shërbim është shumë i amortizuar. Konkretisht kërkohet realizimi i rikonstruksionit për të gjithë godinën e maternitetit. Një problem shumë delikat dhe i pazgjidhur ishte problemi i asgjesimit të mbetjeve spitalore të cilat groposeshim në një vend të caktuar nga Bashkia e qytetit dhe jo të digjeshin në krematorium, siç edhe duhet të ndodhë realisht. Nga drejtuesi na u shpjegua se ishte duke negociuar me Ministrinë e Shëndetësisë për zgjidhjen e këtij problemi.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201201979. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar:

- Marrja e masave për përmirësimin e kushteve dhe plotësimin e nevojave, për të gjitha konstatimet që Avokati i Popullit parashtroi për Spitalin Rajonal të Gjirokastrës.

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj sqaron se do të shihet mundësia e rikonstruksionit të ambjenteve të shërbimit obsetrik gjinekologjik, ndërsa përsa i përket trajtimit të mbetjeve spitalore në buxhetin e këtij viti, spitalit i është akorduar fondi për blerjen e një inceneritori për djegjen e mbetjeve, sigurimi i të cilit është në procesin e tenderimit.

7. Në Spitalin Rajonal, Sarandë

Mungesë të personelit mjekësor dhe konkretisht të gastrohematolog, hematolog, dy pediater dhe një kirurg. U vu re se megjithese spitali ishte i rikonstruktuar, tualetet ishin me lageshtirë por në mungesë të fondeve nuk ishin rregulluar. Ushqimi ishte i pamjaftueshem për shkak të kuotës së ulët ushqimore. Problem emergjent është gjëndja e godinës ku ndodhet materniteti, e cila ishte tërësisht e amortizuar ndërkohe që janë paraqitur projekte pranë Ministrisë së Shëndetësisë pa u marrë në konsideratë për shkak të vlerës së madhe të projektit.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201201980. Pas konstatimeve të bëra, rekomanduar:

- Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve dhe plotësimin e nevojave, për të gjitha konstatimet që Avokati i Popullit parashtroi për Spitalin Rajonale të Sarandës.

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj sqaron se përsa i përket maternitetit të qytetit, në master plan është vendosur që të afrohet në ambientet e spitalit. Ka përfunduar projekti dhe pritet të akordohet fondi për ndërtimin e tij.

8. Në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë

Pas investimit në vlerën e rreth 3 miliard lekëve akorduar nga buxheti i shtetit për rikonstruksionin e godinës së këtij spitali, ishin shfaqur edhe disa difekte teknike në disa prej ambienteve spitalore. Drejtori i spitalit kishte kontaktuar me firmën duke i kërkuar riparimin e difekteve të shfaqura. Një problem tjetër shqetësues ishte edhe amortizimi i paisjeve hotelerike si dollapë, komodina, krevatë, batanije, çarçafë etj. Vit pas viti ky institucion ka kërkuar fond për këtë zë në buxhet, por nuk është realizuar akoma. Edhe lavanderia ishte në kushte jo normale pune, me mure me lagështirë, me tavanë që pikonin pasi aty kalonin edhe tubat e kaldajës, me tuba të amortizuar që nxirrnin avull etj. Punonjëset e këtij shërbimi punonin në kushte të vështira.

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201202154. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar:

- Marrja e masave për zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga Avokati i Popullit për plotësimin e standarteve në shërbimin spitalor.

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj sqaron se do të shihet mundësia dhe zgjidhja e problemit të lavanderisë si dhe e paisjeve hotelerike nëpërmjet buxhetit të 2013-tës si dhe nga të ardhurat dytësore të vetë institucionit.

9. Në Spitalin Rajonal, Lushnjë

Kjo çështje është filluar "Ex officio" dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me nr.201202154. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar:

- Shtimin e buxhetit me qëllim rikonstruksionin total të repartit të infektivit të të rriturve, pajisjen me artikuj të rinj hotelerie për disa reparte të caktuara si dhe blerjen e mjeteve dhe aparturave të nevojshme sidomos në repartin e pediatriisë dhe gjinekologjisë.
- Krijimin e hidro-izolimit të tarracës me qëllim shmangien e lagështirës për gjithë katin e III-të të spitalit si dhe krijimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të ngrohje-ftohjes.

Jemi në pritje të përgjigjes nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Konkluzione

Vazhdon të mbetet problematikë e mprehtë e spitaleve rajonale mungesa e mjekëve të specialiteteve të ndryshme për të cilën Ministria e Shëndetësisë na bën me dije se: Në bashkëpunim me USAID-in është duke punuar në drejtim të ngritjes së sistemit të telemedicinës, e cila konsiston në funksionimin e mjekësisë në distancë, që do të ndikojë dhe në zbutjen e këtij problemi. Zgjidhja e këtij problemi do sjellë uljen e fluksit të pacientëve drejt QSUT-së apo spitaleve të tjera rajonale si Durrësi apo Vlora. Edhe mungesa e medikamenteve dhe materialeve mjeksore vlen për tu evidentuar në periudha të ndryshme të vitit, për shkak të procedurave të zgjatura të prokurimit publik për tenderimin e tyre.

Nga inspektimet e kryera si dhe nga rastet e trajtuara që lidhen me të drejtën për kujdesin shëndetësor, është arritur në konkluzionin se, në përgjithësi, shërbimet shëndetësore dhe sociale që u ofrohen individëve në këto qendra kanë nevojë për më shumë fonde investimi, plotësim organike, shpejtësi në realizimin e projekteve, përqëndrim dhe vëmendje më të madhe në trajtimin human të të sëmurëve. Inspektimet dhe vizitat e kryera në këto institucione, kanë patur një rol të madh në evidentimin e problematikave që ekzistojnë në këto institucione, lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse ku institucioni i Avokatit të Popullit ka paraqitur rast pas rasti rekomandimet përkatëse.

N. Synimi për një mjedis të shëndetshëm

Vështrim i përgjithshëm

Synimi për një mjedis të shëndetshëm ka qenë një ndër prioritetet e punës së Institucionit i Avokatit të Popullit. Problematikat e ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2012 ka qenë kryesisht të fokusuara shmangien e ndotjeve të ambientit nga agjentë të ndryshëm apo aktivitete të paligjshme e të palicënuara, ndotjen e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, hedhjen e mbeturinave në vende publike, vibrimet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në zona të prekura nga këto ndotje. Ky është i njëjti objekt i ankesave të trajtuara edhe më përpara nga ana jonë.

Gjatë vitit 2012 janë regjistruar 22 ankesa në të cilat individë të ndryshëm kanë kërkuar ndëhyrjen e Avokatit të Popullit për zbatimin korrekt të dispozitave ligjore nga organet e administratës publike për të patur një ambient të pastër dhe mjedis të shëndetshëm, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe cilësinë e tyre të jetesës.

Nga ankesat e parashtruara gjatë këtij viti, 10 raste janë zgjidhur në favor të ankuesve, 6 kanë qenë në kompetencë të organeve të tjera të administratës publike për t'u ndjekur në vijim nga ana e tyre, ndërkohë që për 3 ankesa janë dërguar edhe Rekomandime organeve respektive me qëllim që të merrnin masat e parashikuara në dispozitat ligjore për të siguruar dhe garantuar një mjedis sa më të shëndetshëm jo vetëm për ankuesit që kishin parashtruar pretendimet e tyre pranë Avokatit të Popullit, por edhe për komunitetin e zonës të prekur nga shqetësimet mjedisore. Ndërkohë që 3 ankesa kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2013.

Analizë e rasteve konkrete

Gjatë shqyrtimit të ankesave të parashtruara, Avokati i Popullit konstaton se ka në vijimësi një ndëgjegjësim të individëve për të kërkuar mbështetjen dhe reagimin e institucioneve shtetërore për mbrojtjen e mjedisit. Në krahasim me vitin 2011, gjatë vit 2012 ka patur një numër më të vogël të ankesavë të parashtruara, por që tregon për një mosveprim të strukturave qendrore dhe lokale për të ushtruar kompetencat e njohura atyre me ligj për verifikimin dhe zgjidhjen e problematikave.

Problematiche gjatë periudhës së raportimit, sidomos gjatë sezonit të pushimeve verore, janë ndotjet akustike në vijën bregdetare apo zonat e banuara të qyteteve, të cilat shkaktojnë shqetësime serioze tek pushuesit dhe qytetarët e thjeshtë.

Lidhur me ankesat e shqyrtuara dhe të zgjidhura në favor të ankuesve mund të përmendim rastin e shtetases M.S. e cila parashtrroi pretendimin e saj, edhe të një grupi banorësh të pallatit të saj, në Rrugën "A.Moisiu", Tiranë, për zhurmat dhe ndotjet që i shkaktoheshin nga një subjekt, i cili në katin e parë të pallatit ku banonin, kishte hapur dhe ushtronte aktivitetin e prodhimit dhe shitjes së bukës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ankuesja i kishte bashkëngjitur ankesës së saj, rezultoi ndër të tjera se ARM e Qarkut Tiranë i kishte refuzuar këtij subjekti pajisjen me autorizim mjedisor pasi jo vetëm nuk plotësonte asnjë standard minimal për ushtrimin e këtij aktiviteti, por edhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për përmbushjen e detyrave të lëna nga inspektorët. Ndërkohë, Instituti i Shëndetit Publik, pas kërkesës tonë, konfirmoi faktin, duke u bazuar edhe në ekspertizën e kryer nga specialistët e këtij Instituti, se aktiviteti në fjalë krijonte shqetësime reale direkte për ankuesen dhe banorët e pallatit. Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe qëndrimeve që mbajtën organet e administratës publike të përfshirë në këtë procedim, rekomandoi marrjen e masave urgjente për mbylljen e këtij aktiviteti pasi nuk plotësonte asnjë kriter për prodhimin dhe shitjen e bukës në ambiente të tilla, si dhe krijonte shqetësime të mëdha shëndetësore për banorët përmes zhurmave, tymrave dhe avujve që dilnin gjatë procesit të prodhimit të bukës. Rekomandimi u pranua dhe ankuesja na vuri në dijeni se pas reagimit të organeve shtetërore në zbatim të rekomandimit tonë, subjekti e kishte mbyllur aktivitetin në këtë ambient.

Lidhur me këtë problem, Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ nr. 2 datë 25.07.2012 "Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare", por sërish është konstatuar se nuk ka patur një zgjidhje efektive e këtij problemi. Kjo edhe për shkak të miratimit të këtij Akti në kulmin e sezonit të verës, pa marrë parasysh organizimin dhe strukturat kompetente që duhet të ngriheshin për të vepruar.

Shqetësuese paraqitet edhe situata gjatë vijës bregdetare përsa i përket largimit të ujrave të zeza të hoteleve dhe shtëpive të banimit, të ndërtuara fare pranë vijës së ujit. Në realitet, situata në plazhet publike paraqitet e papajtueshme me synimin për një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm për kryerjen e pushimeve .

Konkluzione

Avokati i Popullit konstaton se situata mjedisore dhe mbrojtja e ambienti në Shqipëri kërkojnë

një vëmendje të veçantë dhe bashkëveprim të të gjithë individëve dhe strukturave shtetërore, me qëllim që të kujdesemi për shëndetin dhe rrisim cilësinë e jetës. Ende konstatohen probleme me hedhjen mbetjeve dhe trajtimin e përpunimin e tyre, apo edhe respektimin e normave të tjera mjedisore, të cilat në këndvështrimin e parë nuk lënë pasoja, por efektet e tyre janë afatgjata, të ngadalta dhe të padukshme, duke rrezikuar seriozisht shëndetin dhe jetën e individëve.

Inspektoratet e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit në rang qarku duhet të evidentojnë detyrat dhe përgjegjësitë që u burojnë nga aktet ligjore dhe nëligjore, për të patur një kontroll sa më efikas mbi territorin në të cilin ato ushtrojnë funksionet e veta. Duhet evidentuar dhe ndëshkuar rastet e hedhjes në vende të hapura dhe djegia e lirë e mbetjeve, trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre⁹, monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike¹⁰, monitorimin dhe marrjen e masave për heqjen e mjeteve motorrike, të rimorkiove, si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare¹¹, si dhe detyra të tjera që burojnë nga larmia e akteve që rregullojnë çështjet mjedisore.

O. Problematikat e pushtetit vendor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve të tij

Vështrim i përgjithshëm

Në kuadër të detyrimeve kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron edhe veprimtarinë e njësisve të qeverisjes vendore, me qëllim që të garantohet mirëqeverisja dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.

Legjislacioni aktual që rregullon funksionimin dhe kompetencat e pushtetit vendor është i plotë, por niveli i zbatimit të tij në veprimtarinë ekzekutive, kryesisht të komunave, paraqitet i dobët, në krahasim me performancën që kanë administratat e bashkive të mëdha.

Ashtu siç e kemi theksuar edhe në raportet e mëparshme tonë, në administratën e disa organeve të qeverisjeska probleme me formulimin e akteve administrative, mungesën e referencave ligjore, mënyrën e procedimit administrativ, mosrespektimin e afateve ligjore, shkeljen e parimeve të tilla si bashkëpunimi i administratës me personat private, përgjegjshmërinë e organeve dhe nëpunësve të tyre, përfundimin e procedimit me marrjen e një vendimi, të drejtën për të informuar individët, konflikt të interesave në vendimmarrje, lidhjet gjinore apo farefisnore mes pushtetarëve lokal dhe banorëve, duke sjellë edhe subjektivizëm në vendimmarrje ose edhe në ekzekutim të akteve administrative apo planeve konkrete të njësisve të qeverisjes vendore. Të gjitha këto pasqyrohen në një nivel të ulët shërbimi të administratës ndaj qytetarit, zvarritje në zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë banorët e zonave nën juridiksionin tyre, si dhe mohim të standarteve të një administrate në shërbim të individit.

9 Shih Rregullore Nr. 1, datë 30.03.2007 të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

10 Shih VKM Nr. 587 datë 07.07. 2010.

11 Shih Aktin Normativ nr. 3 datë 07.09.2011.

Analizë e rasteve konkrete

Nga ankesat e paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet një shqetësim i individëve lidhur me detyrimin e komunave dhe bashkive për mbrojtjen e mjedisit, funksionin e parashikuar në nenin 10, pika 2/ "f", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave, si dhe ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit" që disiplinon marrëdhëniet ndërmjet individit, komunitetit dhe mjedisit. Ky shqetësim është konstatuar edhe më përpara në raportet tona vjetore, por me keqardhje vëmë re se nga ana e njësive të qeverisjes vendore nuk po i kushtohet një rëndësi e veçantë zbatimit dhe respektimit rigoroz të kompetencave të tyre në këtë fushë.

Nga ankesat e regjistruar pranë institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton se 18 ankesa kanë qenë ndaj Prefekturave dhe organeve në varësi siç është Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, 532 ankesa ndaj Bashkive, 125 ankesa ndaj Komunave si dhe 6 ankesa ndaj Qarqeve.

Nisur nga numri i lartë i ankesave që parashtrohen ndaj këtyre organeve të pushtetit vendor, vihet re një zbatim jo korrekt i dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Ashtu si edhe në vitet e kaluara, mungesa e bashkëpunimit të shumë njësive të qeverisjes vendore me komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë prefektëve të qarqeve, sipas ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" mbetet ende një nga shkaqet për zvarritje të procedimeve administrative dhe më pas gjyqësore, pra efektshmëri të ulët të Komisioneve, mandati i të cilëve, në bazë të ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, është shtyrë tashmë deri në 31 dhjetor 2013.

E drejta për informim gjatë procedimit administrativ

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 23 parashikon se: "E drejta e informimit është e garantuar". Kjo e drejtë parashikohet edhe në ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumenta zyrtarë", në nenin 18 të të cilit parashikohet kompetenca e Avokatit të Popullit për zbatimin e këtij ligji, që siguron dhe garanton transparencën e organeve të administratës publike në marrëdhënie me shtetasit. Kodi i Procedurave Administrative e parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike. (Kjo përbën bazën ligjore dhe është e njëjtë me raportin e kaluar)

Nga ankesat që janë shqyrtuar, rezulton se nga ana e administratës vendore nuk respektohet dhe nuk zbatohet e drejta për informim gjatë zhvillimit të një procesi administrativ, ndaj atyre subjekteve të së drejtës administrative që kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose të ligjshëm në këtë proces. Problematika e shqyrtuar nga ana jonë gjatë vitit 2012 është e njëjtë me vitet e kaluara. Më konkretisht kemi vënë re se palët nuk njoftohen për fillimin apo përfundimin e gjykimit administrativ, thirrjen për marrjen pjesë si palë, kur çënohen interesat e tyre, si dhe ka tejkalim të afateve ligjore për vënien në dispozicion të informacionit apo akteve zyrtare që individët kanë kërkuar, duke respektuar procedurat që aplikojnë këto organe të qeverisjes vendore, por që nuk përebusin më pas detyrimet e tyre ndaj individëve.

Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga A.L.U.I.Z.N.I. në Qarqe

Gjatë shqyrtimit të ankesave rezulton se një pjesë e konsiderueshme shtetasish kërkojnë të informohen zyrtarisht, për ecurinë e procedurës së legalizimit të objekteve të ndërtuara prej tyre pa leje ndërtimi, por që kanë paraqitur brenda afateve ligjore formularin e vetëdeklarimit. Në këtë kuadër, është konstatuar një fluks i madh kërkesash për informim lidhur me aplikimin e paraqitur nga shtetas pranë A.L.U.I.Z.N.I.-t të qarkut për legalizimin e ndërtimeve informale, pronë të tyre, për të cilat nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Lidhur me këto raste, problematike paraqitet zyra e A.L.U.I.Z.N.I.-t të qarkut Tiranë, për shkak edhe të fluksit të madh të kërkesave dhe dosjeve që përpunohen. Nisur nga problematika e disa ankesave të parashtruara, Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorit të kësaj zyre, duke vënë në dijeni edhe Drejtorinë e Përgjithshme të A.L.U.I.Z.N.I. që të na vihej sa më parë në dispozicion informacioni zyrtar mbi dosjet e ankuesve, si dhe të shmangeshin zvarritjet e vazhdueshme në kthimin e përgjigjeve dhe informimin zyrtar edhe të vetë institucionit të Avokatit të Popullit. Rekomandimi u pranua duke na vënë në dispozicion informacionin e kërkuar për rastet e përshkruara në rekomandimin tonë, i cili iu përcoll më tej ankuesve të veçantë.

Mosveprim i organit të administratës vendore

Ankesat e paraqitura pranë Avokatit të Popullit për mosveprim të organeve të administratës vendore, i referohen veprimtarive të I.N.U.V.-ve të bashkive/komunave, si dhe në një rast të ndërmarrë me iniciativë për Komunën Luz i Vogël lidhur me dhënien e lejes së ndërtimit për një objekt, shqyrtimi i mëtejshëm i së cilës ka kaluar në organet gjyqësore.

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 janë paraqitur 106 ankesa me objekt mosveprimin e Inspektorateve Ndërtimore Urbanistike Vendore në verifikimin e ndërtimeve të paligjshme, marrjen e masave dhe sanksioneve ligjore ndaj kundravajtësve, si dhe mosekzekutim të vendimeve për prishje.

Mosveprimi i Inspektoriatit Ndërtimor, në rang komune, bashkie apo kombëtar, në shumë raste përbën shkak dhe burim për konflikte dhe mosmarrëveshje mes palëve si dhe zvarritje të mëtejshme të tyre në organet e prokurorisë apo ato gjyqësore me qëllim që të vihet në vend e drejta e shkelur apo të pushohet cënimi i pretenduar. Veprimi në kohë dhe zbatimi rigoriz i dispozitave ligjore do të shmangte burokracitë dhe do të sillte një pozitë më të sigurtë juridike për qytetarin dhe pronën e tij.

Lidhur me procedurat e kompesimit për efekt shpronësimi për interes publik, pranë Avokatit të Popullit janë paraqitur ankesa ku janë parashtruar pretendime për përdorim të pronës për interes publik pa respektuar procedurat e shpronësimit.

Gjatë vitit 2012 janë regjistruar gjithsej 11 ankesa me objekt zvarritje të procedurave të kompesimit për efekt shpronësimi. Kështu mund të përmendim ankesën me **nr. doc. 201200337**, ku shtetas bashkëpronarë të pasurive të paluajtshme u ankuan për mospërfundim të procedurave të shpronësimit në favor të tyre, ndërkohë që për interes të ndërtimit të veprës publike, "Unaza e madhe e Tiranës", aktualisht firma e kontraktuar për këtë qëllim po kryente punime, të cilat në referim të dispozitave ligjore në fuqi, u konsideruan cënim flagrant i të drejtës së pronësisë.

Avokati i Popullit pas kryerjes së veprimeve procedurale dhe përfundimit të informacionit zyrtar nga organet respektive shtetërore, rekomandoi përfundimin e procedurave administrative për kompesimin për efekt shpronësimi të këtyre banorëve. Ky rekomadim u pranua nga Komisioni i Posacëm i ngritur për këtë qëllim.

Nga ana tjetër, mund të përmendim edhe ankesën e banorëve të fshatit Bestrovë, Komuna Qendër, Vlorë, pronarë në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar, të cilët ankoheshin për cënim të pronës së tyre nga ushtrimi i stërvitjes të Brigadës të Stërvitjes Bazë në Bunavi. Pas kryerjes së hetimeve, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e masave për kompensimin për efekt shpronësimi të banorëve, si dhe pushimin e cënimit të pronës së tyre. Në përgjigjen e tij, drejtuesi i Qendrës së Stërvitjes Individuale, vlerësoi maksimalisht Rekomandimin tonë për ndërprerjen e cënimeve të pronësisë së tokave të banorëve të fshatit Bestrovë, pronarë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar, në ZK me nr.1173, nga ushtrimi i stërvitjes të Brigadës të Stërvitjes Bazë në Bunavi, duke e konsideruar prioritet vijimin e procesit të shpronësimit, duke synuar njëkohësisht minimizimin e përdorimit të sipërfaqeve jashtë planvendosjes të QSI-së për qëllime stërvitore.

Respektimi i afateve ligjore

Mos respektimi i afateve ligjore, si në trajtimin e ankesave apo kërkesave të personave fizikë dhe juridikë privatë nga organet e administratës vendore, ka qenë dhe mbetet një problem mjaft i mprehtë, i konstatuar nga ana e Avokatit të Popullit edhe në raportet e kaluara. Mosrespektimi i afateve ligjore i referohet kryesisht veprimtarisë së I.N.U.V.-ve në Bashki dhe Komuna

Konstatimi i kundravajtjeve si dhe mosekzekutimi i vendimeve për prishje të marra nga I.N.U.V.-të brenda afateve ligjore, është tashmë një realitet shqetësues. Aksionet që ndërmerren herë pas here nga INUV janë selektive dhe nuk japin asnjë efekt në shmangien e ndërtimeve pa leje, për të cilat janë ngritur konkretisht këto Inspektorate. Inspektorët respektive nuk ushtrorin funksionet e tyre që në momentin e fillimit të punimeve të paligjshme, të cilat denoncohen nga individë të ndryshëm të cënuar nga këto punime. Në vijim, Inspektorët justifikoen me pamundësinë për të vepruar pasi tashmë ndërtimet kanë përfunduar, janë të banuara apo kanë shkaqe objektive për skak të mungesës së mjeteve.

Në qytetet e mëdha, I.N.U.V funksionon deri në momentin e konstatimit të objektit të kundërligjshëm, nxjerrjen e akteve përkatëse për pezullim të punimeve, si dhe vendimeve për prishje, e përfundimisht mosekzekutimin e tyre në tejkallim të afateve ligjore, parashikuar në ligjin nr. 9780 date 16.07.2007, "Për inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar, neni 13/3 ku parashikohet se "Vendimet e I.N.U.V të bashkisë / komunës / qarkut / kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë. Përjashtimisht vendimet për prishjen e ndërtimit të kundraligjshëm kanë afat deri në 30 ditë".Kjo është e njëjta problematikë konstatuar edhe në raportin e vitit të kaluar, por që sërish përbën një shqetësim serioz në veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore. Nga mosveprimi në kohë, tashmë është bërë praktikë punës që subjekte të veçantë apo firma ndërtimi, ndërtojnë në shkelje të hapura me lejet e ndërtimit, respektimi i të cilave duhet bërë nga INUV, dhe më pas procedojnë me deklarimin e tyre për legalizim pranë zyrave rajonale të ALUIZNI në rang qarku.

Në Bashkitë e vogla dhe në komuna, mosveprimi i INUV dhe respektimi i dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit vjen edeh nga lidhjet nepotike, të gjinisë, farefisit apo edhe mbi baza të bindjeve politike të drejtuesve vendorë me subjektet që duan të ndërtojnë.

Marrëdhëniet e punës

Gjatë vitit 2012 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 58 ankesa për ndërprerje të marrëdhënieve të punës nga ana e punëdhënësit apo edhe zvarritje e parregullsi në pagesat e punëmarrësve. Avokati i Popullit ka kryer procedurat e shqyrtimit dhe hetimit të pretendimeve të ankuesve, por në shumë raste ka qenë i vështirë rikthimi në punë i ish-punonjësve, për shkak edhe të zëvendësimit të menjëhershëm të tyre dhe pamundësisë financiare për të shlyer pagat e tyre.

Strehimi

Strehimi është një problem i mprehtë, serioz dhe shqetësues për shoqërinë tonë. Gjatë vitit 2012 janë regjistruar 272 ankesa në thelb të cilave kanë patur problemet e strehimit të ankuesve dhe familjarëve të tyre. Avokati i Popullit i ka orientuar të interesuarit të përebusin kriteret ligjore për përfitimin e statusit të të pastrehit.

Gjatë muajve të parë të vitit 2012 Avokati i Popullit ka ndjekur dhe hetuar çështjen e strehimit të familjeve romë, rezidente në disa zona të qytetit të Tiranës, të cilat për disa javë me rradhë u strehuan në ambientet e brendshme të institucionit. Ankuesit shpreheshin se, së bashku me familjet e tyre, jetonin në baraka, në kushte tejet të vështira jetese, pa plotësuar asnjë nga nevojat minimale të jetës së përditshme. Pas komunikimit zyrtar me Bashkinë e Tiranës dhe institucione të tjera që mbulonin problemet e komunitetit rom, Avokati i Popullit u informua mbi statusin e aplikimeve respektive të secilës familje për të përfituar nga programet sociale të Bashkisë Tiranë. Ndërkohë, me insistimin e Avokatit të Popullit dhe në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrinë e Mbrojtjes, me Vendimin nr. 51 datë 02.02.2012 të Këshillit të Ministrave u vu në dispozicion një truall dhe ambientet respektive të një ish-reparti ushtarak në Sharrë për ta përdorur për sistemimin dhe ngritjen e një vendqëndrimi të përhershëm për familjet e komunitetit romë. Avokati i Popullit ka inspektuar disa herë këtë vendqëndrim dhe ka konstatuar se nuk është kryer ende asnjë investim me qëllim plotësimit standarteve minimale të jetesës për ato familje që duhet të strehoeshin aty. Sa më sipër kemi vënë në dijeni Kryeministrin dhe kemi kërkuar reagimin konkret të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga VKM nr. 51 datë 02.02.2012. Në vijim të këtij Rekomandimi, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në dt. 18.02.2013, na bën me dije se ka parashikuar fondin prej 8,000,000 lekë për ndërhyrje fillestare, i cili do të pasohet nga një fond prej 22,000,000 lekësh të parashikuara në fushat e investimit për të kryer rikonstruksionin e këtyre ambjenteve në vazhdimësi.

Në përgjithësi, Avokati i Popullit konstaton se për shtresa të caktuara të popullsisë, të cilat vuan një jo vetëm probleme të strehimit, plotësimi dhe përmbushja e kërkesave dhe kriterëve ligjore, është shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, duke sjellë një mënjanim të tyre nga lista e subjekteve përfitues të programeve sociale që aplikojnë organet e pushtetit vendor

Policia Bashkiake

Avokati i Popullit ka ndjekur dhe shqyrtuar gjate vitit 2012 edhe ankesa të parashtruara nga individë të ndryshëm ndaj policisë bashkiake, si një organ në varësi të Kryetarit të Bashkisë për monitorimin dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore. Me vëmendje të veçantë është hetuar dhe monitoruar veprimtaria e policisë Bashkiake në Tiranë, e cila për një periudhë të caktuar u fokusua ndaj antarëve të komunitetit Rom duke bllokuar aktivitetin e tyre të përditshëm si edhe mjetet e tyre lëvizëse, si i vetmi burim i sigurimit të të ardhurave të jetesës. Konkretisht, pjesëtarë të komunitet Rom të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme ngritën shqetësimin mbi sekuestrimin dhe ndalimin e mjeteve të punës së këtij komuniteti, nga Policia Bashkiake Tiranë. Ata raportuan se prej më shumë se tre javësh, përveç sekuestrimit të mjeteve motorike, mbetjeve të grumbulluara dhe vënien e gjobave, anëtarëve të këtij komuniteti nuk u lejohej grumbullimi i materialeve të riciklueshme si plastikë, letër, metale etj, pavarësisht nëse këto i mbledhnin nëpër kontenier të mbetjeve urbane, apo në burim. Gjatë procesit të sekuestrimit, u raportua nga ana e tyre se inspektorë të Policisë Bashkiake kishin ushtruar dhunë verbale dhe fizike ndaj anëtarëve të këtij komuniteti.

Institucioni i Avokatit të Popullit pa paragjykuar qëllimin e ndërhyrjes dhe bazueshmërisë ligjore të këtyre veprimeve nga Bashkia e Tiranës, të cilat mund të ishin edhe në të mirë të interesit publik, ndërmoi hapa ligjorë për verifikimin e kësaj shtate, duke kërkuar shpjegime dhe aktin administrativ, i cili kishte orientuar si prioritet të funksionimit të Policisë Bashkiake Tiranë, sekuestrimin e të vetmit mjet jetese të një numri të konsiderueshëm shtetasish të këtij komuniteti, si dhe dokumentacionin përkatës sipas të cilit legjitimohej bllokimi dhe mbajtja e mjeteve, pranë ambienteve të Policisë Bashkiake Tiranë. Duke mos pasur një përgjigje zyrtare nga ana e strukturave të bashkisë dhe duke ju referuar ankesave të këtij komuniteti, Avokati i Popullit konstatoi problematikat e mëposhtme:

1. Gjatë procesit të ndalimit dhe sekuestrimit, Policia Bashkiake përveç mjeteve të punës kishte sekuestruar edhe të gjitha materialet e riciklueshme të mbledhura para bllokimit, si dhe kishte gjobitur personat e ndaluar.
2. Anëtarë të komunitetit Rom, të “vetëpunësuar” në këtë aktivitet si e vetmja mundësi e ofruar në vite, dhe duke mos u njohur me asnjë paralajmërim paraprak për ndalimin e këtij lloj aktiviteti, kishin investuar në blerjen dhe/ose përshtatjen e mjeteve të transportit për këtë qëllim, si mënyra e vetme për të siguruar të ardhura për mbulimin e kostove bazë të jetesës.
3. Në të njëjtën situatë emergjente, krijuar si rezultat i ndalimit të këtij aktiviteti në mënyrë të menjëhershme dhe i pashoqëruar me masa tranzitore dhe zbutëse përveç 92 individeve Rome të cilëve u ishin sekuestruar mjetet dhe ndëshkuar me gjoba, vlerësohej të ishin mbi 700 familje Rome në Tiranë, të përfshira në mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme, si të vetmin burim të ardhurash.
4. Ky komunitet nuk ka mjet tjetër për sigurimin e të ardhurave të domosdoshme me qëllim përmirësimin apo ruajtjen e situatës ekonomike të anëtarëve të komunitetit rom të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme.

5. Nga procedura e ndjekur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, por edhe nga ankesat dhe kërkesat e vetë qytetarëve Rom, konstatoam mungesë të transparencës nga strukturat e bashkisë, përfshirë këtu edhe Policinë Bashkiake. Edhe nga takimet e zhvilluara me këtë komunitet dhe me përfaqësues të OJF-ve që mbrojnë të drejtat e tyre, kemi konstatuar që Bashkia nuk ka zhvilluar diskutime paraprake me vetë pjestarë të këtij komuniteti, si grup i drejtpërdrejtë i prekur nga veprimet e Bashkisë dhe i interesuar për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

6. Nga OJF-të që mbrojnë të drejtat e komunitetit Rom u informuam se Bashkia e Tiranës, ka filluar procedura ndërmjetësimi për punësimin e qytetarëve rom. Përveçse me strukturat dhe ndërmarrjet e vetë bashkisë, kjo e fundit kishte marrë përsipër punësimin e tyre edhe në sipërmarrje private. Bazuar në nenin 19 të Kodit të Punës, Bashkia e Tiranës duhet pasi të negociojë drejtpërdrejtë me vetë individët e interesuar, t'i përcjellë më tej ata pranë autoriteteve që ka përcaktuar dispozita e Kodit të Punës, pra pa i ndërmjetësuar drejtpërdrejt vetë me subjektet private për punësimin e tyre.

Sa më sipër Avokati i Popullit rekomandoi:

- Ndërprerjen e veprimeve arbitrare dhe denigruese ndaj antarëve të komunitetit rom, të cilët për të siguruar jetesën e tyre detyrohen të merren me grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme.
- Nga ana e Bashkisë së Tiranës të ndërmerret inisiativë për konsultim të përbashkët rreth impaktit social-ekonomik, që ka sjellë ky urdhër duke parashikuar masa tranzitore apo për të siguruar një alternativë tjetër, për sigurimin e të ardhurave të domosdoshme me qëllim përmirësimin e situatës ekonomike të anëtarëve të komunitetit rom të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme.
- Angazhimin e komunitetit Rom jo vetëm si aktor por edhe si pjesëmarrës aktiv në vendimmarrje.
- Pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe vetë pjestarëve të komunitetit Rom, në hartimin e politikave vendore që Bashkia e Tiranës duhet të ndjekë për punësimin e tyre, të cilat duhet të jenë në përputhje me politikat e legjislacionit në fuqi. Zbatimi i tyre të bëhet nëpërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse të përcaktuara nga ligji.

Institucioni i Avokatit të Popullit do jetë gjithnjë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të Komunitetit Rom si pjesë e shoqërisë ashtu siç mbron interesat dhe të drejtat e kategorive të tjera në nevojë. Gjithashtu, Avokati i Popullit do të jetë i hapur për çdo bashkëpunim institucional shtetëror dhe shoqëror, i cili do sjellë mbrojtjen dhe respektimin denjësisht të Komunitetit Rom në të gjitha fushat. Përmirësimi i kushteve të jetesës së Romëve duhet të jetë një angazhim i të gjithë aktorëve dhe faktorëve shtetëror, në kuadrin e Dekadës së Përfshirjes së Romëve, si një kusht për marrjen e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Europian.

Krahas Rekomandimeve konkrete për përmirësimin e kushteve të jetesës në vendqendrimin e Romëve në Sharrë, Avokati i Popullit i ka Rekomanduar Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ndërmarjen e iniciativës për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të

Ministrave nr. 787/2005, "Për pëcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike" i ndryshuar, duke propozuar ndryshime konkrete me qëllim që anëtarë të komunitetit Rom të kenë mundësi të jetojnë në të njëjtin standard jetese me pjesën tjetër të popullsisë në vendin tonë. Lidhur me përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetesës së anëtarëve të komunitetit Rom në zona të caktuara të komunave dhe bashkive në mbarë Shqipërinë, Avokati i Popullit i Rekomandoi Ministrin të Punëve Publike dhe Transportit, iniciimin e procedurave për ndryshimin e ligjit nr. 9232/2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane", i ndryshuar, duke sugjeruar shtimin e pëcaktimeve që do të rregullonin strehimin e qytetarëve Romë. Përsa i përket regjistrimit të popullsisë Rome, Avokati i Popullit i ka Rekomanduar Ministrin të Brendshëm që në Ligjin Nr.10129 datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar, të parashikohen dispozita tranzitore të kufizuara në kohë, të cilat të konsiderohen si masa të veçanta të përkohshme për këtë komunitet, me synimin e integritit të tyre social. Konkretisht kemi propozuar:

- Të ndërmerret iniciativa për ndryshime në Ligjin Nr.10129 datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", në mënyrë që brenda një afati të kufizuar kohor (të paktën 1 vjeçar), të lehtësohen nga afatet e parashikuara në ligj, si dhe t'u njihet mundësia e regjistrimit apo ndryshimit të vendbanimit edhe nëse nuk plotësojnë dokumentacionin e parashikuar për këtë qëllim, në gjendjen civile ku janë vendosur aktualisht.

- Në nenin 15, në fund të pikës 3 kemi propozuar që të shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

"Familjet e minoritetit rom të cilat do të regjistrojnë ndryshimin e vendbanimit, në bane-sa që nuk kanë statusin e vendbanimit, përjashtohen nga afati i përcaktuar në këtë pikë, deri në 31.12.2013."

- Në nenin 22, në fund të pikës 1, kemi propozuar që të shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

"Për familjet e minoritetit rom, zyra e gjendjes civile në territorin e të cilës janë vendosur, regjistron deklarin e vendbanimit të tyre edhe nëse nuk paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në këtë pikë, të këtij neni."

Lidhur me qëndrimin e mbajtur ndaj këtij rekomandimi, Ministri i Brendshëm, na ka vënë në dijeni se do të ngrihet një grup pune për këtë problem, ku do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit. **Përmbajtjet në Shkodër**

Avokati i Popullit që në ditët e para të ushtrimit të funksionit të tij kushtetues ka kryer një vizitë në zonat e përmbytura në Bashkinë e Shkodrës si dhe komunat Bërdicë e Anamali, duke kontaktuar me drejtues të pushtetit lokal dhe banorë të këtyre zonave. Shqetësimet dhe problemet serioze të këtyre banorëve u administruan, si dhe u ndoqën procedura hetimore me organe të pushtetit lokal dhe më tej edhe në nivel qendror me qëllim që të shmangeshin zvarritjet e mëtejshme të kompesimiti financiar të këtyre banorëve.

Në përfundim të procedurave të ndjekura, Avokati i Popullit hartoi një Raport të Veçantë me anë të të cilit ka njohur Kuvendin e Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave me situatën e krijuar dhe masat që duheshin marrë nga autoritetet shtetërore respektive për të zbutur pasojat e përmbytjes dhe përmbushur detyrimet ligjore që burojnë nga Vendimi i Këshillit të Ministrave

nr. 842, datë 06.12.2011. Ky raport nuk është diskutuar ende në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk kemi patur asnjë reagim zyrtar nga institucionet të cilave u jemi drejtuar. Duke pasur parasysh edhe gjendjen e krijuar si dhe periudhën në prag të dimrit, Avokati i Popullit, rekomandoi se duheshin alokuar sa më parë fondet nga KESH në një Depozitë të veçantë të Qeverisë Shqiptare, si dhe duhet të zbatohet vendimi i Këshillit të Ministrave për dëmshpërblimin e banorëve të Shkodrës, të cilët kanë pësuar dëme serioze në banesat dhe orenditë e tyre shtëpiake.

Taksat lokale

Avokati i Popullit, mbi bazën e shumë ankesave individuale të prezantuara nga qytetarët, por dhe nga informacioni i marrë nëpërmjet medias së shkruar, ka ndjekur me iniciativë çështjen e aplikimit dhe mbledhjes së taksave lokale. Pas administrimit të dokumentacionit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, Avokati i Popullit i rekomandoi Kryetarit të Bashkisë dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak Tiranë përjashtimin e kategorive në nevojë nga detyrimi i taksës së pastrim-gjelbërimit, kur kanë persona të tjerë në ngarkim deri në moshën 25 vjeç, si dhe të konsumatorëve që kanë aplikuar me kërkesë për pezullim të përkohshëm të ujit në banesë, për arsye të mospërdorimit të ambienteve respektive. Në përgjigje të Rekomandimit tonë, Kryetari i Këshillit Bashkiak Tiranë u shpreh se, Rekomandimi do të shtrohet për diskutim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Konkluzione

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të administratës, në këtë rast vendore, detyrimisht sjell impakt pozitiv për mirëqeverisje nga ana e këtyre organeve. Pushteti vendor duhet të garantojë të gjitha shërbimet dhe të përmbushë detyrimet ligjore ndaj të gjithë individëve. Duhet patur parasysh zbatimin efektiv dhe ushtrimin brenda afateve ligjore i këtyre kompetencave, duke u fokusuar kryesisht në rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, respektimin dhe përmbushjen e të drejtës së tyre për informim për të gjitha fushat që u garantohen me ligj, trajtimin e barabartë të individëve në programet sociale, apo edhe dhënien në kohë të ndihmave ekonomike dhe sociale për familjet, të cilat në mjaft raste i kanë edhe burim të vetëm jetese. Kjo do të rriste besimin e publikut në organet e pushtetit vendor, përmirësonte shërbimet që u ofrohen individëve, por do të kontribuonte edhe në ngritjen në një nivel më të lartë të vetë administratës lokale, si shërbëtoreshë e të gjithë individëve që janë nën juridiksionin e saj, pa patur dallime apo paragjykitime.

P. Trajtimi i ankesave të të përndjekurve politikë

Vështrim i përgjithshëm

Një grupim ankesash të cilat janë marrë në shqyrtim nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012, janë ankesat apo kërkesat e individëve ish të dënuar politikë të regjimit komunist, apo të trashëgimtarëve dhe të afërmeve të tyre. Numri i përgjithshëm i këtyre ankesave për vitin 2012, është 45.

Problematikat e parashtruara në këto ankesa, apo kërkesa kanë të bëjnë me pretendimet

për: mospërfitimin në mënyrë të padrejtë të dëmshpërblimit në kushtet e cilësuar nga ligji nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar; mosgjetjen e eshtrave të të afërmeve ish të dënuar politikë, të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; mospërfitimin e kësteve të dëmshpërblimit që përfitojnë si ish të dënuar politikë; caktimin jo korrekt të masës së dëmshpërblimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë; zvarritjen e procedurave për caktimin e masës së dëmshpërblimit; mosgjetjen e mundësive reale të futjes në përdorim të letrave me vlerë të përfituara si ish të dënuar politikë; mundësimin e marrjes së shumës totale të dëmshpërblimit në mënyrë të menjëhershme dhe jo sipas radhës së kësteve të përcaktuara; zvarritjen e procesit të dëmshpërblimit për grupimin e të internuarve, sipas parashikimeve të ligjit; trajtimin me ndihmë sociale nga shteti për këtë kategori.

Nga ankesat dhe kërkesat e marra në shqyrtim rezulton se, janë ende në shqyrtim 6 prej tyre, ndërsa për 39 të tjera ka përfunduar shqyrtimi. Nga ankesat dhe kërkesat e përfunduara rezulton se, 9 kanë qenë jashtë kompetencave tona, 21 kanë rezultuar të pabazuara, 7 janë zgjidhur në favor të ankuesve, apo kërkuarve, ndërsa 2 kanë rezultuar jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

Një zhvillim i ri në kuadër të kërkesave që, ish të dënuarit politikë kanë parashtruar për zgjidhje për realizimin e të drejtave të tyre individuale gjat vitit 2012, ka qënë greva e urisë së një grupi ish të dënuarish politikë, e cila u zhvillua në një ambient të hapur në Tiranë, gjatë kohështirjes së muajve Shtator-Tetor 2012.

Në datën 3.10.2012 grupi i grevistëve të urisë, ka paraqitur një kërkesë për ndërhyrje në Institucionin e Avokatit të Popullit, ku parashtroheshin këto problematika kryesore:

- Zhdëmtimi i plotë dhe i menjëhershëm i të burgosurve politikë në shumën e llogaritur paraprakisht, sipas ligjit.
- Përfitimi nga shërbimet sociale shtetërore të të gjithë të burgosurve politikë, aktualisht pa përkrahje dhe të vetmuar.
- Garantimi i përgjithshëm i shërbimit mjekësor falas për të gjithë të burgosurit politikë.
- Futja në përdorim e letrave me vlerë, në vlerën e tyre reale.
- Marrja e masave të shpejta për mundësimin e punësimit të ish të burgosurve politikë.
- Ndërhyrje për miratimin në Kuvend të projekt ligjit që mundëson trajtimin e dosjeve të vonuara të të burgosurve-dënuarve politikë, që nuk kanë mundur të përfitojnë dëmshpërblim deri tani dhe amendimin paraprak në këtë projekt ligj për disa përcaktime të bëra në të.

Kërkohej gjithashtu, ndërhyrje për ndryshim apo propozim të nxjerrjes së legjislacionit të ri, për:

- Shtimin në masën 30% të vlerës përkatëse nominale të llogaritur si dëmshpërblim për çdo ish të burgosur politik, si pasojë e inflacionit që ka ndodhur në vend për vitet 2007-2012.
- Lidhjen e një pensioni të posaçëm për të gjithë të burgosurit politikë, të cilët aktualisht janë gjallë, sikurse është parashikuar në ligjin nr.7703 datë 11.09.1993, në nenin 5/c, si dhe në VKM nr.429 datë 12.09.2002.
- Amendimin e legjislacionit në fuqi, pasi ka persona ish të burgosur politikë, që nuk kanë patur mundësi për arsye të ndryshme, që të përgatisin dokumentet për marrjen e dëmshpërblimit brenda afatit që përcaktonte ligji.

Bazuar në këto problematika, të cilat paraqesnin një kompleksitet kërkesash dhe rrugë zgjidhjesh dhe pas një analize të kujdesshme të legjislacionit në fuqi, i cili rregullon çështjet dhe marrëdhëniet juridike konkrete të prekura në kërkesën e grevistëve të urisë, i jemi drejtuar me anë të shkresës sonë nr.K3/G60-4 datë 15.10.2012, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave, Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Në këtë shkresë është bërë një përmbledhje e gjithë problematikës dhe rrugëve të mundshme ligjore të zgjidhjes së tyre, duke gjykuar se pas ditëve të kaluara të grevës së urisë, kishte ardhur koha të mendohej seriozisht për një zgjidhje të gjithëpranuar nga palët, duke i sugjeruar institucioneve respektive të administratës publike se, mënyra e duhur për të gjetur rrugën e zgjidhjes ishte fillimi dhe zhvillimi i një procesi negocimi me grevistët, për kërkesat e parashtruara prej tyre.

Pavarësisht përfundimit të grevës së urisë, kësaj kërkesë për bashkëpunim në të mirë të procesit, i është përgjigjur vetëm Ministria e Financave, ndërkohë që ka munguar përgjigja nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Duke e konsideruar problematikën e parashtruar nga grevistët e urisë si aktuale, shqyrtimi i saj është parë në një këndvështrim shumë më të gjerë se sa momenti i inicimit të grevës. Për këtë arsye, për të patur një tablllo të plotë dhe të qartë të procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, i jemi drejtuar në vazhdim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për dhënien e informacionit, në lidhje me çështjet në vijim:

1. Sa është numri total i aplikantëve që kanë paraqitur kërkesë, për të përfituar në bazë të kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar?
2. Sa nga ky numër total aplikantësh kanë paraqitur kërkesat e tyre brenda afatit të përcaktuar në ligj dhe sa prej tyre jashtë këtij afati?
3. Sa është numri i kërkuesve të cilëve iu është miratuar kërkesa për dëmshpërblim, të cilët kanë kaluar për miratimin e dëmshpërblimit financiar në Këshillin e Ministrave. Sa nga ky numër janë ende në proces miratimi në Këshillin e Ministrave?

4. Nga numri total i ish të dënuarve politikë, i miratuar me VKM, për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, sa prej tyre kanë përfituar një apo më shumë këste të dëmshpërblimit të miratuar?
5. Sa këste janë shpërndarë deri më sot për ish të dënuarit politikë, të cilëve iu është miratuar me VKM dëmshpërblimi financiar?
6. A ka qënë i mjaftueshëm buxheti i vënë në dispozicion vit pas viti, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 12, të Ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, për të shlyer detyrimet financiare ndaj ish të dënuarve politikë që përfitojnë nga ky ligj?

Ministria e Financave ka dërguar informacionin e kërkuar, me shkresën nr.17096/1 datë 13.11.2012, ndërkohë që Ministria e Drejtësisë, pas më shumë se dy muajsh dhe kërkesave të përsëritura për këtë qëllim, ende nuk ka kthyer një përgjigje.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e Ministrisë së Financave, sqarohet se:

- Lidhur me numrin total të ish të dënuarve politikë, të miratuar me VKM, për përfitimin e dëmshpërblimit financiar dhe për numrin e tyre që, kanë përfituar një, apo më shumë këste të dëmshpërblimit të miratuar, Ministria e Financave konfirmon se: *“...dëmshpërblimi nominal është miratuar me VKM, për këstin e parë, për 11729 dosje. Janë paguar për këstin e parë, 10166 dosje dhe për këstin e dytë 1841 dosje”*.
- Lidhur me mjaftueshmërinë e buxhetit të vënë në dispozicion vit pas viti, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 12, të Ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, për të shlyer detyrimet financiare ndaj ish të dënuarve politikë që përfitojnë nga ky ligj, Ministria e Financave konfirmon se: *“...gjatë viteve 2009 deri në 2012, Ministria e Financave ka punuar me kapacitet të plotë të personelit dhe nuk ka patur pamjaftueshmëri të fondeve buxhetore, por gjithmonë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, pra duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga përfituesit. Nuk kemi patur asnjë periudhë ku të kemi lënë dokumenta të papaguara, për arsye të mungesës së fondit”*.
- Në vazhdim në përgjigje thuhet se: *“Skema e shpërndarjes së dëmshpërblimit është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.419 datë 14.04.2011, ndërsa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.189 datë 13.03.2012 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.419 datë 14.04.2011...”, është përcaktuar që, “Afati i shpërndarjes së këstit të dytë fillon më 26 Mars 2012. Menjëherë mbas miratimit të këtij VKM-je, ka filluar edhe shpërndarja e këstit të dytë, sipas prioriteteve, që na lejon VKM nr.419 datë 14.04.2011”*.

Bazuar në shqyrtimin e çështjes për ecurinë e procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, në përputhje me parashikimet e bëra në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, kemi konstatuar se:

Akti nënligjor që, duhej të nxirrej nga Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 32, të ligjit nr.9831 datë 12.11.2007, lidhur me miratimin e afateve dhe të skemës për shpërndarjen e fondeve të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë, është nxjerrë me vonesë, në shkelje të të gjitha afateve të parashikuara nga vetë ligji, i ndryshuar.

Konkretisht, në nenin 32, të ligjit nr.9831 datë 12.11.2007, parashikohet se: “Në ligjin e buxhetit planifikohen fondet vjetore për zbatimin e këtij ligji. Këshilli i Ministrave brenda 15 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, saktëson faturën financiare të dëmshpërblimit dhe i propozon Kuvendit skemën 8-vjeçare të shpërndarjes së fondeve”.

Nëse do t’i referohemi kohës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, rezulton se, ai është botuar në Fletoren Zyrtare nr.160 të vitit 2007, në faqen 4669, me datë aprovimi 12.11.2007 dhe me datë botimi 3.12.2007. Sipas llogaritjes së afateve të hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 84/3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del se ligji ka hyrë në fuqi në datën 19.12.2007.

Sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9831 datë 12.11.2007, duhej që brenda datës 19.03.2009 të ndërmerrej inisiativa përkatëse ligjore nga ana e Këshillit të Ministrave, për saktësimin e faturës financiare të dëmshpërblimit dhe t’i propozohej Kuvendit, skema 8-vjeçare e shpërndarjes së fondeve”.

Efektivisht kjo gjë nuk ka ndodhur, por me ndryshimin që ky nen ka pësuar me Ligjin nr.10111 datë 2.04.2009, ka ndodhur që, skema e shpërndarjes së fondeve nuk ka më të përcaktuar afatin 8 vjeçar, kjo pasi në nenin 12, të ligjit nr.10111 datë 2.04.2009, thuhet se:

“Në nenin 32, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë :“Këshilli i Ministrave, brenda vitit 2009, miraton afatet dhe skemën e shpërndarjes së fondeve”.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Vendimin nr.419 datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”. Sikurse evidentohet, ky akt jo vetëm që është nxjerrë me gati dy vjet vonesë nga koha që ka përcaktuar ligji, por në përmbajtjen e dispozitave të tij, vërehet se, afati i shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit është kthyer nga një çështje afati taksativ të përcaktuar nga norma, në një afat që varet krejtësisht nga ecuria korrekte e miratimit të plotë dhe përfundimit të dëmshpërblimit të shpërndarjes së këstit të dytë, për të gjithë ish të dënuarit politikë. Realisht, kemi një skemë dëmshpërblimi me shpërndarje në tetë këste të barabarta, por me një afat kohor që njeh vetëm një datë fillimi të procesit dhe jo një datë fikse mbarimi.

Pra, mund të thuhet se, përmbajtja e ligjit bazë (ligjit nr.9831 datë 12.11.2007), e ndryshimeve që ai ka pësuar, por edhe e akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre (kjo pjesë i referohet VKM nr.419 datë 14.04.2011), ka krijuar konfuzion në ecurinë e pritshme të procesit të dëmshpërblimit nga ana e subjekteve të interesuara dhe efektivisht ka çuar në konkluzionin e perceptuar prej tyre, të moszbatimit të ligjit.

Ky moment cënon parimin e sigurisë juridike, si një komponent i rendësishëm i shtetit të së drejtës, i cili në këtë rast ka të bëjë me trajtimin administrativ të çështjes brenda afateve të arsyeshme kohore, që plotësojnë pritshmërinë e palëve të interesuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë, afate që efektivisht janë ndryshuar, duke përkeqësuar periudhën kohore të trajtimit dhe realizimit të së drejtës individuale, ndërkohë që ato kanë qënë parashikuar me një akt tjetër normativ të mëparshëm në mënyrë më favorizuese për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist.

Çështja e trajtimit me dëmshpërblim të ish të dënuarve politikë do të komplikohet edhe më shumë, në këndvështrimin e skemës dhe afateve të shpërndarjes, pas miratimit të mundshëm të projekt-ligjit që, ndodhet aktualisht për miratim në Kuvend, i cili u jep mundësi ish të dënuarve politikë, që nuk kanë paraqitur në afatin ligjor kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për përfitim dëmshpërblimi financiar, t'i paraqesin ato brenda 6 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Pra, do të shtohet një numër tjetër ish të dënuarish politikë, për të cilët do të ketë një proces të ri dëmshpërblimi financiar, të veçantë nga ai që zhvillohet sot.

Në këto kushte të arrihet në konkluzion se, ndryshimet e ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", kanë sjellë si pasojë zgjatjen kohore të procesit të dëmshpërblimit, pa një afat përfundimtar të përcaktuar qartë.

Për sa më sipër me anë të shkresës nr.K1/G60-17 datë 12.02.2013, i është rekomanduar Ministrit të Drejtësisë, që në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, realizimi i iniciativës legislative, për një ndryshim në VKM nr.419 datë 14.04.2011 "Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist", me qëllim përcaktimin e një afati përfundimtar të arsyeshëm, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit, për ish të përndjekurit politikë të regjimit komunist.

Nga shqyrtimi i ankesave individuale që lidhen me këtë fushë, ka rezultuar gjithashtu se, ende nuk ka filluar trajtimi i kategorisë së të internuarve nga regjimi komunist me dëmshpërblimin përkatës, sipas kushteve të parashikuara në ligj. Sikurse evidentohet në këto ankesa, megjithëse individët e interesuar kanë kohë që kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë, ende nuk ka filluar trajtimi i tyre me dëmshpërblim. Në kuptim të ligjit, trajtimi i kësaj kategorie të përfaqësuar prej personave të internuar, ose të dëbuar në kampe, përbën një pjesë të procesit kompleks të dhënies së dëmshpërblimit financiar nga ana e shtetit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist.

Në një prej ankesave që po shqyrtohen nga ana e Institucionit tonë mbi këtë problematikë, kemi marrë përgjigje nga ana e Ministrisë së Financave, me anë të shkresës nr.17265/1 datë 13.11.2012, se nuk ka asnjë rast të miratuar me Vendime të Këshillit të Ministrave për trajtimin e kategorisë së të internuarve nga regjimi komunist me dëmshpërblim, sipas kushteve të parashikuara në ligj.

Siç rezulton, pavarësisht kërkesave të hershme për dëmshpërblim, që janë paraqitur nga subjektet e interesuara, përfaqësues të kategorisë së të internuarve nga regjimi komunist, Ministria e Drejtësisë nuk i ka propozuar ende Këshillit të Ministrave, miratimin e dëmshpërblimit për këtë kategori ish të dënuarish politikë, me anë të Vendimeve përkatëse që nxirren prej tij.

Mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor identifikon jo vetëm shkelje të parashikimeve ligjore, nga institucionet përgjegjëse për ecurinë e procesit, por edhe shkelje të së drejtës së ligjshme të individëve përfaqësues të kategorisë së të internuarve nga regjimi komunist, për t'u trajtuar me dëmshpërblim sipas parashikimeve të Ligjit "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar.

Në një numër ankesash, ngrihet pretendimi për mosmarrjen e kësteve të dëmshpërblimit nga ana e personave të interesuar edhe pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar për këtë qëllim. Siç ka rezultuar nga shqyrtimi i disa prej këtyre rasteve, shkak për këtë gjë është bërë paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim dhe e dokumentacionit përkatës shoqërues, jashtë afateve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 19, të Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"Mosparaqitja e kërkesës brenda afatit 1-vjeçar sjell humbjen e së drejtës së dëmshpërblimit për ish të dënuarin politik apo familjarin e viktimës me dënim kapital. Sipas këtij ligji ish i dënuari politik i regjimit komunist, kujdestari i tij ligjor apo familjari i viktimës së pushkatuar nuk mund të rivendosen në afat, për paraqitjen e kërkesës, kur ka kaluar mbi 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji".

Aktualisht, Kuvendi ka në procedurë miratimi një projekt ligj, i cili nëse do të miratohej në termat e paraqitura të dispozitave përkatëse ligjore (neni 20), do të sillte edhe zgjidhjen e këtyre ankesave, pasi rezulton se shkaqet për vonesat në paraqitjen e dokumentacioneve janë nga më të ndryshmet dhe të arsyeshme për të rikonsideruar dhënien e një mundësie të dytë personave të interesuar, për të përfituar nga trajtimi me dëmshpërblim.

Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave, janë vërejtur zvarritje apo edhe mospërgjigje nga ana e institucionit të Ministrisë së Drejtësisë në dërgimin e shpjegimeve zyrtare për sa u kemi kërkuar në shkresat tona, fakt që ka ndikuar në afatet e shqyrtimit të ankesave përkatëse nga ana jonë.

Një nga grupimet e parashikuara për t'u trajtuar me dëmshpërblim financiar nga ky ligj, është ai i personave të internuar, ose të dëbuar gjatë regjimit komunist. Konkretisht, në gërmën "c", të nenit 6, të Ligjit "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, thuhet se: "Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë: - për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave".

Duke ndjekur nga afër ecurinë e procesit kompleks të përfitimit të dëmshpërblimit financiar, sipas kategorive dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj, kemi konstatuar se, ende nuk është plotësuar baza e nevojshme ligjore, e cila do t'i hapë rrugë dhe do të mundësojë procesin faktik të dëmshpërblimit financiar për kategorinë e të internuarve ose të dëbuarve, të parapara në nenin 6 të ligjit.

Sikurse evidentohet në këto raste, megjithëse individët e interesuar kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë, për ta nuk ka filluar ende trajtimi me dëmshpërblim, sipas skemës së parashikuar në ligj, pasi Këshilli i Ministrave nuk ka detajuar me anë të vendimit që duhet të nxjerrë për këto kategori, skemën e pensionit nga e cila ata do të përfitojnë.

Ky fakt konfirmohet edhe në shkresën nr.2709/2 datë 8.01.2013 të Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën ndër të tjera thuhet se: "...në ligjin nr.9831 datë 12.11.2007, neni 6 i tij, përcakton si masë dëmshpërblimi për personat e internuar ose të dëbuar një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende".

Pavarësisht kërkesave të hershme për dëmshpërblim, që janë paraqitur nga subjektet e interesuara, përfaqësues të kategorisë së të internuarve ose të dëbuarve nga regjimi komunist, Këshillit i Ministrave ende nuk ka miratuar skemën e pensionit me anë të Vendimit përkatës, skemë nga e cila do të përfitojnë dëmshpërblimin këto kategori ish të dënuarish politikë.

Sa më sipër i kemi rekomanduar Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta dhe Ministrit të Drejtësisë, paraqitjen në një kohë sa më të shpejtë të mundshme në Këshillin e Ministrave, të propozimeve për miratimin e skemës së pensionit për kategorinë e të internuarve ose të dëbuarve nga regjimi komunist, me qëllim nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore që, do t'i mundësojnë marrjen e dëmshpërblimit këtyre kategorive.

Analizë e rasteve konkrete

Shtetasi Sh.K., **ankesa nr.201203112**, ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit një ankesë për mosdhënien e së drejtës për të përfituar dëmshpërblimin financiar, si i dënuar politik. Sikurse ai shkruan në ankesë, i është dhënë statusi i ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, në bazë të Vendimit nr.9 datë 05.05.1994 të Komisionit Shtetëror Tre Palësh. Ankuesi pas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit në Ministrinë e Drejtësisë, pretendon se i është refuzuar padrejtësisht, e drejta për të përfituar dëmshpërblim si ish i përndjekur politik, gjatë regjimit komunist.

Pas marrjes në shqyrtim të çështjes, janë kërkuar shpjegime nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka sqaruar se shtetasi Sh.K ka paraqitur kërkesën e tij për dëmshpërblim, jashtë afateve ligjore të përcaktuara në pikën 2, të nenit 19, të Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar. Ky fakt bën që, pavarësisht se ankuesi mund të plotësojë kërkesat e ligjit për t'u trajtuar me dëmshpërblim, ai nuk mund të fitojë këtë të drejtë për shkak të mosrespektimit të afatit procedural për paraqitjen e kërkesës. Ankuesi është vënë në dijeni në lidhje me këtë fakt, ndërkohë që është sqaruar gjithashtu, për procesin e miratimit në të cilin po kalon një projekt ligj i ri, në Kuvend, i cili do t'i rijapë mundësinë për të kërkuar trajtimin me dëmshpërblim.

Shtetasi H.H, **ankesa nr.201203586**, ka paraqitur një ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, për zvarritje në trajtimin e tij si një ish i internuar nga regjimi komunist, me dëmshpërblimin përkatës, sipas kushteve të parashikuara në ligj. Sikurse ai shkruan në ankesë, megjithëse ka kohë që ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë, ende nuk ka filluar trajtimi i tij me dëmshpërblim.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështjeje, janë kërkuar shpjegime për trajtimin e saj nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe prej Ministrisë së Financave. Megjithëse, Ministria e Drejtësisë nuk ka kthyer ende përgjigje, përgjigja e dhënë nga Ministria e Financave konfirmon faktin se, nuk ka asnjë rast të miratuar me Vendime të Këshillit të Ministrave për trajtimin e kategorisë së të

internuarve nga regjimi komunist me dëmshpërblim, sipas kushteve të parashikuara në ligj. Ky konfirmim, evidenton mungesën e veprimit të detyruar ligjor të Ministrisë së Drejtësisë, për t'i propozuar Këshillit të Ministrave, miratimin e dëmshpërblimit për këtë kategori ish të dënuarish politikë.

Për këtë arsye, do t'i paraqitet gjatë vitit 2013 një Rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku do t'i kërkohet paraqitja në një kohë sa më të shpejtë të mundshme në Këshillin e Ministrave, e propozimeve për miratimin e dëmshpërblimit nominal për kategorinë e të internuarve nga regjimi komunist, me qëllim nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore që, do t'i mundësojnë marrjen e dëmshpërblimit kësaj kategorie.

Konkluzione

Megjithëse, Ligji nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, ligjëron fillimin e një procesi dëmshpërblimi financiar për ish të dënuarit politikë, përsëri konstatohet se, ndryshimet ligjore që kanë shoqëruar këtë proces nuk janë në dijeninë e atyre subjekteve, të cilat përfitojnë prej tij. Kjo tregon se, së paku, në rastin më të keq, draftet e ndryshimeve, paraprakisht nuk janë konsultuar me ta, apo me përfaqësues të tyre, si dhe se, ekzistojnë faktorë të ndryshëm, që kanë ndikuar në krijimin e një situatë, e cila rezulton të jetë në momente të caktuara serioze.

Për më tepër, rezulton se, edhe në këto kushte, ligji nuk është zbatuar korrektësisht nga ana e organeve shtetërore, të cilave ky i fundit, iu njuh detyrimin të kryejnë procedura të caktuara, apo të ndëmarrin inisiativa legislative për të filluar apo vazhduar ecurinë normale të procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë.

Avokati i Popullit, ka ndërhyrë me disa rekomandime për rregullimin e kësaj gjendjeje, dhe do të vazhdojë të ndërhyjë, duke ndjekur nga afër ecurinë e procesit të dëmshpërblimit dhe realizimit efektiv të atyre të drejtave që, ligji i njuh kësaj shtrese të përvuajtur të shoqërisë sonë.

Q. Veprimtaria e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës

Mandati ligjor dhe veprimtaria monitoruese

Gjatë vitit 2012 institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) ka ngritur dhe përmirësuar një strukturë efektive që punon me profesionalizëm në shqyrtimin e çdo fenomeni që sjellë si pasojë shkelje të të drejtave të njeriut në formën e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Si rezultat i këtyre përmirësimeve veprimtaria e MKPT ka pasur rritje cilësore në parandalimin e fenomeneve të mësipërme, promovimin e praktikave të mira dhe forcimin e dialogut me autoritetet shtetërore.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ushtron veprimtarinë e vet bazuar në një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtareku dy më të rëndësishmet janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Protokolli Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)", miratuar me Ligjin Nr. 9094, dt.03.07.2003.

Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektimeve në institucionet e vuajtjes së dënimeve dhe garantojnë një aktivitet konform standardeve ndërkombëtare në këtë drejtim, ndërkohë që neni 19/1, i Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, autorizon një veprimtari monitoruese dhe hetimore të pavarur, të gjithanshme dhe të plotë për çdo rast torture, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, duke garantuar akses të madh në çdo ambient apo zyrë, ndaj çdo zyrtari pa imunitet dhe mbi çdo dokumentacion, qoftë dhe të klasifikuar, të organeve të administratës publike.

Edhe ndryshimet e kryera me Ligjin Nr. 9888, datë 10.03.2008, në Ligjin Nr.8328 datë 02.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, bënë të mundur krijimin e një hapësire më të madhe të Avokatit të Popullit në funksionin e tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) për të kryer detyrat gjatë kontrollit të shërbimeve penitenciare. Në Nenin 74/1 të këtij ligji, Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, i njihet e drejta si subjekt i veçantë për mbikëqyrjen e zbatimit dhe realizimit të ligjit për të dënuarit dhe paraburgosurit. Institucioni i Avokatit të Popullit gëzon kompetenca për të vëzhguar rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues. Sipas kësaj dispozite, ky Institucion ka të drejtë që të paraqesë në mënyrë specifike raporte dhe rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Inspektimet, vizitat dhe çdo kontroll tjetër i kryer në Institucionet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (burgje dhe paraburgime), në Spitale Psikiatrike dhe Infektive, në baza dhe reparte ushtarake, në Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit si dhe në qendrat e tjera të strehimit të emigrantëve të paligjshëm dhe personave të trafikuar, ka patur si objektiv të sigurojë një mbulim të plotë monitorues mbi situatën e të drejtave të njeriut në këto organe, të parandalojë shkeljet, si dhe të mbaj një qëndrim zyrtar mbi problematikat e konstatuara.

Gjatë vitit 2012, Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer 125 inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita në të gjitha vendet e privimit të lirisë dhe institucionet e tjera të përmendura më sipër. Krahas kësaj, kjo strukturë ka trajtuar edhe rreth 181 ankesa të individëve të marra gjatë kontakteve direkte në inspektimet e kryera. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me 54 rekomandime.

Rekomandimet dhe ndërhyrjet e mësipërme janë fokusuar kryesisht në masat që duhen marrë për respektimin dhe përmirësimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, në plotësimin e nevojave të tyre jetësore, shëndetësore dhe arsimore.

Përveç rekomandimeve të mësipërme janë rekomanduar një sërë masash të tjera që kanë synuar kryerjen e investimeve të brendshme infrastrukturore, plotësimin e organikës me punonjës. Është punuar paralelisht me administratën e burgjeve për nxitjen dhe promovimin e veprimtarive që synojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar mbajtjes së një komunikimi të vazhdueshëm të Avokatit të Popullit me personat të cilëve u është privuar liria nëpërmjet numrit pa pagesë të Institucionit

si dhe nëpërmjet ankesave të cilat depozitohen në kutitë e posaçme postare që hapen vetëm nga personeli i Avokatit të Popullit në çdo burg dhe paraburgim.

Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke monitoruar e kontrolluar ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, trajtimin e tyre brenda ambjentëve të Policisë, kushtet e ambjentëve etj.

Përveç sa më sipër, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, gjatë vitit 2012 ka qënë i fokusuar edhe në monitorimin e standardeve të të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet kësaj veprimtarie ka synuar monitorimin e respektimit të të drejtave të ushtarakëve të parashikuara në statusi e ushtarakut, monitorimin e masave disiplinore dhe të kushteve të dhomave të ndalimit disiplinor. Për realizimin e këtij qëllimi, janë kryer inspektime dhe vizita në bazat dhe repartet ushtarake, janë bërë takime me ushtarakët dhe është marrë informacion lidhur me respektimin e të drejtave të tyre ligjore të garantuara nga aktet normative përkatëse.

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2012 në Qendrat Spitalore, Burgjet dhe Paraburgimet (Seksionet e femrave dhe të miturve)

Gjatë vitit 2012 Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer rreth 18 inspektime dhe kontrole tematike në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan, Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, IEVP 313 në Sektorin e Femrave dhe të Miturve, IEVP 302 në Tiranë, IEVP Berat, IEVP Durrës, IEVP Fushë Krujë. Inspektimet në Qendrat Spitalore, Qendrat Sociale, Burgjet dhe Paraburgimet për meshkuj, femra dhe të mitur, kanë një rol të madh në evidentimin e problematikave në këto institucione lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me aktet normative. Ky mision ligjor ka pasur një rol aktiv që në fillim të vitit 2008 dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet kryesore të këtij mekanizmi.

Monitorimi i këtyre institucioneve është shumë i rëndësishëm jo vetëm për të vlerësuar respektimin dhe zbatimin e ligjit për të drejtat dhe liritë e individëve që trajtohen në këto institucione, por dhe për të këqyru kushtet infrastrukturore të ambienteve të tyre. Gjithashtu për vlerësimin e nivelit të zbatimit e respektimit të të drejtave të individëve që trajtohen në këto institucione një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe trajtimi me rigorozitet i ankesave individuale të bëra nga shtetasit, apo familjarët e tyre.

Kuadri ligjor mbi bazën e të cilit MKPT ka ushtruar rolin e tij për respektimin e dispozitave ligjore sipas përkatësisë institucionale, përveç ligjit "Për Avokatin e Popullit", është ligji "Për Shëndetin Mendor", ligji "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", ligji Nr.9888 datë 10.03.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim".

Inspektimet e kryera në këto institucione në kuadër të zbatimit të Rekomandimit të 12 të Komisionit European për Shqipërinë.

1. Inspektimi me iniciativë në Spitalin Psikiatrik Shkodër, regjistruar me Nr. Dok. 201202139. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:

- Përshpejtimi i punimeve të cilat vareshin kryesisht nga fondet e planifikuara për vitet 2011-2012, me qëllim kalimin e pacientëve të këtij spitali në ambientet e godinës së re brenda afatit të parashikuar.
- Plotësimi i të gjithë gamës së medikamenteve të munguara, si dhe përmirësimin e cilësisë së detergjentëve sanitare për këtë spital, me qëllim mundësimin e një higjene brenda standardeve, për vetë specifikën e pacientëve që kuron ky institucion.

Mundësimi me trajnime periodike për stafin kujdestar lidhur me rolin e rëndësishëm që kryen ky staf në funksion të kësaj kategorie, me qëllim përmirësimin dhe kualifikimin e profesionit të tyre sipas standardeve të kërkuara, përgjatë ushtrimit të detyrës.

2. Inspektimi me iniciativë në Spitalin Psikiatrik Vlorë, regjistruar me Nr. Dok. 201202138. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:

- Lëvrimi i fondeve për ndërtimin e godinës së re, pasi kushtet aktuale në godinën e vjetër ku strehohet edhe pjesa më e madhe e pacientëve të këtij spitali, lenë për të dëshiruar.
- Shtimi i numrit të mjekëve në organikë dhe krijimin e personelit task-forcë për rastet specifike në urgjencën e këtij institucioni, me qëllim ofrimin e një shërbimi dhe përkujdesjeje ndaj pacientëve brenda standardeve të kërkuara.
- Mundësimi i vazhdueshëm i trajnimeve afat-gjata për stafin kujdestar dhe infermier, me qëllim përmirësimin e këtij stafi në nivel profesional dhe mundësimin e një shërbimi me përkujdesje të kualifikuar gjatë ushtrimit të detyrës, kundrejt pacientëve të këtij institucioni.

3. Inspektimi me iniciativë në Spitalin Psikiatrik Elbasan, regjistruar me Nr. Dok. 201202140, i bërë në datën 09.04.2012. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:

- Shtimi i infermierëve në organikën e këtij institucioni, sipas standardeve të kërkuara dhe nevojave të tij.
- Vënia në funksion e sistemit ngrohës në të gjitha ambientet e tij, me qëllim përmirësimin e kushteve jetësore të pacientëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe eliminimin e situatave të padëshiruara përgjatë stinës së dimrit me pasoja negative në shëndetin e tyre.
- Kryerja e hidroizolimit të tarracës së godinës për evitimin e lagështirës nëpër pavione, si dhe marrjen e masave për rikonstruksionin e rrjetit të ujit të pijshëm, me qëllim përmirësimin e kushteve të pacientëve.
- Blerja e një pajisjeje të re lavanterie profesionale me qëllim përmbushjen e nevojave të pacientëve.
- Plotësimi dhe shtimi i mjekëve në organikën e këtij institucioni, sipas standardeve të kërkuara dhe nevojave të këtij institucioni, si dhe shtimi me personel kujdestar dhe socialo-edukativ në shërbimin e veçantë, si specifik për këto funksione.

4. Inspektimi me iniciativë në Qendrën Spitalore të Burgjeve Nr. Dok. 201202137, i bërë në datën 05.04.2012. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:

- Lyerja e dhomave të pacientëve në sektorin e femrave dhe meshkujve, me qëllim përmirësimin e higjenës së ambientit ku ato qëndrojnë më së shumti përgjatë kurimit të tyre.

- Rikonstrukcioni sa më parë i dhomave në sektorin e femrave, pasi qëndrimi i gjatë në këto ambiente me lagështirë të theksuar, përbën rrezik serioz për shëndetin e tyre.
 - Krijimi i menjëhershëm i një dhome të veçantë observimi për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi, pasi mungesa e një të tillë përbën problem serioz për stafin mjekësor, i cili nuk disponon mjetet e duhura të shtrëngimit sipas standardeve të kërkuara.
 - Shtimi në organikë të stafit rehabilitues dhe kryesisht atë kujdestar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit kundrejt pacientëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe zgjerimin e ambientit të edukimit dhe mundësimin e të gjitha mjeteve për kryerjen e aktiviteteve brenda këtij ambienti, me qëllim përmirësimin e kushteve për rehabilitimin dhe ndikimin pozitiv në nivel psiko-social, për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe specifikisht të rasteve që trajtohen me mjekim të detyruar.
 - Marrja e masave mbrojtëse për stafin mjekësor kundrejt rasteve me sëmundje infektive, si dhe të zbatohet Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim mundësimin në kohë të të gjitha ekzaminimeve mjekësore me specifikë të profilizuar nga institucionet spitalore palë të këtij Memorandumi, për persona me liri të kufizuar.
5. Inspektimi me iniciativë në IEVP 313, Seksioni i Femrave, regjistruar me Nr. Dok. 201202133.
6. Inspektimi me iniciativë në IEVP 313, Seksioni i të Miturve, regjistruar me Nr. Dok. 201202132. Pas inspektimit të bërë në këto dy seksione është rekomanduar:
- Lyerja e qelive dhe ambienteve në tërësi në regjimin e të miturve dhe femrave në Institucionin e Paraburgimit 313, riparimin e dusheve dhe furnizimin me kosha mbeturinash dhe produkte higjieno-sanitare të çdo qelie, me qëllim përmirësimin e cilësisë jetike dhe higjenes vetjake të personave që gjenden në këto ambiente.
 - Kryerja e të gjitha restaurimeve në regjimin e femrave dhe eliminimin e lagështirës në qeli, dushe dhe tualete.
 - Përshpejtimi i procesit për pajisjen e qelive të të miturve me mjete akomoduese të reja, si dhe paisja e këtij regjimi me një sistem qëndror ventilues, me qëllim evitimin e temperaturave të larta përgjatë stinës së verës, si dhe pajisjen e shërbimit stomatologjik me produktet e nevojshme për mjekime dentare me qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi në regjimin për të miturit.

Inspektimet e kryera sipas Plan-inspektimit

1. Inspektimi me iniciativë në IEVP 313 (regjimi i të miturve), regjistruar me Nr. Dok. 201202266. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:
- Marrja e masave për riparimin e dusheve, zëvendësimin e koshave në qeli, sipas parametrave mjedisore, lyerja e disa qelive, si dhe ndërrimi i pllakave qeramike të thyera në dushe dhe tualete.
 - Marrja e masave për pajisjen e çdo qelie me aparat ventilues, ose me një sistem qëndror ventilues, me qëllim evitimin e temperaturave të larta përgjatë stinës së verës, si dhe mbulimi i kutive të shpërndarjes elektrike sipas parametrave mbrojtës, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe mbrojtjes së të miturve konform legjislacionit në fuqi.

- Marrja e masave për vënien sa më parë në funksion të mjeteve kompjuterike në ambientin për shërbimin social edukativ, rifreskimin e literaturës bibliotekare, etiketimin e llojshmërisë së tyre, me qëllim përmirësimin e shërbimit social edukativ dhe ndikimit pozitiv në rehabilitimin e të miturve në jetën sociale.
 - Marrja e masave nga shërbimi shëndetësor për trajtimin e ankesave në kohë të të miturve, lidhur me shqetësimet dhe trajtimet shëndetësore, paisja e shërbimit stomatologjik me produktet e nevojshme për mjekimet dentare, ofrimin e medikamenteve qetësues në llojshmëri dhe sasi sipas specifikave diagnostikuese, me qëllim mundësimin e një shërbimi shëndetësor me efikasitet, kundrejt kësaj kategorie.
 - Implementimi i Marrëveshjes së Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Drejtësisë për arsimimin dhe vijimësinë e programeve mësimore sipas përkatësisë pedagogjike, për të miturit në IEVP 313 në Tiranë.
2. Inspektimi me inisiativë në IEVP 313 (regjimi i femrave), regjistruar me Nr. Dok. 201202265. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:
- Marrja e masave për eliminimin e lagështirës në qelinë nr.10 dhe shfrytëzimin e çdo mundësie për largimin nga kjo qeli të të paraburgosurave, me qëllim evitimin e çdo pasoje të rëndë shëndetësore në dëm të personave me liri të kufizuar dhe ofrimin e një përkujdesjeje konform legjislacionit në fuqi.
 - Marrja e masave për ushtrimin e një plani-masash për të gjithë elementët që mund të rrezikojnë jetën e të paraburgosurave brenda ambienteve të këtij regjimi, për zgjidhjen e problematikave në infrastrukturë (riparime të suvasë, punime në tualete, eliminimi i kabllove elektrik të pambrojtur, zëvendësimi i pllakave qeramike të thyera).
 - Marrja e masave për instalimin e ventilatorëve të brendshëm me qëllim uljen e temperaturave të larta dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit gjatë periudhës së nxehtë të verës.
 - Shtimi i një pajisje larëse brenda këtij regjim.
 - Pajisja e shërbimit stomatologjik me të gjitha materialet e nevojshme për të mundësuar riparimet dentare.
3. Inspektimi me inisiativë në IEVP 302, regjistruar me Nr. Dok. 201203868. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:
- Marrja e masave për eliminimin e lagështirës, kryesisht në sektorin 3, me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore në pjesët e amortizuara të godinës.
 - Rikonstruktimi i ambienteve të veçimit, observimit dhe tranzitit lidhur me të gjitha mangësitë e hasura në këto ambiente, si dhe krijimi i mundësisë për ndriçimin natyral dhe ajrimin nëpërmjet zgjerimit të dritareve të qelive, pa cënuar elementët e sigurisë së institucionit, me qëllim respektimin e të drejtave të të paraburgosurve konform ligjit dhe eliminimin e pasojave në shëndetin e tyre nga mungesa e ajrit përgjatë qëndrimit në këtë institucion.
 - Marrja e masave për dezinfektimin periodik të institucionit për eliminimin e prezencës së insekteve, me qëllim parandalimin e një epidemie të mundshme.
 - Furnizimi me produkte higjeno-sanitare në sasi dhe cilësi, lyerjen e shtretërve të oksiduar dhe zëvendësimin e enëve të shpërndarjes së ushqimit, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe mundësimin e një higjene me parametra bashkëkohorë.

- Marrja e masave për krijimin e një ambienti takimi për të paraburgosurit me fëmijët e mitur, me qëllim ofrimin e një ambienti të pranueshëm për fëmijët e mitur përgjatë takimit me prindërit e tyre dhe të përshtatshëm në aspektin psikologjik.
 - Krijimi i një hapësire për aparatin telefonik jashtë kollonës së punonjësit të regjimit, me qëllim sigurimin e privatësisë për të paraburgosurit përgjatë komunikimit të tyre.
 - Përmirësimi i infrastrukturës së ambientit të shërbimit shëndetësorë dhe stomatolog, me qëllim arritjen e standardeve të kërkuara dhe përmirësimin e shërbimit që ofrohet kundrejt kësaj kategorie.
4. Inspektimi me iniciativë në IEVP Fushë Krujë, regjistruar me Nr. Dok. 201203731. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:
- Marrja e masave për eliminimin e lagështirës në të gjithë godinën, vënien në funksion të sistemit ngrohës përgjatë stinës së dimrit, si dhe lysterja e ambienteve (tualet, qeli, korridore, observim, veçim), me qëllim përmirësimin e kushteve për shtetasit që trajtohen në këtë institucion konform standardeve të kërkuara.
 - Marrja e masave për sigurimin me energji elektrike, ujë të pijshëm, ujë të ngrohtë dhe eliminimin e sigurimit të ujit të ngrohtë nga vetë të paraburgosurit nëpërmjet mënyrave primitive dhe riskuese, me qëllim respektimin dhe zbatimin e të drejtave të tyre konform legjislacionit në fuqi dhe evitimin e situatave të padëshiruara.
 - Marrja e masave për shtimin e një mjeku të përgjithshëm në organikën e këtij institucioni, kryerja e të gjitha procedurave administrative dhe farmaceutike për implementimin e skemës së re në shërbimin shëndetësorë dhe tërheqjen e barnave të rimbursueshëm nga depoja përkatëse në kohë, me qëllim ofrimin e një shërbimi shëndetësorë sipas kritereve të parashikuara në Marrëveshjen Trepalëshe DRSKSH-IEVP-Depo Distributore.
 - Marrja e masave për kryerjen e dezinfektimit në të gjitha ambientet, pajisjen e të paraburgosurve me produkte higjieno-sanitare në sasi dhe në llojshmëri, paisja e qelive me kosha mbeturinash të mbuluar, me qëllim parandalimin e një epidemie të mundshme dhe mundësimin e një higjene me parametra bashkëkohore.
 - Marrja e masave për veçimin e të paraburgosurve të grup moshave 18-21 në ambientet përkatëse, me qëllim respektimin e ligjit për këtë kategori.
5. Inspektimi me iniciativë në IEVP Berat, regjistruar me Nr. Doc. 201203709. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:
- Marrja e masave për përfundimin e godinës së re, me qëllim kalimin e të paraburgosurve sa më shpejt në ambientet e reja, pasi kushtet mjedisore dhe infrastrukturore në këtë institucion janë jashtë standardeve.
 - Marrja e masave për riparimin e dusheve, lysterjen e ambienteve në tërësi, furnizimin me produkte të ndryshme higjieno-sanitare, pajisjen e qelive me kosha mbeturinash të mbuluar, si dhe mbulimin e kutive të shpërndarjes elektrike sipas parametrave teknik mbrojtës dhe tendosjen e kablllove elektrik në lartësinë e duhur, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe mbrojtjen e të paraburgosurve nga situata të padëshiruara, konform legjislacionit në fuqi.
 - Marrja e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për shërbimin social edukativ, rifreskimin e literaturës bibliotekare, etiketimin e llojshmërisë së tyre, shtimin e programeve riintegruese, me qëllim përmirësimin e shërbimit social edukativ dhe ndikimit pozitiv në rehabilitimin e të paraburgosurve.

- Marrja e masave për shtimin në organikë të personelit infermier dhe stomatolog në shërbimin shëndetësor, krijimin e një dhome mjeku, përshpejtimin e procedurave për realizimin e marrëveshjes trepalëshe për listën e barnave të rimbursueshëm dhe tërheqjen e medikamenteve, me qëllim mundësimin e një shërbimi shëndetësorë efikas, kundrejt kësaj kategorie.
 - Implementimi i marrëveshjes së Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Drejtësisë për arsimimin dhe vijimsinë e programeve mësimore sipas përkatësisë pedagogjike, për të paraburgosurit në këtë IEVP.
6. Inspektimi me iniciativë në Qendrën Spitalore të Burgjeve, regjistruar me Nr. Doc. 201202181. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:
- Marrja e masave për pajisjen e pacientëve dhe ambjenteve në tërësi me produkte higjieno-sanitare në të gjitha repartet e kësaj qendre, me qëllim përmirësimin e higjienës vetjake dhe të ambientit ku ato qëndrojnë më së shumti përgjatë kurimit të tyre.
 - Marrja e masave për ndrimin e pajisjeve hotelerike (çarçaf, peshqirë), lyerjen e shtretërve të oksiduar, si dhe riparimin e aparateve të dusheve me qëllim përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e një shërbimi sipas standardeve të kërkuara.
 - Krijimi i menjëhershëm i një dhome të veçantë observimi për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi, pasi mungesa e një dhome të tillë përbën problem serioz për stafin mjekësor, si dhe pajisjen e këtij institucioni me mjetet e duhura të shtrëngimit fizik në sasi dhe cilësi.
 - Marrja e masave për mundësimin e zgjatimit të kordonit të aparateve telefonik dhe shtimin e rampeve në këto ambjente, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe lehtësimin e sforcimeve fizike të pacientëve tetraplegjikë në këtë qendër.
 - Marrja e masave për stafin rehabilitues dhe kryesisht atë psiko-social, me qëllim përmirësimin e cilësisë me të gjitha programet e duhura (riaftësuese,riintegruese) dhe kryesisht të shërbimit kundrejt pacientëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe zgjerimin e ambientit të edukimit, plotësimin me materiale letrare të bibliotekës dhe mundësimin e të gjitha mjeteve për kryerjen e aktiviteteve brenda këtij ambienti, me qëllim përmirësimin e kushteve për rehabilitimin dhe ndikimin pozitiv në nivel psiko-social, për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe specifikisht të rasteve që trajtohen me mjekim të detyruar.
 - Marrja e masave për zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim mundësimin në kohë të të gjitha ekzaminimeve mjekësore me specifikë të profilizuar nga institucionet spitalore palë të këtij Memorandumi për persona me liri të kufizuar, si dhe evitimin e situatave të padëshiruara si pasojë e mosevidentimit në kohë të problemeve shëndetësore .
 - Marrja e masave për rishikimin e menisë ushqimore që serviret për pacientët, si dhe realizimin e një ambienti takimi të pacientëve me familjarët e tyre sipas kushteve dhe parametrave bashkëkohor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit kundrejt kësaj kategorie.
 - Marrja e masave për ruajtjen e medikamenteve në infermieritë e kësaj qendre konform parametrave farmaceutik, plotësimi i këndeve me medikamentet e munguara, si dhe adaptimi i mjekimeve alternative me gama profilaktike psikiatrike në llojshmëri, konform specifikave dhe diagnozave të trajtuara në këtë institucion, me qëllim mundësimin e një kurimi me efikasitet dhe ofrimin e një shërbimi mjekësor rezultativ në dobi të kësaj kategorie.

- Marrja e masave për ruajtjen e kampionit ushqimor konform rregullores së përgjithshme institucionale, sigurimin e një mjeteve ambulator sipas parametrave mjekësor dhe standardeve të kërkuara, si dhe evitim të ekspozimit të mjeteve të forcës nga punonjësit e sigurisë, përgjatë qëndrimit në ambientet e brendshme të kësaj qendre.
- 7. Inspektimi me inisiativë në Spitalin Psikiatrik në Tiranë, regjistruar me Nr. Dok. 201202632. Pas inspektimit për këtë institucion është rekomanduar:
 - Marrja e masave për ndrimin e xhamave, pajisjeve hotelerike (çarçaf, peshqirë), pajisjen e të gjitha reparteve me tavolina dhe karrige, lysterjen e mureve, si dhe riparimin e të gjitha problematikave në infrastrukturë me qëllim respektimin e privatësisë së tyre dhe përmirësimin e kushteve për ofrimin e një shërbimi sipas standardeve të kërkuara.
 - Marrja e masave për vendosjen e dyerve të munguara në tualetet e çdo reparti, pajisjen me produkte higjieno-sanitare, si dhe mundësimin e ujit të pijshëm 24 orë pa ndërprerje, me qëllim përmirësimin e kushteve të trajtimit të tyre.
 - Rregullimi i ambientit të ngrënies, krijimi i një hapësire për takimet me familjarët në çdo repart me komoditetin e duhur, vënia në funksion të sistemit të alarmit për emergjencat civile, si dhe vënia në funksion të ashensorëve në çdo repart, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në këto ambiente.
 - Marrja e masave për stafin rehabilitues dhe kryesisht atë psiko-social, me qëllim përmirësimin e cilësisë me të gjitha programet e duhura riaftësuese, riintegruese dhe kryesisht të pasqyrimin të tyre me axhendë përkatëse, krijimi i një formulari ankesë-kërkesë për çdo pacient, si dhe pajisjen me të gjitha mjetet për kryerjen dhe konkretizimin e aktiviteteve brenda këtij ambienti.
 - Marrja e masave për shtimin në organikë të personelit infermier, përzgjedhja e personelit task-forcë sipas kërkesave profesionale, trajnimi i vazhdueshëm i stafit infermier-kujdestar dhe psiko-social, si dhe implementimi i një stafi teknik-rregullues të brendshëm për riparimin e të gjitha dëmeve infrastrukturore, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe rritjen e nivelit profesional me specifikë të profilizuar në këtë institucion.
 - Marrja e masave për rishikimin e ambientit të observim-izolimit me të gjitha parametrat bashkëkohor, krijimi i të gjitha mundësive për evitim të situatave me pasoja të padëshiruara, nxjerrja e pacientëve në shesh-ajrimin e oborrit të spitalit dhe evitim të lënies së tyre në ambiente të mbyllura dhe në gjendje shtrati.
 - Marrja e masave për ruajtjen e medikamenteve në infermieritë e këtij spitali konform parametrave farmaceutik, plotësimin e reparteve me medikamentet e munguara dhe pajisjen e menjëhershme me rripa sigurimi.
 - Marrja e masave për vënie në funksion të oborrit në repartin e të miturve, krijimin e një ambienti qëndrimi për prindërit, vënie e mjeteve akomoduese në ambientin e pritjes, si dhe rishikimin e mundësisë për zgjerimin e këtij reparti duke pasur parasysh që është i vetmi në llojin e tij, i cili trajton specifikisht vetëm të mitur.

Zbatimi i Rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me problematikat e konstatuara.

Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës pasi ka bërë rekomandime për të gjitha konstatimet e pasqyruara më sipër, ka ndjekur nga afër ecurinë për përmirësimin e problematikave duke mbajtur komunikim dhe bashkëpunim ndër-institucional me qëllim zbatimin e tyre.

Për të gjitha rekomandimet e bëra, institucionet përkatëse kanë dërguar përgjigje duke i mirëpritur ato dhe kanë kontribuar për realizimin e tyre. Theksojmë se, megjithëse rekomandimet e Avokatit të Popullit janë pranuar nga institucionet përkatëse, zbatimi i tyre në disa raste është bërë i plotë, ndërsa në shumicën e rasteve është bërë i pjesshëm. Kemi konstatuar se një ndër shkaqet kryesore për moszbatimin e tyre është mungesa e fondeve të nevojshme në buxhetet e këtyre institucioneve.

Ankesat e trajtuara nga MKPT gjatë vitit 2012 në këto institucione

Gjatë vitit 2012 janë trajtuar 42 ankesa për institucionet e cituara më sipër, në të cilat ankuesit pretendonin për shkelje të të drejtave të tyre ligjore nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike dhe kërkonin vënien në vend të së drejtës së shkelur. Shqyrtimi i këtyre rasteve ka përfunduar dhe mënyra e përfundimit të tyre është: 23 janë zgjidhur në favor; 4 kanë qënë të pabazuara dhe 15 kanë qënë jashtë kompetencës. Objekti i ankesave dhe kërkesave ka qënë: për mos trajtime mjekësore të specifikuara dhe nga qendra shëndetësore të cilat kanë mjetet e duhura në lidhje me sëmundje që nuk mund të trajtohen në IEVP; për mungesë medikamentesh mjekësore; ankesat për leje shpërblyese të mohuar; për mos lejimin e takimeve me të afërmit; ankesa për mos transferime pranë qendrave të banimit të të dënuarve; kërkesa për konsulencë ligjore në gjykata; për ndërmjetësim me institucionet përkatëse me qëllim mundësimin e përfaqësimit ligjor falas etj.

Shqyrtimi i këtyre ankesave është bërë me profesionalizëm dhe objektivitet. Ndërkohë vlen të theksojmë se qëndrimi i drejtuesve të institucioneve ndaj të cilëve drejtoheshin ankesat ka qënë bashkëpunues.

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2012 në Burgjet dhe Paraburgimet

Gjatë vitit 2012 janë trajtuar 152 ankesa e kërkesa nga persona ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgjeve për çështje që lidhen me administratën dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në IEVP-të.

Për Institucionet e burgjeve dhe paraburgimit janë **bërë 31** rekomandime, nga të cilat 18 rekomandime janë bërë pas kryerjes së monitorimeve dhe vizitave në institucionet penitenciare, nëpërmjet të cilave janë trajtuar çështje të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve dhe 13 rekomandime të tjera kanë qënë me natyrë përgjithësuese për standardizimin e kushteve të trajtimit të personave të privuar dhe respektimin e të drejtave të tyre nga administrata e IEVP-ve.

Nga përmbajtja e 31 rekomandimeve, si dhe nga kontrolli i kryer për zbatimin e tyre nga ana e Avokatit të Popullit vërehen një sërë problematikash të cilat kanë nevojë të ngutshme të shqyrtohen dhe përmirësohen. Ky proces ka nevojë të kalojë me vendimmarrje të organeve të larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ai ka si pengesë mungesën e fondeve dhe të nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Konkretisht në vijim po paraqesim disa nga problemet ende të pazgjidhura të cilat në terma praktike duhet të konsiderohen prioritete. Pavarësisht se disa prej tyre janë konstatuar edhe

gjatë vitit 2011 dhe për të cilat Avokati i Popullit ka bërë rekomandime përkatëse, ato mbeten të pazgjidhura. Ndërkohë ato ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të privuar nga liria.

Nga përmbajtja e 31 rekomandimeve të mëposhtme, si dhe nga kontrolli i kryer për zbatimin e tyre nga ana e Avokatit të Popullit vërehen një sërë problematikash të cilat duhen zgjidhur pa humbur kohë.

Problematikat e sistemit penitenciar dalë nga ankesat dhe konstatimet e kryera gjatë inspektimeve në vitin 2012.

Pavarësisht insistimit të Avokatit të Popullit, edhe gjatë vitit 2012 vazhdojnë të mbeten pa zgjidhje problematika të identifikuara për të cilat është theksuar nevoja e ndryshimeve të menjëhershme. Për rrjedhojë, detyrohem të sjellim përsëri në vëmendjen tuaj problematikat e ngritura edhe në raportin vjetor të vitit 2011 të Institutcionit të Avokatit të Popullit, si më poshtë:

- “1. Gjatë vitit 2012 shumë prej burgjeve dhe paraburgimeve në vend vijnë nga probleme të amortizimit dhe kushteve të papërshtatshme të tyre, veçanërisht të lagështirës (Burgjet 325 Tiranë, Rrogozhinë, Tepelenë, Lezhë, Kosovë e Lushnjës, Burrel, Paraburgimet Berat, Sarandë, 313 dhe 302 Tiranë), mungesës së ujit, sidomos gjatë periudhës së verës (Burgjet Rrogozhinë, Krujë), kushteve jashtë standardeve të tualeteve, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, mungesës së ambienteve të edukimit, ushtrimit të riteve fetare, veprimtarisë sportive etj (Burgjet Burrel, Lezhë, Tepelenë, Kosovë e Lushnjës dhe Paraburgimet Sarandë, Berat, 313 dhe 302 Tiranë). Avokati i Popullit ka rekomanduar dhe insiston që të mbyllet burgu i Burrelit, të vazhdojnë të transferohen të sëmuret mendorë nga Burgu Krujë etj, në një institucion të specializuar shëndetësor, sepse nuk plotësojnë standardet përkatëse. Gjatë inspektimeve dhe ri-inspektimeve të kryera gjatë vitit 2012, në të gjitha këto institucione është përsëritur nevoja urgjente për investime kryesisht të pjesshme që do të përmirësojnë ndjeshëm kushtet ekzistuese. Këto probleme janë adresuar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Një nga problematikat kryesore që vijon të mbetet shqetësuese për Avokatin e Popullit është mosgjetja e një zgjidhjeje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar me gjithë hapjen e një sektori të veçantë në paraburgimin e Durrësit. Avokati i Popullit e ka ngritur çdo vit këtë çështje dhe nuk është pajtuar me situatën në të cilën ende këta persona mjekohen brenda ambienteve të sistemit të burgjeve. Gjatë vitit 2012 jemi vënë në dijeni se nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë po merren masat që të kalojë në administrimin e tyre Burgu Krujë, apo të ndërtojnë një institucion të veçantë për të trajtuar këta persona sipas ligjit, ashtu siç ka rekomanduar edhe Avokati i Popullit. Ndërtimi i një institucioni të ri sipas standardeve ndërkombëtare do të ishte një zgjidhje ligjore¹².
3. Një problem tepër serioz që vazhdon të ngrihet në mjaft komunikime konfidenciale me të dënuarit dhe paraburgosurit është ai i korrupsionit në segmente të administratës së burgjeve. Ky korrupsion

12 Me miratimin e ligjit të ri nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i cili është i standardeve bashkëkohore dhe përgatitjen e nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të tij, besojmë se ky problem shqetësues disa vjeçar do të gjej zgjidhje përfundimtare

ka bërë që të pretendohet për cënim të rëndë të të drejtave dhe trajtimit të individëve brenda këtyre institucioneve. Avokati i Popullit megjithëse është përpjekur të verifikojë disa raste të denoncuar për korrupsion, e ka patur mjaft të vështirë të mundësojë zbardhjen e së vërtetës. Nisur nga gjetja periodike e sendeve të ndaluara në qeli të veçanta, apo nga trajtimi i pabarabartë që u bëhet disa të dënuarve dhe paraburgosurve në vend, në mënyrë indirekte lihet të kuptohet se korrupsioni në sistemin penitenciar është prezent dhe përbën kërcënim për mbarëvajtjen e trajtimit të të drejtave të individëve të dënuar ose të paraburgosur.

4. Gjatë vitit 2012 shërbimi shëndetësor në sistemin penitenciar nuk pati përmirësime. Në shumë raste u vunë re mangësi, kryesisht në mungesën e ilaçeve, në trajtimit të patologjive jo të zakonshme, në mjetet e transportit (ambulanca) në disa burgje, në mungesën e mjekut me kohë të plotë në institucion, në mungesën e shtimit të personelit mjekësor të specializuar, në moskrijimin e ambienteve optimale të shërbimit shëndetësor, etj.
5. Megjithë hapjen e institucioneve të reja të vuajtjes së dënimit dhe konsolidimit të funksionimit të Shërbimit të Provës, mbipopullimi vijon të mbetet një problem kryesor në burgje dhe sidomos në paraburgime. Avokati i Popullit e ka nënvizuar shpesh rëndësinë e uljes së numrit të të dënuarve në këto institucione, duke respektuar standardet e hapësirës për jetesë, kërkesë kjo e parashtruar dhe në raportet e CPT-së për vendin tonë.
6. Është konstatuar se burgjet dhe paraburgimet në vend nuk plotësojnë kushtet minimale për të strehuar dhe për të trajtuar persona me aftësi të kufizuar. Rast përjashtimor janë vetëm kushtet që ofrohen në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë dhe së fundmi seksioni i veçantë në Paraburgimin e Durrësit. Ky konkluzion ka dalë për shkak të mungesës së personelit për t'ju përgjigjur të gjitha nevojave të kësaj kategorie personash, si dhe mungesës së pajisjeve për të mundësuar një trajtim sa më të përshtatshëm të paaftësisë së tyre. Në këto kushte del si detyrë emergjente që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të mundësojë blerjen e pajisjeve të posaçme dhe shtimin e personelit për të trajtuar sipas standardeve këtë kategori." (fq. 159-160)

Rekomandimet e Avokatit të Popullit për Sistemin e Burgjeve e Paraburgimeve

Zbatimi i rekomandimeve të bëra në dy vitet e fundit për burgjet dhe paraburgimet është ndjekur me përparësi edhe për shkak të Rekomandimit nr. 12 të Komisionit Europian, një nga rekomandimet që duhet të përmbushen për antarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Referuar Rekomandimit nr. 12, shteti shqiptar duhet të merrte masa shtesë për të përmirësuar trajtimin e personave të privuar nga liria në komisariatet e policisë, paraburgime dhe burgje, si dhe të përmirësonte zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në këtë drejtim. Për këtë qëllim u caktua një grup pune i cili në Maj të vitit 2012 bëri verifikimin në vend të zbatimit të rekomandimeve të bëra gjatë vitit 2011 e në vazhdim gjatë vitit 2012 për burgjet, paraburgimet dhe komisariatet e policisë.

Sistemi i Paraburgimit në Shqipëri përbëhet nga institucione që funksionojnë vetëm si institucione paraburgimi dhe nga seksione të paraburgimit që ndodhen në institucione që funksionojnë kryesisht për të dënuarit me vendim të formës së prerë.

IEVP-të që janë kategorizuar vetëm si institucione paraburgimi:

IEVP në Rrugën “Jordan Misja” në Tiranë

IEVP në Rrugën “Mine Peza” në Tiranë

IEVP Vlorë

IEVP Durrës

IEVP Sarandë

IEVP Berat

IEVP Tropojë

IEVP Kukës

IEVP Elbasan

IEVP-të që kanë seksione paraburgimi:

IEVP “Ali Demi” ka një seksion për gra të paraburgosura me fëmijë deri në moshën tre vjeç.

IEVP Fushë Krujë

IEVP Burrel

IEVP Tepelenë

IEVP Rrogozhinë

IEVP Peqin

IEVP Lezhë

IEVP Korçë

Në mënyrë të përmbledhur po përmendim problematikën e trajtuar në rekomandimet e bëra gjatë vitit 2012 për sistemin e paraburgimet nëpërmjet të cilave është kërkuar:

Përfundimi sa më parë i ambienteve të reja para stinës së dimrit.

Pajisja me mjet transporti me parametra bashkëkohore sigurie.

Shtesë në organikë për sektorin e lavanderisë dhe sanitarë.

Krijimi i dhomës së takimit me familjarët.

Vendosja e aparatit telefonik në një vend ku garantohet privatësia.

Pajisja e punonjësve të kuzhinës me libreza shëndetësore.

Plotësimi i kartelave mjekësore me rigorizitet.

Vendosja e dyerve në ambientet e tualeteve dhe dusheve.

Vendosja e një frigoriferi në shërbim të të paraburgosurve.

Pajisja e shesh-ajrosjeve me tenda mbrojtëse.

Instalimi i sistemit të ngrohjes dhe ventilimit në qeli.

Etiketimi i kampioneve të vakteve ushqimore.

Plotësimi i stafit mjekësorë me mjek me kohë të plotë.

Shpallja dhe përditësimi i listës me çmimet e ushqimeve që shiten në dyqanet e tyre.

Përdorimi i dorezave dhe uniformës gjatë shpërndarjes së ushqimit.

Sigurimi i një frigoriferi për ruajtjen e kampioneve të vakteve të ushqimit.

Pajisja me ambulance.

Dizinfektimi periodik i ambienteve.

Plotësimi i inventarit të farmacive me ilaçe si ato të përgjithëshme ashtu edhe të urgjencës.

Plotësimi i stafit mjekësor me stomatolog me kohë të plotë.

Pajisja e sektorit të stomatologjisë me pajisjet dhe materialet e nevojshme.

Pajisja e dentistëve me llampë polimerizimi.

Zgjerimi dhe krijimi i hapësirave shtesë për dyfishimin e dusheve dhe banjove.

Krijimi i ambienteve të përshtatëshme për shërbimet e kultit dhe aktiviteteve kulturore.

Përmirësimi i kushteve të dhomave të veçimit.

Eleminimi i lagështirës.

Riparimi i kokave të dusheve, lidhjeve elektrike, rrjedhjeve të ujit.

Riparimi i kaldajës të ngrohjes qendrore.

Pajisja e dhomave të tranzitit dhe veçimit me dyshek, çarçafë, jastëk, batanije dhe lyerja e tyre.

Zgjerimi i ambienteve të ajrimit.

Kontrolli i ushqimeve nga ana e policisë të bëhet duke përdorur dorashka.

Lyerja e dhomave.

Përshtatja e dhomës së takimit të të paraburgosurve me familjarët në mënyrë që biseda të shikohet por jo të dëgjohej.

Inspektimet me iniciativë dhe rekomandimet e bëra gjatë vitit 2012

1. IEVP 313 Tiranë nr. dok. 201202629

Pas inspektimit në këtë institucion u bënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Përmirësimi i ambienteve të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të banjove në sektorë, në mënyrë të veçantë eliminimin e lagështirës, tubacionet e prishura, kokat e dusheve, ndriçuesat dhe lidhjet elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik.
2. Përmirësimi i normave ushqimore të paraburgosurve.
3. Marrja e masave të menjëherëshme për përdorimin e uniformave, dorezave, gjatë shpërndarjes së ushqimit për të paraburgosurit si dhe kontrollin e vazhdueshëm nga ana e personelit përgjegjës të normave të ushqimit në vakte.
4. Marrja e masave për të siguruar që të gjithë të paraburgosurit të jenë të pajisur me sasinë

e mjaftueshme të produkteve bazë të higjenës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e mjaftueshme për të pastruar qelitë e tyre.

5. Trajnimi i stafit psiko-social mbi psikodiagnostikën, planet ndërhyrëse dhe shënimet në dosje.
6. Trajnimi i stafit për trajtimin e personave me varësi nga substancat narkotike.
7. Bashkërendimi më i mirë me OJF që ofrojnë shërbime psikologjike për pasqyrimin në dosje të ndërhyrjeve të ofruara.
8. Mbulimi me shërbime të mbështetjes emocionale për të gjithë të paraburgosurit.
9. Zbatimi i marrëveshjes ekzistuese për arsimin e detyruar e kurset kundër analfabetizmit.
10. Aplikimi i procedurave më e shpejta për kryerjen e konsultave dhe vizitave mjekësore.
11. Funksionimi më i mirë dhe më i shpejtë i kujdesit stomatologjik.
12. Shtimi në organikë i një mjeku dhe ndihmësmjeku.
13. Pajisja e dhomës së mjekut me shtrat vizite apo me pajisje portative (ECHO, Ro-Grafi) për kontroll më të shpejtë të të paraburgosurve.
14. Vënia në funksion e laboratorit dhe rikonstruksioni i dhomës së stomatologut dhe infermierisë.
15. Rivlerësimi i diagnozave të të sëmurëve mendorë për të përcaktuar llojin e çrregullimit. Rishikimi i trajtimit të tyre për të shtuar në terapi AD (antidepresiv) apo dhe Stabilizues humori të tjerë, si edhe trajtimi më adekuat për vartësitë nga medikamentet.
16. Rishikimi i organikës me qëllim përfshirjen e një mjeku psikiatër me kohë të plotë.

Nga përgjigjia e ardhur u informuam se rekomandimet u mirëpritën dhe do të merren të gjitha masat për zbatimin e tyre.

2. I EVP 302 Tiranë nr. dok. 201203868

Nga inspektimet dhe vizitat e kryera në këtë institucion u konstatuan një sërë problemesh, për të cilat u bënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Marrja e masave për eliminimin e lagështirës dhe kryesisht në sektorin 3, me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore në pjesët e amortizuara të godinës.

2. Rikonstruktimi i ambienteve të veçimit, observimit dhe tranzitit lidhur me të gjitha mangësitë e hasura në këto ambiente, si dhe krijimin e mundësisë për lejimin e ajrit dhe dritës natyrale nëpërmjet zgjerimit të dritareve nëpër qeli, pa cënuar elementët e sigurisë së institucionit, me qëllim respektimin e të drejtave të të paraburgosurve konform ligjit dhe eliminimin e pasojave në shëndetin e tyre nga mungesa e ajrit përgjatë qëndrimit në këtë institucion.
3. Marrja e masave për dezinfektimin periodik të institucionit për eliminimin e prezencës së insekteve, me qëllim eliminimin e një epidemie të mundshme si pasojë e mos dezinfektimit në kohë.
4. Furnizimi me produkte higjieno-sanitare në sasi dhe cilësi, lyerja e shtretërve të oksiduar dhe zëvendësimi i enëve të shpërndarjes së ushqimit, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe mundësimin e një higjene me parametra bashkëkohorë.
5. Marrja e masave për krijimin e një ambienti takimi për të paraburgosurit me fëmijët e tyre të mitur, me qëllim ofrimin e një ambienti të pranueshëm për fëmijët e mitur përgjatë takimit me prindërit e tyre dhe të përshtatshëm në aspektin psikologjik.
6. Spostimi i aparatit telefonik jashtë kollonës së punonjësit të regjimit, me qëllim sigurimin e privatësisë për të paraburgosurit përgjatë komunikimit të tyre.
7. Përmirësimi i infrastrukturës së ambientit të shërbimit shëndetësorë dhe stomatolog, me qëllim arritjen e standardeve të kërkuara dhe përmirësimin e shërbimit që ofrohet ndaj kësaj kategorie.

Nga përgjigja e ardhur u informuam se rekomandimet u mirëpritën dhe do të merren të gjitha masat për zbatimin e tyre.

3. IEVP Berat nr. dok. 201203709

Nga organizimi i disa inspektimeve dhe vizitave u konstatuan një sërë problemesh për të cilat u bënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Marrja e masave për përfundimin e godinës së re, me qëllim kalimin e të paraburgosurve sa më shpejt në ambientet e reja, pasi kushtet mjedisore dhe infrastrukurore janë jashtë standardeve.
2. Marrja e masave për riparimin e dusheve, lyerjen e ambienteve në tërësi, furnizimin me produkte të ndryshme higjieno-sanitare, paisjen e qelive me kosha mbeturinash të mbuluar, si dhe mbulimin e kutive të shpërndarjes elektrike sipas parametrave teknik mbrojtës dhe tendosjen e kabllove elektrik në lartësinë e duhur, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe mbrojtjen e të paraburgosurve nga situata të padëshiruara, konform legjislacionit në fuqi.
3. Marrja e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për shërbimin social edukativ, rifreskimin e literaturës bibliotekare, etiketimin e llojshmërisë së tyre, shtimin e programeve riintegruese, me qëllim përmirësimin e shërbimit social edukativ dhe ndikimit pozitiv në rehabilitimin e të paraburgosurve.

4. Marrja e masave për shtimin organikës me personel infermier dhe stomatolog në shërbimin shëndetësor, krijimin e një dhome mjeku, përshpejtimin e procedurave për realizimin e marrëveshjes trepalëshe për listën e barnave të rimbursueshëm dhe tërheqjen e medikamenteve, me qëllim mundësimin e një shërbimi shëndetësorë efikas ndaj kësaj kategorie.
5. Zbatimi i marrëveshjes së Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Drejtësisë për arsimimin dhe vijimsinë e programeve mësimore sipas përkatësisë pedagogjike, për të paraburgosurit në IEVP në Berat.

Nga përgjigja e ardhur u informuam se rekomandimet u mirëpritën dhe do të merren të gjitha masat për zbatimin e tyre.

4. IEVP Korçë nr. dok. 201203949

Pas inspektimit të kryer në këtë institucion u bënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Marrja masave të nevojshme për riparimin, mirëmbajtjen, eliminimin e lagështirës dhe disiplinimin e ujrave të zeza.
2. Krijimi i kushteve dhe përmirësimi i procedurës së larjes në dushe me ujë të ngrohtë duke u garantuar të dënuarve dhe paraburgosurve larjen në ambientet e dusheve të përbashkëta minimalisht një herë në javë.
3. Marrja e masave për përmirësimin e furnizimit me ujë në sektorë duke zgjatur kohën e furnizimit për të dënuarit.
4. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së gatimit për të dënuarit.
5. Marrja e masave të menjëherëshme për riparimin e dhomave, tualeteve dhe paisjen e ambienteve të observimit, me rroba fjetje të reja duke i kthyer ato brenda parametrave të jetesës parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve
6. Marrja e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar qelitë e tyre.
7. Plotësimi sa më parë i organikës së institucionit me një psikolog me kohë të plotë.
8. Sigurimi i ngrohjes në sektorët sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
9. Përmirësimi i ambienteve dhe kushteve të takimeve speciale dhe krijimi i një dhome të veçantë për takime me fëmijët e mitur.

10. Marrja e masave për mundësimin e telefonatave me familjarët për personat të cilët bëjnë një kërkesë të tillë edhe pas orës 16.00.
11. Përmirësimi i shërbimeve psikologjike dhe pasqyrimi në dosje të ndërhyrjeve të ofruara për ata persona që nuk kanë kontakte me familjarët.

5. IEVP Fushë Krujë nr. dok. 20120309

Pas inspektimit të kryer në këtë institucion u bënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Marrja e masave për eliminimin e lagështirës në të gjithë godinën, vënien në funksion të sistemit ngrohës përgjatë stinës së dimrit, si dhe lyerjen e ambienteve (tualet, qeli, koridore, observim, veçim), me qëllim përmirësimin e kushteve për shtetasit që trajtohen në këtë institucion konform standardeve të kërkuara.
2. Marrja e masave për sigurimin me energji elektrike, ujë të pijshëm, ujë të ngrohtë dhe eliminimin e sigurimit të ujit të ngrohtë nga vetë të paraburgosurit nëpërmjet mënyrave primitive dhe riskuese, me qëllim respektimin dhe zbatimin e të drejtave të tyre konform legjislacionit në fuqi dhe evitimin e situatave të padëshiruara.
3. Marrja e masave për shtimin në organikën e këtij institucion të një mjeku të përgjithshëm, kryerjen e të gjitha procedurave administrative dhe farmaceutike për implementimin e skemës së re në shërbimin shëndetësorë dhe tërheqjen e barnave të rimbursueshëm nga depoja përkatëse në kohë, me qëllim ofrimin e një shërbimi shëndetësorë sipas kritereve të parashikuara në Marrëveshjen Trepalëshe DRSKSH-IEVP-Depo Distributore.
4. Marrja e masave për kryerjen e dezinfektimit në të gjitha ambientet, paisjen e të paraburgosurve me produkte higjieno-sanitare në sasi dhe në llojshmëri, paisjen e qelive me kosha mbeturinash të mbuluar, me qëllim parandalimin e një epidemie të mundshme dhe mundësimin e një higjene me parametra bashkëkohore.
5. Marrja e masave për veçimin e të paraburgosurve të grup moshave 18-21 në ambientet përkatëse, me qëllim respektimin e ligjit për këtë kategori nga administrata e IEVP-ve.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve në përgjigjen e dërguar na informoi se vazhdimisht është përpjekur të minimizojë problemet që lidhen me kushtet e jetesës për të burgosurit, si dhe në trajtimin e tyre duke bashkëpunuar në vazhdimësi me institucione dhe organizata të ndryshme joqeveritare për zgjidhjen e këtyre problemeve.

6. Qendra Spitalore e Burgjeve Tiranë nr. dok. 201203869

Pas inspektimit të kryer në këtë Institucion i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve si më poshtë vijon:

1. Marrjen e masave për paisjen e pacientëve dhe ambienteve në tërësi me produkte higjieno-sanitare në të gjitha repartet e kësaj qendre, me qëllim përmirësimin e higjienës vetjake dhe të ambientit ku ato qëndrojnë më së shumti përgjatë kurimit të tyre.
2. Marrjen e masave për ndrrimin e paisjeve hotelerike (çarçaf, peshqirë), lyerjen e shtretërve të oksiduar, si dhe riparimin e aparateve të dusheve me qëllim përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e një shërbimi sipas standardeve të kërkuara.
3. Krijimin e menjëhershëm të një dhome të veçantë observimi për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi, pasi mungesa e saj përbën problem serioz për stafin mjekësor, si dhe paisjen e këtij institucioni me mjetet e duhura të shtrëngimit fizik.
4. Marrjen e masave për mundësimin e zgjatimit të kordonit të aparateve telefonik dhe shtimin e rampeve në këto ambiente, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe lehtësimin e sforcimeve fizike të pacientëve tetraplegjikë që kurohen në këtë qendër.
5. Marrjen e masave për stafin rehabilitues dhe kryesisht atë psiko-social, me qëllim përmirësimin e cilësisë me të gjitha programet e duhura (riaftësuese e riintegruese) dhe kryesisht të shërbimit ndaj pacientëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe zgjerimin e ambientit të edukimit, plotësimin me materiale letrare të bibliotekës dhe mundësimin e të gjitha mjeteve për kryerjen e aktiviteteve brenda këtij ambienti, me qëllim përmirësimin e kushteve për rehabilitimin dhe ndikimin pozitiv në nivel psiko-social, për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe specifikisht të rasteve që trajtohen me mjekim të detyruar.
6. Marrjen e masave për zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim mundësimin në kohë të të gjitha ekzaminimeve mjekësore me specifikë të profilizuar nga institucionet spitalore palë të këtij Memorandumi për persona me liri të kufizuar, si dhe evitimin e situatave të padëshiruara si pasojë e mos evidentimit në kohë të problemeve shëndetësore .
7. Marrjen e masave për rishikimin e menisë ushqimore që serviret për pacientët, si dhe realizimin e një ambienti takimi të pacientëve me familjarët e tyre sipas kushteve dhe parametrave bashkëkohorë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj kësaj kategorie.
8. Marrjen e masave për ruajtjen e medikamenteve në infermieritë e kësaj qendre konform parametrave farmaceutik, plotësimi i këndeve me medikamentet e munguara, si dhe adaptimi i mjekimeve alternative me gama profilaktike psikiatrike në llojshmëri, konform specifikave dhe diagnozave të trajtuara në këtë institucion, me qëllim mundësimin e një kurimi me efikasitet dhe ofrimin e një shërbimi mjekësor rezultativ në dobi të kësaj kategorie.
9. Marrjen e masave për ruajtjen e kampionit ushqimor konform rregullores së përgjithshme institucionale, sigurimin e një mjeteve ambulator sipas parametrave mjekësor dhe standardeve të kërkuara, si dhe evitimin e ekspozimit të mjeteve të forcës nga punonjësit e sigurisë, përgjatë qëndrimit në ambientet e brendshme të kësaj qendre.

Rekomandimi u pranua nga DPB, e cila ka filluar zbatimin e tij.

7. IEVP Sarandë nr. dok. 201202050

Pas inspektimit në këtë institucion u bënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Marrja e masave për plotësimin e organikës së institucionit me personel shërbimi sipas standardeve të kërkuara.
2. Plotësimi i stafit mjekësor me stomatolog me kohë të pjesshme.
3. Marrja e masave për caktimi i dhomave ose ambienteve të përshtatshme për ushtrimin e riteve fetare në këtë institucion.
4. Marrja e masave të nevojshme për zgjerimin e ambienteve të përshtatshme për ajrosjen e të paraburgosurve.
5. Planifikimi i fondeve për rikonstruksionin e përgjithshëm të ambienteve kryesore të godinës së këtij institucioni në të ardhmen.

Nga përgjigjia e dërguar u informuam se janë marrë në konsideratë rekomandimet tona.

8. IEVP Tepelenë nr. dok. 201203950

Pas inspektimit të kryer në këtë institucion rekomanduam:

1. Marrjen e masave të nevojshme për të ulur nivelin e mbipopullimit në institucion dhe respektimin e standardit në hapësirën jetike për çdo të dënuar në m² dhe m³.
2. Përmirësimin e ambienteve të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme për eliminimin e lagështirës, riparimin e kokave të dusheve, të ndriçuesave dhe të lidhjeve elektrike të cilat të bëhen sipas standardeve të sigurimit teknik.
3. Respektimin e normave ushqimore dhe përmirësimin e cilësisë së gatimit për të dënuarit e paraburgosurit, si dhe kontrollin e vazhdueshëm nga ana e personelit përgjegjës të normave të ushqimit në vakte.
4. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjenës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e mjaftueshme për të pastruar qelitë e tyre.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen e dyerve ndarëse të tualeteve në qelitë e të dënuarve.
6. Marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes për të dënuarit dhe paraburgosurit gjatë stinës së dimrit.
7. Marrjen e masave për kryerjen në kohë të konsultave dhe vizitave mjekësore nga ana e personelit mjekësorë.
8. Marrjen e masave për të bërë të mundur funksionimin e plotë dhe në kohë të kujdesit stomatologjik.
9. Rishikimin e organikës me qëllim përfshirjen e një mjeku dhe stomatologu me kohë të plotë në institucion.
10. Marrjen e masave për përshtatjen e ambienteve të ajrimit me tenda mbrojtëse nga kushtet atmosferike dhe zgjerimi i tyre për përdorim të aktiviteteve sportive.

11. Marrjen e masave të nevojshme për rritjen e numrit të librave në bibliotekën e këtij institucioni.
12. Marrjen e masave të nevojshme për të bërë efikas sistemin e ankesave dhe kërkesave të të dënuarve dhe paraburgosurve.

9. IEVP Vlorë nr. dok. 201203951

Pas inspektimit në këtë institucion rekomanduam:

1. Të shikohet mundësia e paisjes së këtij institucioni me një autoambulancë si mjet i domosdoshëm për transportimin e të sëmurëve për rastet e dërgimit urgjentë në Spital.
2. Të rishikohet organika këtij institucioni për të punësuar një mjek psikiatër.
3. Të forcohet bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës urbane degëzimi nga rruga e Nartës deri tek ky institucioni.

10. IEVP Tropojë nr. dok. 201202391

Pas inspektimit në këtë institucion rekomanduam:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për mobilimin e godinës së re, e cila kishte përfunduar së ndërtuari dhe transferimin e të paraburgosurve në këtë godinë.
2. Në kushtet aktuale, të merren masa të menjëhershme për zbatimin me korrektësi të Ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.
3. T’i propozohet Ministrit të Drejtësisë që në urdhërin e kategorizimit të burgjeve kur të hyjë në efikasitet paraburgimi i Tropojës, të parashikohet një seksion për të dënuarit, me qëllim që të burgosurit e këtij rrethi të sistemohen pranë vendbanimit, ashtu siç e kërkon paragrafi i pestë i nenit 31 i Ligjit *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”*. Kjo masë të merret duke patur parasysh largësinë e këtij qyteti nga vendet ku aktualisht janë IEVP-të për të dënuarit.

11. IEVP Kukës nr. dok 201203858

Pas inspektimit në këtë institucion rekomanduam:

1. Marrjen e masave për sigurimin dhe përshtatjen sipas standardeve dhe rekomandimit të CPT-së të ambienteve të takimit të paraburgosurve me familjarët në këtë institucion.
2. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti të veçantë për takimet e të paraburgosurve me fëmijët e mitur të shoqëruar me familjarët e tyre.
3. Marrjen e masave për paisjen e kuzhinës me paisjet e nevojshme industriale të gatimit si dhe kontrollin e vazhdueshëm nga ana e personelit përgjegjës të normave të ushqimit në vakte.
4. Marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes në sektorin e regjimit të brendshëm sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e burgjeve.

5. Marrjen e masave për sigurimin e privatësisë gjatë telefonatave në regjimin e brendshëm duke spostuar vendin e telefonit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen e kamerave të sigurisë në ambientet e regjimit të brendshëm të paraburgimit.

12. IEVP Burrel nr. dok. 201203859

Pas inspektimit të kryer në këtë institucion rekomandua:

1. Marrjen e masave për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerje të dhomave të të dënuarve.
2. Përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të banjove në sektorin e sigurisë së lartë, për eliminimin e lagështirës, riparimin e tubacioneve të dëmtuara, të kokave të dusheve, të ndriçuesave dhe të rrjetit elektrike i cili duhet bëhet sipas standardeve të sigurimit teknik.
3. Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm të këtij institucioni.
4. Marrjen e masave të menjëherëshme për përdorimin e uniformave dhe dorezave gjatë shpërndarjes së ushqimit për të dënuarit si dhe kontrollin e vazhdueshëm nga ana e personelit përgjegjës të normave të ushqimit në vakte.
5. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjenes personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar qelitë e tyre.
6. Vënien në zbatim të marrëveshjes ekzistuese për arsimimin e detyruar të personave analfabet dhe atyre që nuk kanë përfunduar arsimin e detyruar.
7. Marrjen e masave të nevojshme për të siguruar trajtim mjekësor me kohë të plotë në institucion.
8. Marrjen e masave të nevojshme për funksionimin më mirë të kujdesit stomatologjik.
9. Shtimin sa më parë në organikën e institucionit të një mjeku me kohë të plotë.
10. Sigurimin e ngrohjes në të gjithë sektorët sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e burgjeve.
11. Sigurimin dhe vënien në përdorim të një ambienti për ushtrimin e besimeve fetare nga të dënuarit.

12. Përmirësimin e ambienteve të takimeve të të dënuarve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë për takimet me fëmijët e mitur.
13. Marrjen e masave për vendosjen e aparateve të telefonit në regjime përveç atyre në ambientet e ajrimit.
14. Marrjen e masave për mundësimin e telefonatave me familjarët për personat të cilët bëjnë një kërkesë të tillë edhe pas orës 14.00.
15. Përmirësimin e komunikimit të punonjësve të policisë me të dënuarit dhe të bëhen si praktikë pune kontrollet e befashme në qeli më tepër gjatë ditës se sa natën.
16. Përmirësimin e shërbimeve psikologjike dhe pasqyrimin në dosje të ndërhyrjeve të ofruara.

Nga përgjigja e ardhur u informuan se rekomandimet u mirëpritën dhe do të merren masa për zbatimin e tyre. Ndërsa për sa i përket çështjes së lagështirës e cila kërkon fonde investimesh për hidro-izolim, pritet të zgjidhet me investimet që janë planifikuar për vitin 2013.

Ankesa dhe kërkesa të paraqitura nga të dënuarit dhe të paraburgosurit.

Nga trajtimi i 152 ankesë-kërkesave kanë përfunduar 142 dhe janë në ndjekje 10 prej tyre. Nga të përfunduarat, 55 raste janë zgjidhur në favor, 53 raste të pabazuara, 30 raste janë nxjerrë jashtë juridiksionit e jashtë kompetencës; 4 raste kanë hequr dorë nga ankesat.

Objekti i ankesave të ndjekura për vitin 2012 kryesisht ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet e privimit të lirisë dhe që i drejtohen administratës të burgut ose Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ato kanë qenë për përmirësimin e kushteve materiale në burg, për refuzim të padrejtë të kërkesave për leje, për dhënie mase disiplinore të padrejtë, për veprime të kundraligjshme të punonjësve të policisë (dhunë fizike ose psikologjike, veprime poshtëruese, shkelje e privatësisë etj.), refuzim të kërkesës për transferim në një burg tjetër dhe ankesa për shërbimin shëndetësor. Gjithashtu ka patur edhe ankesa ndaj Ministrisë së Drejtësisë për moskthimin e përgjigje të kërkesave të tyre për falje, ndaj organit të prokurorisë për mosllogaritje në dënim të kohës së paraburgimit, si dhe ankesa ndaj gjykatave dhe vendimeve gjyqësore për dënime të padrejta. Ndërkohë ka pasur edhe kërkesa për të dhënë shërbim ligjor falas.

Disa rekomandime lidhur me ankesat individuale.

Rasti i regjistruar me nr. **201202003** dok. Ky rast u fillua pas ankesës së bërë nga një shtetase, e cila pretendonte se dy djemtë e saj të cilët ndodheshin të paraburgosur në IEVP "Jordan Misja" Tiranë, ishin keqtrajtuar nga punonjësit e policisë.

Në përfundim të hetimit të këtij rasti arritëm në konkluzionin se, ndaj dy shtetasve të paraburgosur ishte ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e Policisë së Burgjeve. Njëri prej tyre

ishte ketrajtuar fizikisht në dhomën e ndihmësmjekut nga dy punonjës policie. Ndërsa tjetri ishte keqtrajtuar fizikisht në dhomën e veçimit nga 5 punonjës policie. Kjo sjellje e bërë ndaj të arrestuarve nga punonjësit e policisë, duke i goditur me shqelma, grushta, pëllëmbë në pjesë të ndryshme të trupit të dy dhe veçanërisht njërin prej tyre, të cilin pasi e kishin urdhëruar të hiqte atletet e çorapet, e kanë ulur në dysheme dhe ndërkohë që dy i mbanin me forcë krahët prapa, njëri i mbante me forcë këmbët, dy të tjerë e godisnin me shkop gome në shputat e këmbëve dhe të pëllëmbëve të duarve, përbën një trajtim çnjerëzor e poshtëruës. Si pasojë e kësaj dhune, ankuesve u janë shkaktuar dhimbje e vuajtje të rënda fizike e mendore.

Trajtimi i të dy të arrestuarve nga punonjësit e policisë ishte çnjerëzor dhe ishte bërë me qëllim për ndëshkimin e tyre për shkak të dyshimeve që ata kishin ndaj njërit për simulim si i sëmurë. Ndërsa ndëshkimi i tjetrit ishte bërë për shkak të fyerjeve që ai kishte bërë ndaj personelit të paraburgimit.

Për këtë rast u bë rekomandim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të 5 punonjësve të Policisë së Burgjeve efektivë të I EVP “Jordan Misja” Tiranë, për veprën penale të “Torturës” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 86 dhe 25 i K.Penal, të ndryshuar.

Organi i prokurorisë na informoi se e mirëpriti rekomandimin tonë dhe mbi këtë bazë filloi procedimin penal për veprën penale të “Torturës”, por në përfundim të hetimeve e ka pushuar atë.

Rasti i regjistruar me nr. dok. **201203488**. Ankuesi, i cili ishte i paraburgosur në I EVP Durrës, paraqiti një ankesë nëpërmjet telefonit duke pretenduar se ishte keqtrajtuar fizikisht nga një punonjës i policisë së burgjeve. Në përfundim të hetimit të këtij rasti dhe nga provat e administruara, si regjistrimet filmike të sistemit monitorues të këtij institucioni, dëshmitë dhe Akt-Dëshmia Mjekoligjore u arrit në konkluzionin se pretendimet e ankuesit për dhunim fizik nga punonjësi i policisë ishin të vërteta. Kryerja e veprimeve dhunuese ndaj ankuesit nga punonjësi i policisë së burgjeve përmbante elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Për sa më sipër, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës fillimin e hetimit në ngarkim të punonjësit të policisë që i kishte kryer veprimet e kundërligjshme, efektiv i I EVP Durrës, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i K.Penal, të ndryshuar.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, na informoi se e mirëpriti rekomandimin dhe kishte rregjistruar procedimin penal për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Rasti i regjistruar me nr. dok. **201200104**. Ky rast u regjistrua në bazë të ankesës së bërë nga një shtetas, i cili pretendonte se djali i tij mbahej padrejtësisht nga organi i prokurorisë në Qendrën Spitalore të Burgjeve.

Nga verifikimi i kësaj ankese u konstatua se djali i ankuesit kishte kryer një vepër penale dhe për këtë ishte arrestuar në flagrancë nga policia. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin e datës 20.04.2011, kishte caktuar ndaj këtij shtetasi *masën shtrënguese të sigurimit personal “Shtrim*

në një spitalin psikiatrik". Më pas gjykata me vendimin e datës 29.06.2011, ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës mjekësore të mjekimit të detyrueshëm ndaj tij, por prokurori nuk kishte urdhëruar ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe nxjerrjen nga QSB Tiranë.

Mbajtja në Spitalin e Burgut e këtij shtetasi nga data 29.06.2011 deri më dt. 25.01.2012, për një kohë prej rreth 7 muaj ishte e kundërligjshme. Ky veprim vjen në kundërshtim të plotë me dispozitat e K.Pr.Penale, nenet 24/1, 417/2, 462/2, 463/1 dhe 464/3 e 4 dhe Ligjin Nr. 8331, dt. 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", nenet 2; 9; 22 etj., të cilat sigurojnë veprimtarinë normale të organit të Prokurorisë në bazë të parimit të ligjshmërisë që të mos preket liria e shtetasve, e mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme. Mirëpo në rastin konkret, për shkak të mosveprimeve të prokurorit janë cënuar rëndë këto marrëdhënie juridike, sepse është cënuar veprimtaria normale e institucionit të prokurorisë dhe në të njëjtën kohë është shkelur rëndë liria e shtetasit në fjalë e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe dispozitat procedurale penale të përshkruara më sipër.

Qëndrimet mosvepruese të Prokurorit të Rrethit Gjyqësor Kavajë, i cili ka qënë prokuror i çështjes provoheshin në dy momente të rëndësishme ligjore:

1. Mospushimi i procedimit penal ndërkohë që ishin rrethanat për ta pushuar atë, sepse në bazë të aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor Nr. 107, dt. 08.06.2011 të Institutit të Mjekësisë Ligjore ky shtetas rezultoi i papërgjegjshëm para ligjit për veprën penale të kryer, si dhe në çastin e kryerjes së saj. Sipas nenit 290/b të K.Pr.Penale, *procedimi penal nuk mund të fillojë dhe në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjëndje të procedimit kur personi është i papërgjegjshëm".* Ndodhur në këto rrethana prokurori duhet të zbatonte ligjin duke pushuar procedimin penal dhe jo të vazhdonte hetimet duke zgjatur pa shkak ato, si dhe duke paraqitur kërkesa të përsëritura në gjykatë. Nëse do të kishte vendosur pushimin e procedimit penal, për rrjedhojë në bazë të nenit 261/1/a të K.Pr.Penale do të ishte shuar edhe masa shtrënguese e sigurimit që ishte vendosur ndaj këtij shtetasi. Theksojmë se këtë shkelje procedurale gjatë hetimit të këtij rasti e kishte konstatuar edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë në vendimin e datës 22.12.2011.
2. Mosnxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si për vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë Nr. 61009-00373-12-2011 dt. 29.06.2011, ashtu edhe për vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës Nr. 173 dt. 26.07.2011, i cili ishte i formës së prerë. Detyrimi i tij si prokuror për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore është i parashikuar në nenet 24/1, 462/2, 463/1, 464/3, 463/4 të K.Pr.Penale.

Këto qëndrime mosvepruese të prokurorit, duke moskryer me dashje disa veprime, janë në kundërshtim me ligjin dhe përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës që i është ngarkuar atij me ligj si prokuror, përmbajnë elementët e figurës së veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Për këtë arsye i rekomandua Prokurores së Përgjithshme fillimin e hetimit ndaj këtij prokurori për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës". Por rekomandimi ynë nuk u morë në konsideratë, duke i konsideruar si të ligjshme veprimet e kryera nga prokurori.

Meqënëse qëndrimin e mbajtur në këtë rast nga Prokurorja e Përgjithshme e vlerësuam jo kor-

rekt dhe subjektiv, e përsëritëm rekomandimin tonë duke argumentuar veprimet e kundërligjshme të prokurorit të kësaj çështjeje.

Sipas gjykimit tonë, meqënëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin e datës 29.06.2011, e rrëzoi kërkesën e prokurorit për caktimin e masës mjekësore të mjekimit të detyrueshëm, që në fakt është një lloj “dënimi” penal, atëherë prokurori duhet të kishte urdhëruar ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe nxjerrjen nga QSB Tiranë të këtij shtetasi në bazë të nenit 462/2 të K.Pr. Penale. Nëse nuk do të ishte kështu lind pyetja, përse ky prokuror urdhëroi në datën 24.01.2012 ekzekutimin e vendimit penal Nr. 12-2011-1572, dt. 22.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Kavajë, megjithëse ai nuk kishte marrë formë të prerë.

Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin Nr. 12-2011-1572, dt. 22.12.2011 është shprehur se, *masa shtrënguese e sigurimit personal “Shtrimin në një spitalin psikiatrik”, ishte në fuqi*. Pra kjo gjykatë ka marrë të njëjtin vendim duke rrëzuar kërkesën e prokurorit për caktimin e “masës mjekësore të detyrueshme”, sikurse ishte marrë edhe nga gjykata me vendimin e datës 29.06.2011, i cili ka marrë formë të prerë në datën 26.07.2011, për të cilin ai nuk nxori urdhër ekzekutimi. Sqarojmë se edhe në vendimin e fundit të datës 22.12.2011, gjykata nuk e ka revokuar masën shtrënguese të caktuar ndaj këtij shtetasi me vendimin e datës 20.04.2011, megjithatë prokurori urdhëroi ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor duke mbajtur qëndrim ligjor. Mirëpo edhe rekomandimi i dytë nuk u mirëprit dhe ndërkohë u refuzua.

Konkluzione

Në IEVP-të si dhe në Spitalet Psikiatrike konstatohet se:

- Në disa prej tyre infrastruktura është e amortizuar dhe jashtë standardit;
- Trajtimi i problemeve shëndetësore dhe diagnostifikimi i shtetasve nuk bëhet në kohën e duhur;
- Ka mungesa në organikë të stafit psiko-social, mjekësor (mjek të përgjithshëm dhe sidomos mjek psikiatër);
- Ka mungesë të pajisjeve të ventilimit;
- Ka mungesë të sistemit të ngrohjes;
- Ka mungesë të programeve rehabilituese dhe riaftësuese kryesisht në institucionet ku qëndrojnë të miturit;
- Mungon trajnimi i vazhdueshëm i stafit shëndetësor;
- Ka mbipopullimi në Spitalet Psikiatrike në Vlorë dhe Elbasan;
- Ka mungesë të mjeteve shtrënguese bashkëkohore, të ambiente konform specifikave për kryerjen e terapive intensive, mungesë të stafeve task-forcë për rastet emergjente, mungesë në raportin mjek-pacient, infermier-pacient dhe kujdestar-pacient, mungesë e programeve rehabilituese dhe ri-integruese në Spitalet Psikiatrike dhe në QSBurgjeve.

KREU III

Marrëdhëniet me publikun dhe bashkëpunimi

1. Pritja e qytetarëve

Në Insitucionin e Avokatit të Popullit, që prej krijimit të tij funksionon Zyra e Pritjes së Popullit, si një mjet që lehtëson qytetarët në paraqitjen e ankesave, apo kërkesave dhe njoftimeve të tyre. Bazuar në rregulloren e brendshme të Avokatit të Popullit, si kontakt i parë me qytetarët, zyra jep ndihmë në plotësimin e ankesave dhe kërkesave të tyre, si dhe në këshillimin ligjor në rastet kur objekti i ankesës të paraqitur nga qytetari ka qenë jashtë sferës së veprimtarisë së Avokatit të Popullit, duke e drejtuar atë në organin apo institucionin që ka për kompetencë trajtimin e ankesës.

Me qëllim mirorganizimin e veprimtarisë dhe rritjen e efektivitetit të shërbimit të ofruar nga Sektori i Pritjes, Avokati i Popullit me Urdhrin Nr.98 datë 24/09/2012 “Për Strukturën dhe Organikën e Institucionit të Avokatit të Popullit”, në mbështetje të nenit 35 të ligjit Nr. 8454 datë 04/02/1999, plotësuar me ligjin Nr. 8600 datë 10/04/2000, ndryshuar me ligjin Nr. 9398 datë 12/05/2005 “ Për Avokatin e Popullit ”, rregullores së brendshme neni 68, ka miratuar strukturën dhe organikën e re të institucionit, nga ku Sektori i Pritjes tashmë është inkuadruar pranë Drejtorisë së Shërbimeve ndaj Qytetarëve.

Ky ndryshim strukturor, mbështetur nga raporti i ekspertëve të EURALIUS, për shkak dhe të fluksit në rritje të numrit të qytetarëve të paraqitur pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ka ngritur nivelin e trajtimit të problematikave të këtij sektori, në një nivel më të lartë.

Në kuadër të mirëfunksionimit të kësaj zyre, si dhe të vlerësimit maksimal të çdo problematike të parashtruar nga qytetarët, Avokati i Popullit me Urdhrin Nr. 109 datë 08/10/2012 “Për vlerësimin ditor të kërkesave, ankesave të paraqitura në institucion” ka caktuar krijimin e një sistemi vlerësimi të çdo ankese të paraqitur pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Nisur nga kjo procedurë, çdo ditë një grup *ad-hoc*, i përbërë nga tre ndihmëskomisionerë të çdo seksioni si dhe nga Njësia për Parandalimin e Torturës, bëjnë vlerësimin e të gjitha ankesave të paraqitura gjatë ditës.

Pranë Sektorit të Pritjes përgjatë vitit 2012 kanë paraqitur ankesë, kërkesë apo njoftime 1565

qytetarë, nga të cilat 1180 ankesa, kërkesa apo njoftime janë pranuar dhe më tej regjistruar për shqyrtim të mëtejshëm nga institucioni i Avokatit të Popullit. Ndërkohë që janë këshilluar 385 qytetarë, ankesat e të cilëve kanë pasur për objekt çështje jashtë juridiksionit apo kompetencave të Avokatit të Popullit, duke iu dhënë orientimin e duhur për rrugën ligjore që duhet të ndjekin, me qëllim zgjidhjen e problemit që kanë.

Muaji	Ankesa Gjithësej	Ankesa për t'u shqyrtuar	Ankesa të Këshilluara
Janar	198	154	44
Shkurt	163	137	26
Mars	154	129	25
Prill	164	149	15
Maj	122	102	20
Qershor	116	100	16
Korrik	118	81	37
Gusht	152	111	41
Shtator	103	72	31
Tetor	98	50	48
Nëntor	103	52	51
Dhjetor	74	43	31
Totali	1565	1180	385

Shënim: Shifrat e paraqitura në këtë tabelë gjejnë pasqyrim dhe në statistikat përmblendhëse në fund të raportit. Në çdo rast këtu nuk pasqyrohen ankesat dërguar institucionit të Avokatit të Popullit me e-mail, postë, telefon, takimeve me qytetarët në zyrat rajonale, apo ditët e hapura, si dhe ankesat e shqyrtuara me iniciativë.

Problematikat e shfaqura

Në një vështrim të përgjithshëm mbi ankesat e parashtruara nga qytetarët, të cilat janë konsideruar jashtë juridiksionit apo kompetencave dhe për pasojë nuk janë regjistruar për ndjekje të mëtejshme, rezulton të kemi një ndarje të tyre si më poshtë:

- Ankesa ndaj vendimeve të Gjykatave Shqiptare: 112
- Ankesa ndaj subjekteve private: 81
- Kërkesa për përfaqësim në gjykatë: 54

- Ankesa ndaj shteteve të huaja: 31
- Konflikte midis individëve: 31
- Konflikte në familje: 18
- Ankesa ndaj organeve të policisë së shteteve të huaja: 12
- Ankesa ndaj përfaqësive të huaja në Shqipëri: 8
- Të tjera: 38

Siç vihet re, pjesë e konsiderueshme e numrit të ankesave, të cilat nuk janë pranuar, ashtu si dhe në raportin e paraqitur vitin e kaluar, e zenë ato drejtuar vendimeve të gjykatave shqiptare të të gjitha niveleve, apo ankesa drejtuar gjyqtarëve, për mosgjykim të drejtë të çështjes gjyqësore. Në këto raste qytetarëve i'u është këshilluar ndjekja e rrugës së ankimimit gjyqësor, si dhe t'i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi pretendimet e tyre ndaj gjyqtarëve. Përqindja e tyre në raport me numrin e përgjithshëm është 29%.

Pjesë të madhe përbëjnë gjithashtu dhe ankesat që qytetarët kanë ndaj subjekteve private, të cilat kryesisht lidhen me largime të pajustificuara nga puna, ose pretendime mbi mosrespektimin e kushteve të kontratave të sipërmarrjes nga këto subjekte. Nga Sektori i Pritjes, qytetarëve i'u është këshilluar ankimimi pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Reflektimi i tyre në përqindje është 21%.

Në tabelën e mësipërme, konstatohet dhe një numër ankesash drejtuar organeve, apo institucioneve të shteteve të huaja. Në problematikat e këtyre rasteve, pjesën më të madhe e zenë ankesat lidhur me shkeljen e të drejtave që pësojnë qytetarët shqiptarë nga vendimet e gjykatave të huaja.

Objekt tjetër i ankesave të këshilluara, janë dhe ankesat drejtuar individëve të tjerë, apo ankesa që kanë të bëjnë me konfliktet brenda familjes. Në këto raste qytetarët kërkojnë ndërhyrjen e Avokatit të Popullit në zgjidhjen e konflikteve, natyra e të cilave kryesisht lidhet me të drejtën e pronës.

2. Veprimtaria e Zyrave Rajonale dhe "Ditët e Hapura"

Veprimtaria e Zyrës Rajonale në Shkodër gjatë 2012

Përshkrimi i veprimtarisë së Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër, është konceptuar në mënyrë të tillë që të shpërndajë një informacion sa më të plotë mbi fushat e veprimtarisë së kësaj Zyre gjatë vitit 2012, përfshirë Nënseksionin për të Drejtat e Fëmijëve.

Nëpërmjet Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit çdo qytetar ka tashmë mundësinë për drejtimin e ankesave individuale, kolektive (përmes instalimit të kutisë postare pranë ambienteve të jashtme të institucionit) lidhur me pretendimet e shkeljes të së drejtave të tyre. Qytetari trajtohet

me profesionalizëm dhe me korrektësi.

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkodër numëron 213 ankesa të qytetarëve dhe 96 këshillime ligjore për çështje të caktuara gjatë vitit 2012.

Theksohet se më së shumti ankesat e qytetarëve kanë qënë të fokusuar në:

- Ankesa individuale dhe kolektive mbi dëmshpërblimet financiare të familjeve e bizneseve të përmytura .
- Ankesa kolektive dhe individuale të banorëve mbi ndërtimin e by pass -it Shkodër.
- Ankesa ndaj ndërmarrjeve CEZ e Ujesjellës SH.A Shkodër mbi faturime të padrejta të qytetarëve ankues.
- Ankesa për mospërfitim në kohë të pagesave të aftësisë së kufizuar nga qytetarët që përfitojnë nga kjo formë pagese.

Ankesat me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve janë bërë kryesisht nga prindërit ose kujdestarët ligjorë të të miturve, e kryesisht lidhen me verifikimet e pagesave të ndihmës ekonomike, pagesave të kujdestarisë, etj .

Veprimtaria e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër pati këtë vit një risi në promovimin e politikave favorizuese në rang Qarku, veçanërisht për nivelin e Komunave, për kategoritë e fëmijëve në nevojë , duke forcuar më tej bashkëpunimin e frytshëm me Observatorin për të drejtat e Fëmijëve; Komunitat dhe Këshillin e Qarkut Shkodër, në procesin e shkëmbimit të të dhënave me bazë mirëqenien e fëmijëve dhe zbatimin e Strategjisë Rajonale për Fëmijët dhe Planin përkatës të Veprimit 2011-2013 në nivel Qarku.

Përgjatë vitit 2012 Nënseksioni i të Drejtave të Fëmijëve pranë Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër ka operuar bashkarisht me institucionet rajonale dhe organizatat e shoqërisë civile me fokus në monitorimin e të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku.

Aktiviteti i zyrës rajonale për fenomenin e gjakmarrjes

Gjakmarrja është një nga fenomenet akoma shqetësuese për Qarkun Shkodër. Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë aktiviteteve rreth ndërgjegjësimit të publikut dhe autoriteteve përkatëse, për t'i thënë 'Ndal' këtij fenomeni. Në këtë drejtim, Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit ka ofruar gjithë asistencën e nevojshme dhe ka koordinuar punën me partnerë të ndryshëm duke u fokusuar në:

- Promovimin dhe ndërgjegjësimin për realizimin e të drejtave të fëmijëve sipas standardeve; (fëmijëve të ngujuar u mohohet e drejta e shkollimit)
- Bashkëpunime ndër-institucionale për zbatim rigoroz të të drejtave të njeriut;
- Promovim dhe mbështetje institucionale për "Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve" në nivel Qarku;
- Ndërmjetësim me organizatat e shoqërisë civile që kanë si fokus të punës së tyre fenomenin e gjakmarrjes për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit;

- Takime dhe konsultime me përfaqësues ndërkombëtarë mbi masat që duhet të merren për zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes (takim me Konsullin e Italisë në Shkodër, takim me përfaqësuesin e OSBE në Shkodër etj)
- Pjesëmarrje dhe ndërmjetësim me Shoqërinë Civile nëpërmjet Kuvendit «Kundër Gjakmarrjes» të krijuar me iniciativën e Avokatit të Popullit;

Veprimtaria e Nënseksionit të të Drejtave të Fëmijëve

Nënseksioni i të Drejtave të Fëmijëve funksionon pranë Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër që në Tetor të vitit 2006. Mandati i këtij Nënseksioni është *“të shërbejë si një avokat, një katalizator dhe një organ monitorues i të drejtave të fëmijëve sipas Konventës të së Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”*.

Përsa i përket funksionimit të tij, ai:

- Shqyrton ankesat individuale mbi shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga veprimet, ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;
- Promovon ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;
- Rekomandon përmirësimin e kuadrit ligjor;
- Studion dhe shqyrton legjislacionin dhe rregullimet administrative mbi promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe përgatit raporte mbi këto çështje.
- Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organet administrative.

Aktivitetet e ndërmarra nga Nënseksioni i të Drejtave të Fëmijëve pranë Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 kanë qënë të fokusuar në aktivitete lobuese e advokuese; promovim të praktikave pozitive të bashkëpunimit ndërsektorial; aksesim të dhënash në lidhje me treguesit e mirëqenies së fëmijëve në bashkëpunim me Observatorin e fëmijëve etj.

Pjesëmarrje në disa nga aktivitetet më të rëndësishme gjatë vitit 2012

- Pjesëmarrje në takimin zhvilluar nga Agjensia e Mbrojtjes të së drejtave të fëmijëve dhe Bashkia Shkodër mbi ligjin e të drejtave të fëmijëve-mekanizmi referues;
- Pjesëmarrje në tryezen e rrumbullakët organizuar nga Eorld Vision rreth problematikave të komuniteteve ku ato punojnë;
- Pjesëmarrje mbi Barazinë Gjinore-Bashkia Shkodër;
- Takim në Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit me fëmijë përfitues të shërbimeve të SOS Fshatrat e Fëmijëve në ditën Kombëtare të Fëmijëve me qëllim njohjen e institucioneve që mbrojnë të drejtat e fëmijëve në Qarkun Shkodër

Mbështetje institucionale dhe bashkëpunim reciprok me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve në nivel Qarku

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkodër ka vazhduar të mbështesë institucionalisht

Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve në nivel Qarku.

Tashme Observatori për të drejtat e fëmijëve me mbështetjen e fuqishme institucionale dhe bashkëpunimin e frytshëm e reciprok të Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit, ka arritur sëbashku të krijojë mekanizmin e mbledhjes së të dhënave për fëmijët.

Ky mekanizëm është i vlefshëm jo vetëm në prezantimin e situatës së zbatueshmërisë të së drejtave të fëmijëve në Shqipëri, por edhe në formulimin e politikave të reja e favorizuese për fëmijët drejtuar institucioneve të qeverisjes vendore.

Nga informacioni i mbledhur në këtë drejtim janë dhënë disa rekomandime përkatësisht sipas fushave, ku ndër më të rëndësishmet citojmë:

- Ngritja e njësisë të të drejtave të fëmijëve në nivel të çdo komune për të raportuar dhe koordinuar rastet e shkeljes të të drejtave të fëmijëve;
- Minimizimi i fenomenit të gjakmarrjes për Qarkun Shkodër;
- Shtimi i stomatologëve dhe shtritja e shërbimit falas të stomatologjisë edhe për nxënës të shkollave rurale;
- Identifikimi dhe ofrimi i shërbimeve për rastet e fëmijëve me HIV/ AIDS;
- Arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuar në kopshte e shkolla të integruara;
- Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuar me shërbime komunitare dhe veçanërisht në zonat rurale të Qarkut Shkodër;
- Alternim i pagesës së ndihmës ekonomike me shërbime sociale në mënyrë që fëmijët e përfshirë në skemën e pagesës së ndihmës ekonomike të jenë përfitues të shërbimeve të caktuara të nevojshme për to;
- Ngritja e një strehëze në nivel qarku për viktimat e dhunës në familje dhe koordinim më i mirë ndësektorial lidhur me çështjet e dhunës në familje;
- Nxitja e pavarësisë së strukturave të Qeverisë së Nxënësve dhe fuqizimi i mëtejshëm i tyre për të raportuar rastet e shkeljes së drejtave të tyre në strukturat përkatëse;
- Vëmendje më e madhe ndaj komunitetit rom, veçanërisht për fëmijët e familjeve romë të instaluar në çadra apo tenda buzë lumit Buna;
- Zbatueshmëria e Planit Përkatës të Veprimit bazuar në Strategjinë Rajonale të Fëmijëve të Qarkut Shkodër.

Edhe përgjatë vitit 2012 këto dy struktura bashkëvepruan në procesin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve në Qarkun Shkodër, evidentimin dhe referimin e çështjeve problematike të plotësimit të të drejtave të fëmijëve dhe promovimin e praktikave të mira drejt zbatimit të të drejtave të tyre.

Përgjatë vitit 2012, Observatori Kombëtar i të Drejtave të Fëmijëve prezantoi në formë të dixhitalizuar Raportin mbi Përfshirjen shoqërore të fëmijëve për vitin 2010, ku paraqitet një tablo e gjendjes së fëmijëve të cilët janë të përjashtuar.

Veprimtaria e Zyrës Rajonale në Fier gjatë 2012

Në muajin Maj 2012, është bërë e mundur pranë ambienteve të Bashkisë Fier, fillimi i funksionimit

të Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Fier. Kjo zyrë u krijua jo vetëm për përballimin në vazhdimësi të fluksit në rritje të ankesave e kërkesave të individëve, në lidhje me shkeljen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të tyre, por edhe për t'ju ardhur në ndihmë qytetarëve sa më pranë vendbanimeve të tyre.

Hapja e kësaj Zyre Rajonale është pjesë e strategjisë së Avokatit të Popullit dhe e filozofisë së tij për të qenë një institucion proaktiv, gjithmonë pranë dhe në shërbim të qytetarëve. Zyra Rajonale Fier do të shërbejë si: zyrë për pritjen, orientimin dhe këshillimin e popullit, për mbledhjen e ankesave të qytetarëve, mediacion mes Avokatit të Popullit dhe Bashkisë së Fierit, monitorim të shërbimeve sociale etj.

Ofrimi i shërbimit pranë kësaj Zyre Rajonale kryhet për çdo të premtë të çdo jave. Edhe pse periudha e funksionimit të kësaj zyre është vetëm shtatë mujore, është bërë i mundur pranimi për shqyrtim i 49 ankesave e kërkesave të qytetarëve, si dhe sqarimi, këshillimi e orientimi i 72 shtetasve për zgjidhjen e problemeve të prezantuara prej tyre, në rastet kur çështja e parashtruar nuk ishte objekt i veprimtarisë së Avokatit të Popullit.

Ankesat

Në rastet e paraqitura për trajtim, problematikat e ankesave, kërkesave apo njoftimeve, të prezantuara prej individëve të ndryshëm janë nga më të ndryshmet. Për rastet e pranuar për shqyrtim, ankuesit kanë shprehur shqetësimet e tyre si ndaj organeve të pushtetit lokal, ashtu dhe ato të pushtetit qendror, si:

- Bashkia Fier,
- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore,
- Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,
- "Ujësjiellës-Kanalizime" sh.a., Fier,
- Zyra e Përmbartimit, Fier,
- Këshilli Bashkiak, Fier,
- Spitali Fier,
- CEZ-Shpërndarje, Fier,
- Zyra e Gjendjes Civile, Fier,
- Drejtoria Arsimore, Fier,
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier,
- Prokuroria pranë Rrethit Gjyqësor, Fier.

Media

Një rol mjaft pozitiv në mbarëvajtjen e kësaj Zyre Rajonale është dhënë dhe nga media lokale, e cila herë pas herë ka pasqyruar veprimtarinë e kësaj zyre duke promovuar shërbimet e ofruara prej saj.

Në prezantimet në media kemi theksuar se kjo zyrë u mundëson qytetarëve paraqitjen e

ankesave, apo kërkesave, si dhe përfitimin në kohë sa më të shkurtër të shërbimeve që mund t' u ofrojë institucioni ynë.

Shtimi i zyrave rajonale

Aktualisht institucioni i Avokatit të Popullit funksionon me dy Zyra Rajonale, Zyrën Rajonale të Shkodrës dhe Zyrën Rajonale të Fierit, ku qytetarët mund të depozitojnë ankesat e tyre.

Qëllimi i institucionit të Avokatit të Popullit është hapja e tre zyrave të reja rajonale në mënyrë që të sigurohet mbulimi sa më i plotë i territorit të vendit.

Në kuadrin e mbështetjes së Mbretërisë së Danimarkës, institucioni i Avokatit të Popullit është përfshirë në një nismë për hartimin e një strategjie shumë vjeçare.

Projekti ka në përbërje të tij tre komponentë kryesore, një nga të cilët është bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me pushtetin vendor, brenda këtij komponenti përfshihet dhe hapja e tre zyrave rajonale të reja.

“Ditët e hapura”

Në përputhje me vizionin e tij, si një avokat proaktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar “Ditë të hapura” pothuajse në të gjitha bashkitë dhe komunat e vendit.

Në këto ditë, janë pritur gjithësej 682 shtetas, të cilët rast pas rasti janë këshilluar për rrugët që duhet të ndjekin në realizimin e marrjes së shërbimit nga organet e administratës publike, ose u janë pranuar çështjet për trajtim të mëtejshëm prej institucionit të Avokatit të Popullit.

“Ditët e hapura” kanë tërhequr interesimin e qytetarëve në prezantimin e shqetësimeve të tyre pranë grupit të ekspertëve të institucionit, si dhe kanë mundësuar informimin e qytetarëve mbi veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

“Ditët e hapura” të organizuara gjatë vitit 2012 kanë pasur një axhendë të paracaktuar nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Vizitat e Avokatit të Popullit dhe stafit të tij janë njoftuar gjithnjë në mediat lokale, kjo për të vënë në dijeni çdo qytetar mbi praninë e Avokatit të Popullit.

Gjithnjë takimi i parë gjatë ditëve të hapura është zhvilluar me organizatat e shoqërisë civile që vepronin në vend.

Takimi me organizatat e shoqërisë civile ka pasur si qëllime kryesore :

- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes organizatave dhe institucionit të Avokatit të Popullit (institucioni i Avokatit të Popullit numëron 114 marrëveshje të nënshkruara me organizatat e shoqërisë civile në mbarë vendin)
- Informimin mbi problematikat me të cilat përballëshin qytetarët e komunës, apo bashkisë ku zhvillohej “Dita e hapur” dhe gjithashtu informimin e Avokatit të Popullit me vështirësitë që përballen organizatat e shoqërisë civile gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Pas takimit me organizatat e shoqërisë civile, Avokati i Popullit ka zhvilluar takime me përfaqësues të pushtetit vendor.

Takimet me përfaqësues të pushtetit vendor janë fokusuar mbi problematikat që paraqesin qytetarët e zonës tek këto pushtete, si dhe problemet që kanë vetë organet e pushtetit vendor në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Ndër çështjet e diskutuara me përfaqësuesit e organeve të pushtetit vendor gjatë takimeve janë:

- Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nga organet e qeverisjes vendore;
- Bashkepunimi për të paraqitur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, çështje për të cilat mund të ndërhyet institucionalisht nga AP, për të bërë rekomandime konkrete ndaj organeve të administratës publike;
- Trajtimi sipas legjislacionit në fuqi, i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, të paraqitura pranë organeve të qeverisjes vendore;
- Zbatimi i parimeve të sanksionuara në Kodin e Procedurës Administrative, (përgjegjshmëria, ligjshmëria dhe transparencë gjatë procedimit administrativ etj) për të gjitha vendimmarrjet individuale dhe kolegjiale të organeve të qeverisjes vendore;
- Bashkëpunimi i bashkisë/komunës me organizatat e shoqërisë civile, të cilat veprojnë në territorin ku ajo shtrin juridiksionin e saj;
- Procedurat e regjistrimit, transferimit të familjeve rome;
- Strehimi i familjeve të pastreha, që i përkasin grupeve vulnerabël;
- Zbatimi i kriterëve ligjorë në përcaktimin e familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike;
- Funksionimi në nivel bashkie i mekanizmave të referimit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, viktimat e trafikimit, si dhe fëmijët që janë në rrezik ;
- Ngritja e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për grupet në nevojë (gratë e dhunuara, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara).
- Funksionimi i Inspektoriateve të Ndërtimit dhe Urbanistikës Vendore; etj.

Gjithashtu takime të veçanta janë organizuar dhe me Prefektët e Qarqeve, me të cilët është diskutuar mbi gjendjen e zbatimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe mbi mundësitë e përmirësimit të jetës së qytetarëve, nëpërmjet respektimit dhe zbatimit të lirive dhe të drejtave të tyre kushtetuese.

Pas takimit me organet e pushtetit vendor, Avokati i Popullit vetë personalisht, i shoqëruar dhe nga ekspertë të institucionit prisnin qytetarët, për të dëgjuar nga afër problemet me të cilat ata përballëshin.

Ankesat e qytetarëve, të cilat ishin brenda juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit regjistroheshin dhe më pas niste trajtimi i tyre, ndërsa në rastet kur ankesa ishte jashtë juridiksionit, këshillohej qytetari për rrugën që duhet të ndiqte në zgjidhje të saj.

Ndërsa Avokati i Popullit vazhdonte vizitat në ambiente ku ishin shfaqur probleme (vizitë në Bërdicë në Shkodër, ku po gërryhej lumi, vizitë në Vlorë në një pallat, në të cilin banorët pretendonin se ishin duke u bërë ndërtimje pa leje që rrezikonin shembjen, etj) ekspertët vazhdonin me pritjen e qytetarëve.

Gjatë kësaj kohe, ekspertë të tjerë të institucionit të Avokatit të Popullit dhe në disa raste dhe personalisht Avokati i Popullit bënë inspektime në institucionet shtetërore të shërbimeve publike, për të monitoruar gjendjen e tyre.

Gjatë praktikës së “Ditëve të Hapura” janë inspektuar: komisariatet dhe ambientet e paraburgimit, spitale, shkolla, institucionet e shëndetit mendor, qendrat rezidenciale të përkujdesit social dhe burgje.

Pjesë e axhdendës së “Ditëve të Hapura” ka qenë dhe bashkëpunimi i ngushtë me median lokale. Pothuajse në çdo bashki dhe komunë ku institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar “Ditë të Hapura”, janë marrë masa për dhënien e intervistave dhe prononcime në studio e televizioneve lokale.

Nëpërmjet intervistave në televizionet lokale është synuar:

- Informimi i qytetarëve mbi të drejtat dhe liritë e tyre
- Informimi i qytetarëve mbi kompetencat e Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar “Ditë të Hapura” në:

- Shkodër (6 herë)
- Fier (3 herë)
- Korçë
- Pogradec
- Librazhd
- Kukës
- Sarandë
- Gjirokastër
- Lezhë
- Levan
- Durrës
- Dropull i Sipërm
- Dropull i Poshtëm
- Elbasan
- Vlorë
- Himarë. Etj

Ekspertë të Avokatit të Popullit kanë vizituar thuhetse çdo bashki dhe komunë të vendit, ku kanë mbledhur ankesat e personave me aftësi të kufizuara, të cilët në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2012 nuk kishin marrë pagesën e aftësisë.

3. Marrëdhëniet me median

Institucioni i Avokatit të Popullit është transparent dhe sigurohet që informacioni mbi veprimtarinë e institucionit të jetë gjithnjë i arritshëm nga qytetarët, partnerëve ndërkombëtarë,

apo palët e interesuara, nëpërmjet pasqyrit të tij në media. Synimi konstant i tërheqjes së vëmendjes së autoriteteve vendore dhe qendrore mbi domosdoshmërinë e përmirësimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve nëpërmjet prezantimit publik të problematikës së tyre, ka sjellë rrjedhimisht një bashkëpunim të fortë dhe të vazhdueshëm gjatë këtij viti mes Avokatit të Popullit dhe mediave në vend.

Që në ditët e para të marrjes së detyrës, Avokati i Popullit e prezantoi bashkëpunimin e ngushtë me mediat si pjesë të rëndësishme të vizionit të tij. Performanca dhe pritshmëritë e larta të krijuara në publik gjatë këtij viti kanë vërtetuar se institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm ka punuar ngushtësisht me mediat bazuar në qëllimin e sipërcituar, por edhe që ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm përsa i përket promovimit në publik të problematikës së lidhur me të drejtat e njeriut.

Prej fillimit të mandatit, u deklarua publikisht se mediat dhe shoqëria civile do të ishin aleatët e Avokatit të Popullit gjatë këtij mandati dhe mund të thuhet se ndërveprimi i përbashkët ka qenë i dukshëm gjatë vitit 2012. Asnjëherë më parë në historinë e Institucionit, prezantimi dhe diskutimi i problematikës së të drejtave të njeriut nga Avokati i Popullit nëpërmjet mediave nuk ka qenë në nivelet e këtij viti. Dëshmia e qartë e efikasitetit të këtij bashkëpunimi me median mund të konstatohet jo vetëm në njohjen që publiku ka tashmë për prezencën dhe rolin e Avokatit të Popullit, por edhe në një numër çështjesh që janë shndërruar në tema të ditës për opinionin publik nëpërmjet televizioneve, gazetave dhe mediave të tjera kombëtare.

Duhet theksuar se bashkëpunimi me median gjatë këtij viti ka qenë i frytshëm, por edhe i dyanshëm. Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë shpesh e përzgjedhur si tematikë qendrore në median e përditshme, por nga ana tjetër edhe mediat kanë shërbyer shpesh për nxitjen e veprimeve institucionale nga ana e stafit tone, në fushat që lidhen me të drejtat e njeriut.

Avokati i Popullit, kabineti i tij dhe administrata e institucionit kanë kontakte të vazhdueshme institucionale, direkte dhe nëpërmjet zyrës së shtypit, me gazetarë dhe përfaqësues të mediave print, mediave online dhe atyre vizive. Aktivitetet e rëndësishme të Avokatit të Popullit kanë gjetur interesimin e mediave në gazetatat, televizionet dhe saitet online kryesore në vend. Avokati i Popullit dhe anëtarë të stafit dhe kabinetit kanë qenë po ashtu në vijimësi prezent në media në të gjitha rastet që media dhe publiku kanë kërkuar përfshirjen dhe angazhimin tonë, por veçanërisht në rastet kur detyra dhe ligji na obligojnë të tërheqim vëmendjen mbi problematikat që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në Shqipëri.

Institucioni i Avokatit të Popullit si burim informacioni

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 ka qenë në vazhdimësi pikë referimi, si burim lajmi për mediat dhe operatorët e tyre:

Çështjet dhe veprimtaria e Institucionit për të drejtave të njeriut që kanë shënjuar vitin 2012 janë:

- Çështja rome
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqërinë civile

- Çështja për personat LGBT
- Banoret e përmbytur në Shkodër
- Fenomeni i gjakmarrjes
- Problemet e ish-naftëtarëve
- Ngjarja në fshatin Qelëz të rrethit Pukë në datën 29.06.2012
- Greva e urisë e ish të dënuarve politikë
- Problematika qeramarrësit dhe banesat e ish-pronarëve
- Zgjedhja e komisionerit të ri nga radhët e aftësisë së kufizuar
- Problemi i pagesave të personave me aftësi të kufizuar
- Etj.

Intervista të Avokatit të Popullit, z.Igli Totozani në televizionet kombëtare:

Gjatë punës së tij 1 vjeçare në drejtimin e institucionit, vetë Avokati i Popullit, z.Igli Totozani, ka qenë i pranishëm në intervista në studiot televizive, të cilat kanë qenë të fokusuara:

1- mbi punën dhe fokusin institucional të Avokatit të Popullit

2- mbi tema dhe çështje të caktuara, të cilat janë trajtuar nga Avokati i Popullit dhe stafi i tij.

Me daljet e drejtpërdrejta të Avokatit të Popullit në media është synuar veçanërisht promovimi i të drejtave të grupeve vulnerabël, dhe problematika të tjera, si dhe promovimi i imazhit dhe punës së institucionit, qartësimi mbi kompetencat e Avokatit të Popullit dhe mbrojtjes që ai u bën të drejtave, lirive, interesave të ligjshme të individit nga veprimet, ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës.

Gjatë kësaj periudhe një vjeçare Avokati i Popullit, z.Igli Totozani, ka qenë prezent në këto studio televizive dhe emisione:

- Tonight- Ilva Tare/ Ora News
- Debat- Alfred Peza/ Vizion Plus

- Prizem- Aleksandër Furxhi (të ftuar në studio Avokati i Popullit të Shqipërisë, Avokati i Popullit të Kosovës dhe Avokati i Popullit të Maqedonisë) Albania Screen
- Studio 24- Denis Minga/ News 24
- Wake Up- Ledion Liço, Eno Popi/ Top Channel
- Natën Vonë- Jonida Shehu/ Ora News
- Zip- Vizion Plus
- Intervista e mbrëmjes- Patrik Sadikaj/ Ora News
- Arena- Roland Qafoku/ Tv Planet
- Përjasje- NTV
- Intervista në studio për çështje të ndryshme/ A1 Report
- Makinë me dy timonë/ Club Tv dhe Radio
- Intervistë në Studio- ABC Televizion

Komisionerë, përfaqësues nga kabineti, ndihmës komisionerë dhe anëtarë të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë gjithashtu të pranishëm në televizion për të diskutuar mbi çështje të cilat lidhen drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ekspertë të stafit tonë kanë qenë pjesëmarrës në studio televizive të Top Channel, News 24, Ora News, AS, Vizion Plus, UTV, etj.

Në intervistat e cituara më sipër janë përfshirë vetëm intervistat në studio dhe debatet televizive; (këtu nuk janë përfshirë intervistat që vetë Avokati i Popullit dhe ekspertë të institucionit kanë dhënë për edicionet informative të lajmeve). Intervista për edicionet informative janë dhënë thuajse për të gjitha televizionet ku do përmendim: Ora News, Vizion Plus, News 24, A1 Report, UTV, Albanian Screen, Top Channel, Top Neës, Tv Koha, Tv Klan, Channel One, Scan Tv, Planet Tv, Shijak Tv, etj.

Avokati i Popullit prezent në faqet e opinioneve të të përditshmeve shqiptare

Jo vetëm në intervista dhe debate televizive, por edhe në faqet e opinioneve dhe komenteve të të përditshmeve shqiptare, Avokati i Popullit, z.Igli Totozani, ka qenë mjaft i pranishëm. Në fokus të opinioneve dhe komenteve kanë qenë të drejtat e njeriut, respektimi i tyre, çështje të legjislacionit dhe zbatimit të tij çfarë mund të përmirësohet, çfarë mund të ndryshohet për të përmirësuar cilësinë dhe standardet e jetesës së grupeve në nevojë siç janë: komuniteti rom,

të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, fenomeni i gjakmarrjes, personat me aftësi të kufizuar, komuniteti LGBT etj.

- Një vit- Të drejtat e njeriut/ Gazeta Shqip 10 Dhjetor 2012
- Përballë një fëmije të verbër/ Gazeta Shqiptare, 4 Dhjetor 2012
- Apeli pas një kongresi të invalidëve/ Gazeta Panorama, 8 Tetor, 2012
- Për bashkëqytetarët me aftësi të kufizuara/ Gazeta MAPO, 27 Qershor 2012
- Qytetarët që s' mund të vetëmbrohen, 7 kërkesa për KNJ/ Gazeta Shqiptarja.com, 16 Qershor 2012
- Disa përgjigje për pikëpyetjet mbi LGBT/ Gazeta Panorama, 19 Qershor 2012
- Për qytetarët që s' mund të vetëmbrohen/ Gazeta Panorama, 24 Maj 2012
- Dita Kundër Urrejtjes/ Gazeta Shekulli, 18 Maj 2012
- Pse një Komision Kombëtar për të Drejtat e Njeriut/ Gazeta Panorama, 5 Prill 2012
- Ligji dhe personat me aftësi të kufizuar/ Gazeta Shekulli, 14 Mars 2012
- Ndryshime në përfitimet e invalidëve/ Gazeta Shqiptare, 13 Mars 2012¹³

Faqet Online

Gjatë vitit 2012 lajmet e Avokatit të Popullit kanë pasur një pasqyrim të gjerë në mediat dhe portalet online si: Top Cannel, Balkanëeb, Tema, Panorama, ResPublica, Shekulli, Shqiptarja.com, Mapo, Shqip, Dita, Ama-Neës, Gazeta Start, NOA, Gazeta Idea, etj.

Pasqyrimi në media dhe portale Online i këtyre lajmeve ka sjellë dy elementë kryesorë në punën e Institucionit:

- Informacioni dhe lajmi mbi aktivitetin e Avokatit të Popullit është bërë universal, pra i aksesueshëm nga çdo vend i botës;

13 Të gjithë artikujt mund të gjenden në website zyrtar www.avokatipopullit.gov.al/ në seksionin Media dhe AP.

- Analiza e veprimtarisë së Institucionit e parë nën këndvështrimin e ri të krijuar nga reagimet e publikut dhe lexuesve.

Reagimet e publikut dhe sugjerimet qytetarëve të ardhura direkt nëpërmjet mediave ose nëpërmjet publikut që reagon ndaj informacionit të tyre, kanë shërbyer si ndihmë për të ripërcaktuar pika orientimi në punën e Avokatit të Popullit bazuar në prioritetet, pritshmëritë dhe ndjeshmëritë e opinionit publik.

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe veprimtaria e tij e pasqyruar në mediat ndërkombëtare

Një nga ngjarjet që pati jehonë në median ndërkombëtare ishte strehimi i 8 familjeve romë në ambientet e Institucionit të Avokatit të Popullit në dimrin e frohtë të fillim-vitit 2012, si dhe mbrojtja që i ka bërë Avokati i Popullit personave LGBT në Shqipëri.

Ngjarjet në fjalë gjetën trajtim në media prestigjoze ndërkombëtare si:

- Reuters
- The Associated Press
- Huffington Post
- ANSA
- Radio Free Europe
- Le Matin
- Giornalettismo
- Repubblica
- Washington Post
- Voice of America (VOA)
- Daily News
- Balkaninsight
- BBC

- Bota Sot
- Zeri
- Revista ELLE
- Prishtina Press

Intervista në televizionet lokale

Veç mediave qendrore në vend, Avokati i Popullit ka qenë prezent në mediat lokale të qyteteve që ka vizituar në kuadër të ditëve të hapura. Kështu gjatë 2012 Avokati i Popullit ka qenë në intervista në studio televizive të këtyre televizioneve:

- Tv Channel one në Shkodër
- Tv Korça
- Tv Riviera në Sarandë
- Tv Aulona në Vlorë
- Tv Apollon në Fier

Intervistat në studio në televizionet lokale kanë patur si qëllim informimin e komunitetit të zonës mbi veprimet dhe mosveprimet, kompetencat dhe aktivitetin e institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe përgjigje direkte mbi problematika lokale që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor të detyrave dhe prioriteteve të Avokatit të Popullit.

4. Komunikimi nepërmjet faqes zyrtare të web-it dhe medias sociale



Që prej vitit 2009. Institucioni i Avokatit të Popullit zotëron dhe një faqe zyrtare internet www.avokatipopullit.gov.al Faqja përveç dhënies së informacioneve të shumta në lidhje me institucionin e Avokatit të Popullit, siç janë: historiku, raporte, kuadri ligji mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Avokatit të Popullit, kontakte etj, krijon dhe një mundësi komunikimi mes qytetarëve, mediave dhe të gjitha palëve të interesuara.

Në faqen e Avokatit të Popullit, gazetarët dhe qytetarët e interesuar përveç të dhënave statike, të pandryshueshme mund të konsultojnë dhe materiale dhe informacione të ndryshme si: raporte, rekomandime, rekomandime legislative, aktivitete, deklarata dhe njoftime për media, njoftime për vende të lira pune, njoftime për shpallje tenderash, etj.. Të gjitha këto të dhëna rifreskohen dhe pasurohen, për të qenë sa më transparentë ndaj qytetarëve dhe efikasë në punën tonë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në qendër dhe në fokus të punës së tij qytetarët, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të tyre. Për të qenë sa më pranë qytetarëve në faqen e Avokatit të Popullit, përveç kontakteve të zyrave (të numrave të telefonave dhe emailit) janë publikuar dhe dy numra telefoni në shërbim të qytetarëve. Në dispozicion të publikut është numuri celular 0689034648. Ky numër është i hapur 24 orë, çdo ditë të javës. Qytetarët mund të dërgojnë në mënyrë të përmbledhur me SMS problemin, si dhe adresën e plotë të ankuesit dhe më pas kontaktohen nga ekspertë të institucionit të Avokatit të Popullit. Ndërsa për personat që ndodhen në Institucionet e Vuajtjes së Dënimit, komunikimi realizohet përmes telefonatave të drejtpërdrejta. Gjithashtu për këta persona shërben edhe telefoni falas 0800 1111 gjatë orarit zyrtar 08:30 deri 16:30, nga e hëna në të premte.

Pasqyrimi i vazhdueshëm i punës së institucionit të Avokatit të Popullit në media, të qenurit gjithnjë në kontakt me qytetarët, ka sjellë dhe një numër të madh klikimesh të website-t krahasuar kjo me vitet e kaluara.

Statistika më të detajuara me të dhëna mbi saitin i gjeni si më poshtë :



Një website i ri për Institucionin e Avokatit të Popullit

Në kuadrin e mbështetjes së Mbretërisë së Danimarkës, institucioni i Avokatit të Popullit është përfshirë në një nismë për hatimin e një strategjie shumë vjeçare e cila ka si fokus përmirësimin e punës dhe ndërhyrjen në disa fusha.

Një nga fushat e ndërhyrjes së strategjisë është dhe fusha që lidhet me komunikimin. Një nga objektet e ndërhyrjes në këtë pikë do të jetë dhe përmirësimi i faqes zyrtare të web-it të Avokatit të Popullit. Faqja është menduar të pasurohet me elementë dhe opsione të reja, të cilat do të lehtësojnë aksesin e qytetarëve dhe gjithashtu do të ofrojnë informacion më të plotë dhe në kohë reale.

Një element mjaft i rëndësishëm në këtë kuadër është dhe mundësimi i kryerjes së ankesës online dhe gjithashtu ndjekja e procedurës të kësaj ankese online. Kjo risi do të krijojë një mundësi të shkëlqyer për qytetarët, të cilëve nuk do t'u duhet të drejtohen në institucionin e Avokatit të Popullit, apo në zyrat tona lokale në Shkodër dhe Fier, por nëse ata kanë akses në internet, mund të kryejnë ankesën e tyre nga vendi ku ata jetojnë. Gjithashtu, nëpërmjet internetit në faqen zyrtare ata mund të ndjekin dhe procesin nëpër të cilin kalon trajtimi i ankesës.

Një tjetër element që do t'i shtohet faqes së web-it të Avokatit të Popullit është mundësia e lënies së komenteve në rubrika të ndryshme, ç'ka do të thotë që qytetari nuk është vetëm një lexues i thjeshtë në faqen e Avokatit të Popullit, por është dhe një bashkëbisedues.

Website i ri është menduar të ketë si pjesë të tij dhe mjaft element të tjerë si video, fotogaleri, rubrika të reja, lidhje me portale dhe faqe të tjera të institucioneve ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, etj.

Avokati i Popullit dhe rrjetet sociale

Ndërveprimi nëpërmjet Web-it në fushën e informacionit po ndryshon thellësisht edhe qasjen e institucioneve dhe organizatave ndaj komunikimit me publikun. Kjo mënyrë e re e komunikimit dhe bashkëbisedimit është bërë domodoshmëri, veçanërisht me zhvillimin e rrjeteve sociale. Miliona përdorues në të gjithë botën kanë akses çdo ditë në rrjete të ndryshme sociale nëpërmjet të cilave informacionet lindin, qarkullojnë dhe përhapen me shpejtësi.

Është e qartë që edhe gjatë këtij viti marrëdhënia mes institucioneve dhe qytetarëve jeton një fazë ndryshimi rrënjësor përsa i përket mënyrave të komunikimit. Saitet tradicionale të institucioneve vijojnë të shërbejnë si pika për akses në informacion, por këto sajte duhet tashmë të marrin në konsideratë se gjithnjë e më shpesh qytetarët kërkojnë dialogun e drejtpërdrejtë me interlokutorin e tyre në brëndësi të hapësirave të reja të komunikimit ku mundësohet edhe dialogu i drejtpërdrejt.

Në rrjedhën e këtyre ndryshimeve, edhe Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërtuar module të reja ndërveprimi dhe pjesëmarrjeje në komunikim, me synim përforcimin e transparencës dhe efikasitetit. Gjatë këtij viti kemi gjykuar se hapësirat për media sociale paraqesin një mundësi të madhe për Institucionin tonë, jo vetëm për të informuar dhe për të komunikuar, por edhe për të ndërtuar një marrëdhënie besimi, për të dëgjuar dhe për të monitoruar shqetësimet prioritare dhe çështjet me ndjeshmëri të lartë për qytetarët.

Aktualisht Avokati i Popullit është prezent në rrjetin social Facebook dhe Twitter. Konsiderimi i faktit që institucioni të ketë një profil në një, apo disa rrjete sociale ka qenë prezent në punën tonë gjatë këtij viti, por duam njëherazi të theksojmë që këto mënyra komunikimi integrohen, pa zëvendësuar kanalet tradicionale të komunikimit nëpërmjet të cilave institucioni bën të aksesueshme informacionet dhe shërbimet e tij ndaj qytetarit.

Avokati i Popullit dhe mënyra të reja marrëdhëniesh me qytetarët

Qëllimi i pasqyrimin të aktiviteteve tona në rrjete sociale ka qenë:

- Ilustrimi i aktiviteteve dhe funksioneve të institucionit;
- Lehtësimi i aksesit në shërbimet publike duke zhvilluar dijenitë ligjore mbi to;
- Promovimi i dijeve dhe temave me interes publik dhe social;
- Promovimi i imazhit të Institucionit duke u referuar në aktivitete me rëndësi lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare (aktivitete, njoftime për media, etj).

Gjithashtu, disa nga avantazhet dhe mundësitë që i janë dhënë institucionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet aksesit në median sociale, të cilat sjellin po ashtu dhe avantazhe për qytetarët, paraqiten si më poshtë:

- **Efikasiteti**- thujse të gjithë përdoruesit e internetit janë tashmë të mësuar të kenë akses të përditshëm në median sociale, konkretisht Facebook. Të qenurit pjesë e këtyre mediave i ka dhënë mundësi institucionit të arrijë tek qytetarët paralelisht me kanalet e komunikimit tradicional.
- **Kostoja**- një përdorim i përshtatshëm i mediave sociale për të arritur qytetarin sjell dhe uljen e shpenzimeve që bëhen për komunikimin (fushata publicitare, sondazhe, pyetësorë, fletëpalosje etj).
- **Monitorimi**- një monitorim i aktiviteteve të përdoruesve të lejon të kuptosh pritshmëritë e qytetarëve mbi temat që trajton Institucioni, në këtë rast mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Këto fokus grupe paraqesin një tregues të sensibiliteteve dhe shqetësimeve tek qytetarët.
- **Dëgjim, dialog, besim**- vetë prania e institucionit në faqet e rrjeteve sociale perceptohet nga qytetari si hapje dhe mesazh gadishmërie për dialog.
- **Transparencë**- Marrëdhënia solide mes qytetarit dhe institucionit të Avokatit të Popullit në një media sociale sjell domosdoshmërisht edhe një transparencë më të madhe të institucionit.

Në punën tonë gjatë këtrij viti në këtë segment të kooperimit me mediat kemi patur parasysh që të qenurit thjesht *on line* nuk mjafton më, prendaj ne:

Ndryshuam mënyrat e kërkimit në web: rrugët e ndjekura nga qytetarët për të arritur tek informacioni janë më specifike. Faqja e web-it, apo portali publik, janë mjete të nevojshme, por jo të mjaftueshme, ndaj kemi punuar gjatë vitit 2012 dhe po vijojmë punën për zgjerimin e mëtejshëm të kapaciteteve të këtij komunikimi nëpërmjet ndryshimeve në faqen ëeb dhe pikëlidhjet me rrjetet sociale.

Zgjeruam komunikimin: Avokati i Popullit po punon me vendosmëri që jo vetëm të vejë në dispozicion të qytetarit informacionin në momentin që ata e kërkojnë, por edhe ta informojë atë në kohë për tema të caktuara.

Nga njoftim në komunikim: Rrjetet sociale online, bëjnë të mundur të kemi jo vetëm komunikim me një drejtim, por një bashkëkomunikim. Qytetari nuk ka pse të jetë më një target për t'u "peshkuar" me një mesazh, apo me një shërbim, por një aktor me të cilin mund të ndërveprohet. Ne mendojmë se ai duhet të përfshihet në aktivitetin e institucionit të Avokatit të Popullit ndaj komunikimi direkt ne rrjetet sociale nga stafi ynë është kthyer këtë vit në një prioritet që do vijojë edhe më tej.

Duhet theksuar se përballja me këtë ndryshim kulturor të thellë në komunikim, konsiderohet nga Avokati i Popullit si një mundësi unike për të përmirësuar marrëdhënien me qytetarët dhe vetëdijësimin për të drejtat dhe rolin e tyre. Ndaj prezenca në rrjetet sociale, për institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë gjatë këtij viti dhe do të vijojë të jetë në vazhdimësi, një prioritet në fushën e komunikimit dhe medias.

5. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse

Me një aktivitet dhe kontribut të shquar personal në fushën e shoqërisë civile, Avokati i Popullit, që në platformën e paraqitur për konkurrin, e më pas në dëgjesën publike, vendosi theksin në rolin thelbësor e të pazëvendësueshëm të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe, për rrejdhojë, edhe në rëndësinë e bashkëpunimit të Institucionit me organizatat e shoqërisë civile. Besnik ndaj angazhimeve të marra publikisht, me të marrë zyrtarisht detyrën, Avokati i Popullit e identifikoi shoqërine civile (së bashku me mediat dhe me komunitetin ndërkombëtar) si një nga shtyllat dhe aleatët natyrorë në përmbushjen e mandatit të tij kushtetues.

Në kuadrin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, vlejné të përmenden aksionet e Avokatit të Popullit në mbrojtje të komunitetit rom në janar-shkurtin e vitit 2012. Muajt e parë të këtij viti u karakterizuan nga një bashkëpunim intensiv i Institucionit të Avokatit të Popullit me organizatat që punojné në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe grupet e ndryshme të interesit, si dhe përfshirjen e tij pa rezerva në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës së komunitetit Rom për akses në shërbimet shoqërore dhe skemat e ndryshme të mbështetjes sociale. Në ato ditë, Avokati i Popullit u vizitua nga organizata të ndryshme humanitare dhe shoqërore që dhanë kontributin e tyre në menaxhimin e situatës së pazakontë. Këtu, duhet të përmendim ndihmesën e *Terre des Homme, World Vision, Red Cross, Save the Children, Swiss Foundation for Innovation, Romani Baxt Albania, Vodafone Albania, AS@N* e shumë organizatave të tjera. Në të njëjtën kohë, përfaqësues të shumtë të organizatave ndërkombëtare në Tiranë përfshirë edhe Ambasadorin e Delegacionit të Bashkimit Evropian, zotin Ettore Sequi, përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Ambasadës së Zvicrës, Ambasadës Franceze, etj., vizitonin Institucionin çdo ditë. Në anën tjetër, një mumër i madh mediash dhe gazetarësh transmetonin live në baza ditore gjithë sa ndodhte brenda Institucionit.

Një tjetër moment i rëndësishëm, është thirrja e hapur që Avokati i Popullit u drejtoi organizatave të shoqërisë civile, vendase e të huaja, për t'u solidarizuar me banorët e bllokuar nga dëborat e dimrit të ashpër. Në përgjigje të kësaj thirrjeje u grumbulluan ndihma të shumta të cilat vetë organizatat dhe Avokati i Popullit i transportuan për në veri në një karvan që u quajt karvani i solidaritetit.

Avokati i Popullit që në fillimet e punës së tij nuk hezitoi që publikisht të deklaronte se të drejtat e komunitetit LGBT janë të drejta njerëzore. Që nga ai moment e në vazhdim Avokati i Popullit për asnjë moment nuk ka munguar t'i vijë në ndihmë këtij komuniteti sa herë ka qenë nevoja. Madje, për herë të parë në Shqipëri, Institucioni hartoi një raport të posaçëm për këtë komunitet, i cili pasi u konsultua gjerësisht me organizatat e shoqërisë iu dërgua Kuvendit.

Për ta bërë lidhjen me organizatat e shoqërisë civile sa më funksionale dhe qasjen ndaj saj sa më sistematike dhe metodike, që në muajt e parë, stafi u përfshi në një punë të madhe për evidentimin dhe identifikimin e organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut. Organizatat u grupuan sipas objektivit të punës së tyre dhe Institucioni ndoqi qasjen që fokusonte me përparësi grupet e marginalizuara, përfshirë të gjitha llojet e minoriteteve dhe personat me aftësi të kufizuara. Hapi i dytë kishte të bënte me lidhjen e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me organizatat e ndryshme të shoqërisë civile. Deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, Avokati i Popullit kishte nënshkruar 100 marrëveshje bashkëpunimi me organizatat që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara, përfshirë problemet mendore dhe fizike, gratë, romët, fëmijët, personat LGBT, organizatat që monitorojnë transparencën dhe mirëqeverisjen në nivel qendror dhe vendor, etj. Në total janë nënshkruar 114 marrëveshje nga të cilat 54 në Tiranë dhe të tjerat në Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Pogradec, Korçë, Kukës e Lezhë. Puna në këtë drejtim vazhdon. Në marrëveshjet e përfunduara parashikohet bashkëpunimi me organizatat në fushat me interes të ndërsjelltë, shkëmbimi i informacioneve, organizimi i aktiviteteve lobuese dhe advokuese në favor të grupeve të ndryshme në nevojë, kryerja e studimeve të përbashkëta, etj.

Vlen për t'u shënuar fakti që Avokati i Popullit konsultohet në baza të rregullta me organizatat e shoqërisë civile për të gjitha problemet thelbësore që shqetësojnë grupet e interesit të cilat ato mbrojnë. Në funksion të arritjes së rezultateve sa më të mira në favor të këtyre grupeve, Avokati i Popullit i ka ftuar përfaqësuesit e shoqërisë civile që të përdorin së bashku instrumentin ligjor të rekomandimeve për përmirësime ligjore, përfshirë këtu edhe mundësinë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Një shembull i një sinergjie të tillë është rasti kur Avokati dhe Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuara iu drejtuan kësaj Gjykate në rastin e pagesave të aftësisë së kufizuara.

Në vijë të gjera, aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit në bashkëpunim me shoqërinë civile gjatë vitit 2012, mund të grupohen si më poshtë:

Aktiviteti në mbrojtje të grupeve të ndryshme vulnerabël

Mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGBT. Në mars të vitit 2012, pas një takimi me përfaqësues të komunitetit LGBT, Avokati i Popullit u shpreh se të drejtat e personave LGBT janë të drejta njerëzore dhe se Institucioni që ia drejtonte do të përdorte të gjitha mjetet dhe mundësitë në dispozicion për t'i mbrojtur dhe promovuar këto të drejta. Në vazhdimësi, Avokati i Popullit qëndroi dhe vazhdon të qëndrojë përkrah këtij komuniteti. Në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit Shqipëri-BE, dhe Rekomandimet e vitit 2010 në Opinionin e Komisionit Evropian, zbatimi i parimit të 'trajtimin në mënyrë të barabartë në legjislacionin e punës', është

vlerësuar si element themelor për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*. Në të njëjtën linjë, Avokati i Popullit i ka dërguar një rekomandim Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ku është propozuar plotësimi i nenit 9, të Ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”. Konkretisht, është kërkuar përfshirja në pikën 2 të këtij neni, të shkaqeve për diskriminim, edhe i “orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, si dhe në fund të nenit, përfshirja e një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin. Propozimi i Avokatit të Popullit është pranuar dhe në ndryshimet që do t’i bëhen Kodit të Punës do të parashikohen propozimet për ndryshim në nenin 9 të Kodit të Punës.

Në vijim të Rekomandimit 11 të Komisionit Europian, si dhe mbi bazën e propozimeve të ardhura nga komuniteti LGBT, Avokati i Popullit ndërmoi një studim krahasues të legjislacionit penal në lidhje me mbrojtjen që i garantohet anëtarëve të këtij komuniteti. Nga studimi i legjislacionit penal të vendeve të tjera rezultoi se ato kanë të zhvilluar konceptin e të ashtuquajturit ‘krim të urrejtjes’, duke e parashikuar këtë akt në Kodin Penal si vepër penale, ose si rrethanë lehtësuese. Në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit, i ka dërguar Rekomandim Ministrisë të Drejtësisë, ku ka propozuar që në nenin 50, germa “j”, të Kodit Penal, të shtohet si rrethanë rënduese kryerja e veprës shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me orientimin seksual. Ky Rekomandim është marrë në konsideratë nga Ministria e Drejtësisë, dhe në rastin më të parë të ndërmarrjes së iniciativës për rishikimin e Kodit Penal, do të merret në analizë edhe rekomandimi i sipërpërmendur.

Pasi u vu në dijeni nga Ambasada Pink dhe LGBT Pro Shqipëri, për shqetësimin mbi disa tekste mësimore në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të cilët përmbajnë elemente dhe përkufizime jo shkencore dhe diskriminuese për komunitetin LGBT, Avokati i Popullit i është drejtuar me rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, që të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të menjëherëshme për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në këtë rekomandim është theksuar se ekziston një nevojë e fortë për të rishikuar programet dhe materialet mësimore. Po ashtu, theksohet fakti që është detyrë e gjithë strukturave shtetërore, por jo vetëm e tyre, të ndihmojnë në zbutjen e këtij fenomeni.

Në zbatim 1) të Konventës Evropiane Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, e cila parashikon që metodat, kurrikulat dhe burimet arsimore duhet të shërbejnë për zgjerimin e të kuptuarit dhe respektimin e të drejtave të individit, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual ose identiteti gjinor, duke përfshirë edhe nevojat e veçanta të nxënësve, studentëve, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjeve të tyre; dhe 2) të Rekomandimit 2010 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ku ndër të tjera nënvizohet fakti se lëndët mësimore nuk duhet të përmbajnë tekste të njëanshme, diskriminuese dhe denigruese ndaj komunitetit LGBT, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës përfshirjen në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social apo trajtim çnjerëzor në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Avokati i Popullit, gjithashtu, ka rekomanduar trajnimin e stafit akademik për moslejimin e asnjë forme diskriminimi për shkak të përkatësisë seksuale, duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore.

Më datë 05.09.2012, i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë dhe Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z Bujar Nishani, Raporti i Posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 për të drejtat e personave LGBT. Ky raport ende nuk është marrë në shqyrtim nga Kuvendi.

Mbrojtja e të drejtave të Komunitetit Rom. Përveç strehimit në mjediset e institutionit të 8 familjeve rome për të mos lejuar humbjen e jetëve njerëzore, veçanërisht të fëmijëve, në kushtet e një dimri tejet të ashpër, Avokati i Popullit në bashkëpunim dhe në konsultim me organizatat rome dhe organizata të tjera të të drejtave të njeriut hartoi tre rekomandime për (1) Marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom në regjistrat e gjendjes civile dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të të dhënave të gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin e ri; (2) Marrjen e masave për ngritjen e klasave përgatitore për arsimin parashkollor, për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve Romë në të gjitha nivelet e arsimit dhe bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të ndërgjegjësuar pjesëtarët e komunitetit Rom për moslargimin e fëmijëve të tyre nga ndjekja e shkollës; dhe (3) Marrjen e masave për përfshirjen në vazhdimësi, me prioritet, të pjesëtarëve të minoritetit Rom në programet e formimit profesional dhe punësimin në vazhdimësi, me prioritet, të personave në moshë pune të minoritetit Rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që ky minoritet të mos ndihet i diskriminuar.

Më 06.08.2012, Avokati i Popullit organizoi një takim me përfaqësues të komunitetit rom dhe me organizatat e shoqërisë civile me temë: **“Të mbrojmë të drejtat e komunitetit Rom.”** Gjithashtu, në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Europian, përfaqësues nga “Terre des Hommes”, nga organizata “Save the Children” etj. Takimi me fokus problemet e komunitetit rom, kishte si qëllim të tregonte përpjekjet që ka bërë Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtyre muajve për të zgjidhur këto probleme. Në takim gjithashtu u diskutuan dhe nismat dhe hapat e mëtejshme me qëllim zgjidhjen e problemeve më të mprehta me të cilat përballet komuniteti rom. Në të gjithë aktivitetin e tij Avokati i Popullit ka bashkëpunuar ngushtësisht me organizatat rome si “Gruaja rome e së nesërme”, “Romani Baxt Albania”, “Amaro Drom”, etj.

Mbrojtja e të Drejtave të Grave. Viti 2012 ka qenë një vit i karakterizuar me dhunë të shtuar në familje, duke shënjestruar më së shumti gratë dhe duke çuar në shumë raste dhe në humbjen e jetës së tyre. Përveç një pjesëmarrjeje të gjerë në të gjitha aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e grave, përfshirë edhe ato ekonomike, Avokati i Popullit hartoi edhe një raport të veçantë për dhunën ndaj grave, i cili ë iu dërgua për mendim organizatave joftimprurëse që ushtrojnë aktivitetin e tyre për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe që bashkëpunojnë ngushtësisht me Institucionin e Avokatit të Popullit. Organizatat e sipërpërmendura janë shprehur dakort lidhur me raportin dhe kanë dhënë disa sugjerime për përfshirjen në të, të çështjeve apo problematikave të caktuara, sugjerime të cilat janë përfshirë në brendinë e raportit. Gjithashtu, raporti i është dërguar për mendime edhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Ai i është dorëzuar Parlamentit të Shqipërisë në muajin korrik 2012 dhe ende pritet që të shqyrtohet prej tij.

Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve. Në vitin që shkoi Avokati i Popullit është përqendruar në grupet më vulnerabël në rradhët e fëmijëve. *Fëmijët jetimë* kanë qenë në vëmendje të aktivitetit të Institucionit dhe bashkëpunimi me organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ka qenë i frytshëm. Kështu, është hartuar marrëveshje me një nga organizatat kryesore që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e fëmijëve jetimë si “Instituti Kombëtar për Integrimin e Jetimëve Shqiptarë” drejtuar nga zoti Ilir Cunami.

Fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë janë një plagë e shoqërisë shqiptare e cila nuk po arrin të përmirësohet pavarësisht projekteve të organizatave dhe donatorëve. Problematika e tyre është bërë objekt i të gjitha aksioneve të ndërmarra nga Avokati i Popullit, i cili ka vënë theksin në nevojën e mobilizimit të të gjithë shoqërisë për ta vënë nën kontroll këtë fenomen.

Të drejtat e fëmijëve të ngujuar nga gjakmarrja gjithnjë e më shumë u vunë në fokusin e aktivitetit të përditshëm të Avokatit të Popullit. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut më datë 10.12.2012 në Institucionin e Avokatit të Popullit u pritën 12 fëmijë të qarkut të Shkodrës, të cilët prej vitesh vuajnë pasojat e fenomenit të gjakmarrjes. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin Ambasadorja e Francës, Znj. Moro, Zv/Ministri i Brendshëm Z. Ndoka, Zv/Ministri i Drejtësisë Z. Dobi, Zv/Ministrija e Arsimit Znj. Malaj, përfaqësues të komuniteteve fetare, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Fëmijët paraqitën dhe një ekspozitë me piktura të realizuara nga ta, si dhe recituan poezi të krijuara nga vetë ata, ku binin në sy mesazhet që përcilleshin kundër gjakmarrjes dhe vuajtjes së tyre nga ky fenomen. Në përfundim të aktivitetit organizata Save the Children shpërndau dhurata për fëmijët pjesëmarrës.

Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar (PAK). Kategoritë e personave me aftësi të kufizuar në mënyrë të natyrshme përbëjnë një nga grupet vulnerabel më në nevojë për mbrojtje dhe mbështetje nga Institucioni i Avokatit të Popullit. **Që në krye të herës, Avokati i Popullit ndër morri një evidentim të shoqatave të shoqërisë civile që vepronin në mbrojtje të këtyre grupeve. Si rrjedhojë,** Institucioni ka vendosur kontakte dhe bashkëvepronon në mënyrë aktive me këto shoqata në mbrojtje të të drejtave të tyre, si “Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar”, “Shoqata e Personave që nuk Dëgjojnë”, shoqatat që mbrojnë të drejtat e personave para dhe tetraplegjikë, ato për të drejtat e personave me prapambetje mendore, “Shoqata e Invalidëve të Punës” etj. **Në kujtesën e të gjithëve do të mbetet një takim i Avokatit me personat tetra dhe paraplegjikë në oborrin e** Institucionit në të cilin morën pjesë edhe një numër ambasadorësh të akredituar në Shqipëri. Me këtë rast u përrua edhe rampa e ndërtuar për të mundësuar autonominë në lëvizje të personave me aftësi të kufizuara fizike.

Së fundmi, në dhjetor 2012, Avokati i Popullit zhvilloi një **tur konsultimesh me të gjitha organizatat e shoqërisë civile** që veprojnë në fushën e të drejtave të aftësisë së kufizuar si dhe me personalitete të shquara e drejtues të organizuave kryesore në vend, me **qëllim përzgjedhjen e një Komisioneri nga rradhët e personave me aftësi të kufizuar.** Rezultat i këtyre konsultimeve ishte përcjellja e dy kandidaturave nga kjo kategori për shqyrtim dhe miratim nga Parlamenti Shqiptar. Nëpërmjet këtij akti, Avokati i Popullit synon të përforcojë punën **për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve duke sjellë në Institucion sensibilitetin e këtij grupi shoqëror kundër çdo lloj tabuje dhe paragjykimi, si dhe** dëshiron të japi jo vetëm një shans të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, por edhe një shans për shoqërinë dhe vendin, për ekonominë, politikën dhe kulturën tonë, për të shfrytëzuar këtë kapital njerëzor të pamatshëm dhe të nënvlerësuar deri tani.

Aktiviteti me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën gjakmarrjes. Më 21 shtator 2012, në mjediset e Institucionit u organizua një takim me organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e fenomenit të gjakmarrjes, në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe grave, të cilët shpesh herë janë subjekte që preken nga ky fenomen. Gjatë komunikimit u hodhën ide për mënyrën e veprimit dhe bashkëpunimit për të gjetur rrugët për të luftuar këtë dukuri. Në këtë veprimtari, Avokati i Popullit ka gjetur mbështetjen e organizatave të tilla si “Forumi për Mendimin e Lirë”, “Ambasadorët e Paqes”, etj

Po kështu, gjatë vitit 2012, Institucioni hartoi një raport për të analizuar fenomenin në tërësinë e tij, si dhe ngriti një task-force për monitorimin e veprimtarisë së Policisë të Shtetit dhe strukturave të tjera shtetërore në funksionin e luftës kundër gjakmarrjes, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë rast pas rasti në vazhdimësi monitorimin e çështjeve që kanë lidhje me fenomenin e gjakmarrjes, si

dhe zbatueshmërinë e ligjit Nr.9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

Mbrojtja e të drejtave të personave të privuar nga liria që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të veprave penale. Respektimi i të drejtave të qytetarit në institucionet e paraburgimit, të burgimit dhe të policisë së shtetit është një nga boshtet kryesore të punës së Institucionit. Gjatë vitit që kaloi, Seksioni i Veçantë i Avokatit të Popullit dhe Njësia për Parandalimin e Torturës intensifikuan bashkëpunimin me organizata të tilla si Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për Rehabilitimin e Torturës, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Instituti European i Tiranës si dhe me koalicionet e të drejtave të fëmijëve që monitorojnë situatën dhe të drejtat e të miturve në sistemin e burgjeve dhe paraburgimit, si Bashkë për Kujdesin Tërësor ndaj Fëmijëve, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve, Alo 116, etj. Me disa nga organizatat e shoqërisë civile janë organizuar inspektime të përbashkëta në mjediset e ndalimit dhe vuajtjes së dënimit.

Organizimi i konferencave të përbashkëta me organizatat e shoqërisë civile dhe pjesëmarrja në aktivitetet e organizuara nga shoqëria civile

Ligji për Avokatin e Popullit parashikon bashkëpunimin e Avokatit të Popullit me organizatat e shoqërisë civile dhe organizimin e të paktën një konference kombëtare me fokus në një nga të drejtat njerëzore dhe me pjesëmarrjen e gjerë të organizatave të shoqërisë civile. Gjatë vitit të kaluar, Avokati i Popullit organizoi 4 konferenca të tilla.

- (1) Avokati i Popullit, Tirana Legal Aid Society, Ministria e Drejtësisë dhe Euralius organizuan më 23.05.2012 seminarin mbi “Perspektivën e Ndhmës Ligjore në Shqipëri”. Në takim mori pjesë edhe Ambasadori i Delegacionit të BE në Shqipëri, Zoti Ettore Sequi. Seminari u ndoq nga një numër i madh përfaqësuesish nga organizatat e shoqërisë civile. Në fjalën e tij, Avokati i Popullit, ndër të tjera, vuri në dukje: “Parimi i barazisë para ligjit, si një parim kushtetues shtrihet në të gjithë anëtarët e shoqërisë, por për më tepër ai është edhe më i ndjeshëm për t’u zbatuar dhe garantuar në mbrojtjen e të drejtave, lirive, si dhe integritetin, e individëve, grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara.... Shqipëria synon të bëhet pjesë e familjes së madhe europiane, të cilës duhet t’i bashkohet duke u përputhur me të jo vetëm institucionalisht por dhe me praktikën dhe legjislacionin e saj. Shoqëria shqiptare dhe ne të gjithë së bashku, duhet të tregojë se jemi një shoqëri që respekton parimin e barazisë para ligjit, të drejtat e liritë themelore të njeriut, si dhe garantojmë të drejtën e individit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.
- (2) Më 25.06.2012, Avokati i Popullit dhe Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar organizuan **Konferencën e parë Kombëtare me temë “Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, pjesë integrale e të drejtave themelore të njeriut”,** në të cilën morën pjesë Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Evropian, Z. Ettore Sequi, Zv. Ministria e Arsimit, Znj. Nora Malaj, Z. Sinan Tafaj, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të OSBE, PNUD, UNICEF, etj. Gjatë fjalës së tij, Avokati i Popullit, u shpreh se personat me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e tyre, përbëjnë një nga misionet më të rëndësishme të institucionit të Avokatit të Popullit. Ato janë pjesë e rekomandimit 11, të përcaktuar nga BE për Shqipërinë, dhe në këtë kontekst, zhvillimet në legjislacionin dhe politikën për personat me aftësi të kufizuara, si dhe zbatimi i tyre, kanë qenë objekt i diskutimeve, vlerësimeve dhe rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit.
- (3) Avokati i Popullit në bashkëpunim me Pink Embassy, Mbretërinë e Hollandës, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve

të Barabarta organizuan më 11.12.2012 seminarin me temë: **“Respektimi i të drejtave të komunitetit LGBT: Arritje dhe sfida”**. Gjatë takimit, të zhvilluar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, është diskutuar mbi rekomandimet e posaçme të Avokatit të Popullit, planin e veprimit të grupit të punës të ngritur nga ministria, gjendjen e komunitetit LGBT në vend dhe sfidat me të cilat përballen institucionet publike dhe organizatat LGBT për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

(4) Më 16 tetor 2012, Avokati i popullit në bashkëpunim me shoqatën “Forumi i Mendimit të Lirë”, organizuan në Shkodër një Kuvend Kombëtar me titull: **“Gjakmarrja sfidë e përbashkët”**. Institucioni i Avokatit të Popullit bashkë me organizatat joqeveritare, duke e konsideruar luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes si një nga prioritetet më të rëndësishme të punës së tij, thirri këtë Kuvend me qëllim diskutimin e përbashkët, sensibilizimin e shoqërisë mbi problematikën e rëndë të gjakmarrjes, denoncimin me forcë dhe gjetjen e formave të reja efikase të luftës për ç’rrënjosjen e tij.

Më 21.11.2012 Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën Shkencore me temë: **“Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri”**. Në fjalimin e tij Avokati i Popullit vuri theksin në rëndësinë e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe problemet që shqetësojnë ata. “Konstatohet mungesa e dispozitave ligjore lidhur me rehabilitimin e fëmijëve që kanë qenë viktime të dhunës ose dëshmitarë të dhunës. Në legjislacionin në fuqi nuk ekzistojnë dispozita të veçanta detyruese për raportimin e akteve të dhunës që ushtrohen ndaj fëmijëve, nga qytetarët si dhe nga pjesëtarë të ekipeve në përgjithësi, në institucione të ndryshme, në shkolla etj. Nuk parashikohen, po ashtu, rregulla të veçanta procedurale, në lidhje me rastet e denoncimit për ushtrimin e dhunës kundër fëmijëve. Procesi i decentralizimit të kompetencave nga pushteti qendror tek qeverisja vendore, ka evidentuar se, në përgjithësi, qeverisja vendore nuk është përfshirë sa duhet në ushtrimin e përgjegjësisë për administrimin efektiv dhe monitorimin e institucioneve të transferuara në varësinë e njësisë të kësaj qeverisjeje; mungesa e kapaciteteve dhe mundësitë e kufizuara financiare bëjnë që qeverisja vendore të mos u përgjigjet kërkesave për ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve,” u shpreh ndër të tjera Z. Totozani.

Më 22.11.2012, Avokati i Popullit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile organizuan **një aktivitet në kuadër të Javës së Fëmijëve**. Aktiviteti u organizua në mjediset e Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe në të merrnin pjesë Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian, Z. Ettore Sequi, organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, fëmijë nga fshati SOS, fëmijë nga shtëpia e fëmijës etj. Gjatë fjalës, Avokati i Popullit evidentoi edhe disa problematika që ka vendi ynë lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve si: (1) Funksionimi vetëm i 11 njësisë të të drejtave të fëmijës në nivel qarku dhe i 62 njësisë të mbrojtjes së fëmijëve në nivel bashkie dhe komune; (2) Mosmbledhjen e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në baza të rregullta - deri tani ky Këshill ka zhvilluar vetëm një mbledhje; (3) Mungesat në lidhje me monitorimin dhe mbështetjen e fëmijëve që largohen nga institucionet rezidenciale të kujdesit në moshën 15 vjeçare; (4) Mosmiratimin e strategjisë dhe planit të veprimit në kuadrin e drejtësisë për të miturit, etj. Vërehen gjithashtu, probleme të moskoordinimit dhe mos-institucionalizimit të bashkëpunimit mes qeverisjes vendore, OJF-ve dhe strukturave të tjera shtetërore. Po kështu, është e nevojshme marrja e masave për përmirësimin e kuadrit ligjor për rehabilitimin e fëmijëve që kanë qenë viktime ose dëshmitarë të dhunës; raportimin e detyrueshëm të akteve të dhunës që ushtrohen kundër fëmijëve; vendosjen e rregullave të veçanta procedurale në lidhje me rastet e denoncimit për ushtrimin e dhunës kundër fëmijëve, etj.

Më 14.06.2012, Avokati i Popullit ishte pjesëmarrës në **Seminarin e parë Rajonal për Personat LGBT**, organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri nën kujdesin e Departamentit të Shtetit dhe Departamentit të Drejtësisë. Avokati i Popullit, i cili ishte dhe pjesë e panelit kryesor në këtë seminar, theksoi se të drejtat dhe liritë themelore të komunitetit LGBT, janë përfshirë brenda Rekomandimit 11 të BE “Liritë dhe të drejtat e njeriut”, duke qenë kështu vendimtare për procesin e Integritimit të Shqipërisë në BE. “Por ka edhe një parim, më të padukshëm, më të heshtur, më personal i cili e udhëheq mbrojtjen ndaj cdo diskriminimi: ai i vënies së vetes nën lëkurën e tjetrit, pra, në vendin e atij që ka nevojë për ndihmë. Ky parim i ndjeshmërisë dhe dashurisë njerëzore na nxit – mbi dhe veç të tjerëve – të reflektojmë pa pushim e me intensitet, – duke na ndihmuar të kuptojmë se sa përpara kemi ecur në këtë drejtim, por dhe se lufta kundër homofobisë dhe transfobisë është shumë larg të konsideruarit e fituar,” - u shpreh z.Totozani në fjalën e tij.

6. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare

Sic është theksuar edhe më sipër, Avokati i Popullit e konsideron komunitetin ndërkombëtar një aleat dhe partner të rëndësishëm në realizimin e objektivave të tij. Nga ana e tij, komuniteti ndërkombëtar, i cili që në krye kishte përshëndetur mënyrën transparente dhe kompetitive të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit dhe mbështetjen me bazë të gjerë që i dhanë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, që në momentet e para demonstuan mbështetjen e tyre jo vetëm me deklaratat, por edhe me vizitat e tyre në Institucion..

Në përgjithësi, aktiviteti ndërkombëtar i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 mund të strukturohet sipas këtyre shtyllave kryesore: 1) projekte me mbështetjen ndërkombëtare; 2) aktiviteti në rrafshin shumëpalësh, në kuadrin e organizatave rajonale, europiane dhe ndërkombëtare; dhe 3) aktiviteti në rrafshin dypalësh.

1. Projekte të Avokatit të Popullit me mbështetjen ndërkombëtare

Aktualisht Institucioni i Avokatit të Popullit po mbështetet nga projekti i financuar nga Qeveria Daneze dhe i zbatuar nga Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut me titull **“Forcimi i Ombudsmanit Shqiptar: Më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015).”** Projekti ka pesë shtylla kryesore: 1. Hartimi i një plani strategjik shumëvjeçar për Institucionin; 2. Përmirësimi i sistemit teknologjik (IT) të Institucionit; 3. Forcimi i partneritetit me Shoqërinë civile dhe Mediat; 4. Forcimi i partneritetit me njësitë e qeverisjes vendore; dhe 5. Përmirësimi i inspektimeve në sistemin e burgjeve dhe paraburgimit.

Faza e parë e projektit ka filluar me hartimin, për herë të parë në historinë e Institucionit, e Planit Strategjik për periudhën 2013-2016. Në kuadër të këtij procesi, janë mbajtur dy seminare me stafin e Avokatit të Popullit. Seanca e parë e formulimit të strategjisë është zhvilluar në datat 4-5 dhjetor 2012. Seanca e dytë u zhvillua në datën 14-15 janar 2013. Ndërsa seanca e ardhshme do të zhvillohet në datën 25-26 shkurt 2013. Periudha midis dy seminareve është një periudhë pune për punonjësit e Avokatit të Popullit, të cilët për herë të parë janë pjesë e një procesi të tillë dhe po punojnë intensivisht për hartimin e këtij dokumenti strategjik.

Duhet theksuar se hartimi i këtij Plani Strategjik është menduar të jetë një proces sa më i hapur dhe transparent, ku të përfshihen të gjithë aktorë: shoqëria civile, mediat, institucionet

shtetërore, organizatat ndërkombëtare, të cilët janë ftuar të japin opinionet e tyre në lidhje me mënyrën e ndërtimit të strategjisë dhe përmbajtjes së saj. Kështu, të pranishëm në seminarin për trajtimin e strategjisë, përveç stafit të institucionit të Avokatit të Popullit, kanë qenë përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë. Gjithashtu, pasi të hartohet drafti i parë i këtij dokumenti, ai do t'u shpërndahet grupeve të interesit për të dhënë sugjerimet e tyre.

Paralelisht me strategjinë po punohet edhe për përmirësimin e sistemit IT. Në këtë fushë, Ombudsmeni Danez ka vënë në dispozicion një specialist të fushës. Puna në projekt do të fillojë sipas fazave dhe etapave të vendosura në dokumentin e projektit.

Një tjetër projekt i rëndësishëm u zhvillua në Institucionin e Avokatit të Popullit nga Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve me financim të Ambasadës Britanike në Tiranë, me titull: **“Monitorimi dhe përmirësimi i punës të Zyrës së Avokatit të Popullit”**. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit përmes monitorimit në rritje nga shoqëria civile dhe rritjes së njohurive dhe kompetencave të stafit të Avokatit të Popullit. Gjatë vitit të kaluar projekti ka bërë një vlerësim të punës së stafit, bazuar në studimin e dosjeve të çështjeve të ndrsyhme, mbi të cilin është përgatitur edhe një raport paraprak. Në muajin dhjetor, projekti organizoi një seminar dyditor në datat 20-21 dhjetor me stafin e Institucionit për thellimin e njohurive të tyre rreth Artikullit 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, që ka të bëjë me lirinë e informimit.

Programi **EURALIUS** i financuar nga Bashkimi Europian gjatë vitit të kaluar dha mbështetjen e tij, duke financuar një eksperte për të bërë një analizë tërësore të Institucionit të Avokatit të Popullit, përfshirë strukturën, ligjin dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij. Raporti i ekspertes u konsiderua i dobishëm dhe me vlerë nga stafi drejtues dhe disa nga rekomandimet tashmë janë vënë në zbatim. Me kërkesë të Avokatit të Popullit, ekspertja është kontraktuar sërish nga EURALIUS për të ndihmuar Institucionin për përmirësimin e Ligjit të Avokatit të Popullit, për përmirësimin e metodologjisë së inspektimeve dhe hetimeve dhe përmirësimin e trajtimit të ankesave.

Me nismën e Avokatit të Popullit, Institucioni u përfshi në projektet IPA 2013 për t'u asistuar në forcimin e kapaciteteve të tij institucionale. Së bashku me Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Institucioni është përfshirë në fushën e luftës kundër diskriminimit. Aktivitetet dhe detajet e tjera të projektit janë në proces formulimi dhe miratimi. Gjithashtu, në kuadrin e IPA 2014, Institucioni, si kundër edhe institucionet e tjera shqiptare, është përfshirë në procesin e formulimit dhe plotësimit të kërkesave pëkatëse për të qenë përfitues nga këto fonde.

Për forcimin e kapaciteteve të stafit, Avokati i Popullit ka planifikuar të përdorë gjerësisht mbështetjen e ofruar nga **Programi TAIEX** i Bashkimit Evropian. Janë formuar grupet e punonjësve, janë identifikuar fushat dhe nevojat për trajnim dhe bashkëpunim, si dhe është rakorduar e rënë dakord me një numër institucioneve homologe si Mbrojtësi i të Drejtave të Njeriut në Francë, Kontrollori i Përgjithshëm i Vendeve të Privimit të Lirisë në Francë, Ombudsmeni Spanjoll, Ombudsmeni Danez, etj., për pritjen dhe trajnimin e këtyre grupeve. Janë paraqitur kërkesat pranë TAIEX dhe pritet që në fillim të 2013 të nisen grupet e para të punonjësve në këto vizita studimore në Institucionet homologe.

Për një qasje më afatgjatë në shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e sistemeve të punës së tij, Avokati i Popullit ka hartuar një **kërkesë për një projekt binjakëzimi** me një institucion homolog në një nga vendet e Bashkimit Europian dhe ia ka paraqitur Ministrisë së Integritimit Europian dhe Zyrës së Delegacionit Europian në Tiranë për shqyrtim dhe financim.

2. Bashkëpunimi në rrafshin rajonal dhe ndërkombëtar dhe përfshirja në rrjetet rajonale/ndërkombëtare

Që në ditët e para dhe në vijim të vitit 2012, Avokati i Popullit u vizitua nga një numër ambasadorësh që i shprehën atij vlerësimin e lartë për mënyrën transparente dhe konkurruese të zgjedhjes si dhe e siguruan për mbështetjen e tyre të vazhduar në përmbushjen e mandatit të tij kushtetues. Mund të përmendim këtu vizitat e Ambasadorit të Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, **Z. Ettore Sequi**, Ambasadorit të SHBA, **Z. Alexander Arvizu**, Ambasadorit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, **Zotit Eugen Wollfarth**, Ambasadores së Francës, **Znj. Christine Moro**, Mbretërisë së Bashkuar, **Znj. Fiona McIlwham**, Ambasadores së Konfederatës Zvicerane, **Znj. Yvana Enzler**, Ambasadores së Gjermanisë, **Znj. Carola Müller -Holtkemper**, Shefi i Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, **Z. Marco Leidekker**, etj. Gjatë gjithë vitit, Avokati i Popullit është vizituar në mënyrë të vazhduar nga ambasadorë të ndryshëm si Ambasadori britanik, **Z. Nicolas Cannon**, Ambasadori austriak, **Zoti Florian Raunig**, etj.

Vizita pune të përfaqësuesve ndërkombëtarëve në institucionin e Avokatit të Popullit

Më 07.02.2012, **Z. Stefano Sannino**, Drejtor i Përgjithshëm për Zgjerimin në Komisionin Europian dhe **Z. Ettore Sequi** vizituan zyrën e Avokatit të Popullit në Tiranë duke rikonfirmuar mbështetjen e tyre për institucionin, si një nga shtyllat e të drejtave të njeriut, demokratizimit dhe përmirësimit të qeverisjes.

Më 3 maj 2012, Komisioneri për Zgjerimin në Bashkimin Europian, **Zoti Stefan Fule**, i shoqëruar nga **Zoti Stefano Sannino** dhe **Ambasadori Ettore Sequi**, në kuadrin e vizitës së Komisionerit në Shqipëri, vizituan zyrën e Avokatit të Popullit. Ndër të tjera, Komisioneri Fule u shpreh se ndihej i nderuar dhe vlerëson gjithçka që ka bërë Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtyre muajve. Më tej, ai vijoi: "Vizita ime në këtë Institucion ka për qëllim të shprehë mbështetjen e plotë të Komisionit Europian për ju dhe kolegët tuaj si dhe të nënvizojë rëndësinë e punës suaj në axhendën e zgjerimit të Bashkimit Europian dhe integritimit në Bashkimin Europian."

Avokati i Popullit priti më 06.09.2012 në zyrën e tij **Z. Nils Muiznieks**, Komisioner për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës. Në takim u diskutua për situatën e të drejtave të njeriut në vend dhe për rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave. Nga ana e tij, Avokati i Popullit bëri një përshkrim të aktivitetit të Institucionit në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe e njohu z. Muiznieks me disa raporte të veçanta për gjendjen e të drejtave të njeriut që ka përgatitur Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012. Z. përgëzoi Avokatin e Popullit për punën e bërë nga institucioni në drejtim të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut.

Më 07.09.2012 **Ministri për Zhvillim dhe Bashkëpunim i Mbretërisë së Danimarkës, Z. Christian Friis Bach**, vizitoi Institucionin e Avokatit të Popullit. Z. Totozani i shprehu Ministrin mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë shteti i Danimarkës që nga themelimi

i Institucionit dhe siguroi për angazhimin maksimal të tij dhe Institucionit se projekti danez do të realizohet me sukses dhe çdo qindarkë do të shpenzohet me efektivitet dhe transparencë.

Më 05.10.2012 Avokati i Popullit u vizitua nga **Z. Lamberto Zannieri, Sekretar i Përgjithshëm i OSBE**, i shoqëruar nga ambasadori Eugen Ëollfarth dhe një pjesë e stafit të tij. Z. Zannieri përgëzoi z. Totozani për standardet që ai po vendos me punën e tij dhe për vendimin për të qendruar vetëm një mandat në krye të Institucionit. Z. Lamberto Zannieri theksoi në fjalën e tij se OSBE mbështet aktivitetet e Avokatit të Popullit dhe e konsideron si një Institucion shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. “Që nga momenti i zgjedhjes dhe deri tani ju keni kontribuar në rritjen e prestigjit të këtij Institucioni. Vlerësojmë shumë iniciativën tuaj personale për çështjet që keni trajtuar gjatë punës tuaj. Ju keni mbështetur çështjet e shtresave vuilnerabël, të cilat janë dhe prioritet për OSBE-në, dhe na vjen mirë që kemi përcaktuar të njëjtat prioritate. Do të vazhdojmë të mbështesim Institucionin tuaj dhe ju personalisht” - u shpreh në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm i OSBE, Z. Lamberto Zannieri.

Ombudsmani danez është institucioni që ka kontribuar drejtpërdrejt në themelimin e Institucionit të **Avokatit të Popullit në Shqipëri**. Mbështetja e tij ka vazhduar deri në vitin 2005 dhe në vitin 2011 Ministria e Jashtme Daneze miratoi vazhdimin e ndihmës për Institucionin e Avokatit të **Popullit**, tashmë në një kontekst të ri, atë të konsolidimit të Institucionit. Gjatë vizitës së tij në Tiranë, në muajin maj 2012, **Ombudsmani Danez, Z. Jørgen Steen Sørensen**, i zgjedhur rishtazi uroi homologun e tij për detyrën dhe e siguroi për vazhdimin e bashkëpunimit në kushtet e reja të rritjes së Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri.

Me rastin e bërjes publik të Progres Raportit 2012 të Komisionit Europian për Shqipërinë, **Z. Vassilis Maragos**, Shef i Njësisë për Shqipërinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit në Komisionin Europian, i shoqëruar nga Kreu i Seksionit Politik, Ekonomik dhe Informacionit pranë Delegacionit të BE në Shqipëri, **Zoti Clive Rumbold**, vizituan Avokatin e Popullit. Në takim u diskutua për rëndësinë e institucionit në kuadrin e proceseve integruese të Shqipërisë si dhe u vu theksi në forcimin e aktivitetit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të qytetarëve nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm e korrekt të organeve e strukturave të administratës publike.

Më datë 06.06.2012 Avokati i Popullit priti në zyrën e tij **Zëvendës Drejtoren për Programin e Europës dhe Azisë Qendrore të Amnesty International, Znj. Jezerca Tigani**. Në fjalën e saj, zj. Tigani përshëndeti punën e Avokatit të Popullit gjatë këtyre muajve dhe u shpreh se ka ndjekur me vëmendje dhe në vazhdimësi qëndrimet e Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me çështjen e familjeve rome, komunitetit LGBT dhe çështjen e grave të dhunuara në qendrën rezidenciale në Kamëz. Avokati i Popullit i parashtrroi dhe i përshkroi në mënyrë të detajuar të gjitha ndërhyrjet e kryera për çështjet e sipërpërmendura. Gjatë bisedës së z. Totozani dhe zj. Tigani u shkëmbyen informacione mbi problematikat dhe çështjet që kanë lidhje me situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Në takim u ra dakord për vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm mes Avokatit të Popullit dhe Amnesty International.

Avokati i Popullit priti më 05. 12. 2012 me kërkesën e tyre dy **ekspertë amerikanë për Viktimat dhe Dëshmitarët pranë Prokurorive Federale, zotin Eric Day dhe Znj. Michelle Scott**. Ekspertët e OPDAT-it, Departamentit Amerikan për Çështjet e Drejtësisë, vizituan vendin tonë me qëllim vlerësimin e saktë të situatës së viktimave dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë në Shqipëri dhe planifikimin e aktiviteteve të ardhshme të OPDAT-it në këtë fushë. Zoti Totozani i informoi ekspertët e OPDAT -it në lidhje me punën e institucionit të Avokatit të Popullit dhe, në mënyrë specifike, me përvojën e grumbulluar në punën me palët e dëmtuara

dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë. Të dyja palët shprehën vullnetin e tyre për të vazhduar komunikimin dhe shkëmbimet e ndërsjella në këtë fushë.

Vizitat dhe prania e Avokatit të Popullit në aktivitetet rajonale e shumëpalëshe

Me ftesë të Komisionit Europian, **Avokati i Popullit zhvilloi një vizitë zyrtare treditore në Bruksel nga 18- 20 janar 2012.** Ai u prit në një takim të posaçëm pune me njësinë përgjegjëse për Shqipërinë nën drejtimin e Zotit **Vassilis Maragos**, Shef i kësaj Njësie në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit pranë Komisionit Europian. Në këtë takim u diskutua në mënyrë të hollësishme rreth situatës në Shqipëri dhe aktivitetit të Avokatit të Popullit në procesin e demokratizimit dhe forcimit të qeverisjes së mirë në vend. Po ashtu, Z. Totozani u prit edhe nga **Z. Pierre Mirel**, Drejtor i Njësies për Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën në Drejtorinë e Zgjerimit dhe Drejtori për Zgjerimin në Komisionin Europian, **Z. Stefano Sanino**. Në kthim nga kjo vizitë, z. Totozani bëri një ndalesë në Strazburg ku u prit në takime nga zyrtarë të ndryshëm të Këshillit të Evropës. Gjithashtu, ai pati një takim edhe me stafin e Ombudsmanit Europian.

Në muajin prill 2012, **Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)** publikoi në gazetën elektronike dhe saitin e tij zyrtar në internet www.theioi.org dy artikuj, të cilët pasqyrojnë punën e Avokatit të Popullit, lidhur me aktivitetin dhe rolin e tij për çështjen e komunitetit LGBT dhe çështjen e komunitetit rom.

Më 22.07.2012 **Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet Ambasadorit të tyre në OSBE, Z. Ian Kelly**, kanë lëshuar një deklaratë për t'i uruar mirëseardhjen Ambasadorit Wollfarth në Këshillin e Përhershëm. Ndër të tjera, në deklaratën e tij Ambasadori Kelly mbështeti punën e Avokatit të Popullit, si një punë që vlen të përgëzohet dhe njëkohësisht u bëri thirrje autoriteteve shqiptare t'u kushtojnë vëmendje deklaratave dhe rekomandimeve të tij. "Na inkurajoi emërimi i Avokatit të Popullit për të vazhduar punën për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të popullit shqiptar. Ai deri tani ka bërë punë për të cilat duhet përgëzuar dhe i nxisim autoritetet shqiptare t'u kushtojnë vëmendje deklaratave e rekomandimeve të tij".

Avokati i Popullit u ftua të marrë pjesë në një tryezë diskutimi, organizuar nga **Komiteti i Këshillit të Evropës kundër Tolerancës dhe Diskriminimit (ECRI) në datat 31 maj – 1 qershor 2012 në Strazburg.** Në aktivitet merrnin pjesë drejtues të institucioneve kombëtare që monitrojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut. Pjesë e axhendës së Avokatit të Popullit ishte dhe takimi me zj. Claudia Luciani, Zëvendës Drejtore e Përgjithshme në Drejtorinë e Programit në Këshillin e Evropës. Gjatë takimit me zj. Luciani u diskutua lidhur me mundësitë e bashkëpunimit, për trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe për përmirësimin e metodologjisë dhe punës së Institucionit. Në kontekstin e rëndësisë që i kushton njohjes së stafit me instrumentet dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur ka kërkuar nga stafi që këto dokumente t'i bëjnë pjesë të pandarë të punës së tyre. Specializimi i stafit për grupe të caktuara të drejtash është një masë e rëndësishme drejt përthithjes së këtyre dokumenteve në punën e përditshme. Në këtë kuadër, Institucioni i Avokatit të Popullit mirëpriti raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit mbi situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri duke e vlerësuar këtë dokument si një dokument pune shumë të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të njeriut. Raporti dikton vëmendje të posaçme në fusha që përbëjnë objektin e punës së Avokatit të Popullit, si dhuna në familje, abuzimi ndaj grave dhe fëmijëve, dhuna në polici e burgje, diskriminimi mbi baza etnike, identiteti gjinor apo orientimi seksual, etj.

Më datat **11 dhe 12 qershor në Paris, Francë, u zhvillua takimi i gjashtë i Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut** (Association des Ombudsmans de la Mediterranee/ AOM) me temë: “Fuqizimi i rolit të Ombudsmanit”. Në takim u zhvilluan diskutime dhe u shkëmbyen eksperiencia lidhur me autoritetin e Ombudsmanëve ndaj administratës publike, rolin e tij në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve vulnerabël, si dhe ndikimin e këtij institucioni në edukimin dhe informimin e publikut lidhur me të drejtat e njeriut. Në mbledhjen e zhvilluar në Paris, u zgjodhën dhe organet drejtuese të Organizatës, Bordi Drejtues dhe Këshilli Administrativ. **Avokati i Popullit, u zgjodh me votë unanime të anëtarëve të pranishëm, anëtar i Këshillit Administrativ të përbërë nga 5 anëtarë.** Këshilli Administrativ është një organ i rëndësishëm i Organizatës që diskuton dhe përcakton prioritetet e saj gjatë një periudhe të caktuar kalendarike, drejtimit e veprimtarisë, aktivitetet periodike të saj etj.

Nga data **05 -07 qershor 2012 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u zhvillua një aktivitet tre ditor me pjesëmarrjen e Njësive të Parandalimit të Torturës të Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Sllovenisë.** Aktiviteti, i cili u mbështet nga Këshilli i Europës dhe u bashkëfinancua nga Komisioni European, u zhvillua në formën e shkëmbimit të eksperiencave të ekspertëve ballkanikë, si dhe të një ekspertimi të përbashkët në ambientet e spitalit psikiatrik, Tiranë.

“**Civil Rights Defender**” (CRD - <http://www.civilrightsdefenders.org/>) me qendër të Stokholm shpërndau në rajonin e Ballkanit një pyetësor për organizatat jofitimprurëse, ku këto të fundit pyeten mbi rolin e Avokatit të Popullit veçanërisht për bashkëpunimin me këtë institucion, gjykimin e tyre mbi aktivitetin e tij dhe ndikimin e avokatisë së përbashkët (institucion + OJF) në shoqëritë përkatëse. Pyetësi i organizatës së njohur të të drejtave të njeriut është shpërndarë në të paktën 40 OJF në vendet e rajonit, përfshirë Serbinë, Shqipërinë, Kosovën dhe Bosnje Hercegovinën. Bazuar në një sistem vlerësimi pikësh, OJF-të e intervistuar kanë dhënë gjykimet e tyre mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit. Nga rezultatet e dala prej pyetësorit Avokati i Popullit i Shqipërisë ka patur nivelin më të lartë të vlerësimit në pikë nga OJF-të e përfshira. Rezultatet janë prezantuar nga CRD në një konferencë të posaçme me titull: “**Transparenca dhe llogaridhënia në Administratën Publike**”, me pjesëmarrjen e ombudsmanëve të ftuar nga vende të rajonit dhe Evropës. Konferenca u mbajt në Stokholm nga dt 12- 14 shtator dhe organizohej nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e Komisionit European, në kuadrin e programit TAIEX.

Avokati i Popullit në rolin e bashkorganizatorit mirëpriti në Tiranë më 17.09.2012 **Tryezën e Rumbullakët të Ombudsmanëve të Rajonit**, në kuadrin e projektit: “Promovimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve në Evropën Juglindore”, mbështetur nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European. Qëllimi i aktiviteve të këtij projekti është forcimi i punës dhe bashkëpunimit midis ombudamanëve të vendeve të rajonit.

Përfaqësuesi i OSBE në Shqipëri, Eugen Wollfarth në raportin për Shqipërinë të prezantuar në **dt. 20.09.2012 në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së, ndër të tjera ka nënvizuar dhe rëndësinë e punës së Avokatit të Popullit** dhe u bën thirrje autoriteteve që të zbatojnë si duhet rekomandimet e Avokatit të Popullit. Ndër të tjera, në raport thuhet: “Sa i përket Avokatit të Popullit, zgjedhja në muajin dhjetor të vitit 2011 nga Kuvendi e Avokatit të ri të Popullit, pas një procesi transparent të përzgjedhjes së kandidatëve zhvilluar nga PS-ja, pati ndikim shumë pozitiv. Ai ka rritur ndërgjegjësimin e publikut për çështjet e diskriminimit të grupeve të dobëta si, për shembull, në rastin e mbrojtjes së familjeve të pastreha rromë në Tiranë. Gjithashtu, ai ka bërë komente mbi projektligje të ndryshme dhe ka dhënë rekomandime në lidhje me praktikën e gabuar administrative dhe keqtrajtimit në vendet e vuajtjes së dënimit. Megjithatë, duket se ka ende një mungesë vullneti nga autoritetet për të zbatuar si duhet rekomandimet e Avokatit të Popullit.”

Për nder të 100 vjetorit të Pavarësisë, Avokati i Popullit bëri përpjekje që konferenca e radhës e Organizatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë të mbahej në Shqipëri me qëllim rritjen e shkallës së njohjes dhe imazhit të vendit në botë. **Konferenca me temë “Forcimi i kompetencave të Mediatorëve dhe Ombudsmanëve në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” u mbajt nga 23-24 tetor 2012 në Tiranë.** Në të morrën pjesë 44 ombudsmanë dhe përfaqësues të institucioneve të ombudsmanëve dhe mediatorëve nga vendet frankofone. Konferenca u ndoq edhe nga **Kryetari i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë, Z. Serigne Diop, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Vendeve Frankofone,** dhe njëherazi Mbrojtës i Drejtave të Njeriut në Francë, **Z. Dominique Baudis.** Të pranishmit u përshëndetën nga **Kryeministri i Shqipërisë, Z. Sali Berisha,** i cili shtroi edhe një darkë zyrtare për të pranishmit në Pallatin e Brigadave.

Anëtarësia në organizatat dhe rrjetet ndërkombëtare

Aktualisht Avokati i Popullit është anëtar me të drejta të plota në 6 prej Shoqatave Ndërkombëtare të Ombudsmanëve, si më poshtë:

1. Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI) krijuar në 1978, anëtar që nga viti 2000.
2. Institutit European të Ombudsmanit (EOI) krijuar në 1988, anëtar që nga viti 2000.
3. Shoqatës së Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon (AOMF), krijuar në 1998, anëtar që nga viti 2000.
4. Shoqatës së Ombudsmanit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USOA) krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2006.
5. Shoqatës së Ombudsmanit të Ndërkombëtar (IOA) krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2007.
6. Shoqatës së Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM), krijuar në 2008, anëtar që nga viti 2009.

Kohët e fundit, Avokati i Popullit ka filluar përpjekjet për t’ua anëtarësuar në Rrjetin European të Ombudsmanëve për Fëmijë. Është marrë kontakt me sekretariatit dhe po shqyrtohen kërkesat që duhet të përmbushen.

Një tjetër nismë ku Avokati i Popullit është përfshirë intensivisht është ajo për krijimin e Rrjetit Rajonal të Njësive për Parandalimin e Torturës të vendeve të Evropës Juglindore. Nisma mbështetet nga OSBE dhe nga Këshilli i Evropës.

Aktiviteti në rrafshin dypalësh

Avokati i Popullit ka vendosur dhe mban lidhje të drejtëpërdrejtë dypalëshe me Ombudsmanët e Kosovës, Malit të Zi, Serbisë, Greqisë dhe Maqedonisë. Kontakte të drejtëpërdrejtë mbajnë edhe anëtarët e tjerë të stafit. Në mënyrë të vecantë, punonjësit e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës ndërveprojnë aktivisht me homologët e Mekanizmave të vendeve të tjera.

Me ftesë të **Mbrojtësit të të Drejtave të Njeriut në Francë, Z. Dominique Baudis,** Avokati i

Popullit vizitoi Institucionin e Mbrojtësit të të Drejtave në Francë. Vizita u krye në peridhën 7-9 mars 2012. Pas takimit zyrtar me z. Baudis, gjatë vizitës së tij treditore, Avokati i Popullit zhvilloi takime me Znj. Stephanie Carrere, Këshilltare Speciale për Çështjet Ndërkombëtare, Znj. Maryvonne Lyazid, Këshilltare e Kolegjit për Luftën kundër Diskriminimit dhe Promovimit të Barazisë, si dhe me një numër zyrtarësh drejtues të departamenteve mbrojtëse të të drejtave të njeriut në Francë.

Me ftesë të **homologut danez**, Avokati i Popullit zhvilloi një vizitë pranë Ombudsmanit të Danimarkës nga 26-29 shtator 2012. Gjatë këtij takimi u ra dakord për çështjet kryesore në të cilat Ombudsmani Danez do të vazhdojë mbështetjen e tij dypalëshe për Institucionin e Avokatit të Popullit. Këtu përfshihen vizitat, shkëmbimet e përvojave, trajnimet si dhe kryerja e inspektimeve të përbashkëta. Gjatë kësaj vizite, Avokati i Popullit u takua me Këshilltarin e Lartë në Ministrinë e Jashtme të Danimarkës me të cilin bisedoi çështje të progresit të Shqipërisë drejt Bashkimit Europian dhe që kanë lidhje të drejtëpërdrejt me punën e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit priti më 19.09.2012 në zyrën e tij homologun e **Maqedonisë, Z. Ixhet Memeti dhe homologun e Malit të Zi, z. Šucko Bakovic**. Në fillim të takimit z. Totozani bëri një përshkrim të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit të Shqipërisë, të kontributit që ka dhënë ky Institucion në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë si dhe filozofisë që ka z. Totozani për drejtimin e Institucionit. Përsa i përket marrëdhënieve mes institucioneve, gjatë takimit u fol për bashkëpunim konkret dhe të vazhdueshëm mes Institucionit të Ombudsmanit të Maqedonisë, Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe Institucionit të Ombudsmanit të Malit të Zi. Në takim u fol për marrëveshje bilaterale mes palëve, për shkëmbim eksperiencash, shkëmbim të raporteve vjetore, takime të përvitshme me fokus në çështje të caktuara që prekin të drejtat e njeriut etj. Nga ana e tij z. Memeti dhe z. Bakovic shprehën mirënjohje për ftesën dhe i vlerësuan si mjaft të dobishme shkëmbimet e eksperiencave dhe bashkëpunimin mes institucioneve homologe në rajon për forcimin e rolit të institucioneve në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Në të ardhmen do ketë takime të përbashkëta mes palëve, të cilat do të formalizohen dhe me marrëveshje konkrete.

KREU IV

Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit

1. Struktura organizative e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe reformimi i saj gjatë vitit 2012

Mbështetur në nenin 35 të ligjit Nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, nenit 6 dhe 7 të Rregullores së Brendëshme të Institucionit, dhe në perputhje me prioritetet dhe vizionin e Avokatit të Popullit, në vijim paraqitet struktura e re organizative e Institucionit.

Përshkrim i shkurtër

Struktura e re organizative e Institucionit të Avokatit të Popullit është miratuar në shtator të vitit 2012 dhe synon të rregullojë dhe të rivendosë raporte të reja, që mbështeten në rolin dhe funksionet e Institucionit të Avokatit të Popullit të sanksionuara me ligjin e lartpërmendur, si dhe në vizionin e ri të Institucionit për ndërmarrë një rol më proaktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut si në institucionet e administratës publike, ashtu dhe më gjerë në shoqëri. Për këtë ishte e nevojshme modernizimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të Institucionit, duke përmirësuar e bërë më efikase dhe transparente praktikën e proceset e brendëshme, si dhe duke rritur në mënyrë të vazhdueshme numrin e stafit të ekspertëve dhe aftësitë e njohuritë profesionale të tyre për të ofruar një shërbim sa më profesional dhe cilësor.

Kjo strukturë u hartua dhe u miratua në kushtet, kur Institucioni për më shumë se tre vite, aktivitetin e tij e ushtroi në mungesë të një titullari të zgjedhur nga Kuvendi, e, si rrjedhojë hapësira ligjore dhe kompetencat e Avokatit të komanduar ishin shume të kufizuara dhe struktura organizative e Institucionit nuk pasqyrore vizionin e një institucioni monokratik.

Për të hartuar strukturën e re të Institucionit të Avokatit të Popullit, u ngrit një grup pune, i cili, pasi analizoi me kujdes nevojat dhe prioritetet e Institucionit, fluksin dhe prirjen e re të problematikave, që sillte një praktikë e re në Institucionin e Avokatit të Popullit, rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, vendore, Kuvendit e shoqërisë civile, kuadrin ligjor në fuqi, si dhe burimet financiare, arriti t’i propozojë titullarit të Institucionit strukturën e re të Institucionit. Më konkretisht, në hartimin e strukturës dhe organigramës së Institucionit të Avokatit të Popullit, grupi i punës u mbështet në:

- Në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011”;
- Në orientimin dhe vizionin e Avokatit të Popullit;

- Në analizën e manaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare të institucionit;
- Në raportin dhe vendimin Nr. 19, datë 14.05.2012 të Komisioni të Shërbimit Civil;
- Në raportin e misionit të Euralius;
- Në Ligjin nr . 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005;
- Rregulloren e brendshme të Institucionit;
- Në ligjin nr 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i Nënpunësit Civil”
- Si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fushen e pagave, të hartimit dhe miratimit të strukturës e organikës.

Avokati i Popullit me Urdhrin nr 98, datë 24.09.2012, pasi vlerësoi propozimin e grupit të punës, miratoi strukturën e re organizative të Institucionit.


Reforma në strukturën organizative të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012

Struktura mëparshme e Institucionit reflektonte problematiken e një mandati të kufizuar të titullarit të komanduar të institucionit dhe fondeve buxhetore të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit të Avokatit të Popullit. Struktura e vjetër kishte këto grupime të punonjësve sipas kategorive të mëposhtme :

- 4 punonjës të zgjedhur nga Kuvendi (1 Avokati i Popullit + 3 Komisionerë)
- 4 punonjës të kabinetit (këshilltarë dhe drejtor)
- 29 punonjës me status nëpunësi civil
- 11 punonjës të sektorit ndihmës

Paraqitja grafike: Struktura e vjetër

■ Te zgjedhur nga Kuvendi ■ Kabineti ■ me status ■ punonjës mbështetës



Ndërsa struktura e re adreson disa probleme. Ajo synon të rregulloje raportet midis “sektorit mbështetës” dhe sektorit të zbatimit të politikave të Institucionit në favor të këtyre të fundit. Struktura dhe organigrama në fuqi përmirëson raportet edhe brënda për brënda punonjësve që gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Nga 33 punonjës me status, 20 prej tyre janë ndihmëskomisionerë, të ndarë në tri seksione dhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës:

- **Seksioni i organeve të administratës:** Merret me ankesat apo kërkesat ndaj organeve të administratës qëndrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre;
- **Seksioni i shërbimeve të veçanta:** Merret me ankesat apo kërkesat ndaj policisë, shërbimit sekret, burgjeve, forcave të armatosura dhe pushtetit gjyqësor;
- **Seksioni i përgjithshëm:** Trajton ankesat apo kërkesat që nuk përfshihen në dy seksionet e para, bashkëpunon me organizatat joqeveritare si dhe bën studime në fushën e zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut;
- **Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës:** Gëzon kompetenca për të vëzhguar rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, si dhe të paraqesë në mënyrë specifike raporte dhe rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Raporti dhe vendimi i Komisionit të Shërbimit Civil (KSHC) , që i referohet strukturës së vjetër, adreson një problem që ka të bëjë me organizimin e brendshëm të Institucionit. Raporti konstaton se, “Nga njëra anë është rregullorja e brendshme e punës së institucionit, që miratohet me urdhër të brendshëm Avokatit të Popullit(akt administrativ), e cila në rastin konkret përcakton vartësinë (e ndihmëskomisionerëve) nga Komisioneri dhe nga ana tjetër, është Ligji për Shërbimin Civil (akt ligjor), i cili, këtë kategori punonjësish e vendos nën hierarkinë e Sekretarit të Përgjithshëm...” (fq 4, raporti i KSHC) dhe në vijim raporti del me konkluzionin se :

“Përcaktimi i strukturës në përputhje me ligjin për shërbimin civil, nuk sjell asnjë pengesë ligjore që ndihmëskomisionerët të kryejnë detyrat e tyre duke pasur vartësi procedurale (tekniko-medotike) nga Komisionerët..... Përkundrazi, probleme sjell vartësia direkte e nëpunësit civil nga pozicione pune që nuk janë në shërbimin civil...” (fq 5, raporti i KSHC).


Struktura e propozuar synon pikërisht ta zgjidh këtë “konflikt” duke vënë në vartësi të Sekretarit të Përgjithshëm të gjithë punonjësit që gëzojnë statusin e shërbimit civil, vartësi lidhur me procedurat e rekrutimit, masave disiplinore, propozimit për largim nga puna, vlerësimin e performancës së punës, ngarkesës së punës, etj.

Gjithashtu, çka është thelbësore, struktura e re përmirëson raportin midis sektorit mbështetës dhe sektorit të zbatimit të politikave në favor të grupimit të fundit. Sipas strukturës së re kemi këtë ndarje të pozicioneve në Institucion:

- 4 punonjës të zgjedhur nga Kuvendi (1 Avokati i Popullit + 3 Komisionerë)
- 4 punonjës të kabinetit
- 33 punonjës me status nëpunësi civil
- 7 punonjës ndihmës

Në strukturën e re organizative ruhet e njëjta ndarje me seksione, por rritet numri i ndihmëskomisionerëve. Duke iu referuar strukturës së miratuar, sipas kategorive të punonjësve, kemi këtë ndarje në forme grafike :

Paraqitja grafike: Struktura aktuale



Po të krahasojmë të dy strukturat, lehtësisht vihet re se ka një përmirësim të ndjeshëm të grupimit të punonjësve me status të nënpunësit civil në raport me punonjësit të cilët marrëdhëniet e punës i bazojnë në kodin e Punës, si dhe përmirësim të raportit midis grupit të punonjësve që mund të klasifikohen në grupin politikëzbatues me grupimin mbështetës. Në këtë menyrë Institucioni ynë zgjidh edhe rekomandimin e Komisionit të Shërbimit Civil që i referohet strukturës së vjetër, citojmë:

“Nuk është respektuar një raport i rregullt midis pozicioneve të punës me karakter menaxherial, drejtues, dhe atyre të nivelit ekzekutiv, si në drejtim të a)organizimit të strukturës, drejtori dhe sektorë ,ashtu edhe të b) numrit të pozicioneve që nevojiten për të ndërtuar keto njësi të strukturës”.

Po kështu raporti i lartpërmendur konstaton, se në katër raste, punonjësit e Institucionit e zhvillonin aktivitetin e tyre në kushtet e punësimit të përkohshëm dhe mardhëniet e punës ishin, rregulluar, sipas Kodit të Punës, pasi punonjësit nuk kishin konkuruar më parë, pamavarësisht se postet e punës, kërkonin që punonjësit të gëzojnë, statusin e nëpunësit civil. Emërimi i tyre në këto pozicione pa konkurim, sipas KSHC ishte në shkelje të parimit të ligjit për shërbimin civil, i cili parashikon emërimin vetëm nëpërmjet konkurimit, bazuar në parimin e barazisë së konkurrentëve.Për katër rastet e konstatuara u ndërmorën të gjitha hapat ligjore dhe u zgjidh ligjshmëria e mardhënieve të punës dhe juridike në perputhje me statusin e nëpunësit civil.

Ndërkohë, organika dhe struktura e re adreson dhe zgjidh edhe parregullsitë në emërimin dhe

krijimin e strukturave, veçanërisht në qelizën më të vogël të piramidës siç është sektori.

Aktualisht me strukturën e vjetër kishim katër përgjegjës sektori :


1. Përgjegjës protokolli
2. Përgjegjës IT
3. Përgjegjës i pritjes së popullit
4. Përgjegjës Finance

të cilët nuk kishin në vartësi asnjë punonjës. Pra sipas strukturës së vjetër, ekzistonin katër sektorë dhe katër përgjegjës sektori, por asnjë specialist. Ashtu sikurse kishim një drejtori, drejtorja e Informacionit, Mardhëniet me Publikun e me Jashtë, të pasistemuar, me tre shefa sektori dhe një specialist.

Struktura e re i zgjidh përfundimisht këto probleme dhe forcon Institucionin në funksion të detyrave dhe ligjit, që rregullon veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në përputhje me rekomandimet e misionit të Euralius, forcimi i marrëdhëniet me qytetarin dhe adresimi, filtrimi i çështjeve me të cilat ballafaqohen qytetarët, merr një rëndësi të veçantë. Gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit, veçanërisht vitin e fundit, e ka zgjeruar bashkëpunimin me zyrat homologe jashtë vendit dhe është anëtar në shumë organizata ndërkombetare të ombudsmanëve. Bashkëndimi i veprimtarive dhe ndjekja e këtyre angazhimeve kërkon burime njerëzore dhe financiare. Për këtë arsye, por edhe sepse në drejtim të Institucionit të Avokatit të Popullit ka shumë detyra që lidhen me procesin e integritetit dhe veçanërisht me plotësimin e kriterëve për marrjen e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Evropian, u pa e nevojshme dhe e rëndësishme krijimi i një sektori për marrëdhëniet me jashtë. Për këto arsye të lartpërmendura, u krijua Drejtorja e Shërbimit ndaj Qytetarit, e përbërë nga Sektori i Pritjes së Qytetarit dhe Sektori i Marrëdhëniet me Jashtë. Sektori i Pritjes së Qytetarit shqyrton ankesat, i seleksionon, i klasifikon ato, si dhe u jep këshilla dhe orientime qytetarëve për rastet që nuk lidhen drejtëpërdrejtë me funksionet e detyrat që ligji i ka ngarkuar Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndërkohë, Sektori i Marrëdhëniet me Jashtë, do të jetë përgjegjës për elementët e renditur më sipër, si dhe do të koordinojë zbatimin e projektit të mbështetur nga Qeveria Daneze "Forcimi i Ombudsmanit Shqiptar: Më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015)."

Aktualisht, Institucioni i Avokatit të Popullit me mbështetjen e projektit Danez dhe në bashkëpunim me partnerët tanë, po harton Planin Strategjik të Institucionit për periudhën 2013-2016, i cili do të orientojë veprimtarinë dhe zhvillimet e ardhshme të Institucionit. Në përputhje me këtë dokument strategjik do të duhen edhe ndërhyrje të tjera si në drejtim të strukturës së Institucionit, rregullores së brendshme të Institucionit, mbështetje dhe anagazhim më të madh të burimeve njerëzore dhe financiare, dhe mbi të gjitha, mbështetje të veçantë nga Kuvendi i Shqipërisë.

AVOKATI I POPULLIT



Nr	Emërtimi	Nënpunës
I	Avokati i Popullit	(1)
II	Kabineti	(5)
	Drejtore	1
	Keshilltar	3
	Asistent/ Sekretare	1
III	Seksioni i Organeve te Administrates	(8)
	Komisioner	1
	Ndihmëskomisioner	7
IV	Seksioni i Sherbimeve te Vecanta	(5)
	Komisioner	1
	Ndihmëskomisioner	4
V	Seksioni i Përgjithshëm	(6)
	Komisioner	1
	Ndihmëskomisioner	5
VI	Sekretar i pergjithshëm	(1)
VII	Mekanizmi kombetar për parandalimin e torturës	(5)
	Drejtues/ndihmëskomisioner	1
	Ndihmeskomisioner	4

RAPORTI VJETOR

VIII	Drejtoria e Personelit dhe Finances	(10)
	Drejtor	1
	Përgjegjës finance	1
	Specialist administrate	1
	Specialist protokoll, sekretar i SP/komisionereve.arkiviste	2
	Nëpunës informacioni, magazine	1
	Shofer	3
	Punëtor pastrimi	1
IX	Drejtoria e shërbimeve ndaj qytetareve	(7)
	Drejtor/ndihmëskomisioner	1
	Përgjegjës (IT/Pritjes së Popullit-Mardhëniet me jashtë)	2
	Specialist shërbimi ndaj qytetarit	2
	Specialist koordinimit dhe mardhëniet me jashtë dhe integrimin	2

2. Buxheti i Institucionit për vitin 2012

Për vitin 2012 Institucionit të Avokatit të Popullit në zbatim të Ligjit nr.10487, datë 05.12.2011 "Për Buxhetin e vitit 2012", i është akorduar, një buxhet në shumën **80,211,000 lekë**. Në qershor të vitit të kaluar, mbështetur në kërkesën tonë, Këshilli i Ministrave, i akordoi Institucionit të Avokatit të Popullit, nga fondi rezervë 2.7 milion lekë duke e çuar buxhetin e Institucionit për vitin 2012, në total **83,929,300 lekë**.

Tabela e mëposhtme jep një pamje të ndarjes së shpenzimeve buxhetore të Institucionit sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe i krahasuar:

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa	Plani ndryshuar	Fakti
600	Pagat	58,061,000	400,000	58,461,000	57,385,328
601	Sigurime	7,350,000		7,350,000	7,120,725
602	Shpenz.operative	13,000,000	2,744,800	15,744,800	15,090,854
604	Transf.brendshme		573,500	573,500	573,500
605	Kuotë anëtarësie	300,000		300,000	288,822
231	Investime (Pajisje)	904,996		904,996	904,574
231	Investime (punime jashte)	595,004		595,004	595,004
	Totali	80,211,000	3,718,300	83,929,300	81,958,807


Buxheti i AP per vitin 2012 sipas zërave

000 leke

nr.	Emërtimi	Plan	Fakt	në %	Ndryshimi
1	Paga	58,400	57,385	98%	-1015
2	sigurime shoqërore	7,350	7,120	97%	-230
3	shpenzime operative	16,617	15,952	96%	-665
4	Investime	1,500	1,500	100%	0
	Totali	83,867	81,957	98%	-1910

struktura e shpenzimeve 2012

■ paga ■ sigurime shoqerore ■ shpenz operative ■ Investime



Realizimi i Fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme dhe rezultojnë të jetë realizuar në masën 98 përqind. Gjatë vitit 2012, numri mesatar i punonjësve ka qenë 45 punonjës, nga 48 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur.

Shpenzime operative të miratuara për Institucionin tonë kanë qenë në vlerën 15,744,800 lekë dhe në fund të vitit niveli i realizimit të shpenzimeve operative rezultojnë në nivelin 96 përqind përkundërsht planit. Për vitin 2012 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e faturave për energji elektrike, ujë, komunikim telefonik (Albtelecom, vodafon, AMC), internet, abonime në gazeta, shërbim postar, karburant, pjesë këmbimi automjetesh, shpenzime siguracioni, dieta brenda e jashtë vendit, shërbime mirëmbajtje fotokopje e printera, shpenzime pritje-përcjellje të delegacioneve të huajve, blerje kancelerie, mjete pastrimi. Theksojmë se pjesa dërmuese e shpenzimeve për Institucionin tonë kanë shkuar për udhëtim e dieta, karburant e kanceleri.

Në tetor të vitit të shkuar, për herë të parë në Tiranë nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Avokatit të Popullit, u mbajt në Tiranë në prag të 100- vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, Konferenca e Ombudsmanëve të vendeve Frankofone. Për përballimin e shpenzimeve që lidhen me mbarëvajtjen e aktivitetit, Institucionit të Avokatit të Popullit me VKM nr.394, datë 20.06.2012, iu akorduan 2.74 milion lekë, të cilat u përdorën për realizimin e suksesshëm të konferencës dhe

pikërisht për marrjen me qera të sallës së konferencës, pritjen dhe përcjelljen e delegacioneve, sigurimin e materialeve logjistike, si dhe për trajtimin ushqimor të anëtarëve të delegacioneve. Në këtë eveniment morën pjesë rreth 40 delegacione nga vende të ndryshme të botës.

Gjithashtu, duke qenë anëtare e organizatave ndërkombëtare si Association des Ombudsmans et Mediateurs de la Francophonie (AOMF), European Ombudsman Institute (EOI), Association of Mediterranean Ombudsmen (AMO), International Ombudsman Institute (IOI), një pjesë e buxhetit është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që lidhen me kuota anëtarësimi, të cilat janë kryer në kohën e duhur dhe që pasyrohen sipas tabelës më sipër .

Përsa i përket zërit të investimeve për vitin 2012, është realizuar në nivelin e planit, pra në nivelin 100 përqind. Me buxhetin e akorduar për investimet (shiko tabelën e mësipërme) është shpenzuar për punime jashtë godine 595,004 lekë (rampe për invalidet, si dhe një investim që lehtëson komunikimin e qytetarëve në Institucion, hyrje e re) dhe 904,574 lekë (pajisje).

Në vijim po paraqesim në forme grafike buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën 2008-2013 (plan).





Tabela në vijim paraqet buxhetin e institucionit të Avokatit të Popullit, për vitet 2008 -2013 (plan në raport me pbb-në) sic lexohet lehtësisht, nga grafiku , buxheti i Avokatit të Popullit në raport me prodhimin e brëndshëm bruto, ka pësuar rënie, nga nga vit në vitë (perjashto 2013). Në krahasim me vitin 2008, buxheti i Avokatit të Popullit për vitin 2013 (plan) rezulton të jetë, 2.2 pikë më pak , nderkohe që ngarkesa e punës është rritur ndjeshëm, por edhe obligimet ndaj procesve integruese, kërkojme medoemos mbështetje me të madhe financiare.Kerkesa per shtese ne fonde lidhet edhe me mbeshtetjen e Bashkimit European. Në takimin e IV-tët, Këshillit të Stabilizim dhe Associmit , Bashkim European – Shqipëri, nga ana e BE, theksohet mbi “... nevojën për alokimin e burimeve të mjaftueshme për zyrën e tij” (AP), fq 6



3. Statistika përmbledhëse e vitit 2012

Gjatë vitit 2012 institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 5165 ankesa, kërkesa dhe njoftime prej të cilave 4244 janë ankesa të regjistruara në vitin 2012, 330 kanë qenë të mbartura nga viti 2011 dhe 591 janë ankesa të cilave u është dhënë përgjigje menjëherë nga ekspertë të Drejtorisë së Pritjes së Qytetarit pranë Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe në Zyrat Rajonale në Shkodër dhe Fier, ndërsa 577 ankesa janë mbartur për shqyrtim në vitin 2013.

Duke u mbështetur në Rezolutën e Kuvendit për Raportin Vjetor 2011, gjatë vitit 2012 Institucioni ka rritur numrin e çështjeve të shqyrtuara me iniciativë. Rezulton se gjatë vitit 2012 numri i çështjeve fillimi i hetimit të të cilave mbështetet në nenin 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” ka arritur në 195.

Në ushtrim të detyrave të tij, Avokati i Popullit ka vijuar kryerjen e inspektimeve në institucionet publike dhe autoritetet administrative, duke u fokusuar kryesisht në institucionet ku ndodhen persona të cilëve u është e kufizuar bazuar në akte vullneti të organeve kompetente shtetërore (paraburgim, burgje, spitale psikiatrike etj), si dhe në qendrat rezidenciale për fëmijë (shtëpitë e fëmijës), qendrat rezidenciale për të moshuarit etj.

Në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore e Poshtërore (OPCAT), gjatë vitit 2012, Avokati i Popullit ka kryer 125 inspektime në funksion të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Numri i inspektimeve është reduktuar në krahasim me ato të kryera gjatë vitit 2011, duke realizuar inspektime më të pakta por më cilësore e më të thelluara, kjo në përputhje me Rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011”, projektin Danez, i cili ka rekomanduar realizimin e inspektimeve më të thelluara. Për më tepër duke e koordinuar veprimtarinë tonë monitoruese me shoqërinë civile ne synojmë të përdorim burimet njerëzore dhe ekspertizën më të mirë për të realizuar inspektime të përbashketa më të thella dhe më cilësore.

Trajtimi i ankesave drejtuar Avokatit të Popullit

Gjatë periudhës së raportimit kanë përfunduar së shqyrtuari gjithsej 3965 ankesa, nga të cilat ka rezultuar se 409 ankesa ose 10 % e tyre kanë qenë jashtë juridiksionit dhe 898 ankesa ose 22 % e tyre kanë qenë jashtë kompetencave të Avokatit të Popullit. 863 ankesa ose 22 % kanë rezultuar te pabazuara. Në total rezultojnë 2170 ankesa që ngrenë pretendime të cilat nuk mund të shqyrtoheshin prej institucionit të Avokatit të Popullit ose për të cilat organet e administratës nuk kanë përgjegjësi. Në këtë grup përfshihen ankesat që kanë të bëjnë me vendimet gjyqësore, çështje apo konfliktet private të pronësisë, etj. Për këto raste ankuesit janë orientuar dhe këshilluar për rrugën ligjore që duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemeve që parashtronin.

Nga numri total prej 3965 ankesash të regjistruara, duke zbritur 2170 ankesat që bëjnë pjesë në grupin e shpjeguar më sipër, rezulton se Avokati i Popullit ka shqyrtuar në themel 1795 ankesa, prej të cilave 1368 ose 76% janë zgjidhur në favor të ankuesve gjatë procedurave të hetimit dhe ndërmjetësimit, pa lindur nevoja për t'ju drejtuar organeve të administratës publike me rekomandim zyrtar.

Për ankesat të cilat nuk janë zgjidhur gjatë procedurës së hetimit dhe ndërmjetësimit, janë bërë 402 rekomandime dhe propozime për zgjidhje, drejtuar organeve të ndryshme të administratës publike prej të cilave 75 janë refuzuar. Rezulton të jenë pranuar plotësisht 238 rekomandime, 34 rekomandime janë ende në proces zbatimi, ndërsa për 55 rekomandime Avokati i Popullit ende nuk ka marrë përgjigje, ndonëse rekomandimi është ridërguar duke i rikujtuar organit të administratës publike detyrimin ligjor për tu shprehur në lidhje me rekomandimin. Pavarësisht mungesës së përgjigje, ankesat vazhdojnë të ndiqen dhe do të përdoren të gjitha rrugët ligjore dhe kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit për të bërë të mundur rivendosjen e të drejtës dhe/ose pushimin e cënimit.

Rezulton gjithashtu se në 114 raste, ose 3 % të numrit total të ankesave të regjistruara, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit.

Për sa i përket 577 ankesave të kaluara për shqyrtim në vitin 2013, nuk ka qenë e mundur të hetohen dhe përfundohen brenda vitit 2012 për shkak të depozitimit në periudhën e fundit të viti si dhe mosdhënies së informacionit apo moskthimit përgjigje për rekomandimin nga organet e administratës publike, brenda afateve ligjore.

Zbatimi efektiv i ankesave dhe rekomandimeve të pranuar të Avokatit të Popullit.

Për të vlerësuar zbatimin efektiv të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Qendra për Zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve përgatiti një studim, gjatë të cilit ka kryer një sondazh mbi 400 dosje, duke telefonuar personalisht subjektet ankues. Gjatë këtij sondazhi ka rezultuar se 58 % e rekomandimeve apo ankesave të pranuar janë zbatuar plotësisht, 13 % ishin në proces zbatimi, 2 % ishin zbatuar pjesërisht, 23 % nuk ishin zbatuar ndërsa për 4% palët nuk dhanë informacion. Rezultatet e detajuara të këtij sondazhi mund ti gjeni në kapitullin tre të këtij raporti.

GRAFIKET ILUSTRUES

Tabelat në vijim japim në mënyrë grafike një informacion, rreth çështjeve që janë trajtuar gjatë vitit 2012, nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Viti 2012 shënoi numrin më të madh të ankesave (ankesa, kërkesa dhe njoftime) të paraqitura në Institucionin e Avokati të Popullit që nga fillimi i funksionimit të tij, përpara 12 vjetësh, plot 5165 ankesa nga të cilat 330 janë të mbartura nga 2011 dhe ka vijuar te shqyrtohen gjatë vitit 2012.







Tabela e mëposhtme jep në mënyre grafike informacion mbi mënyrën se si janë trajtuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit ankesat adresuar Institucionit tonë, ndër të cilat respektivisht 58% kanë rezultuar brenda mandatit të Avokatit të Popullit, 17% janë konsideruar jashtë kompetence dhe qytetarët janë orientuar nga punonjësit e specializuar, 8% ndaj totalit janë ankesat të vlerësuara nga ekspertët tanë jashtë juridiksionit, dhe në 7% të ankesave, qytetarët janë këshilluar drejtëpërdrejtë nga ekspertët tanë. 16% e ankesave , nga ekspertet tane jane konsideruar te pabaza.




Ndarja e ankesave sipas mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes



Mënyra e zgjidhjes së ankesave brenda juridiksionit dhe kompetencës gjatë 2012




Krahasimi i ankesa brenda juridiksionit e të zgjidhura për vitet 2000-2012




Grafikët e mëposhtëm tregojnë rrethet nga të cilat vijnë qytetarët që kanë paraqitur rastet e tyre në Institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe reflektojnë shpërndarjen e trajtimit të ankesave sipas seksioneve të Institucionit, shpërndarjen e tyre sipas të drejtës së shkelur, si dhe ndarjen sipas ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të administratës publike në vartësi të tyre.

Shpërndarja e rasteve të regjistruara gjatë vitit 2012 sipas rretheve







Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2012 sipas të drejtës së shkelur



Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2012 sipas institucioneve



Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2011, nënvizonte nevojën për uljen e rasteve, që konsiderohen jashtë kompetencë dhe jashtë juridiksionit. Duke reflektuar rreth këtij opinioni Avokati i Popullit, nisur edhe nga rekomandimet e misionit Euralius, e adresojë këtë problem, duke adaptuar strukturën e institucionit dhe krijuar një Drejtorin e Shërbimeve ndaj Qytetarit, por edhe me urdhëra të brendshme specifike. Grafiku në këtë rast “flet vehte”, rastet jashtë juridiksionit (A3) dhe jashtë kompetence (A2), prej muajit shtator shënojnë një rënie sistematike.



Shtojca I

A. Rekomandime legjislative

I. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

1. **Rekomandim për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit** nr.10289, datë 17.06.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetëm në krye apo për shkak të detyrës”, duke i dhënë fuqi prapavepruese e shtrirë efektet e zbatimit të tij që nga data 01 Janar 1991.
2. **Rekomandim**, në zbatim të ligjit nr 9389, datë 4.05.2005, “Për krijimin dhe funksionimin e keshillit kordinues në luftë kundër fenomenit të gjakmarrjes”, hartimi i tre projekvendimet që lehtësojnë zbatimin e ligjit të lartëpërmendur

II. Seksioni i Administratës

Rekomandim për nxjerrje aktesh nenligjore për te permbyturit ne Shkoder.

1. **Rekomandim** për hartimin e Projekt-Ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme” në referim me nenin 5 të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave” dhe kalimin për miratim në Kuvënderin e Shqipërisë,
2. **Rekomandim** që në aktet ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit financiar ish pronarëve, të gjejë zbatim të saktë dhe të plotë Vendimi Unifikues nr.6, datë 24.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
3. **Rekomandim** për ndryshimin e Udhëzimit nr. 02, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”

III. Seksioni i Përgjithshëm

Rekomandim për hartimin e akteve nenligjore, “Për ushtrimin e nismës për plotësimin e nenit 29 të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” Ministrisë së Financave

1. **Rekomandim**, “ Për nxjerrjen e aktit nenligjor në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr.9128 date 29.07.2003 “Per nje trajtim te vecante financiar te piloteve fluturues, ne pension”, i ndryshuar. Ministrise se Financave, Ministrise se Brendeshme , Presidentit (miratuar)
2. **Rekomandim , amendim ligjor** “Për ndryshim në Ligjin nr.7961 date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.(ne favor LGBT) **Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**
3. **Rekomandim**, akt nenligjor, “Për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të komu-

nitetit Rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual. Kemi propozuar që në Ligjin Nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, të parashikohen dispozita tranzitore të kufizuara në kohë, të cilat të konsiderohen si masa të veçanta të përkohshme për këtë komunitet, me synimin e integritit të tyre social. Ministrit të Brendshëm.

4. **Rekomadim, akt nenligjor,** “Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787/2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike” (i ndryshuar). **Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.**
5. **Rekomandim,** për ndryshimin e Ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar) Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit,
6. **Rekomandim, ndryshim legjislativ, per** përfshirjen e veprave penale me natyrë politike të ligjit 1138 te vitit 1950, në nenin 5 të ligjit nr.9831, dt.12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik të regjimit komunist”, (i ndryshuar). Ministrise se Drejtesise
7. **Rekomandim,** akt nenligjor, per marrjen e masave për përgatitjen dhe miratimin e VKM për dhenien e dëmshpërblimit për periudhën e internimit. Ministrise se Financave dhe Ministrise se Drejtesise
8. **Rekomandim, ndryshim ligjor,** per nje shtese ne ligjin per te drejtat e femijeve Ministrise se Financave, MPCSSH

IV Seksioni i Veçantë

1. **Rekomandim,** Për ndryshimin dhe permiresimin e nenit 450 te Kodit te procedures Penale-pranuar drejtuar Ministrise se Drejtesisë
2. **Rekomandim** “Për ngritjen e shkolles së riedukimit për personat, që nuk kanë përgjegjesi ligjore – pa përgjigje drejtuar Ministrisë së Drejtesisë

B. Në tre raste i jemi drejtuar Gjykatës Kushtetuese

1. Kundër aktit normativ “Për lirimin e banesave te ishpronareve”
2. Kundër ndryshimeve ne “Per statusin e te verberit”
3. Kundër ndryshimeve ne ligjin “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tretraplegjik”